

SKENDER JASĀ



Rrezja e padukshme

Roman

8/4 - 31
J 34

SKËN D E R J A S A

*Rrezja
e
padukshme*

roman

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAPITULLI I

Rrezarti lëvizte pincetën e saldimit të elektrogenit me ngadalë duke i qepur me tegel rripat e kurbuar prej çeliku që formonin sferën. Njëra nga këto, e salduar plotësisht, shembellente si një glob i stërvogëluar, i ndarë në meridiane. Shkëndijat që binin në çelik kthehen prapa dhe si fishekzjarrë, me një larmi ngjyrash, përhapeshin përreth. Saldatori, i dashuruar me mjeshterinë e tij, përpiquej të ruante gjaktohtësinë që të mos i dridhej asnjë nerv i dorës e i krahut. Çdo tronditje, sado e vogël, shkaktonte pore e deri zgavra gjatë saldimit. Këto avari mund të krijonin katastrofa, se brenda sferës do të kishte presion të lartë.

Përbri Rrezartit, me të njëjtin ritëm, saldonte në sférën prej çeliku edhe usta Sala. Ai mbahej si saldatori me duar të arta që nuk kishte lënë fabrikë e kombinat të ri pa marrë pjesë në montime. Me një lëvizje të kokës të mbuluar nga maska mbrojtëse, herë pas here i bënte shenjë shokut ngjitur që të mos shpejtohej. Duhej të qepnin tegelin mbi çelik që të dy në të njëjtën kohë.

Rrezarti hoqi maskën e saldimit nga fytyra dhe dorën

e lirë e zgjati nga supi i ustait. I rrahu dy a tri herë miqësish me pëllëmbë sa supin e sa qafën e përkultur. Kjo ishte shenja se ai e ndërpriste punën pér atë natë.

— Si thua, o shkencëtar, e lëmë pér sot? — ia priti usta Sala duke qeshur me shokun dhe atë çast pérplasi pincetën e elektrogjenit në një copë hekur. Një tufë shkëndijash e rrethuan Rrezartin. Ai e ngiste djaloshin, e thërriste shkencëtar, sepse Rrezarti kishte ndër mend të përgatiste një aparat me rreze të padukshme pér të gjetur defektet e saldimit në brendësi të metaleve.

Mjeshtri plak iu afroa sferës së çeliktë dhe, si i ra asaj me grusht dy a tri herë, vazhdoi:

— Po hë, or shkencëtar, kur do të na e shpikësh atë aparatin që të shikojë brenda, në zemrën e çelikut, se si e kemi qëndisur ne ngjitjen?

— Ti mendon se ato rrezet e padukshme, pér të cilat të kam folur unë, janë përrallë? — e pyeti Rrezarti duke e vështruar në sy.

— Nuk di unë nga ato, o Rezi. Derisa nuk i kam parë me sy, nuk them as kështu dhe as ashtu. Po të shpikësh atë aparatin, unë të heq kapelen. — Ai hoqi beretën nga koka dhe u përul para shokut sikur ai t'ia kishte arritur qëllimit.

— E atëherë mos thuaj të heq dorë nga studimet universitare, — i tha befas Rrezarti, — sepse pa dije të thella nuk shpiket ai.

— Zanati, byzlyk floriri, o Rezi. Edhe pa shkollë të lartë të tjerët po bëjnë shpikje dhe racionalizime, bile po marrin edhe çmimë republike.

— Por shpikje si këto me rrezet e padukshme, o usta, nuk bëhen pa shkollë të lartë. Dhe, ja ku po ta përsëris prapë se nuk do të heq dorë nga fakulteti.

— Ndoshta e mas me kutin tim që, po të lexoj dy faqe libri, nis e më dhemb koka. Po pate takat, jepi, ore vëlla, që ç'ke me të. Portat i ke të hapura. Fundi, edhe po nuk gjete vend pér fizikan, shkollën e ke pér vete. Eja tanë, do të vish, se ika unë... Më pret një shok pensionist në lulish-ten «Kurora e pishave» pér të pirë racionin e rakisë.

Usta Sala s'i kishte mbushur të pesëdhjetëepesë vjetët, po e ndiente veten të plakur e të lodhur. Pas njëzet e katër vjet pune si saldator, ai kishte arritur të humbte cilësitë e një saldatori të kategorisë së lartë. Duart herë-herë i dridheshin dhe ai e kuptonte se alkooli po e bënte punën e tij. Disa ditë më parë vendosi t'i thoshte drejtorit të fabrikës që ta largonin nga puna e saldatorit, por hoqi dorë nga ky mendim kur dëgjoi sekretarin e organizatës-bazë të partisë që tha se duhej të dorëzonin linjën e re të fabrikës brenda vitit. Lu duk sikur po dorëzohej.

— Kemi bërë punë sot dhe jo shaka. Ma ha mendja që enët e gazit ne i përfundojmë nga fundi i javës, por montimi i sistemit të sprucatorëve të furrës tunel është prapa, — tha usta Sala dhe u nis të shkonte.

— Prit, usta, se do të vij dhe unë të lahem. Do të qëndroja dhe ca, por sonte përvèç leksionit në fakultet më duhet të studioj një kapitull të vështirë të fizikës bërthamore, reaksionin zinxhir të zërthimit bërthamor të atomit...

U lanë, u çlodhën, u ndërruan dhe dolën së bashku.

— Natën e mirë, Rrezja e Padukshme, — thirri usta Sala kur u ndanë diku afër derës dhe i shkeli syrin. — Ruaje thëllëzën, se mos të fluturon, — shtoi ai, duke treguar me kokë pragun e derës. Atje po qëndronte një vajzë e veshur me pantallona. Ishte mbështetur te kolona dhe dukej sheshit se dikë po priste.

— Mirëmbrëma, Merita! — i tha Rrezarti dhe i zgjati dorën.

— Mirëmbrëma! — u përgjigj ajo buzëqeshur duke hedhur flokët e zinj si mëndafsh i nderë në diell prapa shpine. Fjalët nuk dëgjoheshin nga zhurma e trenit, po merreshin me mend nga lëvizja e buzëve. Ajo ia shtrëngoi dorën djaloshit dhe atë çast ndjeu një drithërimë që i përshkoi trupin.

— Mos ke ftohtë? — e pyeti Rrezarti.

Ajo qeshi, duke zbuluar para vështrimit të tij fytyrën vezake të hijshme e tërheqëse me atë gojën e saj të vogël dhe dhëmbët e bardhë e të rregullt.

— Kam një copë herë që të pres, — i tha ajo. — U bë vonë për shkollë.

— Ngadalë, or bij, ngadalë, — u tha xha Marku, roja e fabrikës, kur i kaluan vetëtimthi para syve. — Ç'më kalloni kështu si «rrezja e padukshme...»

— Natën e mirë, o veterani i dy luftërave, — ia pati një punëtor trupngjeshur që mbante nën sjetull një violinë me këllëf të rrjepur në dy cepat.

— Nuk më mbushet mendja se fatin e luftës së tretë, në qoftë se ndodh, e vendos ajo «rrezja e padukshme», or Rrezart, — e shpotiti rishtas plaku.

— E kush të tha ndryshe, o xha Mark? Fatin e luftës e vendos zemra e ushtarit, e vendosin popujt dhe revolucioni, — iu përgjigj në të ikur Rrezarti, duke buzëqeshur.

— Edhe unë de ashtu ju them, or djem, se e kam provuar në lëkurën time, — thirri roja duke hapur krahët.

I tërë grupi i punëtorëve u derdhën rrugës së asfaltuar që dukej si tunel nga plepat e rritur në të dy anët, kurorat e të cilëve preknin njëra-tjetren. Gjethet e zverdhura në ngjyrën e ndryshkut dridheshin si fletët e harabellave në fluturim nga era e shirokës që nisi të frynte. Dhe retë si copa pëlhure davariteshin nga jugu. Si pa vëtëdije trumbat e djemve dhe të vajzave nisën të ndaheshin dy e nga tre sipas shkallës së njohjes dhe bisedave që u interesonin. Rrezarti dhe Merita mbetën ca më prapa nga të tjerët. Arti, ai violinisti diletant, ktheu kokën duke u hedhur një vështrim kuptimplotë. Ai e kishte kuptuar prej kohësh se diç «lëvrinte» midis tyre dhe kjo ishte shndërrimi i miqësisë në hapat e parë të dashurisë që **vinin ashtu si maji pas prillit**. Derisa mbërritën në stacionin e autobusit që ishte nja njëqind metra larg fabrikës, Rezi dhe Merita mundën të këmbenin disa mendime të shkëputura nga takimet e tyre të mëparshme.

— Pavarësisht nga ajo që tha përgjegjësi i fabrikës se nuk i nevojiten fizikanët, ti, Rezi, nuk duhet të heqësh dorë nga provimet e mbrojtjes së diplomës, — i tha Merita dhe e vështroi në sy sikur donte t'ia impononte mendimin e vet.

— Të them të drejtën, me ato debate që kanë shpërthyer në katedër për temën e diplomës, më është ftetur kjo

punë. Më duket ndonjëherë sikur ustai ka të drejtë. — Rrezarti ia tha mendimin e tij duke shikuar diku larg.

— Jo, ti nuk duhet të heqësh dorë nga shkenca, — tha e vendosur Merita me një pamje paksa të trishtuar.

Ajo e zuri nga krahë.

— Më mirë është të qëndroj kështu siç jam, sesa të fluturoj pa krahë qiellit të errët. Atë çast me një buzëqeshje të hidhur vështroi Meritën, pastaj ia hodhi asaj dorën në qafën e gjatë e të nxirë nga dielli. Më kot u mundua të sillte ndër mend se në cilin libër e kishte lexuar këtë shprehje.

— Ti po flet si një idealist pesimist, — ia pat befas Merita dhe, duke mos ia shqitur shikimin, vazhdoi: — Neve na jep krahë Partia bile të fluturojmë në ato skuta të tokës e të qiellit ku nuk ka shkelur njeri tjetër.

Ata nuk patën më kohë të shkëmbenin biseda të tjera, se autobusi i gjatë fizarmonikë «Shkodra», doli në kthesë dhe qëndroi në stacion. Merita e para dhe pas saj Rrezarti rendën drejt autobusit ku shokët e shoqet po ua bënin me dorë që të afroheshin. Rrezarti çau përmes turmës dhe hi- pi më parë në shkallën e autobusit. Një çast Merita mbajti këmbët, se aty para saj parakaluan me shpejtësi, si një turmë dallëndyshesh, disa të rinj me bicikleta. Ajo, kur pa Rrezartin që shtriu dorën për ta ndihmuar që të hipte në autobus, e shtoi vrapi dhe sakaq dora e Rrezartit shtrëngoi të sajën dhe e tërroqi si pupël brenda. Ata u gjendën përballë njëri-tjetrit pothuajse puthitur gjoks më gjoks. Rrezit i endej në fytyrën tërheqëse dhe në sytë e ndezur bu- zëqeshja e dashurisë.

Kur autobusi nisi të ecë dhe nga ndryshimi i shpejtësisë masa e njerëzve u tronditën (Rrezarti me Meritën u përplasën trup më trup nja dy a tri herë), dikush aty prapa tyre tha:

— E ka fajin Ligji i inercisë i Njutonit.

Rrezartit atë çast iu përfyrua figura e asistente Sofijes që pas leksionit në auditor, ishte përpjekur t'ia bënte akoma më të qartë teorinë e relativitetit të Ajnshtajnit. Edhe herë të tjera pedagogjia e re e katedrës së fizikës bërt

thamore kishte treguar përkujdesje të veçantë për ta ndihmuar atë në përvetësimin e lëndëve teorike të fizikës bërthamore.

— Ku të iku mendja? — i tha befas Merita kur e pa ashtu të kredhur në mendime.

— Teoria e relativitetit dhe fizika klasike, — buzëqeshi si i druajtur Rrezarti. — Sonte kemi përsëri leksion për këtë temë.

— Oh..., — psherëtiu Merita, — ti i ke hyrë thellë shkencës, unë këtë e marr me mend... po kjo shkenca e madhe a mundet të përmirësojë cilësinë e prodhimeve tona, si ato tullat e kuqe, çimenton, betonet...?

Rrezarti qeshi në vetvete dhe, duke menduar naivitetin e saj, me një shprehje të papërcaktuar, mblođhi supjet dhe belbëzoi.

— E ku hyn Ajnshtajni te tullat?

Merita rrudhi buzët dhe heshti një copë herë pa ditur ç'të thoshtë, por, kur pa se autobusi po i afrohej stacionit, ia pati befas:

— Dëgjo, Rrezart, me ne bëj atë shkencë që i shërbën përsosjes së teknologjisë së prodhimit, kurse atë shkencën e madhe bëje me atë asistenten e katedrës, Sofijen...

Rrezarti mbeti atë çast si i ngurosur dhe i habitur plotësisht, pa ditur si t'i përgjigjej. Por autobusi kishte qëndruar në stacion dhe Merita papritmas ishte shkëputur prej tij.

— Lamtumirë, Rrezart!

Rrezarti, kur u përmend, nuk pati kohë të përgjigjej, por me zemër të lënduar tundi dorën nga xhami i autobusit për t'i kthyer përshtëndetjen. I erdhi inat me veten që u tregua pa takt dhe mendjemadh, gjëra që ai i urrente të tjerët. A nuk ishte ai, që mendimin thelbësor të revolucionit tekniko-shkencor për t'u kapur pas atyre hall-kave shkencore në dobi të prodhimit e kishte argumentuar e zbërthyer në dy raste në konferencat e mbajtura në fakultet? Pavarësisht se Merita ia tha të thjeshtësuar, por në esencë ajo shprehu atë që ishte e vërtetë. Rrezarti tanë po e kuptonte më qartë se gjatë këtyre dy viteve të fundit që

ai ndiqte fakultetin pa shkëputje nga prodhimi, ngaqë ishte i zënë me studimet e lëndëve të vështira e ndoshta edhe nga ndonjë arsyet tjetër që mund të kishte Merita që ai nuk e kuptonte, marrëdhëniet e tyre të dashurisë sikur ishin zbehur. Bile një ditë ajo ia kishte thënë copë: «Dashuria jonë po shuhet dhe le të mbetemi shokë...» Por ai e kishte qortuar dhe ishte përpjekur ta bindte që të hiqte dorë nga ai mendim mikroborgjez se gjoja po ftoheshin nga dissiveli kulturor midis tyre. Por ja që ky mendim çonte prapë kryet dhe e shqetësonte ndërgjegjen e tij.

Rrezarti ishte ulur në një karrige nga mezi i autobusit dhe me vështrim nga xhami i drifores, i menduar parakalonte pallatet që sa vinin e shtoheshin. Pjesa më e madhe e shokëve të fabrikës kishin qëndruar nëpër stacionet dhe i fundit që e përshëndeti me dorë nga cepi i autobusit ishte Arti. Kur ai doli Jashtë, u afroa te xhami dhe përsëri i bëri me shenjë duke i rënë xhamit me këllëfin e violinës. Rrezarti i buzëqeshi dhe me përtim lëvizi dorën një copë herë sikur po fshinte xhamin. Pa ditur qysh, iu përfytyra koha e disa viteve më parë... Ai, pasi kishte përfunduar lëndët e katër vjetëve, tani përgatitej përmbrojtjen e diplomës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës për degën e fizikës bërrhamore. Kishte rrjedhur shumë ujë gjatë këtyre viteve dhe nuk e kishte pasur të lehtë të arrinte deri këtu. Drejtoria e fabrikës në fillim i nxori pengesa, hezitoi të jepte miratimin që të ndiqte studimet e larta në fizikë, pasi kjo degë s'përputhej me profilin e qendrës së punës. Mirëpo me ndërryrjen e organizatës-bazë të partisë dhe pasi çështja u diskutua edhe në kolektiv, u vendos që për talentin që ai kishte në matematikë e fizikë qysh nga provat e maturës, t'i jepej e drejta e studimit në këtë fushë. Bile shokët e tij të ngushtë treguan edhe pasionin e veçantë që kishte Rrezarti për të studiuar rrezet radioaktive dhe përdorimin e tyre në dobi të prodhimit. Qysh atëherë shokët nisën ta thërrisinin «Rreza e padukshme», sepse ai në bisedat e zakonshme përdorte batutat që lidheshin me këto lloj rrezesh, për të cilat aq shpesh shkruanin revistat.

Rezarti zbriti nga autobusi në stacionin mu përbalilë fakultetit. Me çantën në dorë doli në anën tjetër të rrujës dhe qëndroi një çast te fundi i shkallëve duke hedhur një shikim të shpejtë nga stema mbi derën e madhe kryesore të godinës «UNIVERSITETI I TIRANËS-FILIALI I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS». Pastaj pa derën e hapur dykanatësh. Disa studentë e studente hynin e dilnin.

Nisi të ngjiste shkallët e lërendashme të fakultetit. Përkrah tij hynin në auditor edhe ca shokë e shoqë të vonurara. Njëri prej tyre, kur po hynin në sallën që i përngjante një amfiteatri e përshëndeti me kokë. Ishte një punonjës shkencor i Laboratorit Bërthamor D6, me të cilin që njojur ca kohë më parë.

Rezarti qëndroi një copë herë duke kërkuar me sy në atë mori dëgjuesish ndonjë vend bosh. Një shoku i fizikan, pasi e përshëndeti me kokë, i bëri me shenjë që aty afër tij, mjerisht, nuk kishte vend bosh. Pastaj ai zbriti edhe dy shkallë më poshtë. Menjëherë i zuri syri andej nga rreshti i dytë i auditorit Sofjen, që, e lthyer me kokë nga prapa, tundte dorën dhe bënte gjeste duke e ftuar që të shkonte pranë saj në një karrige bosh. Si çau rreshtin e studentëve, arriti tek asistentja. Sofija zgjati dorën dhe e gëzuar ia shtrëngoi miqësisht.

— Kujtova se nuk po vjen sonte, — i tha ajo me një ton të dashur duke i bërë vend aty pranë vetes.

— U vonova ca, se duhej të saldoja patjetër kupolën e një sfere çeliku. Kemi marrë zotim me rastin e Festës së Çlirimtë përfundojmë linjën e re. Patjetër do të vija. Më intereson kjo temë që zhvillohet sonte, — i tha saldatori pa ia hequr sytë fytyrës së saj të rregulluar nga një tualet i lehtë.

Sofija, e lthyer skic nga ai, i hodhi një vështrim duke ngritur me ngathtësi qepallat.

— Edhe sivjet... e pastaj lartumirë, jetë e saldatorit. Ju pret puna fisnike, shkenca! — Fjalës së fundit Sofija i mëshoi më shumë dhe befas shtoi: — Nuk do të vonoheni më, se do të jemi gjithnjë bashkë në katedrat e universitetit e kabinetet eksperimentale të laboratorëve.

Vështrimi i saj atë çast u ndesh me vështrimin e hutar të Rrezartit. Ai i buzëqeshi me një mendim të papëraktuar.

Një dëgjues, dy vende më tutje Sofijes, një tip i pis-pillosur, herë pas here zgjaste në njëfarë mënyre kokën nga ata, duke përgjuar me një ndjenjë të hapur xhelozie Rrezartin dhe asistenten që këmbezin aq miqësisht biseda me zë të ulët e kokë më kokë. Shikimi i tij, si u përplas me atë të Rrezartit, qëndroi pak sekonda të sytë e Sofijes. Dhe ajo për mirësjellje iu përgjigj me një lëvizje koke të lehtë buzëqeshjes së tij të pështirë.

— Është një koleg pune në një katedër të fakultetit. Një mostër enigmatike, — i tha befas Sofija duke afuar buzët të veshi i tij.

Salla gumëzhinte si koshere bletësh, por në çast si me magji u vendos heshtja dhe e tërë salla u ngrit në këmbë.

— Erdhi profesor Gurra, — tha Rrezarti i kënaqur.

— Edhe fizionominë e ka ashtu siç është, një fizikan i madh, — i tha Sofija në vesh Rrezartit. — Por, si teoricien me fantazi profesor Koti qëndron më lart, — shtoi ajo befas.

Rrezarti e pa asistenten me një ndjenjë dyshimi. Ai ndiente një simpati të veçantë për profesor Buronin, sidomos pas takimeve të fundit me të për përcaktimin e temës së punimeve të diplomës. I dukej me brumë dhe i kapshëm, kurse profesor Koti i dukej abstrakt dhe deri diku i huaj. Pasi bloi me vete mendimin, u kthye nga Sofija dhe i tha:

— Unë simpatizoj profesor Buron Gurrën. Sa për fizionominë e tij, me të vërtetë duket sikur i shembellen lëndës së fizikës. Njoh babanë e një shoku, një poçar i vjetër, që, kur ecën, duket si qyp balte që ecën, — qeshi ai.

— Një krahasim interesant, — belbzëroi Sofija. — Ti ke një dell poetik, — shtoi ajo papritur.

— Them se një shkencëtar i vërtetë krijues duhet të ketë edhe shpirt prej artisti, — iu përgjigj me zë të ulët Rrezi duke u përkulur pakëz nga ajo.

— Si duket shpirtin e ke si emrin... rreze e artë. — Sofija lëvizë qepallat dhe ia nguli sytë. Papritmas Rrezartit nisi

t'i rrihte pulsi me hope, se nuk dinte qysh të mendonte, po ta pranonte këtë shprehje si ndjenjë të një dashurie të fshehtë, ai tradhtonte Meritën. Për një çast ai e mori inat vreten dhe u dha njëfarë të drejte dyshimeve e ftohtësisë që tregonte e dashura e tij, Merita. Rrezi heshtte i kredhur në mendime. Kurse Sofija bënte nga bënte e me një farë guximi të papërmrbajtur sodiste qenien e tij, qafën e gjatë bojë gruri e muskuloze, krahët e fuqishëm, sytë e zez e të ndritshëm, gjymtyrët si të skalitura në fytyrën e rrumbullakët me një farë koniciteti të lehtë nga mjekra dhe me një shprehje ca të ashpër. Rrezarti kishte një trup të lidhur e të zhdërvjetllët, me një gjatësi mbi mesataren e zakonshme të burrave. Ajo e dinte se ai kishte hyrë në të njëzetepesat, por, kur bënte kahasimin me moshën e saj, i dukej ku e ku më i madh se ajo, jo nga vitet, por nga përvoja e jetës. Rrobat e thjeshta që ai mbante (vishej me modestinë e një punëtori të thjeshtë) dhe pamja e tij pak e ashpër, sikur ia ngacmonin shpirtin e butë asaj vajze të rritur brenda mureve të shtëpisë komode të një historiani të vjetër dhe brenda kabineteve universitare. Dhe, këtë ndjenjë ajo nuk ia fshihte dot vetes. Përpiquej të zbulonte te Rrezarti të fshehet e shpirtit të tij; nëse ato shprehjet e miqësisë që tregonte ai kundrejt saj ishin ndjenja miqësie e mirënjohjeje për ndihmën që ajo i jepte si asistente në ndjekjen e universitetit, apo se në zemrën e tij ndoshta kishte nisur të lulëzonin ndjenjat e para të dashurisë për të.

Profesor Buron Gurra, i ulur në tryezën e rëndë të zë prej druri arre para auditorit, kishte një copë herë që gërmonte fijet e letrave në një dosje dhe dukej sikur diçka i kishte humbur. Dhe jepte përshtypjen sikur të kishte harruar se para tij prisnin rreth dyqind studentë, asistentë, pedagogë të fizikës, biokimisë, të kimisë, të shkencave biologjike, madje kishte midis tyre, përvëç matematicienëve, edhe ca pedagogë të filozofisë, të historisë e gjeografisë. Nuk mungonin në këtë leksion edhe ca inxhinierë të prodhimit e punëtorë të pararojës, shpikës e racionalizatorë që nuk hiqnin dorë, krahas eksperimentimeve praktike, edhe nga studimet autodidakte të teorive të reja shkencore. Më në fund profesori ngriti kokën nga dëgjuesit dhe qëndroi

disa sekonda duke vështruar si i hutuar rreth e rrotull auditorit. Kur u ngrit në këmbë, u duk më qartë portreti i tij; një burrë rreth të gjashtëdhjetave, me një trup të gjatë pak të kërrusur, thatim, me fytyrë të rrudhur e të zbehtë si fletë duhani dhe me ca flokë të rrallë. Me një buzëqeshje të ngrirë vazhdonte të qëndronte i heshtur dhe i menduar, sikur hidhte mendimet diku larg, larg.

Pastaj fare papritur profesor Buroni nisi ligjëratën shkencore:

— Teoria speciale e relativitetit e krijuar nga Albert Ajnshtajni solli nocione të reja pér fizikën dhe shkencat përgjithësisht dhe vërtetësinë e saj e provoi praktika. Ajo ka gjetur zbatim në zbërthimet bërthamore, në ndërtimin e aparaturës elektronike, në ndërtimet e fluturimet e anijeve kozmike dhe në degë të tjera të teknikave aplikative.

— Po zbatimi i saj në shkencat shoqërore?... — pyeti Rrezarti asistenten me zë të ulët duke e afruar gojën te veshi i saj i hollë gati-gati si i tejdukshëm.

Sofija, pa ia hedhur sytë, rruahi supet e ngushta e delikate e paksa të kërrusura.

Profesor Buroni theu heshtjen e auditorit duke e ngritur pakëz tonin e të folurit të shtruar e rrjedhës:

...— Në qoftë se Ajnshtajni mundi të bënte në idetë themelore të fizikës një revolucion të vërtetë shkencor, ai e arriti këtë, sepse para së gjithash u shkëput nga pikëpamjet e vjetra filozofike idealiste. Pra, mund të themi se shkencëtari gjenial i shekullit XX më parë gjeti zgjidhjen filozofike të problemit dhe pastaj iu vu punës zbuluese kërkimore pér zgjidhjen konkrete fizike. Ajnshtajni me zbulimet e reja në fushën e fizikës, edhe pa e thënë me gojën e tij, ishte pro dialektikës materialiste.

Rrezarti ishte përpjekur pér të hyrë sa më thellë në anët thelbësore të lidhjes dhe raporteve midis masës, lëvizjes dhe energjisë pér të cilat vazhdoi të fliste profesor Buroni. Ai tanimë kishte njohuri mbi fizikën e përgjithshme, mekanikën, termodinamikën, elektricitetin, optikën e akustikën dhe mbi fizikën bërthamore që e kishte nisur ta studionte me pasion qysh nga shkolla e mesme. Bile thellimin e këtyre teorive e kishte bërë edhe nëpërmjet punës

eksperimentale praktike laboratorike. Intuita e tij për të hyrë në thelbin e këtyre lidhjeve me praktikën e prodhimit i kalonte caqet e dijeve që jepte fakulteti. Anglishtja dhe rusishtja që kishte mësuar i jepnin mundësi që të shfletonte mjaft libra në bibliotekën e Universitetit dhe në Bibliotekën Kombëtare në kryeqytet. Ideja për ta lidhur teorinë shkencore me progresin teknik të prodhimit, e ngulitur fort në mendjen e tij, ishte konkretizuar me zgjedhjen e temave për punën e diplomës në fushën e aplikimeve të metodave bërthamore e të burimeve radioaktive në teknikë, në bujqësi, në biologji, në mjekësi, në gjeologji e fusha të tjera të jetës. Por ai kishte zgjedhur konkretisht përdorimin e gjurmuesve radioaktivë në furrat rrotulluese të çimentos, në industrinë e tullave qeramike, në furrnaltat në metallurgji, në industrinë e mekanikës, në shfrytëzimin e puseve të naftës dhe disa metodave bërthamore në gjeologjinë e minraleve. Zgjedhja e këtyre temave për punën e diplomës që ia kishte paraqitur profesor Kotit kishte shkaktuar reagim negativ nga ana e tij. Sofija, si zëdhënëse e katedrës, i kishte propozuar mendimin e profesor Kotit që të merrete si temë: Natyra e rrezatimit kozmik dhe shpejtësitetë e thërrimave radioaktive që vinin në Tokë nga kozmosi në lidhje me vështrimin e teorisë së relativitetit. Ajo i kishte premtuar jo vetëm ndihmën e saj, por edhe atë të profesor Kotit. Kjo kishte ndodhur disa ditë përpara dhe ai, i topitur ende, nuk ishte përgjigjur. Rrezartit atë çast i shkuar sytë te një inxhinier i oficinës së radiologjisë që ato ditë kishte përfunduar në bashkëpunim me një grup pune prej specialistësh të ndryshëm kraniostatin e parë radiologjik për ekzaminimin e sëmundjeve të kokës dhe ishte po ky edhe iniciatori i ndërtimit dhe i prodhimit të rontgenit të markës shqiptare. Ai e përshëndeti me kokë dhe me buzëqeshje të lehtë sikur të kishte thithur mendimet nga koka e Rrezartit. Saldatorit fizikan i shkrepi një mendim: «Ja, — tha ai me vete, — inxhinier Besniku më duhet për t'u konsultuar e ndoshta për të bashkëpuuar për ndërtimin e aparatit të defektoskopisë.» Ndërkaq profesor Buron Gurra kishte nisur një demonstrim matematik tjetër të teorisë së Ajnshtajnit në lidhje me reaksiionin zinxhir të zbërthimit të atomit

dhe raportet e shndërrimeve të energjive. Në thelb shpjegonte kompleksin materie energji. Pasi foli gjerë e gjatë përkëtë, me shkumësin në dorë ktheu kokën me shpejtësi nga dëgjuesit dhe tha:

— Ka ndonjë pyetje rreth lëndës, qoftë nga studentët e kursit të pestë të fizikës apo edhe nga pjesëmarrësit e tjerë në auditor?

— Profesor! — thirri Rrezarti, duke u ngritur në këmbë si me sustë, me dorën të ngritur lart. — Me leje...

— Po ju dëgjoj! — u përgjigj me një ton dashamirës konferencieri.

Pas një heshtjeje Rrezarti vazhdoi:

— Desha të di, profesor, a i hedh poshtë teoria e relativitetit konceptet e fizikës klasike të deritanishme? — Kandidati diplomant qëndronte në këmbë me sytë ngulitur në një nga formulat e shkruara me shkumës në tabelën e zezë ku binin në sy më tepër gërmat e alfabetit të greqishtes së vjetër.

Profesor Buroni, si la shkumësin në tryezë dhe shkundi pluhurin e bardhë nga mëngët e xhaketës prej stofi të zi, vuri buzën në gaz e tha:

— Kjo pyetje i ka shqetësuar gjithmonë shkencëtarët e fushave të ndryshme, madje edhe filozofët. Teoria e relativitetit të Ajnshtajnit nuk e hedh poshtë fizikën klasike. Ajo vërteton se, kur kemi të bëjmë me objekte që lëvizin me shpejtësi shumë më të vogël se drita, një pjesë e formulave klasike jepin vlera të përaferta me ato që gjenden në formulat relativiste. Dhe është vërtetuar se formulat relativiste të Ajnshtajnit kanë dhënë prova vërtetësie të shkëlqyeshme në përshtpjuesit e thërrimijave, në instalimet ku realizohen reaksionet bërthamore zinxhir e të tjera. E qartë?

— Për mua është e kuptueshme dhe e qartë, — u përgjigj me zë Rrezarti duke qëndruar në këmbë përballë profesorit me pyetjen e dytë ndër dhëmbë.

— Më lejoni të bëj një observacion? — mori prapë fjalen konferencieri dhe bëri dy a tre hapa duke dalë para tryezës me një vështrim ngazellëyes. Në kohën e tij teoremën që zbuloi Pitagora, shkencëtari i qytetërimit të lashtë grek, e kuptionin vetëm pak njerëz që numëroheshin me gishtë-

rinj. Kurse këtë teoremë, në kohën tonë, e njohin nxënësit e klasave të pesta të fillores. Ja, erdhi koha që pas disa dekadave teorinë e relativitetit të Ajnshtajnit ta njohin dhe ta konceptojnë edhe masa e universitarëve, bile edhe mjaft punëtorë të aftësuar në sferat e prodhimit industrial.

Profesor Buroni mbylli dosjen dhe e futi në çantë. Nderoi auditorin dhe pastaj pyeti:

— Mos e zqjata?

Në sallë shpërthyen papritmas duartrokite

Rrezarti ende qëndroi disa sekonda në këmbë dhe, kur u përmend, ai i hodhi shkarazi një vështrim Sofijes, e cila, për herë të parë nga njoftja e tyre, ia shtrëngoi dorën me ngrohtësi dhe plot kuptim.

KAPITULLI II

Rrezarti nisi punën këmbëngulëse dhe me një besim në vetvete se do t'ua dilte mbanë zotimeve që kishte marrë për punët e diplomës. Përveç studimit në përvetësimin e disiplinave shkencore të zbatimit të metodave radioaktive në furnaltat, në puset e naftës dhe në hidroteknikë, ai pune edhe për eksperimentimet konkrete në fabrikë për ndërtimin e pajisjeve e të aparateve me gjurmues radioaktivë në furrat rrotulluese të çimentos për eksperimentimin e densimetrit në përcaktimin e cilësive të tullave të kuqe qeramike dhe të ndërtimit të defektoskopisë. Megjithëse ende nuk kishte marrë përgjigje zyrtare nga katedra e fizikës, ai kishte besim në premitimin e profesor Buron Gurrës se do ta ndihmonte për ato tema që përfshiheshin në punën e diplomës. Jo vetëm kaq, por edhe fizikanë të tjerrë të Laboratorit D 6 që kishin përvojë në ato fusha, do ta ndihmonin dhe do të bashkëvepronin me atë, për të vënë në jetë eksperimentet radioaktive në shërbim të prodhit. Në fabrikë një pjesë e mirë e specialistëve dhe vetë inxhinieri teknolog i prodhit, Artan Shkëmbi, e përkrahë n dhe e ndihmonin konkretisht në ndërtimin e pajisjeve

mekanike, për të cilat qenë caktuar punëtorë të oficinës që t'i kryenin. Ajo që e ngrohte dhe ia shtonte besimin në projektet e tij, ishte përkrahja dhe vendimi që kishte marrë organizata-bazë e partisë e fabrikës përfundit e metodave shkencore në prodhim. Në njëren nga fabrikat e kombinatit të material-ndërtimit, në atë të fabrikës së tullave të kuqe ato ditë inaugurohej linja e re e automatizuar e ngrihet me forcat e vetë ndërmarrjes. Në këtë novacion edhe ai punoi ditë e natë, sidomos në saldimet speciale të bombovave prej çeliku të gazit e në montimin e impiantit të prodhimit të «varféruesit» të ri argjilë e dehidratuar. Presa e re dhe furra tunel me djegie gazi punonin mirë dhe plotësisht sipas projekteve të hartuara. Rrezarti atë ditë priste të vinnin në fabrikë grupi i fizikanëve eksperimentues të Laboratorit D 6 dhe bashkë me ata edhe dy profesorët Diosten Koti dhe Buron Gurra, të cilët përvëç punës konkrete eksperimentuese do të bisedonin edhe me njerëzit e fabrikës përfundit e fizikanit bërrhamor që ai do të mbente para komisionit shtetëror universitar.

Rrezart Deti ecte me njëfarë krenarie rreth fabrikave ku ziente puna prodhuese dhe mendimi shkencor i novatorëve përfundit përsosur teknologjinë e cilësinë e prodhimeve. Duke soditur pamjen e fabrikës së re të ndriçuar nga rrezet e diellit që buisnin në qafat e maleve, vinçat që lëviznin mbi rrrotat e hekurta që shkëlqenin dhe renë e avujve e të tymit që përhapej rrathë-rrathë mbi fabrikat, iu gjëzua zemra nga e ardhmja e botës së re ku dhe ai e ndiente veten njërin nga ushtarët e saj. E atë çast vuri buzën në gaz. Ai qëndroi në këmbë para furrës së vjetër Hofman dhe vështroi punëtorët që dilnin me karrocat me rrota gome e ktheheshin në foletë e tullave përfundit zbrazur tullat e tjera të pjekura. Rezi atë çast mendoi me vete se një ditë edhe kësaj pune të vështirë e të lodhshme do t'i jepej fund duke bërë mekanizmin e nxjerrjes së stivave të tullave të nxehtha nga furra. Në supin e majtë ndjeu dorën e një njeriu dhe, kur ktheu kokën, pa inxhinier Arthanin, të cilin i endej buzëqeshja në fytyrë dhe bulat e djersës sikur t'i kishin mbirë në ballë.

— Erdhe? Mirëmëngjes, Rrezi! — i tha ai befas.
— Mirëmëngjes! — iu përgjigj shoku dhe, si i shtriu do-rën, e përqafoi sïkur të kishin kohë pa u parë. — Erdha të punoj edhe unë me vullnetarët.

— Jemi ca prapa me planin. Stivuesit kanë avancuar më shumë se zbrazësit dhe shiko se si skuqin tullat nga temperatURA e lartë.

Inxhinier Artani e vështroi shokun në mëdyshje dhe diç tjetër donte t'i thoshte. Rrezi e mori me mend, por nuk pati kohë t'i khente ipërgjigje, se usta Sala, që doli me karrocë nga furra, me djersët curril, i drejtuar nga ata, nisi të thërriste:

— Ej, ti, bukurosh, ec të zbrazësh tulla! M'i ke krahët tërë muskuj dhe atë qafën si trung lisi, kurse unë i shkreti jam kockë e lëkurë.

— Vetë dole vullnetar, — ia pati inxhinier Artani. — Nuk të shtrëngoi njeri.

— Pse e prishe gojën, o usta? — u hodh buzagaz Rrezarti dhe, si e shtyu pak lehtë, ia mori karrocën nga dora.

— Lëre, ore, karrocën time, kap atë tjetren! Ja ku e ke, pas stivës. Me të vërtetë jam lëkurëfishkur, por unë e kam kockën çelik stal 35.

— Po, pse flet ashtu atëherë? — Po të dëgjojë njeri i jashtëm si ata shkencëtarët që presin të vijnë sot në fabrikë, do të mendojnë se të kemi detyruar që të japësh shpirtin në furrë... — qeshi Artani.

Rrezarti vajti prapa stivës së tullave dhe, si u zhvesh, doli aty te sheshi gjysmëlakuriq me një palë pantallona doku bluxhins të fërkuara nga puna. Dhe, si nisi vrapi drejt furrës për t'u bashkuar me vulnetarët e administratës, thirri:

— Usta Sala, bëjmë garë kush të nxjerrë më shumë karroca me tulla?

— E ku hahem unë me ty, more dem! — ia pat Sala duke e ndjekur nga pas.

Në të hyrë të furrës Rrezarti ndjeu një afsh të nxeh të dhe në çastin e parë iu duk sikur iu mor fryma, por pastaj u ambientua. Afroi karrocën pranë një punëtori shpatull-gjerë që i hiqte tullat nga stiva me një shpejtësi sikur të

kishte duar prej magneti dhe i stivoste radhazi në karrocë.

— Erdhën vullnetarëtl — tha ai duke e vështruar pjerrtazi Rrezartin dhe pa u bërë merak për djersën që i kuhllonte në gjoksin leshtor.

— Erdhën, — belbëzoi Rrezarti duke vështruar hyrjen e sheshit. Ndërkokë nisi të kapte me duart me doreza doku të gomuar tullat gati të skuqura dhe i hidhte në karrocë.

— Dhe kush na erdhi pa, shkencëtar. Hë, Rezi, kur do ta bësh atë shpikjen që të nxirren tullat nga furra me anën e komandimit të atyre rrezeve të padukshme?

Rrezarti mbeti si i mbërthyer në vend nga pyetja e shokut që iu duk e papërcaktuar: bënte shaka apo e hodhi si mendim fantastiko-shkencor. E mbante akoma në duar tullën që hoqi nga stiva. Por punëtori i zbrazjes, sikur të kishte karrocën motor, fluturoi jashtë. Atëherë Rezi nisi të tërhiqte tulla të tjera për të ngarkuar karrocën me buzë-qeshjen që i endej në fytyrë. Kur doli nga dhoma e furrës, ai u ndesh po me atë punëtorin që kthehej përsëri për të zbrazur tullat dhe ashtu menjëherë ia ktheu përgjigjen:

— Do të vijë edhe ajo ditë kur do t'i nxjerrim tullat nga furra me rrezet e padukshme...

Punëtori e vështri paksa i habitur me kokën kthyer prapa nga ai, e, duke qeshur, tundi kokën.

Usta Sala ishte kureshtar të dinte mbi të fshehtat e atomit, bile kishte dëgjuar nga një shoku i tij peshkatar që e hiqte veten të ditur të thoshte: «Shekulli në të cilin po jetojmë quhet edhe shekulli i atomit.» Ndërsa mjeshtri soldator i përgjigjej: «Shekulli i revolucioneve dhe i shembjes së imperializmit.»

— Dëgjo këtu, o Rrezil — e ngaomonte ai shokun që merrij me studimin e fizikës bërthamore. — Ti a e ke parë me sytë e tu atomin dhe ato grimcat e rrezeve të padukshme që zbërithehen nga bërthama e tij?

Rrezarti çonte buzën në gaz dhe mundohej me fjalë të thjeshta e me figura krahasuese t'u përgjigjej pyetjeve që bënte ustai. Dhe me një ton të shtruar i fliste:

— Të gjitha lëndët, trupat dhe objektet që na rrethojnë qofshin të ngurta, të lëngshme e të gazta, përbëhen nga

atome dhe molekula. Ashtu si edhe trupi e truri yt, o ustal Fjala «atom» vjen nga greqishtja e vjetër, që do të dotë «i pandashëm». Por, shkenca vërtetoi që nuk është i pandashëm. Në qendër të atomit gjendet bërthama, rreth së cilës në orbita të caktuara vërtiten elektronet.

— Po si ta kuptoj? — pyeti usta Sala.

— E di si është përbërja e atomit? — qeshi Rrezi, dhe, duke imituuar me duar rrumbullakësinë, po vetë u përgjigj:

— Po të rrism bërthamën e atomit në përmasat e diellit, atëherë elektronet, do të gjendeshin larg saj, dhjetë herë më shumë sesa është Plutoni, planeti më i largët i sistemit tonë diellor, nga dielli. Zbërthimi i bërthamës së atomit çliron një energji shumë të madhe. Masa dhe energjia lidhen fort midis tyre dhe ndryshe nuk kuptohen. Si ta them unë. Pa diell nuk ka nxehësi dhe as dritë. Pa atom nuk ka as energji atomike si edhe grimca rezesh radioaktive të padukshme. Ashtu siç nuk ka mendim pa tru.

Rrezarti, kur fliste, e vështronte në sy shokun.

— E kuptoval — qeshi usta Sala dhe atë çast i ra miqësisht me grusht në gjoks. — Për besë ti je dreqi! vetë!

— Tashti më thuaj a u takove me Meritën dhe a bisedove me atë për atë çështjen që të tregova?

— Nuk hyj, ore, unë në ato punët tua ja, zgjidheni vetë lëmshin e ngatërruar! — ia ktheu usta Sala.

Rrezarti, i shoqëruar nga Artani, usta Sala, dy mekanikë të oficinës dhe nga shokët e degës së planit, vazhdoi punën për zbrazjen e furrave dy orë pa ndërperje. Rrezi, kur dilte jashtë me karrocën e ngarkuar me tulla, hidh-te vështrimin nga sheshi i fabrikës. Ca punëtorë më tutje ngarkonin me vinç wagonat e trenit me tuba qeramike drenazhi që shërbën për kullimin e tokave, kurse ata të fundit ngarkonin tulla me veshë për soletë. Dy kamionë të ngarkuar ua liruan vendin dy të tjerëve që hynin mbrapsht në vendin e ngarkimit. Ishte një lëvizje e harmonishme në fabrikë dhe dukej me të vërtetë sikur ishin para një beteje të vërtetë.

Ra sirena me një sinjal të veçantë. Ishte pushimi i mëngjesit. Rrezarti e la karrocën me tulla të kuqe që përvëlonin. Shpatullat dhe krahët e tij tërë muskuj ishin larë me

djersë. Nxori nga çanta peshqirin dhe nisi të fshihej. Atë çast po mendonte me vete se nga tërë ajo djersë duhet të kishte humbur ca kripëra të trupit.

— Rrezart! — i thirri Artani. — Pi ca ujë të gazuar me kripë.

— Mos është i ftotë?

— Jo, jo, me temperaturë të zakonshme!

Rrezarti mori shishen e ujit të gazuar nga dora e shokut dhe, si ia hoqi tapën, nisi të pinte me etje.

— Mos, shkencëtar, se do të na ftoshesh! — dëgjoi ai një zë vajze nga prapa.

Rrezarti u kthye nga ajo dhe, si i zënë ngushtë nga e papritura, vuri buzën në gaz. Një çast vështroi vajzën nga koka te këmbët. Kominoshet e saj prej doku vende-vende me njolla vaji, të ngushta e të puthitura pas trupit, tre-gonin një trup të bukur e të zhđervjellët.

— Si je, Merita? — e pyeti ai pasi u ngrit nga stiva e tullave ku ishte ulur dhe i zgjati dorën.

— Më kanë hyrë kominoshet, ngaqë i laja çdo javë, — tha Merita që e vuri re hutimin e tij sikur t'ia kishte le-xuar mendimin në ballë.

Rrezarti nuk tha gjë, por shpuri me njëfarë kuptimi buzën në gaz duke treguar me sy veten. Edhe ai kishte veshur një palë pantallona të ngushta që i vinin mbi nyjet e ikëmbëve. Fytyra i qe nxirë e skuqur nga pluhuri i qymyrat të padjegur dhe pluhuri i argjilës së kuqe të pjekur.

— Në punë njeriu nuk pyet si vishet.

— Nuk ke mësuar këto ditë, — u hodh e tha Merita duke e vështruar me një pamje plot kujdes, si të një motre të dhembshur.

Për një çast Rrezartit iu drodh trupi nga ky mendim. «Merita është e dashura ime,» — tha me vete. Pastaj, si e mblođhi veten, u përgjigj:

— Nuk mund të them se nuk lodhem, bile, kur kthehem këto ditë në shtëpi, shtrihem në krevat dhe fle dy atri orë si i vdekur. Por, ai që do të mësojë, prapë gjen kohë, — qeshi ai. — Natën e kam timen, — plotësoi mendimin.

Artani ishte tërhequr pak si mënjanë dhe hante mëngjesin pa ia hedhur sytë.

— A u vendos tema e diplomës? — pyeti Merita.

— Akoma nuk e kam marrë vulën zyrtare, — iu përgjigj Rezi duke e vështruar në sy Meritën. — Ndoshata sot pas debatit që do të bëhet në mes fizikanëve të katedrës dhe këshillit shkencor të fabrikës mund të marrin rrugë punët.

— Po. E di që pritet të vijnë sot shkencëtarët. Bile si anëtare e bërthamës shkencore të fabrikës edhe unë do të marr pjesë në atë mbledhje.

— Merita, përsë nuk më ke ardhur në takim? — e pyeti befas Rezi, kur pa se drejt tyre po vinin ca punëtorë.

— Nuk dua të bëhem pëngesë..., — i tha ajo dhe i mbeti fjala në grykë.

Rrezarti nuk pati kohë ta vazhdonte bisedën, se grupei i punëtorëve tanimë qëndronte para tyre dhe ata diç kërkonin të bisedonin me të.

— A është e vërtetë se ka një metodë të shpejtë përpërcaktimin e markës së tullave? — e pyeti një nga punëtorët e zbrazjes, një djalosh trupmadh që i shëmbellente një ariu të fuqishëm. Dhe, pa pritur përgjigjen, mori nga arka një shishe me ujë të gazuar dhe e rrëkelleu deri në fund.

— Na ka gjetur belaja, — ia pati një tjetër. — Drejtori na thotë herë pas here se e kemi fajin ne zbrazësit që ndërmarrjet e ndërtimit bëjnë reklamime për parti tullash jo të cilësisë standart.

— E, po ju jeni kirurgët e fabrikës! — qeshi Artani që i ishte afruar Rrezartit. — Mos vendosni asnë tullë të plasarisht apo të deformuar në stivat e magazinës, i vini vecato të këqijat dhe pastaj të dalë përgjegjësia e reparteve të tjera që kanë shkelur procesin teknologjik.

— Ajo nuk bëhet, — kundërshtoi një punëtor tjetër, një ziosk që dukej si arab. — Këtu nuk është fjala për disa tulla, por në disa stiva pesëmbëdhjetë dhe deri në njëzet për qind, sidomos tjequllat marsejeze dalin me cilësi të keqe. E atëherë si t'ia bëjmë ne? Po norma? Ushqejmë fëmijët e veten me këtë punë, ore shok. Apo nuk është punë e rëndë! Më mirë të punonsh në minierë sësa në zbrazjen e furrave.

— Para disa vjetësh ju ia vinit fajin natyrës së argjilës

kodrinore se nuk ishte e përshtatshme për lëndë të parë, po tani që kjo ra poshtë, kush e ka fajin, punëtorët? — tha ai punëtori i parë që e thërrisin shokët «kirurgu» i fabrikës, ngaqë ai ishte i pari që ua kishte vënë këtë nofkë zbrazësve të furrave.

— E ka fajin teknologjia, — ndërhyri Merita. — Ka ardhur koha që çdo nyje e procesit teknologjik lypset të vendoset në baza shkencore. Dhe kjo punë, për mendimin tim, u përket në radhë të parë inxhinierëve dhe specialisteve që ka ushqyer e rritur klasa, por, sikur brirë të kenë ata, vetëm nuk e bëjnë shkencën pa u mbështetur si rrënja e këtij rrapi në tabanin e tokës.

Merita atë çast me buzën në gaz i ra me pëllëmbë trungut të rrapit të vetëm në atë shesh ku skuqnin stivat e tullave të kuqe qeramike.

— Që të mos na qortojnë brezat e ardhshëm! — tha befas Rrezarti duke i hedhur një vështrim kuptimplotë Meritës për mendimin që hodhi.

— E po atëherë ti, saldatori fizikan, vëri në jetë ato «rrezet e padukshme» që t'i shërbejnë prodhimit, — i thirri njëri nga punëtorët.

— Do t'i vëmë në jetë që ç'ke me tël — ia priti Rrezi.
— Por tok së bashku.

— Merre, Rrezart, një byrek! — i tha Merita që iu ul pranë dhe ia afroi.

— Të falem nderit! — iu përgjigj Rrezi dhe nisi të hante menjëherë duke e shoqëruar me gjillenjkat e ujtit të gazuar që i khente pas çdo kafshate.

— Në radhë të parë, — u hodh e tha pas një copë heshtjeje të shkurtër inxhinier Artani, — lypset të mbushim kokat dhe të revolucionarizojmë mendjen e njerëzve, pastaj bëhen të gjitha: përpunimi i argjilave, përdorimi i varféruesve, formimi i gjysmëprodhimit, tharja e tyre në tuneli dhe pjekja, të gjitha këto, të bazuara në shkencë dhe të fiksuarë realistikë në kartat teknologjike...

— Shumë e drejtë! — ia pati «kirurgu» i fabrikës. — Jo siç bëri ai inxhinieri burokrat i byrosë teknologjike që thoshte se mua nuk më duhen kushtet tekniqe të prodhimit, por unë i bëj kartat ashtu siç e thotë literatura tekniqe.

Kurse inxhinier Artani dhe shokët e tij bënë përsosjen e bazave teknologjike ashtu siç e kërkon teknologjia dhe pastaj u hartuan kartat teknologjike.

— Dhe ndryshimin po e shohim! — ndërhyri Merita. — Në linjën e re që ka nisur puna, fiorot teknologjike janë ulur nën 0,5 pér qind dhe marka e tullave është rritur trefish. Pra nuk mbetet gjë tjetër vetëm ta përhapim këtë përvojë edhe brenda fabrikës në linjat e tjera, bile edhe t'ia bëjmë problem ministrisë që ta përhapin në të gjitha fabrikat e tjera.

Sirena kishte disa sekonda që fishkelleu përsëri.

— Ngrihem, shokë, se mos na zërë ngërçi, — tha një punëtor dhe nisi i pari të shtynte karrocën drejt furrës. Pas tij u bënë gati edhe të tjerët të fillonin punën.

Usta Sala kishte vënë dorën në ballë si strehë dhe po vështronë nga hyrja e fabrikës ca njerëz që zbritën nga mikrobusi që shkëlqente nga rrezet e diellit dhe ai nuk ishte në gjendje të dallonte nëse kishte ngjyrë blu apo gri. Si ktheu kokën nga Rrezarti që diç po i thoshte në vesh Meritës, Sala thirri:

— Ja, po vijnë shkencëtarët! — Ata janë për besë!

Rrezarti hodhi vështrimin nga mysafirët dhe menjëherë i kapi syri asistente Sofijen, hapin e saj të çrrregullt duke iu shmangur brigjeve me pluhur të kuq. Përparrë saj ecte profesor Koti me një çantë lëkure në dorë me syze që ndrisnin nga larg si dy projektorë të vegjël. Më pas zbritën nga mikrobusi edhe profesor Buroni i shoqëruar nga laboranti i tij. Kurse nga dera e parë zbriti një njeri që Rrezarti nuk e njihte.

— Është instruktör në komitetin e partisë, — tha usta Sala sikur ta dinte që Rezi nuk e njihte. — E kam njojur në sallën e shahut, në klubin e bashkimeve profesionale. Vështron të tjerët që luajnë me orë të tëra, kurse vetë s'e kam parë ndonjëherë të lozë.

Rrezarti rrudhi supet.

— Nuk e njoj, — i tha ai Meritës që rrinte pranë tij pak si e topitur.

— Po ajo shoqja cila është? — pyeti befas Merita kur ata po vinin drejt tyre.

— Sofija, asistentja e katedrës së fizikës, për të cilën të kam folur, — i tha ai me zë të ulët.

— Qenka delikate dhe e bukur! — ia pati Merita dhe rrëshqitas, pa u vënë re nga Rrezarti, humbi pas një stive tullash që vinte në formë T-je.

Rrezarti, pasi dëgjoi fjalët deri në fund, me pak vonesë, u kujtua ta kthente kokën prapa, por u step një sekondë kur vuri re se Merita ishte zhdukur si hija e një pemë kur dielli futet në copëzën e resë.

Artani bashkë me Rrezartin dolën përpara mysafirëve.

— Mirë se erdhët! — tha Rrezarti buzëqeshur me dorën të zgjatur nga Sofija që ecte në krye të tyre.

— Oh, si qenke bërë, si pastrues oxhaqesh! — qeshi ajo duke vënë njérën dorë në gojën pak të madhe me dhëmbët që zbardhnin si porcelan.

— Klasë punëtore! — ia ktheu ai, duke mos ditur atë çast nëse ia kishte qëlluar si duhet.

— Saldatori fizikan! — ia pati profesor Buron Gurra që ishte afruar pranë tyre duke ia dhënë dorën me dashamirësi dhe, duke e kthyer nga instruktori i komitetit të partisë, shtoi: — Ja, ky është kandidati diplomant, për të cilin të kam folur.

Instruktori buzëqeshi dhe nuk tha asnjë fjalë veçse tundi kokën i kënaqur.

Profesor Koti, dy hapa prapa Sofijes, përshëndeti lehtë-lehtë me një përkulje të kokës duke ulur paksa kapelen republikë.

— Do të dëshironim, para se të fillojmë bisedën në zyrë, të njihemi pak me fabrikën! — tha profesor Buroni dhe bëri përpara drejt furrës Hofman që vinte si një vezë e stërmadhe.

Rrezarti, me gjeste dhe me duar, u tregonte mysafirëve procesin e prodhimit. Djersa bula-bula nisi t'i rridhte në qafë e supe. Sofija, që e ndiqte nga afër, e vështronë herë-herë me bisht të syrit. Një grup punëtorësh, që parakaluan aty rreth tyre duke shtyrë vagonat me tulla të thara, i shikonin mysafirët pak si me kureshtje.

Profesor Koti qëndroi para një dhoma dhe soditi punëtorët që hynin e dilnin me karroca bosh e të ngarkuara

me tulla. Ai habitej me qëndresën e punën e vështirë të punëtorëve dhe e vuri veten për një çast në këmbën e tyre. Iu drodh zemra: «Punë e mundimshme!» — tha me vete.

— Keni qenë ndonjëherë, profesor, në fabrikë tullash? — pyeti befas Rrezarti duke bërë dy a tri hapa para Sofijes drejt tij.

— Hëm... për herë të parë shkel në një fabrikë tullash! — u përgjigji profesori — Nuk më ka sjellë puna. Në disa fabrika të tjera kam qenë...

— Ja, këtu nis përsosja e teknologjisë, — tha inxhinier Artani duke treguar me gisht nga kuadri elektronik që drejtonte hyrje-daljen e vagonave dhe rregullonte automatikisht temperaturat në çdo zonë të furrës.

— Nga është importuar ky impiant? — pyeti befas profesor Koti.

— E kemi ndërtuar me forcat tona, profesor, — tha inxhinier Artani.

— E kam fjalën për panelin elektronik që komandon furrën...

Profesor Koti kishte qëndruar pak më prapa se të tjerët dhe i thoshte fjalët me zë të ulët.

— Rrezarti, studenti juaj me shokët e qendrës elektronike e kanë ndërtuar, — përsëriti Artani.

Prофesor Koti ngriti supet. Ky gjest tregonte atë boshillëkun që ai ndiente në punët praktike: Gjithë jeta në fakultet i kishte kaluar me përkthime dhe përshtatje tekstesh të fizikës klasike dhe kohët e fundit të fizikës bërthamore. Shumë kohë i kishin ngrënë studimet mbi natyrën e rrezeve kozmike. Përfytyrimet e tij ishin të turbullta dhe ditët e fundit kishte nisur të ndiente veten si pranë një humnere, kurse tanë ishte i detyruar të bridhët nëpër fabrika për të lidhur punën shkencore në dobi të prodhimit. Mallkonte veten që ishte futur në debatin për të përcaktuar temat e kandidatit diplomant dhe tanë e shikonte se nuk dilte aq lehtë nga kjo valle.

Te furrat tunel që punonin njëra me lëndë djegëse të gaztë dhe tjetra me energji elektrike që piqte tjugulla marsejeze, ishin mbledhur kokë më kokë profesor Buroni,

laboranti fizikan, inxhinier Artani dhe një specialist manovrator i tunelit dhe po bisedonin gjallërisht për problemin e bilancit termik. Profesor Buroni kishte praktikë të mirë mbi mënyrat e ndryshme të djegieve, bile punën prodhuase para ca vjetësh e kishte bërë në distilerinë e naf-tës në Cërrik. Më vonë pati marrë pjesë në një grup pune për të studiuar bilancin termik dhe shpejtimin e pjek-jes së prodhimeve të porcelanit në furrat elektrike. A ngulte këmbë dhe hidhje poshtë argumentin jo të saktë shkencor të specialistit të tunelit se gjoja, po të zhvendoseshin gjysmë metër të gjitha zonat e furrës tunel, do-bësoheshin dhe u shkurtohej jeta rezistencave elektrike.

— Dëgjo, shok, — i tha ai specialistit. — Eksperimenti është baza e vërtetimeve teorike. Këtë ligj që zbatojmë ne në shkencat e fizikës nuk e tund topi. Provojeni edhe ju.

Specialisti i fabrikës, një djalosh trupnjeshur, me flokë me qime të ashpra si furçë që kishin nisur vendevende t'i thinjeshin, qeshi me njëfarë mosbesimi.

— Ti, Gëzim, — ndërhyri inxhinier Artani me njëfarë toni që pështjellohej nga një notë qortimi, — ndonjëherë me atë prakticitetin tënd ngul këmbë si mushka. Teknika, or vëlla, nuk ka fund. Prandaj vare në vesh mendimin që të dha profesori se nuk është hedhur kuturu, por bazohet shkencërisht. Dhe a e kuption ti se, po të shpejtojmë ciklin e pjekjes një orë për çdo grafik pjekjeje, kjo do të kishte një leverdi të madhe në dy drejtime. E para në rritjen e rendimentit të prodhimit dhe e dyta në kursimin e energjisë elektrike.

Laboranti fizikan i katedrës, që ishte njëkohësisht një mjeshtër i mbaruar në punimin e qelqit, u mori përsipër shokëve të fabrikës ta zëvendësonte pllakën e fibrës ku bëhej regjistrimi i temperaturave automatikisht për çdo minutë, me një copë xhami termik të kurbuar që do ta punonte me duart e veta në laboratorin e fizikës bërthamore.

Profesor Koti kishte qëndruar më prapa shokëve dhe po bisedonte me usta Salën. Ai e mori me mend se përfarë zhvillohej debati midis fizikanëve dhe specialistëve

të prodhimit, dhe, duke e ndier veten profan në problemet e prodhimit, i shmangej debatit. Usta Sala e pyeti për defektoskopin që i kishte hyrë të ndërtonte Rrezarti dhe nëse kishte gjë në torbë. Profesor Koti rrudhi buzët dhe nuk iu përgjigj pyetjes së tij, duke e kaluar bisedën degë më degë. Kur usta Sala i tha për temën e diplomës të «çirakut» të tij saldator, profesori thartoi ftyrën dhe iu përgjigj prerë:

— Universiteti nxjerr shkencëtarë...

— Të rrije me mua! — ia plotësoi usta Sala me buzën në gaz.

— Nuk e kuptoj! — u përgjigj nëpër dhëmbë profesori duke u tkurrur.

— Ne duam që Rrezarti dhe kushdo tjetër të bëjë atë shkencë që i shërben prodhimit, — tha thjesht usta Sala duke treguar gishtërinjtë me kallo.

Profesor Koti u largua drejt grupit të fizikanëve me qëllim që t'u shmangej pyetjeve të usta Salës që nuk po i ndahej këmba-këmbës. Dhe me mendjen e tij nisi të bluante një mendim të mjegulluar. «Po... po... psikika ime, psikika e këtij punëtori dhe ajo e studentit Rrezart Deti, ekzistojnë jashtë ndërgjegjeve tona». Ai i tha këto mendime duke i mbajtur deri te buzët që i fërgëllonin si gjethë plepi pa nxjerrë tingullin e zërit. Mendja iu turbullua dhe sytë iu errësuau aq sa gati desh u përplas te një kolonë betonarmeje, po të mos ishte mbrojtur instinktivisht nga vendosja e duarve në çimenton e ftohtë. Syzet i ranë përtokë. Ai u përkul pak dhe me duart që i tundeshin kuturu përpinqej t'i gjente.

Usta Sala u ul pa vështirësi dhe i mori. Si i pa nëse ishin thyer, zgjati dorën dhe ia dha profesorit duke i thënë me të qeshur:

— Syzet shpëtuan pa u thyer se, përfat, ranë mbi leckat e pastrimit. Syzet janë një ndër shpikjet e mëdha të njerëzimit. Pa ato njerëzit e ditur do ta mbyllnin para kohe punën e tyre kërkimore...

Profesori buzëqeshi me pahir dhe, kur vuri syzet dhe e shqoi qartë ftyrën e punëtorit, tha me mendje: «Çfarë, vallë, donte të thoshte me këto leckat e pastrimit ky djali?

Mos i kuptoi mendimet e mia të fshehura në labirintet e trurit të Keopsit?» Pastaj e mblodhi veten dhe vuri re usta pë që iu dükën sikur po e hetonin dhe, për t'i dhënë fund kësaj ngjarjeje, tha:

— Falemnderit!

— Asgjë! — iu përgjigj thjesht usta Sala dhe, kur profesori u largua për të arritur grupin e fizikanëve, ai lëshoi edhe këto fjalë:

— Paska të drejtë djali, ti fluturoke në hava, o profesor.

Fizikanët kishin zënë vend në njërin krah të tryezës thamës shkencore të fabrikës që përbëhej nga specialistë rit e kolektivit. Në krye kishte zënë vend drejtori i fabrikës, pesëdhjetave, që mbahej ca si krenar nga përvoja e gjatë kishte për t'u dhënë zgjidhje të shpejtë problemeve herë-herë të ndërlikuara të prodhimit. Ai, si u hodhi një veshtrim të gjithëve, ia nguli sytë fytyrës së zverdhur të i dha të kuptonte inxhinier Artanit se mund të fillonte, prandaj Artani nisi të fliste duke thyer heshtjen e takimit të parë me ata njerëz të panjohur:

— Kjo është bërthama jonë shkencore e fabrikës, — tha ai me një nënqeshje të lehtë sikur t'i vinte pak turp nga ata profesorë të universitetit. U mbush me pak fymë dhe vazhdoi: — Kërkohet nga ne të fabrikës të jepim mendim për temat e projektdiplomës të punonjësit tonë, Rrezart Deti.

Profesor Koti, që drejtorit iu duk si njeriu i kyçur me dry, ndërhyri befas:

— Të gjykojmë edhe nëse formojnë objekt shkencor universitar.

Njerëzve të fabrikës, fjalët e profesor Kotit u ranë si ujët e valuar.

Usta Sala, që rrinte ngjitur me Rrezartin, i pëshpë-

riti në vesh: «A e shikon se unë kam të drejtë kur të them se zanati është byzylyk floriri? Pa e futur ende këmbën nisën andrallat.»

— Ne nuk jemi edhe kaq të thelluar në punët e shkencës, — tha drejtori i fabrikës dhe me një buzëqeshje enigmatike shtoi: — Le të dëgjojmë mendimin tuaj...

— Shkenca është një fushë e gjërë, — u hodh e tha profesor Buroni duke i dhënë zërit një ton paksë të ngri-tur, me një notë serioziteti. — Ajo nis nga zbulimet e sëndeve të thjeshta dhe deri tek ato të mëdhatë që sjellin transformime rrënjosore në shoqërinë njerëzore. Por edhe studimet e zbatimet në kushtet konkrete specifike të një fabrike, apo të një vendi, pavarësisht se janë të njohura si fenomene, kërkijnë, për t'u vënë në jetë, metoda të një pune shkencore. Ja, për shembull ne pamë në fabrikën tuaj zbatimin e studimeve shkencore që keni bërë ju vetë në përsosjen e teknologjisë së tullave qeramike duke ulur në mënyrë të ndjeshme firot dhe duke rritur markën e tyre trefish. Dhe kjo është një punë shkencore, sepse keni bërë një punë të veçantë me argjilat gjysmëshkëmbore të vendit tonë që janë të ndryshme si brenda vendit edhe nga ato të vendeve të tjera. Ndërsa studimet e eksperimentimet me burime radioaktive që ka nisur kandidati diplomat i fizikës bërtimore, punëtori juaj Rrezart Deti, janë një dëshmi tjetër e një pune akoma më të thellë shkencore në përcaktimin e shpejtë të karakteristikave fiziko-mekanike të tullave duke nisur nga rezistenca në shtypje e në përkulje dhe deri te përcaktimi i qëndrueshmërisë së tyre si kohë shekullore. Kurse eksperimentimet e ardhshme radioaktive në furrat e çimentos do të jepin mundësi të rritet rendimenti ndoshta edhe tridhjetë për qind në fabrikën ekzistuese pa qenë nevoja për investime zgjerimi. Temat e diplomës unë për veten time i konsideroj një kontribut me vlera shkencore si në fushën e industrisë të material-ndërtimit, ashtu edhe në degët e tjera të industrisë, në metalurgji, në naftë, në hidroteknikë, në teknologjinë e mekanikës e tjera. Më falni, se ndoshta e zgjata dhe u detyrova të marr fjalën i pari.

Profesor Buron Gurra, si tha mendimin e tij, u krodh në heshtje.

— Po, sigurisht, ne duam mendimin tuaj, — ia pati befas profesor Koti si për të humbur gjurmët e një kontradikte midis tij dhe profesor Buronit. Ai me mendjen e tij nuk hiqte dorë nga pikëpamjet e veta për formimin e fizikanëve universitarë vetëm si njerëz teorikë, të shkençës së madhe fondamentale. Kurse ato teza që ngrinte profesor Buroni dhe të tjerë, i quante pikëpamje të rëndomta shkencore.

— Më përpara..., — u hodh e tha inxhinier Artani, — deshëm të dëgjojmë shkurt nga goja e Rrezartit mbi temat që ka propozuar ai.

— Edhe unë ashtu mendoj, — ia pati një punëtor nivator që rrinte i menduar me duart mbështetur mbi tëmtha dhe me këmbët hapur pa kujdes që herë-herë pa dashje ciknin majat e këpucëve të profesor Kotit përkundruall.

— Rrezart, — u dëgjuar zëri i drejtorit sikur të ishte zgjuar nga një gjumë klapie.

Rezi u ngrit në këmbë me ngadalë me sytë ulur mbi fletët e një biloku që mbante përpara. Një çast vështroi fytyrën e Meritës që kishte marrë një shprehje të veçantë dhe në shikimin e saj iu duk sikur pa reflektimin e vuajtjeve të veta.

— Ulunil! — i tha drejtori dhe diç tjetër belbëzoi, por nuk u kuptua. Rrezartit iu duk e papërcaktuar fjala e tij, por nuk e zgjati, u ul. Para se të hapte gojën, mendoi me vete: «Cili jam unë që po flas e bile po ndeshem me profesorët e universitetit? Ja; po rri në një tryezë me profesor Diosten Kotin, një ndër teoricienët e njojur të fizikës klasike që nga dita e parë e themelimit të universitetit, që ia kanë shtrënguar dorën akademikë të huaj e bile personalitetë të shkençës. Emri i tij si fizikan njihet edhe nëpërmjet librave universitarë! Dhe, si ngriti kokën nga shokët e fabrikës, nisi të fliste me zë të ulët e të shtruar:

— Për tematikën e punës së diplomës unë jam mbështetur te mësimet e Partisë dhe të botëkuptimi filozofik

marksist-leninist mbi teorinë dhe praktikën e revolucionit tekniko-shkencor në vendin tonë si pjesë përbërëse e revolucionit socialist shqiptar. — Ai qëndroi një copë herë pa thënë gjë, për të kuptuar efektin e fjalëve që hodhi se mos vallë krijonin përshtypjen se po shiste mend. Por, kur vuri re se nuk pipëtiu frysë njeriu, vazhdoi: — Më është dashur të derdh mund e djersë për të përvetësuar disiplinat e shkencave të përgjithshme të fizikës. Kam punuar me ngulm për të studiuar zbatimet e metodave radioaktive në dobi të prodhimit, bile edhe të zhvillimit të eksperimenteve në kushtet tona materiale. Nëse kjo quhet apo nuk quhet punë shkencore për t'u paraqitur në një diplomë universitare, këtë juva lë ta gjykonit ju, shokë. Ja, këto desha të them.

Sytë e tij morën një ngjyrë më të thellë kaltërsie dhe, si mbylli bllokun përpara, u kroh në një heshtje priteje tërë ankth. Nga shumë mendime që i zienin atë çast në kokë, ishte edhe mendimi që në fund të fundit ai mund të hiqte dorë nga diploma akademike, mjaf-ton që t'i jepej mundësia të punonte përkrah fizikanëve në laboratoret shkencore, të vinte në jetë tërë ato studime që ishin në dobi të prodhimit. Bile ai e ndiente veten të aftë që disa nga këto pajisje e aparate mund t'i ndërtonte me duart e vetu. Dhe në këtë fushë e dinte se kishte ndihmën e shumë novatorëve të tjerë jo vetëm në fabrikën ku ai punonte, por edhe në oficina e uzina mekanike të qytetit.

Asistente Sofija që rrinte pranë profesor Kotit, bënte ca shënime në një fletore sipas porosisë së katedrës për të mbajtur njëfarë procesverballi për mendimet që do të jepnin punëtorët e specialistët e fabrikës. Herë-herë ajo hidhët një shikim të shpejtë mbi Rrezartin dhe pa dashje i tërhoqte vëmendjen qafa e tij e gjatë dhe shpatullat e gjera tërë muskuj. Dhe, me sytë e mendjes turbullohej në shpirë nga një iluzion dashurie që ia ngacmonte qenien e saj delikate. Ajo, e shqetësuar, bluante në kokë edhe mendimet abstrakte për rrugën e shkencës që aq tepër i kishte folur profesor Koti si në katedër ashtu dhe më lirshëm në vizitat familjare që bënte ai në shtë-

pinë e saj. Ajo kishte vënë re njëfarë ndryshimi që ekzistonte në mes koncepteve të fizikanit dhe atyre të baba të vet, pavarësisht se i ati i përkiste plejadës së historianëve të vjetër. I ati mbronte konceptet dialektike në histori dhe në studimet e tij u qëndronte besnik këtyre parimeve. Kurse profesor Koti e zhvishte shkencën e fizi-kës nga konceptet filozofike. Nga ana tjetër Sofija kishte dëgjuar prej tij shpesh mendime filozofike idealiste që ai i ndërthurte dhe i komplikonte edhe me fenomenet e shkencës. Ajo tani po priste shpërthimin e një debati që në fakt kishte nisur midis dy profesorëve qysh në katedër. Por këtë që do ndodhë këtu midis punëtorëve, ajo me mendjen e saj e quante sikur do të shpërthente një minë.

— Për mendimin tim dhe me ato gjëra të hollësishme që kam biseduar me Rrezartin, bile në fushën e aplikimeve të industrisë së çimentos edhe kemi bashkëpunuar, unë jam dakord që kjo temë të jetë në objektin e diplomës së kandidatit të fizikanit bërthamor.

Inxhinier Artani e tha mendimin e tij qartë e me plot besim.

Merita mori fjalën pa marrë leje. Ajo tha thjesht e lirshëm atë që i ndiente zemra:

— Më duket se edhe profesorët e universitetit krejt tehun e punës së tyre teorike shkencore me studentët, inxhinierët e shkencëtarët e ardhshëm e drejtojnë nga shkenca në shërbim të shoqërisë. Po të ndërtohet sipas projektiveve e studimeve të bëra nga ky shok gamafeftoskopi pér të kontrolluar thellësinë e ngjitjeve me saldim të çeliqeve apo saktësinë e derdhjeve të gizës, pér mua është një punë shkencore...

Kur përfundoi, ajo pëshpëriti: «Jo, jo, nuk duhet të thyhesh!»

Profesor Koti, që e kuptoi mendimin e atij belbëzimi, ngriti sytë nga punëtorja dhe iu duk sikur ajo po e qëllonte atë me shigjetë. Pa vetëdije, ashtu siç e quante ai, vuri dorën në zemër, sepse iu duk sikur diçka e pikkoi nga brenda. Kur kjo therje i kaloi ai e mori me mend që edhe të tjerët do ta përkrahnin mendimin e profesor Buron Gurrës dhe mendimi i këshillit shkencor të

punëtorëve do të ndikonte në mbledhjen e katedrës. Po-zita ime do të lëkundet, bloi me vete dhe s'kishte ç'të priste më, veçse të zhvishte shpatën e të qëllonte. U ngrit në këmbë dhe me njëfarë nervozizmi që ra në sy.

— Unë nuk kam kundërshtim për eksperimentet tua-ja në fabrikë dhe as mendoj se ato s'janë të dobishme për prodhimin, sepse një mendim i tillë do të ishte absurd e regresiv, bile jam dakord që të organizohet edhe bash-këpunimi me pënonjësit shkencorë të Laboratorit D6 të Fizikës Bërthamore, por dua të vazhdoj këtu një debat që ka lindur në katedër pikërisht midis meje dhe kolegut tim, profesor Gurrës për karakterin e temave të diplomantëve fizikanë. Profesor Gurra edhe këtu e shfaqi pikëpamjen e tij që të shpie dashur padashur në një prakticizëm të dëmshëm. Universiteti është universitet, shkenca është shkencë, ndaj mendoj që Rrezart Detit t'i jepet një temë shkencore tjetër, e përshtatshme për universitetin...

— E çfarë? — pyeti befas usta Sala, ndërkokë që profesori me syze miopi po ulej në karrigen e tij.

Koti rrinte i përkulur mbi tryezë, i mbështetur me njëren dorë në parvazin e karriges dhe me sytë të hapur shumë nga e papritura. U detyrua të thoshte propozimin: e tij:

— Një djalë i talentuar, një studiuar i apasionuar dhe i thellë si Rezart Deti s'ka pse të sakrifikohet për caqellime utilitare... Ai do t'i jepte një kontribut të madh shkencës sikur t'u futej kërkimeve serioze mbi temën «Natura e rrezeve kozmike», ose një temë tjetër e këtij rangu...

Punëtorët, përmes buzëqeshjeve, shpërthyen në një murmuritje.

— Qetësi, shokël — thirri drejtori i fabrikës. — Shoku Koti ka mendimin e tij. Ai niset nga aftësitë e shokut tonë... Pse t'i trembemi debatit? Më lejoni të them edhe unë diçka. Këshilli shkencor i fabrikës jep mendimin e tij dhe, se çfarë do të bëjë katedra e universitetit, është punë e saj. Por edhe për mendimin tim nuk është e kohës, bile mund të them me kurajë se sot për sot është një luks të shtosh organikën e laboratorit me një fizikan dhe të bësh investime për një shkencë të tillë... Por kjo

nuk do të thotë se, në qoftë se nesër saldatori Rrezart Deti mbron diplomën, shteti t'i qejë vend tjetër...

— Ende nuk është mbyllur diskutimi... kam edhe unë për të shtuar diçka! — ia priti profesor Buroni dhe u ngrit pak i nervozuar në këmbë: — Unë e falënderoj këshillin shkencor për mendimet që rrahu në këtë takim dhe sipas mendimit tim e dha konkluzionin e tij. Ai përkrah temat e propozuara për punën e diplomës nga studenti Rrezart Deti. Sa për atë që tha drejtori i fabrikës, ai është një problem tjetër, zgjidhja e të cilit u përket organeve të partisë e të shtetit. Por, meqë ju e hodhët këtë mendim..., — këtë çast profesor Buroni ngriti sytë nga drejtori i fabrikës dhe pas një ndërprerjeje të vogël, shtoi: — Edhe unë do të them mendimin tim, bile edhe do ta argumentoj aty ku duhet. Në laboratoret e fabrikave tona sa i nevojshëm është kimisti, aq është edhe fizikani...

Inxhinier Artani tha më në fund:

— Si kryetar i këshillit shkencor të fabrikës e mbyll mbledhjen për t'u takuar përsëri ndër beteja të përbashkëta shkencore në dobi të prodhimit.

Kur po ngriheshin nga karriget, anëtarët e këshillit shkencor të fabrikës përshëndesnin me kokë fizikanët e universitetit, kurse ata që ishin afër u shtrëngonin dorën. Drejtori i fabrikës iu afrua Rrezartit, dhe, si i vuri dorën në sup, i tha:

— Ju uroj sukses dhe një vend të nderuar në tryezat e universitetit.

— Unë nuk kam asnjë pretendim, shoku drejtor, — ia ktheu Rrezarti, duke pikasur në buzëqeshjen e tij në cepin e buzëve një ndjenjë ironie.

Në oborrin e fabrikës, kur fizikanët po përgatiteshin të hipnin në mikrobus, profesor Buroni u takua me instrukturin e komitetit të partisë dhe sekretarin e organizatës-bazë të fabrikës që erdhën atë kohë dhe diç biseduan midis tyre për mbledhjen e këshillit shkencor.

Rrezartit i zuri veshi porosinë e instrukturit të komitetit të partisë që i la drejtorit të fabrikës, i cili po i shtrëngonte dorën profesor Buronit për t'i dhënë lamtumirën.

KAPITULLI III

Biku, shoku i fëmijërisë, marangozi mobilier, bashkë me Manushaqen, të fejuarën e tij, një vajzë truphollë e me gërsheta, kishin qëndruar nën shtëpinë e Rrezartit. Ai po i tregonte asaj me gisht dritaren që ndriçonte.

- Qenka në shtëpi, — tha ai.
- Sigurisht që po studion.
- Po vjen edhe ti lart? — dhe bëri ta tërhiqte vajzën nga krahu.
- Jo, se vonohemi, — kundërshtoi ajo.
- E po mirë, po shkoj vetë.

Biku u nda nga e fejuara dhe me vrap u nis drejt shtëpisë së shokut. Trokiti dy a tri herë në derë. Priti pak dhe, kur pa se askush nuk po e hapte, përsëri i ra derës më fort me çokën e dorës. Mibajti vesh dhe ja, dëgjoi këmbë pas dere. Pas pak doli zonja e shtëpisë.

— Ti qenke, Bik? — e pyeti ajo me një buzëqeshje të ëmblët dhe ia bëri me dorë që të hynte brenda.

- Aty është Rrezi?

- E ku tjetër përveçse kokën mbi librat!? Më është bërë kockë e lëkurë...
 — Do të bëhet shkencëtar dreqi! — qeshi Biku duke ecur korridorit.
 — Merre, merre një copë herë të shëtisë, — i tha ajo nga prapa.
 Biku hyri në dhomë.
 Rezi, që nuk e kishte vënë re shokun, u kthyebefas nga ai.
 — Mamuth! — thirri. — Mos ke ardhur të ndeshesh me mua?
 — Jam Bohri danez, Pierr Kyri! Mari Kyri të pret poshtë! Jo, jam Pal Dirak, jo, italianni Enrico Fermi, Plank, Ernest Rutherford, Haisenbergu, Faradeji, Frederik e Irenë Kuri, jo, jo se harrova, jam qifuti Ajnshtajni... Të ftoj përnjë shëtitje buzë detit... Çohu po të them dhe zbrit poshtë, se nuk ta kam ngenë, kam lënë Manushaqen si qyqe nën shtyllën e elektrikut.
 — Lërmë, mamuth, se s'vij dot. Shih...
 — Hajde e mos e zajat më, se pret e bija e botës përijashta, — i tha Biku dhe me duart që i kishte si darë e tërhoqi nga krahu drejt derës.
 — Nuk mundem sonte, mos ma merr për të keq, — kundërshtonte Rezi dhe me njérën dorë të lirë tregonte librat mbi tryezë. — Duhet t'i hedh një sy këtij diksiionieri frëngjisht të atomit. Ashtu siç ka muzika klasike baba-llarët e saj: Mozartin, Beethovenin, Bahun e të tjera, ashtu edhe fizika ka të gjithë ata që përmende ti. Se edhe ti..
 — Pse, si kujtove ti, se unë jam fare kungull dhenuk marr erë nga shkenca! — u mburr Biku. — E veçanërisht në shkencën e drurit...
 — E di, e di... mbylle për hattrin e shoqërisë që kemi, — iu lut Rezi dhe ia zuri buzët shokut më dy gishtërinjtë e dorës, se e dinte që, po të niste të tregonë për rimesot dhe llojet e mobiljeve, nuk pushonte orë të tëra.
 — E po ec pra dhe dalim një shëtitje bregut të detit... Ec!

— Të thashë se sonte nuk është e mundur të ngrihem nga tryesa, më duhet të studioj atë natyrën e rrezes së padukshme gama që përshkon lëndën, tejpërtej.

— Mirë atëherë, qëndro te rrezet e padukshme dhe shkëputi fijet e zemrës dhe mos e mundo vajzën! — Biku heshti një çast duke vështruar shokun në sy nëse po e kuptonte se ku donte të dilte dhe kur pa njëfarë reagimi nga Rrezi, ia priti: — Manushaqja ka lënë takim me Meritën dhe të katër do të ulemi gjëkundi. A e more vesh tani? Vishu po të them, se ndryshe nuk të shkel më në shtëpi! — e ngriti zërin si me kërcënëm ai.

— Aha... kjo është punë tjetër! — tha i habitur Rrezi. — Pse nuk i bie drejt ti?

— E po unë e dija se fizikanët janë njerëz të zgjuar dhe jo kaq të trashë santi, ia pat Biku dhe nisi të ndihmonte shokun të vishej shpejt e shpejt.

Atë çast hyri në dhomë e emrat e Rrezartit, një grua e gjatë dhe e hollë, me një fytyrë të hequr e të dashur. Ajo mbante në dorë një tabaka me göta pijë, dhe një pjatë kristali me llokume me arra. Bikut iu duk sikur ajo të kishte qenë pas dere dhe i kishte dëgjuar bisedat e tyre.

E bëre mirë, Biku, që i erdhe. Djalit po i merret frima nga librat dhe ka harruar të thithë ajrin e pastër.

— Ndërkokë ajo u serviri likerin e llokumet.

— E po nuk është lehtë të bëhesh shkençtar! — qeshi Biku dhe, si mori në dorë gotën e pijes, e ktheu të tërë njëherësh. Pastaj mori dhe llokumin me arra e nisi ta mbillaçiste. — Vetë e keni bërë? Llokum i mirë!

— Merr edhe një tjetër, — tha e zonja e shtëpisë.

— Po të më lejoni, do të marr dy llokume.

— Merr gjithë qejf, — tha ajo duke i bërë me gisht që të merrtë ato më të goditurat.

Biku i mbledhi llokumet me një copë letër që e mori nga tryesa.

— Mos i kishte ndonjë shënim në letër? — pyeti Rrezi tek po krihej në pasqyrë.

— Jo, ore babaxhan, i kam sytë reflektor unë.

— Shkojmë! — tha rezarti, pasi ishte bërë gati. Kishte

veshur një bluzë golf të hollë leshi dhe një palë pantallona terital që i rrinin bukur pas trupit të tij të lidhur prej sportisti. Pastaj iu afroa s'ëmës dhe, si e puthi në ballë, shtoi:
— Lamtumirë, mënë e dashuri!

— Lamtumirë, mënë e Rrezartit! — thirri edhe Biku nga pragu i derës.

— E kalofshi bukur! — i uroi me buzën në gaz ajo dhe, kur ata nisën të zbrisnin shkallët, doli e i përcollti me sy derisa u larguan përtëj shtëpisë.

Të dy shokët krah për krah dolën në rrugë.. Në anën tjetër të trotuarit dy silueta vajzash qëndronin afër njëra-tjetrës dhe diç bisedonin gojë më gojë, si dy lauresha. Manushaqja e kishte kurdisur planin për mrekulli. Meritës i kishte lënë takim një çerek ore më vonë se sa Rrezartit që do ta sillte Biku, i fejuari i saj. Dhe ja, për fat të tyre punët shkuant ashtu siç i kishin menduar ajo dhe i fejuari i saj, Biku. Tani shoqja po i tregonte shoqes arsyen e takimit. Në fillim Merita, kur e mori vesh qëllimin e takimit me Manushaqen, u tregua ca si e zemëruar, por nga argumentet që përdori shoqja dhe nga mbërritja e dy djemve aq shpejt, nuk pati më kohë për biseda të tjera të tepërtë.

— Do vemi të ulemi e të pimë nga një shishe birrë dhe të dëgjojmë muzikë një copë herë te «Kurora e pishës», — tha Biku me ton të prerë dhe menjëherë i zuri nga krahët të dyja vajzat. Me shenjën që i bëri i dha të kuptonte se dhe ai patjetër duhej ta zinte nga krahu Meritën. Rezi u bind. Të ikatër u nisën buzë detit. Ishte një natë e bukur dhe e freskët. Ata ecnin tërë gëzim. Kur sapo morën kthesën për t'u ngjitur kodrës së shkallëzuar, u ndeshën me një marinar e me një vajzë. Marinari diç i thoshtë në vesh, kurse ajo qeshte pa tekli dhe me gjithë zemër. Prapa tyre shkonte një plak babaxhan me takëmin e gjuetisë së peshkut në sup dhe dukej sikur ishte roja e tyre besnike. Biku, për t'i bërë rrugë, e shkëputi Manushaqen nga Merita dhe kapërcyen njëherë dy shkallë. Rezi dhe Merita të zënë për krahu mbetën më prapa. Ajo, sapo bëri edhe dy a tri shkallë më lart, duke u shtënë sikur po këpuste një

degë mimoze që ishte zënë gjysmën e rrugës, e têrhoqi krahun nga Rezi. Dhe, kur ai deshi ta zinte përsëri, ajo belbëzoi me një buzëqeshje pak të ftohtë:

— Lidhja fizike e molekulave shpërbëhet, kurse ato kimike shndërrohen në një përbërje të re.

Rezarti paksa i habitur i tha nga pas:

— E ditkeni mirë ndryshimin midis fenomenit fizik dhe atij kimik:

— Edhe unë bëj shkollë...

Rezarti tani e kuptoï dhe e ndjeu përsëri se dashuria e Meritës ndaj tij ishte zbehur ashtu si ajo hëna atë natë që nisi të pështjellohej nga ca re që ecnin e ecnin diku pa u ndalur. Ai bluanë me vete arsyet përse ishte ndodhur kjo plasaritje. Mos vallë ngaqë ai vitin e fundit u ishte kushtuar ditë e natë studimeve dhe nuk ishte kohë të merrej me të aq sa duhej? «Jo» — thoshte me mendje. Merita e shtynte, bile e nxiste dhe e frymëzonte që të mos thyhej nga përpjekjet për zgjedhjen e diplomës, as edhe nga fjala që ishte hedhur drejtori i fabrikës se gjoja nuk i duhej fizikani. Po atëherë çfarë ishte ndodhur në ndërgjegjen e saj. Për herë të parë i shkrepit një mendim i hidhur: «Mos vallë është ndjenja e xhelozisë? Apo ndoshta kjo mendon se unë kam gjë me asistente Sofijen? Për mendimin tim do të ishte absurditet. Edhe ajo ka shqëri me shokë të punës dhe as më ká vajtur mendja për keq. E atëherë cila do të jetë arsyaja që ajo është ftohur me mua? Nuk di si ta shpjegoj!»

Kështu i kredhur në mendime të papërcaktuara ai shkonte nga pas me një hap të ngadalshëm.

Merita dukej çuditërisht e mbyllur në vetvete. Ata u ngjitën edhe disa shkallë gati afér sheshit ku ishte ndërtuar lokali «Kurora e pishës» pa hapur gojën, pastaj, sikur ajo të ishte lexuar mendimet që i zienin atij në kokë, e pyeti përsëri për punën e temës së diplomës. Këtë herë ajo foli me një ton shqëror dashamirës dhe, kur mori një përgjigje jo aq optimiste nga Rezarti, u hodh e tha:

— Dëgjo, Rezi, nuk është lehtë t'i ngjitesh malit të thepisur të shkencës. Por ti nuk duhet të qëndrosh në gjysmën e rrugës. Nuk duhet të thyhesh.

Ngriti sytë dhe vështroi qafën e tij të gjatë me muskuj të nxirë nga dielli. Ajo përfytyroi se si dikur duart e saj ishin hedhur pa druatje e me dashuri tek ai. Kurse tani një ndjenjë e hidhur i ziente përbrenda, ngaqë mendonte se një vajzë tjetër kishte zënë vendin e saj. «Sofija, ajo asistentja ia ka marrë mendjen», – bloi ajo me vete dhe ndjenja e xhelozisë atë çast e shpoi si turjelë në zemër. Por nuk ishte vetëm kjo arsyaja e ftohjes së saj ndaj Rrezartit. Kishte dhe një shkak tjetër. Ajo e dinte se Rrezarti po i ngjitej malit të thepisur të shkencës dhe ai me siguri do të arrinte në majë, se ia dinte vullnetin e hekurt, bile e kishte kuptuar qartë talentin e shokut të punës për shkençen: Mirëpo vetë ajo nuk e ndiqte dot dhe ndoshta do të bëhej pengesë për ecjen e tij përpëra. Këtë mendim Merita kurrë nuk kishte guxuar t'ia thoshtë asnjeriu, aq më tepër Rrezartit. Dhe i vërtmi ngushëllim ishte që edhe ajo të mësonte, të përfundonte maturën në kursin e natës në degën e politeknikumit të qytetit. Përveç punës si mekanike në brigadën e remontit në fabrikën e tullave, javët e fundit merre pjesë në një grup pune studimore në fushën e mekanikës.

Biku dhe Manushaqja prishnin në cepin e «Kurors së pishës».

— E, ku humbët? — pyeti Biku.
— Erdhëm! — është përgjigj thatë Rezi.
— Zëmë vend tek ajo tryza në skaj të lulishtes që përngjan si ballkon mbi detin, — ia bëri me dorë Manushaqja.

— Si thua? — është përgjigj Rezi Meriten.
— Mirë! — pranoi ajo.

Kamerieri që rrinte në këmbë në mesin e tryezave gjysmë të boshatisura i ndoqi me sy të porsaardhurit dhe u bëri me shenjë se së shpejti do të shkonte tek ata përmarrë porosinë.

Të dy çiftet zunë vend në ballkonin e «Kurors së pishës». Rezi hodhi sytë nga deti. Valët e tij, të shoqëruara me miliona e miliona stërkala që ndrisnin si margaritarë të vegjël, përplaseshin me një zhurmë të këndshme në brigjet me rërë të bardhë si kripë e bluar. Në portin e qyte-

tit të ri bregdetar vaporët e ankoruar dukeshim si yje të zbritura në tokë.

— Ja një peizazh i bukur. Këtë pamje të mrekullueshme do ta kishin zili edhe piktorët më në zë, — tha ai.

Rrezarti ktheu kokën nga Biku dhe jo pa kuptim e pa në beben e syrit.

— Është një rastësi, por një tablo të përafërt si kjo e kësaj nate pothuajse e kam përfunduar. Po zotrote, — u tall ai, — nuk ke ardhur në studion time prej kohësh.

— Marangozi piktor! — qeshi Manushaqja. Ajo e ndihmonte Bikun për krijimin e pikturës së tij në dru duke ia bojatisur thuprat e rimesos, madje herë-herë edhe ia ndryshonte ca tonacionin e ngjyrave. Por, shijet e saj estetike si mjeshtre bojaxheshë mobiljesh shpeshherë ua kalojnë atyre të Bikut. Për ndryshimin e tonacionit të ngjyrave të një kompozimi të Bikut për një betejë partizanesh kundër gjermaneve në Qafëkrrabë kishin bërë një debat të madh. Papo, kur një piktor i njohur i kishte dhënë të drejtë Manushaqes, që nga ajo ditë Biku nuk e kundërshtonte më me atë këmbënguljen e tij.

Rrezarti deshi të thoshte edhe diçka tjetër për një shokun e tij-inxhinier që ishte kthyer në romancier, por e la mendimin pa e shprehur me fjalë, se kamerieri u kishte ardhur tek koka dhe priste porosinë.

— C'urdhëroni? — pyeti kamerieri i ri simpatik me paq pion lidhur pas fytit me një këmishë mëndafshi të bardhë si borë e parë.

— E, si thoni? — iu drejtua Biku vajzave. — Birrë dhe katër bërxolla.

— Edhe katër sallatë me majonezë, — shtoi Rrezarti me buzëqeshje.

— Atëherë le ta bëjmë tamam, — ia pati Biku. — Sillni edhe katër pasta në akull pas një copë here si të mendoni që i kemi dhënë fund porosisë së parë, — dhe ia shkeli syrin kamerierit të sjellshëm që shkruante atë çast në një bllok të veçantë llogarje.

Orkestra nisi t'i binte një pjesë të muzikës së lehtë. Tingujt e violinës, të sakosit, të fizarmonikës, dhe të pianos herë vinin më të lartë dhe herë me tonacion më të ulët.

Mbi drurët dekorativë vareshin ca llamba të stilit të viteve të para të shekullit të njëzetë. Megjithatë ndriçimi nuk të vriste sytë, pasi hapësira e madhe me drurë e pemë e gjallberonte atë. Dhe pikërisht Rrezi po e vrojtonte këtë fenomen, fuqinë dhe shpejtësinë e dritave natyrale e artificiale në hapësirë e në kohë. Ishte ditë jave dhe pak vizitorë kishte në lulishte. Midis tryezave të rralla me njerëz disa çifte kuvendorin me zë të ulët duke u zgjatur nga njëri-tjetri. Kurse muzikantët dukeshin sikur po u binin veglave për qejfin e vet. Ngandonjëherë e ndërronin me muzikë popullore.

Në tavolinën e Rrezit bëheshin copëra bisedash të shkëputura. Rrezarti iu përgjigj pyetjeve të Meritës për shkallën e punimeve në ndërtimin e aparatit të gamadefektoskopisë që ishte kooperuar me specialistët e oficinës së radiologjisë. Kurse Bikut i jepte shpjegime për dobinë e këtij aparati në industrinë mekanike. Dhe biseda që ngjalli më tepër interes ishte prodhimi i kobaltit në kombinatin «Çeliku i Partisë» dhe kthimi i tij në reaktorin bërthamor si element radioaktiv. Manushaqja kërkoi të dinte përdorimin e rezatimëve të kobaltit në shërimin e sëmundjeve kanceroze. Biku ndërroi bisedën duke treguar novacionin e madh në agroteknikë përkultivimin e ullinjeve të rinj me rendimente të larta dhe që nuk e njihnin me shterpësinë. Por ai gjëzohej nga ky revolucion agroteknik edhe për arsyen se trungjet e ullinjeve shekullorë kishin nisur të nxirrin ri-mesa nga më specialet që ai i quante «rimeso të pavdekshme». Në këto biseda, më e përbajtur ishte Merita, Rrezarti e merrte me mend se në ndërgjegjen e saj diçka kiste ndodhur. Dhe, duke qenë në ankthin e këtyre mendimeve të turbullta përfatet e dashurisë së tyre, ai lëshoi një «bombë me tym», siç e quajti më vonë Biku.

— Kam shpikur një «aparat» me rreze të padukshme që dikton se çfarë fshihet brenda në ndërgjegjen e njeriut. Dhe këtë eksperiment do t’ia bëj për herë të parë Meritës... Atë çast u afrua kamerierin me tabakanë plot e përplot.

Rrezarti e vështroi kamerierin pak si i druatjatur, por ai e kuptoi dhe tha:

— Duhet edhe të qeshim... E qeshura të zgjat jetën.

– Le ta pimë këtë gotë për shëndetin e miqësisë tonë,
– tha Biku që i jepte vetes të drejtën e dollibashit, meqë
ai ishte organizatori i asaj mbrëmjeje.

Pas pak Merita befas ngriti gotën dhe me një buzë-qeshje që i endej në fytyrë, duke bërë paksa një lëvizje të kokës nga prapa për të hedhur flokët anash, tha:

– E ngremë këtë dolli për suksesin e diplomës së fizikanit bërthamor, Rrezart Detit. – Ajo i shqiptoi fjalët me njëfarë lirizmi ku vërehej sinqeriteti i vërtetë.

Rrezartin e hutoi dhe e preku zëri aq miqësor i saj dhe e vështroi plot ngrohtësi.

– Eh, ju falem nderit! – tha Rezi duke ngritur edhe ai një dolli. – Ju ftoj ta ngremë këtë dolli, – tha Rrezarti, – për Partinë tonë që i priu lirisë së popullit, që po i prin popullit për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Asaj ia detyrojmë të gjitha...

– Shëndet Partisë sonël – tha i pari Bik marangozi dhe pas tij lëshuan urime edhe të tjerët.

– Të rrojë Partial!

– Shëndet Partisë, të rrojë sa malet tonë, – tha Merita që atë çast u ngrit në këmbë dhe piu gotën e birrës.

Rrezarti e vështroi me dashuri.

Pasi biseduan për një kohë të gjatë, kur po hanin pasta në akull, një burrë shtatlartë e thatim, rrëth të dyzetave, me një veshje elegante, ulur aty në një tryezë ngjitur tyre, me kafe dhe një shishe ujë gline përpara, u zgjat nga Rrezarti me një vështrim pak si të çakërdisur e, duke ju marrë goja, belbzëzi:

– Mos jeni ju sal.. da... tori fizi...kan?

– Jam saldator, por edhe fizikan mund të bëhem, – iu përgjigj Rezi me njëfarë toni ironik dhe me vete u përpoq të sillte ndër mend se ku mund ta kishte parë këtë njeri.

– Unë jam tekniku i qelqit në laboratorin e kimisë aty ngjitur me ju, – tha i panjohuri.

– Nuk të kam parë me të vërtetë asnjëherë, – i tha Rrezarti dhe u kthye nga shokët e tij.

– Kurse unë të njoh, ti je ai studenti i talentuar që nuk të heq nga goja ajo asistentja e katedrës së fizikës,

So...fija: Mua më quajnë Kalem Zenuni, ti do trokasësh patjetër një ditë në derën time... ehe... se si unë s'ka mjeshtër qelqi në shkencat e natyrës, — dhe, kur pa se nuk po ia varnin, ngriti dorën duke e tundur në ajër, thirri kamerierin e i tha: — Sillu nga unë këtyre miqve katër kafe e katër ujë gline.

— Nuk duam asgjë. Do të ngrihem, — tha Rrezarti pa e kthyer më kokën nga ai. Dhe atë sekondë kapi shikimin hetues të Meritës.

Biku shtrembëroi buzët dhe me zë të ulët tha:

— Çfarë llafazani qenkal

— Duket çakërrqejf, — belbëzoi Manushaqja.

Kamerieri erdhi te tryesa e tyre dhe, sì bëri illogarinë në një copë letër, mori paratë dhe u largua. Kur ata nisën të largoheshin, Kalemi nisi të recitonte ca vargje me sytë ngritur nga llamba neon që i varej mbi kokë:

...Derdhmëni, o llamba, mendime të mëdha,
ide vërtitëse turbinash kolosale,
llamba të mesnatës...

Të dy çiftet, shend e verë, zbritën po nga ato shkallë që ishin ngjitur te «Kurora e pishës. Me të zbritur në bullevard, pasi shkëmbyen edhe ca shaka me njëri-tjetrin, u ndanë. Biku dhe Manushaqja u larguan në drejtim të rrugës së madhe të asfaltuar ku zbardhnin pallatet gjashtëkatëshe me ballkonte të panumërtë e me dritare që ndrisnin si yje. Ato zbusnin ca vellon e mugëtirës së natës me atë bardhësinë e tyre të tullave silikate. Rrezarti e shoqëroi Meritën për në shtëpinë e saj.

— Merita, desha të bisedoj me ty për diçka shumë serioze, — i tha Rrezarti duke e vështruar në sy, kur u afruan pranë shtëpisë së saj.

— Është vonë! — iu përgjigj ajo. — Ti nuk ke kohë, se edhe do të studiosh ende. Pastaj ç'nevojë ka për fjalë, Rrezi?! Le ta lëmë kohën të na provojë, — tha ajo me njëfarë vendosmërie.

Rrezarti nuk kundërshtoi më, bile s'foli asnjë fjalë. Ai e mendonte dashurinë si një fenomen që duhet të rrjedhë

lirshäm nga tē dy anët duke e çuar ujin nē një kah tē vijës së mullirit. Bluante me vete dhe e shtrydhte mendjen se mos zbulonte tē fshehtën që ndryhej nē ndërgjegjen e Meritës. Mos vallë ajo priste që ai tē përfundonte provimet e diplomës dhe deri atëherë tē mos bëhej pengesë, apo mos kërkonte që ta nxiste sa tē mbaronte fakultetin dhe pastaj... «Jo! — tha ai me mendje. — Nuk është as e para, as e dyta dhe as e treta. Me sa duket ajo ka nisur tē ndërrojë dhe ajo miqësia me manovratorin e automjetit eksperimentues për kursimin e lëndës djegëse tē karburantit edhe mua nuk më pëlqen. Pse vetëm ajo paska tē drejtë tē bëhet xhelozë? Ia lëmë kohës dhe rrjedhjes së ngjarjeve.»

— Natën e mirë, Rezi! — tha Merita me një buzëqe-shje tē vakët.

Rezi shikoi shprehjen e fytyrës së saj që nuk po dinte tē fshihje ndjenjat e kundërtë që i zienin përbrenda. Ai vuri menjëherë dorën e djathëtë mbi supin e saj si tē derdhur me mermer dhe po i afrohej si me magnet fytyrës së saj tē ndezur prush.

— Jo tashti..., — pëshpëriti ajo dhe u shkëput prej tij si thëllëzë e trembur nga gjuetari. — Mirupafshim, Rezi!

— Mirupafshim! — iu përgjigj Rezi pasi ajo mbylli portën me ngadalë.

KAPITULLI IV

Edhe ai mëngjes i freskët që ia ngjethte ca trupin, e gjeti Rrezin mbi librat dhe dispensat e fizikës bërthamore. Doli në ballkonin e vogël dhe, duke hapur dhe mbyllur krahët e duke thithur ajrin e pastër, vështronë rrezet e diellit. Ja, — thoshte ai me mendje. — Rrezet e diellit kur ndeshin me ajrin e me ujin, i ngrohin ato, kurse natyra e rrezeve gama është e një lloji tjetër. Bota e rrezatimit është e mahnitshme dhe njeriu çdo ditë përpinqet gjithnjë e më shumë të zbulojë të fshehtat e tyre dhe ligjet që rregullojnë këtë kompleks mekanizmash t'i përdorë në dobi të njërit.

Rrezarti qyshtë në moshë të re, në tetëvjeçare dhe në vitet e gjimnazit, nisi të tregonte një interes e pasion të veçantë përfizikën dhe përpinqej të arsyetonte e të argumentonte lëvizjet e trupave, bile atë e tërhoqën edhe më tepër lëvizjet e shpejtësítë e rrezeve. Por, ajo që ia kishte pushtuar mendjen ishte përdorimi praktik dhe i dobishëm i rrezatimeve radioaktive të padukshme përfshirë përsosur tek-

nologjinë e prodhimit dhe për të lehtësuar punën e shokëve të tij punëtorë. Për ongenoskopinë e saldimeve që kryente ai dhe shokët e tij saldatorë kishte menduar që në vitin e tretë të gjimmazit kur nisi të lexonte diçka për natyrën e tyre. Më vonë në vitin e fundit të Fakultetit të Fizikës, kur ai ishte njohur shkencërisht e thellë me rezatimet radioaktive që emetonte bërthama e atomit dhe kur kishte lexuar e kuptuar parimet e zbërthimet e tyre dhe për gamadefektoskopinë që kontrollonte në thellësi saldimin e çeliqeve, ai kishte qeshur me naivitetin e tij. Rezi e mori vesh mirë se, për të zbuluar të fshehta të reja, i duhej të lodhej shumë e të dërsitej shumë e shumë për të studiuar e përvetësuar së pari atë shkencë që shekuj e shekuj me radhë ishte lodhur njerëzimi të zbulonte dhe pastaj të shtrydhite trurin nëse ishte i zoti të zbulonte ndonjë të fshehtë që ende kishte mbetur pa dritë. Por, pavarësisht se gamadefektoskopia ishte shkruar në libra, bile kishte dhe vizatime për ndërtimet e aparatit (ai kishte prekur një aparat të këtij lloji që kishin përdorur specialistët e huaj në azotik apo në montimet në metalurgji), por pikërisht ky aparat nuk gjendej në duart e tyre. Dhe kishte kohë që po vriste mendjen që të ndërtonte një aparat të tillë. Nëse e quante ose jo punë shkencore këtë profesor Koti, aq i bënte atij dhe saldatorëve të tjerë. Ai aparat duhej prodhuar në vend. Nga ana tjetër ai mbartte edhe mëndimin e profesor Buronit, të këtij fizikani të shquar të universitetit dhe sipas Rrezartit ku e ku më i thelluar se ai tjetri, se ndërtimi i këtij aparatit me forcat e veta, në kushtet teknike e materiale të vendit, ishte një punë e lavdërueshme shkencore dhe i sillte dobi prodhimit. Kjo i mjaftonte atij që të punonte e të djersinte që t'ia arrinte qëllimit. Dhe jo vetëm kaq, por profesor Buroni i kishte premtuar se do ta lidhte me fizikanët e laboratorit bërthamor që të zgjidhnin edhe problemet e tjera që kishin të bënin me përdorimin e lëndës radioaktive në aparat. Rezi priste që atë ditë të hynte më në fund në derën e laboratorit bërthamor. Me veten e tij ndiente një emocion të paprovuar, por edhe njëfarë druajtjeje se mos e nën-vleftesonin fizikanët e përgatitur. Ndoshta idetë e tij mund

të ishin të pazbatueshme apo të parakohshme. Ndërkoħe që i mendonte të gjithā kēto, ia kishte nisur tē bēnte disa lēvizje gjimnastikore duke ecur e duke kērcyer nē vend pa e pasur mendjen se ċfarë lēvizjesh po bēnte.

E ēma kishte njē copē herē qē po rrintek nē derē me tabaka nē dorē me mēngjesin tē pērgatituk pēr tē birin. Ajo po e vēshtron te habitur dhe ca e merakosur pēr shēndetin e tij. Dhe shqetēsimin mē tē madh ajo nēnē e dhembshur, qē e kishte lēnē i shoqi tē vetmē para kohe e qē kishte varur shpresat e jetēs te djali i vetmē, e kishte se mos nga lodhja e studimet e tepērtta Rrezarti mund tē pēsonite gjēkafshē. Por e largoi shpejt atē mendim kur pa shpatullat e tij tē forta dhe qeshi duke bellbēzuar me vete: «Ēshtē i shēndetshēm dhe pērballon ċdo gjē.» Si bēri dy a tri hapa brenda nē dhomē, thirri:

— Rrezart, tē solla mēngjesin! — dhe, si largoi me kujdes ca libra, vendosi tabakanē nē njē cep tē tryezēs.

— Oh... ti qenke, nēnēl — tha befas Rrezi. — Tē falem nderit! — shtoi ai dhe hyri brenda nē dhomē. U ul nē njē karrige dhe nisi tē hante mēngjesin: vezē tē fēr-guar me vaj ulliri, njē gotē qumēsht dhe njē copē bukē.

— Dägħo kētu, Rrezart! Edhe drekēn ta kam bērē gati, e ke tē mbuluar nē kuzhinē. Unē po shkoj. Sot do tē vohnem, prandaj ha vetmē. Jemi lajmēruar pēr njē mbledhje tē kolektivit mbi pērfundimet e kontrollit punētor pēr cilēsinē e konfeksioneve pēr eksport, — tha ajo dhe, si u bē gati tē largohej, diç deshi tē thoshte, por u mjaftua me njē ghest qē bēri me dorē.

— Nēnēl — thirri Rrezarti.

— Ċfarē? — pyeti ajo dhe qēndroi nē prag tē derēs duke u kthyer nga i biri me duart hapur sikur prisnin ndonjē ngjarje tē gēzuar, nga ato qē prej disa kohēsh i dēshironte zemra.

— Tē falem nderit, nēnē, shumē shumē...

Nēna qeshi e lumtur.

— Martohu, Rrezart, se do tē mbetesh vetmē! — Ajo e vēshtroi me njēfarē qortimi dhe qeshi me hidhērim. — Ti e di se kētē vit do tē dal nē pension dhe, tē them tē

drejtën, atë kohë që mbetet për të jetuar, do ta përdor përvete. Jam e lodhur nga puna në rrobaqepësi:

- Edhe këtë vit, nënë... — Pastaj u kujtua dhe shtoi:
- Pra do të më lësh vetëm. Por çfarë do të bësh?
- Do të lexoj libra dhe do të shëtis me shoqet e mia,
- vuri buzën në gaz ajo.
- Po premtimin e dhënë se fëmijën e parë do të ma rrisësh ti? — e pyeti i biri që i ishte afruar s'ëmës dhe e vështronte në sy.

Fytyra e nënës shkëlqeu nga lumturia. — Mirë pra, martohu, se fëmijën e parë do ta rris unë, — tha dhe u largua lehtë në errësirën e korridorit.

Rrezarti dëgjoi nga prapa kërcëllimën e derës së jash-tme dhe fjalën e saj që u përhap si erë lulesh në kthinat e shtëpisë, «Lamtumirë, bir..., lamtumirë...»

Rrezarti, si mbaroi së ngrëni, u kthyte përsëri te lëndët e diplomës. Krahas kapitujve për zbatimin e metodave bër-thamore në teknikë, ai kishte vendosur që ato ditë të studionte edhe lëndën e filozofisë marksiste, veçanërisht teori-në e praktikën e PPSH kundër rrymave e versioneve të reja të revizionizmit modern.

KAPITULLI V

Pasi dha provimet e fundit, Rrezarti u mor më shumë me studimin e projektimin, bile edhe me vetë ndërtimin e aparateve eksperimentuese radioaktive për furrat e çimentos dhe për aparatin e gamadefektoskopisë. Me këtë të fundit ai bashkëpunonte me inxhinier Besnikun dhe dy axhustatorë të njojur në radhët e novatorëve të qytetit. Ai nuk e vriste më mendjen për temën e diplomës, por me fjalën që i kishte dhënë profesor Buronit, ato punime që po kryente ai bashkë me grupin e fizikanëve të Laboratorit Bërthamor D 6, do të përbënин edhe temën kryesore të diplomës së tij.

Atë ditë që u kthye në punë usta Sala e rroku me të dyja duart, e përqafoi dhe i tha:

- Rrezart, u ktheve, mor djalë? Po kur do t'i japësh fund asaj diplome, mor bir?
- Ka kohë, usta. Pse si është puna?
- Pse, s'e ke marrë vesh ti? — pyeti usta Sala.
- Për çfarë është fjala?
- Na kanë kërkuar të vemi në metalurgji për ca sal-

dime tepër të ndërlikuara që dikur i bënин vetëm specialistët që vinin nga jashtë.

Fytyra e usta Salës kishte marrë një hije të rëndë dhe shprehja e syve të futur si dy gropat e vogla në ballin e gjerë me rrudha, të linte përshtypjen se një brengë e mundonte shpirtin e tij.

— Po vemi, usta, i përfundojmë, — tha me vendosmëri Rezzi.

— Kërkohen saldatorë me patentë ndërkombëtare për ngjitjen e sferave të çelikut me presione shumë të larta. Fabrika numër 12, — tha paksa i hutuar usta Sala, duke i shoqëruar fjalët dhe me mimikën e fytyrës së përcelluar nga shkëndijat e saldimeve të panumërtë që kishte bërë gjatë njëzet e dy vjetëve si saldator, i kërkon shpejt...

— Zanati byzylyk floriri! — tha Rezarti dhe në fytyrë iu end buzëqeshja e një gjëzimi të brendshëm.

Usta Sala e vështroi thellë sikur të ishte ndonjë psikolog që studionte ndërgjegjen e nxënësit të tij. Heshtja zgjati disa sekonda. Sala nisi diç të belbëzonite.

— Çfarë ke që përpëlitesh! — i tha Rezzi dhe, kur vuri re që ai përsëri e qepi gojën, shtoi: — Ti ke duar të arta dhe i qep si me tegel saldimet. Ta jap unë patentën ndërkombëtare të saldatorit, — i tha Rezzi.

— Unë, Xani, Besa dhe ca shokë të tjerë saldatorë nisemi pasnesër për në metalurgji... kurse për ty ndoshta nuk do të jetë nevoja. Hajt, hajt, bëhu shkencëtar, se u pa puna jote.

— Po qe nevoja, edhe unë jam gati të vij me ju tanë ose edhe më vonë. E shtyj mbrojtjen e diplomës, — tha Rezarti me një shprehje cilitërsie që nuk linte as dyshimin më të vogël.

Të dy shokët u larguan mënjanë për t'i bërë rrugë një grupi të rinjsh që zbritën me bicikleta duke qeshur e duke thumbuar njëri-tjetrin. Ata vazhduan bisedën.

— Ti e di, — tha usta Sala duke ngritur jakën e xhatketës dhe duke kolovitur kokën e stërgjatë me flokë të rrallë e diku të thinjur. — I gjithë halli është se ata të mammalikuar specialistë të huaj përdornin edhe atë aparatin me reze të padukshme për të kontrolluar ngjitjen deri në

zemër të çelikut. Kurse nuk e kemi atë aparat. Po me sferat e presionit të lartë nuk bëhet shaka. U dashka shkenca, o vëllaçkol! Po hajt e thuaj kësaj kokës sime, — i binte Sala me çökën e dorës herë ballit e herë tëmthit.

— Ja prai se sa i domosdoshëm bëhej ndërtimi i aparatit të gamadefektoskopisë në gjendjen e krijuar. Rrezarti me një vështrim të menduar që atë çast e hodhi diku lart në horizont, lëmoi flakët bojëgështenjë dhe me dorën tjetër u mbështet lehtë te supi i usta Salës, pastaj u kthyte nga shoku dhe tha:

— Usta, unë do të bëj qmos me aq sa më vjen për duarsh të ndërtoj aparatin me rreze të padukshme. Por kjo nuk varet vetëm nga unë dhe inxhinier Besniku që ka marrë përsipër të më ndihmojë. Kryesori është laboratori i fizikës bërthamore...

— Shkoj unë qysh nesër te profesor Buron Gurra dhe, po të duash, edhe në Akademinë e Shkencave, — ia priti usta Sala dhe po vetë u përgjigj: — Unë e dì që ata janë gati ta bëjnë natën ditë.

— Nuk është nevoja, Salë. Profesor Buroni ka caktuar dy fizikanë që merrën bashkë me ne për ndërtimin e këtij aparatit. Do të shkoj nesër në laborator bashkë me inxhinierin e oficinës së radiologjisë dhe do të vendosim të shpejtojmë punët. — Atë çast atij iu kujtua hezitimi, bile deri kundërshtimi i hapur i profesorit tjetër, Diosten Kotit, për pamundësinë e prodhimit të aparatit të gamadefektoskopisë. Por Rezi këtë nuk ia tha, se nuk deshi ta zgjaste bisedën.

— E po mirë atëhere. Në Elbasan s'ipo të marrim. Po shkoj vetë. Megjithatë, të të them të drejtën, nuk u besoj shumë duarve të mia dhe të desha pranë... Po atë aparatit e dua nga ti. Hajde, mirë mbetsh, se po shkoj në drejtori dhe do të bëhem gati...

— Udhë e mbarë dhe dalsh faqe bardhë! — i tha Rrezarti duke i shtrënguar miqësisht dorën.

Atë mbrëmje kandidati diplomat u kthyte në shtëpi i kredhur në mendime. Ai bluanë në kokë skemat e ndër-

timit tē labirintit tē kapsollës ku do tē vendosej lënda radioaktive nē aparat.

Kur Rrezarti hyri nē dhomën e tij, qëndroi një copë herë duke vështruar tē ëmën që ishte ulur nē karrigen e tij dhe po shfletonte librat mbi tryezë. Fshesën e kishte mbështetur nē njérin gju. Ai u habit dhe buzëqeshi me vete. Ishte hera e parë që nëna po u hidhët një sy atyre librave shkencorë tē pakapshëm pér tē. Rrezarti, ndonjëherë, kur uleshin nē tryezë pér tē ngrënë drekën ose dar-kën ose pranë televizorit tek shikonin ndonjë program interesant, i fliste me fjalë tē thjeshta pér ato dijet e fizikës bërthamore që përbanin ata libra dhe që ai i studionte.

E ëma e ndjeu tē birin dhe, pa kthyer kokën prapa, pyeti:

— U kthevë, Rrezart? — dhe pás dy a tri sekondash vâzhdoj po më atë qëndrim: — Një punë tē vështirë i ke hyrë, or birl Të gjithë këta libra do tē futësh nē kokë? Mundim i madhi! Yt atë, ndjestë pastë, kishte qejf që ti tē bëheshe njeri i ditur...

Rrezarti shtriu krahët e tij tē gjatë, e pushtoi tē ëmën më dashuri dhe e puthi nē kokë.

— Si duket e paskemi pasur nē gjakun e fisit..., — tha me zë tē ulët.

— Aty ku nuk ka miell, nuk gatuhen bukët, — lu përgjigj e ëma që u kthyë përballë tē birit duke e vështruar seriozisht nē sy. — Yt atë i ka gdhendur ato rafitet nē mur, bille edhe këtë shtëpi e 'ka ndërtuar me duart e veta, bashkë me tē atin, gjyshin tënd tē ardhur këtu e tetëdhjetë vjet më parë nga malësia e thellë e Shëngjergjit. Ti e ke parë shtëpinë dhe mobiljet që ka ndërtuar me djemtë e tij xhaixai yt nē malësi, që ua kalojnë edhe mjeshtërve më tē mëdhenj.

— A e di, nënë, se ky është një mendim i thellë! — tha befas Rezi duke kujtar një debat që para ca kohësh ishte bërë nē katedrën e fizikës me një rreth studentësh e pedagogësh mbi trashëgiminë e prirjeve.

— Veç një gjë nuk e ke mirë, or bir, — qeshi e ëma

dhe u ngrit tē fshinte dhamēn. — Ti nuk kujtohesh tē fshish, Rezart, nuk e sheh që tē ka mbuluar pluhuri?

— Saipo tē mbaroj këto provimet e diplomës, do tē më shohësh, nënë, se çfarë amvise e mirë do tē bëhem...

— Do tē shohim! — iu përgjigj e ëma buzagaz me kokën ulur duke fshirë tryezën. — Paske nisur tē pish cigarette? — pyeti ajo kur nxori më fshesë një fund cigarette tē shtypur me këmbë.

— Në tē rrallë, nënë. Më duket sikur...

— Do tē tē bëhet ves!

— Do tē përpinqem tē mos pi ose shumë rrallë, — i tha i biri që atë çast kishte marrë në dorë nga rafti numrin e fundit tē revistës «Ylli» që e kishte kolëksion dhe po i hidhte një sy një artikulli mbi punën shkencore tē Sami Frashërit.

— Mos nis tē hapësh librat, se nuk ke kohël — i tha e ëma dhe ia mori nga dora revistën. — Mos ke harruar?

— Çfarë?! — pyeti Rezi paksa i habitur.

— E po je ftuar për darkë te profesor Heta... si është ajo vajza e tij, Sofija? — e pyeti e ëma atë çast dhe qëndroi me fshesën në dorë duke vështruar në sy tē birin se mos nxirre gjë nga efekti që mund t'i bënin fjalët e saj.

— Ah, po, nënël Sofija, e bija, feston sante ditëlin-djen. Ajo është asistente në universitet dhe më ka ndihmuar në punën time tē mësimit. — Pasi heshti një copë herë me një mendim tē turbullt e tē papërcaktuar, shtoi: — Asgjë tjetër, nënël

— Hajt, përgatitul Vish kostumin e ri, — i tha ajo dhe, si kishte mbaruar së fshiri, u largua nga dhoma e tij. Ja, po shkoj në bahçë dhe po mbledh ca trëndafila e karafila që nuk i ka kush.

Ajo doli nga dhoma për tē këputur lulet në bahçen e saj që e njihën në tërë lagjen. Ajo ishte shumë e dhënë pas luleve.

— Më tē vërtetë një buketë me lule tē mrekullueshme! — tha Rezi kur pa tē ëmën që hyri në dhomën e tij me lulet në dorë.

— Të thashë unë se kjo është një dhuratë e bukur!

— Ti ke mendime tē mrekullueshme, nënël — i tha Rezi dhe, si e puthi në ballë, doli nga shtëpia me buketën e luleve në dorë.

Muzgu i mbrëmjes kishte hedhur mbi qytet një vello bojëmanushaqe. Pallatet e mijëra dritare e ballkone kishin nisur tē ndrisnin; kurse në rrugë tek-tuk dukej ndonjë njeri. Bëri një copë rrugë duke parakaluar pallatet dhe doli në rrugë ku midis ndërtesave gjashtëkatëshe kishte edhe vila tē rrëthuara me bahçë tē vogla me lule e pemë. «Ja, kjo është me siguri shtëpia e profesorit!» — tha ai me mendje dhe qëndroi para një dere me kangjella druri. Pa orën e dorës e belbëzoi me vete: «Shtatë fiks». Dritat e dhomave tē vilës ndrisnin me ca rrëze tē zbehtë lulet e kurorat e varura tē një mimoze. Ay hyri brenda në oborr dhe, si u mendua ca, shtypi butonin e ziles: Dera u hap e aty u duk Sofija sikur tē kishte qenë aty imbas dere.

— Mirë se erdhel — i tha ajo buzëqeshur e me një ciltërsi ia zgjati dorën me krahun e zhveshur deri në sup. Kishte veshur një fustan mëndafshi tē stampuar me trëndafila e karafila që i rrinte dérdhur pas trupit tē bukur. Flokët i kishte ngritur kurorë.

— Mirëmbrëmal — tha Rezarti me zë tē ulët dhe pak si i druajtur.

Sofija e shoqëroi mysaffirin derisa mbërritën në dhomën e pritjes:

— Më gëzove që erdhe — i tha ajo. — Apo ç'lule më paske sjellë. Të falem nderit, Rezart.

— T'i ka zgjedhur nëna, — i tha buzagaz e me ciltërsi Rezarti duke hyrë në dhomën e pritjes. Dhoma që shtruar me sixhade, me mobilje e me disa kuadro varur mureve. Mbi tryezën me këmbë tē kurbuara, mbuluar me xham kris-tali, ishte vendosur një portret me ngjyra i poetit Naim Frashëri. Sjtë e ndritur tē poetit tē madh dukeshin sikur e vështronin mysaffirin e ulur në një kolltuk përballë. Në faqen e murit, në tē majtë, varej një grafikë e Durrësit antik. Dhe nën tē ishte vendosur një pianoforte me kapakun gjysmë tē hapur, kurse në cep tē saj Rezartit i zuri syri fotografinë e Beethovenit, vënë në një kornizë metalike.

— Unë jam mysafiri i parë? — pyeti Rrezarti me buzëqeshjen që i endej në fytyrë.

— Po. Ti je mysafiri i parë bile miku i veçantë! — iu përgjigj ajo dhe afroi karrigen më afër tij.

Rrezarti tanë po kuptonte se asistentja kishte edhe ndjenja të tjera! Përveç ndihmës që i jepte në studimet e tij, miqësia e saj ndaj tij po i kalonte ca caqet. Ai e vuri re fytyrën e saj vezake të hequr me ato faqet e pudrosura e të lyera me krem që i shkëlqenin dhe sytë e saj si të ngrirë si me ballsam që ia kishte ngulitur atij çuditërisht. Ai u lutua ca dhe për ta thyer atë gjendje të krijuar, me një shpejtësi drite, u mundua të thoshte diçka.

— M'u dashka një punë e madhe për të përvetësuar kapitullin e reaksioneve zinxhir bërthamor të kontrolluara!

Sofija e vështroi vëngër, por megjithatë nuk u dha.

— Më pëlqen poezia e Naimitl — tha ajo duke vështruar portretin e poetit.

— Megjithëse ato poezi i përkasin një shekulli të kaluar, prapëseprapë ato vargje me aq ndjenjë e dashuri për atdheun të lënë mbresa të pashlyeshme në zemër.

— Ato të ingjallin edhe ndjenjën e dashurisë..., — tha ajo.

— Të dashurisë romantike, — qeshi Rrezi.

— Më pëlqen poezia dhe muzika pavarësisht se jam fizikane!

— Por edhe krijimtaria shkencore është një poezi!

Rrezi pa se Sofija u shtang.

— Njëherë e një kohë kam thurur edhe unë vargje e bille vargje ndjenjash! Po ti, Rrezart — e pyeti ajo befas, — mos ke sjellë bashkë me buketën e luleve edhe ndonjë varg të bukur? — Dhe atë çast afroi fytyrën nga vajza në tryezë dhe u mori erë trëndafilave e karafilave.

Rrezartit i ndërroi ngjyra bojë gruri e fytyrës dhe nisi të bëhej lulekuqe kur ajo u ngrit papritmas dhe me krahët e hapur drejt tij sikur po e përpinte, u zgjat nga rafti i futur në mur dhe mori një libër me poezi. Pastaj u ul përsëri në kollukun e saj dhe, si shfletoi disa faqe, nisi të recitonte ca vargje të shkëputura dashurie...

— Vargjet e Lazgushitl — tha Rrezarti.

— Po kjo tjetra? — pyeti ajo dhe me një zë të hollë nisi përsëri të recitonte.

— Këto nuk e di kush i ka shkruar, — ia pati Rrezi dhe qeshi. — Mua për veten time më pëlqen romanin. Një shoku im nga radhët e punëtorëve ka shkruar një roman të bukur. Ma dha ta lexoj. Tani është në shtyp.

Safija atë çast mbylli sytë dhe diç mendoi me vete. Rrezit iu duk sikur ajo nuk donte të shihte reagimin e ndjenjave të tij.

— Po nuk m'u përgjigje, Rrezart, ke shkruar ndonjëherë poezi, apo jo?

— Të them të drejtën, poezi nuk kam shkruar ndonjëherë, tregime po...

— A i ke dërguar për botim?

— Nuk kam pasur guxim t'i dërgoj asgjékundi...

— Për çfarë ke shkruar?

— Për Luftën Nacionalçlirimtare. Fabula është mbësh-tetur në të vërteta historike. Ja njëri nga këto tregime: Komisari partizan çau rrëthimin. Mirëpo, kur pâ se shokët e tij ende gjendeshin në darën e armikut, u kthye përsëri dhe pas një beteje të ashpër, ku u dha mundësinë shokëve të shpartallonin rrëthimin, ai vetë ra në fushën e nderit.

— Një tregim tragjik, — tha ajo e menduar.

— Heronjtë Jetojnë gjithmonë midis nesh, si gjatë betejave të pûnës ashtu edhe në ditë festash e gëzimesh. — Rrezarti e vështroi në sy për të ikuptuar efektin e fjalëve të tij. Nga ana tjetër i erdhi mirë që biseda ndërroi tonin.

— Ashtu është! Heroizmi i popullit tonë ndër shekuj kurdoherë ka qenë dhe mbetet burim fryshtimi për veprat të rëja:

Atë çast nga kthina tjetër ngjitur me të tyren erdhi babai i Sofijes, një burrë thatim e shëndetlig që vuante një jetë të tërë nga ulçera.

— Aha, kush na paska ardhur! — tha ai me një ton të gëzuar.

Rrezarti u ngrit në këmbë si i zënë ngushtë kur pa të

zotin e shtëpisë që hyri brenda në dhomën e pritjes ashtu befas.

— Baba, — thirri pa tekli Sofija, — ky është kandidati i ardhshëm i shkencave bërthamore, për të cilin të kam folur, Rrezart Deti.

Profesor Heta ia zgjati dorën miqësisht.

— Gëzohem së tepërmë që po ju njoh! — Në zërin e tij ndihet ajo etika e një kohe të vjetër që ruhej me kujdes në atë shtëpi.

— Rrezart Deti është një fizikan i talentuar! — shpërtheu Sofija duke e shikuar me buzën në gaz mikun e saj.

— Të them të drejtën, më pëlqejnë njerëzit e talentuar, se janë, sipas meje, shprehja e sintetizuar e koncize e një shoqërie.

— Oh... jo... jo, profesori! Më duket se shoqja asistente po e tepron, — u përgjigj Rrezarti me njëfarë ndrydhjeje në vetvete dhe me një vështrim të butë mirësjelljeje. Pastaj vazhdoi: — Nuk jam veçse një fillestar në fushën e shkençës dhe ende nuk di nëse do të jem i dobishëm për shoqërinë.

— Më pëlqen modestia juaj, djalosh! — tha i zoti i shtëpisë me një ton atëror. Mori në dorë gotën e pijes që ia mbushi e bija, e çiku me mysafirin dhe shtoi: — Për shëndetin tuaj! Por, siç më ka treguar asistentja Juaj, — ai atë sekondë shikoi me bisht të syrit të bijën, — jujeni një reze e padukshme që një ditë do të hidhni në erë një fuçi baruti, — qeshi ai dhe, si piu vëtëm një gllënjkë, la gotën në tryezë e me dorën tjetër i ra në sup miqësisht mysafirit.

— Kështu më thonë si me shaka edhe shokët e fabrikës, tha pak si i turpëruar Rrezarti.

— Hipotezat nuk i trilloj! — tha befas profesori duke vështruar mbi xamat e syzeve.

— Njutoni, — belbëzoi duke vënë buzën në gaz Rrezarti.

— Pikërisht ai, babai i fizikës, e ka thënë këtë. Kurse unë po konstatoj se asistentja juaj nuk paska gabuar në gjykimin e saj.

— Baba..., — ia pati Sofija me një buzqeshje shpërthyese.

— Më falni, po largohem, se kam lënë vetëm shokun tim, profesor Ervinin. Besoj se e keni dëgjuar shkencëtarin tonë të shquar në studimet etimologjike në fushë të gjuhës shqipe.

— E njoh! — u përgjigj me një ton sigurie Rrezarti. — Kam lexuar diçka nga studimet etimologjike në fushën e gjuhës shqipe, që është me të vërtetë një punë e madhe shkencore. Në këtë studim profesor Ervini me kompetencë e me dorë të sigurt prej shkencëtarë i ka kthyer gjuhës shqipe shumë fjalë që mbaheshin të huaja ose të papëraktuara dhe bile përtej fushës gjuhësore, punimet e tij janë me vlera të mëdha edhe për njohjen e kulturës shqiptare në një vështrim më të gjérë.

Sofija paksa e habitur ndiqte me kujdes fjalët që thoshte miku i saj dhe, kur ai e tha mendimin e tij të ngjeshur, ajo rrotulloi sytë nga i ati për të kapur përshtypjen që la tek ai.

— Shumë bukur e përblohdhët! Vepra e shkencëtarit tonë albanolog pa dyshim është me famë botërore. Dhe në veprën e shkencëtarit tonë tanimë argumentohet plotësisht se gjuha shqipe është gjuhë kulture.

Si i tha këto mendime duke shprehur në tonin që u jepte fjalëve njëfarë krenarie, ai u largua nga salloni i pritjes. Rrezarti dhe Sofija mbetën përsëri vetëm. Një copë herë të vogël u krodhën secili në mendimt e veta. Sofija u habit, por edhe u entuziazmua për dijet e përgjithshme që kishte miku i saj edhe në fusha të tjera të shkencave qoftë edhe në atë të albanologjisë. Rrezarti i tregoi asaj për leximin sistematik që u bënte ai shtypit të përditshëm dhe revistave tona si «Shkenca dhe jeta», revistës «Nëntori», «Ylli» dhe butelitëve që nxirrte Akademia e Shkencave. Më të shumtën e tyre ai tha se e lexonte në bibliotekat e qytetit.

— Po të lexojë njeriu tërë këtë shtyp të pasur, mëson shumë dhe bëhet i gjithanshëm. — Ai e vështroi Sofijen në sy se mos vallë e kishte mërzitur me mendimet gë jepte, por përkundrazi, nga mënyra se si qëndronte ajo, me do-rën të vënë në tëmthat, e kuptoi se ajo e ndiqte me interes.

— Ju jeni një dijetar, — qeshi Sofija dhe, si u ngrit pak si vrullshëm nga kolltuku i saj, e zuri për dore Rrezin duke e tërhequr nga dhoma e bukës për t'ia prezantuar profesor Ervinit.

Dhoma e pritjes lidhej me një derë të madhe me dhomën e bukës dhe në raste festash ato bëheshin një sallon i madh. Pastaj nga korridori me hyrje të veçantë ishte kuzhina e gjatë dhe e ngushtë, pak më tej dhe dhoma e Sofijes me dritare nga deti. Profesor Heta, përvëç Sofijes, kishte edhe një djalë pesë vjet më të rritur se ajo që, me të mbaruar Fakultetin e Mjekësisë, ishte transferuar në Tropojë dhe atje ishte martuar me një mësuese. Ai rrallëherë vinte në shtëpi te prindërit, se pushimet zakonisht i kalonte në shtëpinë e së shoqes.

— Prit, moj... prit..., — belbëzonte Rrezi duke u përpjekur lehtë të çlrohej prej saj, por Sofija nuk dëgjonte derisa e dërgoi pranë të atit dhe profesorit albanolog.

Midis albanologut, një burrë i mbajtur mirë, me një trup të gjatë dhe me fytyrë têrheqëse, me një vështrim të menduar, dhe Rrezart Detit, kandidatit diplomat të fizikës bërthamore, nisi një dialog i shtruar. Sofija i foli profesorit me një intimitet familial për dijet që kishte fizikani në fushën e studimit etimologjik të gjuhës shqipe.

— Oh, jo, shoqja Sofije. Mos më paraqit si nuk jam! — i tha Rrezarti me një farë mirësjelljeje të përzier edhe me një notë zemërimi. — Më fal, unë mund të flas më mirë për profesionin tim të saldatorit ose për zhytjet në det dhe gjuajtjen e troftës e sinogrillës, ndoshta këto ngjallin interes për profesorin, sesa të bisedoj për gjëra ku jam i përciptë!

— Nuk e tha keq! — ia priti profesor Heta për të zbutur pamjen ca të zemëruar të së bijës që nuk i erdhë mirë nga kundërshtimi që i bëri ai për të dhënë gjykim mbi studimet etimologjike të Ervinit.

— E atëherë i tre go profesor Ervinit diçka mbi punën tënde në fushën e shkencës bërthamore! — i tha ajo sikur po e shtynte për ta hedhur nga një majë shkëmbi në detin e thellë.

Rrezarti, paksa i hutuar, e vështroi asistenten ngultazi sikur donte të mbrohej.

— Ç'është e vërteta, të zhytur në studimet e profilit tonë, nuk po mundemi të njihemi hollësisht me problemet e imprehta të shkencave teknike në dobi të progresit të prodhimit.

Sofija nuk e përmbajti çudinë e mendimit që hodhi albanologu dhe padashur, e habitur, rruđhi vetullat e hequra si dy gjysma harqesh që rrëthonin sytë e mëdhenj të saj bojë qielli.

— Kam lexuar një artikull shumë interesant në «Zërin e popullit», — vazhdoi profesor Ervini, — mbi senset e drejtimeve të zhvillimit të mendimit shkencor për kushtet konkrete të vendit tonë dhe, të them të drejtën, m'u duk i argumentuar mirë.

— Po, — tha me ton të vendosur Rrezarti. — Është fjala për kryerjen e studimeve komplekse shkencore tekniko-ekonomike të çdo dege të prodhimit industrial duke e vënë konkretisht teknologjinë në baza shkencore për të arritur edhe aty në prodhimet me cilësi të lartë të standardeve ndërkontinentare.

— Shembuj të tillë jepte artikulli në prodhimin industrial të telave të bakrit në Shkodër, të tekstileve në Kombinatin e Beratit, në uzinën e instrumenteve në Korçë dhe në mjaft degë të tjera të industrisë sonë. Studimet shkencore të organizuara edhe për arritjet në ato fabrika ende me teknologji të prapambetur, janë një punë kolosale e bashkëpunimit në mes njerëzve të prodhimit dhe të punonjësve shkencorë të instituteve studimore-kërkimore dhe të Universitetit e të qendrave shkencore të akademisë.

Rrezarti u mbush me entuziazëm për ato mendime që hidhte profesor Ervini. Megjithëse ishte një shkencëtar i një profili tejtër, atij i vinte mirë, se ato përkonin plotësisht me studimet e tij për zbatimin e metodave bërtimore të aparatit të gamadefektoskopisë, por ardhja e zonjës së shtëpisë aty dhe njoftimi që bëri ajo se po vinin mysafirët e tjerë, bëri që biseda të ndërronte temë.

— Dilu, moj bijë, përpëra mysafirëve, — thirri profesor

sor Heta duke e ngritur edhe vetë karrigen për të bërë diçka për darkën që do të shtrohej së shpejti.

Në korridor nisi të bëhej zhurmë njerëzish të gjuar. Murmuritjet e tyre vinin të gjymtuara deri në dhomën e bukës. E zonja e shtëpisë, e veshur me një fustan bojë hiri, u thoshte:

— Mirë se vini... oh, sa na gjeuat... mirë se vini... oh, sa na gjeuat.

— Ju kam sjellë një dhuratë të shijshme...o, sa dhuratë e shijshme, — thërriste me zë të lartë e të zgjatur një kushëri i Sofijes, një mesoburre trupnjeshur që nuk pushonte së qeshuri duke përsëritur: — Një krap të pjekur në tjegull... një krap të pjekur në tjegull... Hë, Sofije, bija ime, të më bëhesh njëqindje, merre krapin dhe vëre në tryezë.

Pas tij hynë miqtë e tjerë.

Sofija ia mori nga dora kushëririt tjegullën me krapin e pjekur dhe pa qejf e vuri në mesin e tryezës së shtruar me antipasta e piye, raki e verë. Ajo erdhi e u bë lulëkuqe në fytyrë kur vështronte Rrezartin që qeshte me gjithë zemër nga sjellja e xha Llazit që nuk pyeste fare për etiketë.

— Thashë unë, — tha Rrezarti duke u kthyer pakëz nga albanologu, — tullat e kuqe argjilore, kur prodhohen me cilësi të lartë, kanë përparësi mbi të gjitha llojet e materialeve të ndërtimit, bile në tjegull piqet shumë mirë edhe kapi.

— Kështu e gatuajnë krapin shkodranët, — tha profesor Ervini, — po mua nuk më është dhënë rasti të ha ndonjëherë krap në tjegull.

— Pse vetëm shkodranët? — pyeti xha Llazi. — Do të lëshosh thonjtë, profesor, kur të shohësh se si e kam gatuar unë, — tha xha Llazi.

— Na e ktheve tërë mbrëmjen, o xha Llazi, në tjegull me krap, — e qortoi i zoti i shtëpisë.

Sofija deshi të njihte docent Rrokun dhe gruan e tij, një grua e pashme rrëth të dyzetave, me profesor Ervinin.

— E njoh unë, — ndërhyri xha Llazi që kishte zënë vend në mesin e tryezës, duke vështruar pa tekllif mezet e pijet, — jemi shokë fëmijërie me Rrokun, ehu sa herë

kemi dalë tē gjuajmë peshik. Unë u kapa pas tregtisë, kurse ky korbi deti bëri shkollë tē lartë pér peshkun. Këtu te ne nuk mbeti njeri pa bërë shkollë tē lartë.

— Enjoh, e njoh edhe unë docent Rrokun, — i tha në vesh Rezi Sofijes, — éshëtë autor i një studimi shkençor pér gjuetinë e sardeles në bregdetin lindor tē Mës-dheut, bile edhe tē gjuetisë së saj me drita nën ujë. Punimet e tij shkencore përmenden edhe në disa traktate shkencore tē botës.

Nëna e Sofijes përfundon pas shërbimit vështronit Rrezartin, mikun e së bijës. Sofija i ngjante shumë s'ëmës nga sytë.

— Hajde këtu, o kushëritë! — e ftoi xha Llazi tē zo-njën e shtëpisë me gotën e rakisë në dorë. — Le tē na rrojë çupa e të na bëhet nusel. Hajt, Gëzuar, ditëlindjen! — E zonja e shtëpisë imori një gotë verë edhe e çukiti më Llazin. — Të gjithë vëllai i tashë që këtia mëqëjetë është. Gëzuar, miq! — Thirri dhei zoti i shëtëpisë ulur në krye tē tryezës.

Gëzuar ditëlindjen! — i tha profesor Ervin i deduke iu drejtuar me gotën e verës Sofijes.

— Shëndet! — i tha edhe Rrezartini.

Të gjithë ngritën dollinë duke uruar kushëme verë, kush me raki.

Pa mbaruar mirë urimi i parrë, ra ziljadë derës. E zo-njën e shtëpisë lajgotënë dhe dolë përndë pritur mysa firët e tjerët. O ia thuhet se i ka dhënë qëndrueshmë.

— E shikon, o kushëri, se ç'ndodhi kurr shpejtohesh në shtëpi tē tjetrit? — i tha me thumb Heta latij, — Ende nuk janë mbledhur të gjithë tē ftuarit.

— Nuk presim deri më mesnatë! — i tha pati xha Llazi. Kush vjen me vonesë, peshk në tjequll nuk do tē hajë.

— Hajt, angreje, o saldatori me shkollë tē lartë, — ia bëti ai me shenjë Rrezartit, — seunë e di që ti e spindon njëherë rakinë. Më mban mendimua, apo jo?

Si përplasëni gotatbatë tē dy pinë dollinë me fund. Sofija e vështronit e habitur. Rrezartini që sillej ashtu lirshëm më xha Llazin që ajo ia njihet huqet.

— Erdhi profesor Koti me tē tijtë, — thirri i zoti shtëpisë.

Në dhomën e bukës, tē shoqëruar nga e zonja e shtëpisë, hynë me njëfarë buje profesor Koti dhe e bija, një vajzë e hedhur që i ndrisnin sytë prej gëzimit që bënte kontrast tē madh me tē atin e tkurrur nën syzet e nën petkat e zeza që i viuin tē gjera si thes.

— Mirëmbrëma, miql! — tha me zë tē mekur Koti me një pamje si tē hallakatur e duke i hedhur vështrimin hetues nën syzet sa njërit, sa tjetrit. Nja dy sekonda kryqëzoi shikimin me studentin punëtor, kandidatin diplomant, Rrezart Deti.

Sofijes iu duk sikur kapi një ndjenjë trishtimi nga shprehja e syve zhbiruese tē Rrezartit.

— E bëtë mirë që erdhët! — i tha i zoti i shtëpisë që i doli përpara duke i zgjatur dorën. Pastaj përshtëndeti edhe vajzën e tij. Ajo zuri vend në karrigen përkrah Sofijes, kurse profesor Koti u ul pranë Ervinit.

E zonja e shtëpisë u mbushë gotat me verë mysafirëve tē porsaardhur. Pa orën e madhe në mur dhe tha me një shprehje pakënaqësie.

— Nëntë ora!

Rezi në fillim nuk e kuptoi se çfarë donte tē thoshte e zonja e shtëpisë me atë qëndrim.

— Ata nuk vijnë më! — belbëzoi Heta. E kishte fjalën pér tē birin dhe gruan e tij. — Kushedi si e kanë pasur punën! — belbëzoi ai.

Sofija afroi gojën në veshin e Rrezartit dhe i tha me zë tē ulët:

— Atë mjekun e Tropojës, tim vëlla, e sundon si skillav e shoqjal!

— Matriarkati! — qeshi Rrezarti.

I zoti i shtëpisë, sipas zakonit të vjetër që kishte kur shtronte ndonjë darkë pér ngjarje tē shënuar tē familjes, u ngrit nga tryesa dhe vajti në cep tē dhomës dhe shtypi butonin e një magnetofoni tē vendosur nën tryezën ku ishte vendosur televizori. Pa nisur mirë lëvizjen shiriti, ai u kthyte dhe u ul në vendin e tij duke mbajtur vesh. Mysafirët

dhe ata që nuk e dinin këtë zakon, qëndruan në njëfarë pritjeje nga pamja që mori i zoti i shtëpisë.

Tingujt e një muzike simfonike drodhën tërë ajrin e dhomës.

— Bethoveni..., — tha me zë të ulët Sofija e kthyer pak nga Rrezi. Ai luajti kokën dhe belbëzoi:

— Po, simfonia e tij e shtatë.

Sofija, e habitur, ktheu kokën fare pranë fytyrës së tij. Rrezarti dhe shumë shokë të tij punëtorë e studentë të die-lave paradite kalonin një orë në sallën e koncerteve ku jepj muzikë simfonike e autorëve të njohur vendës e të huaj.

Zana, vajza e profesor Kotit, bëri një lëvizje të lehtë prapa shpinës dhe, si u zgjat pakëz nga Rrezarti, me të cilin takohlej për herë të parë, pëshpëriti me një buzëqeshje miqësore:

— Dëgjoni kur im atë të thotë atë shprehjen e tij që e kam dëgjuar dhjetëra e dhjetëra herë...

Rrezarti e pa vajzën e profesorit me një shikim hetimi dhe iu duk sikur ajo dinte mbi pikëpamjet e tyre të ndryshme në lidhje me caktimin e temave të diplomës.

— Ja, edhe ndër këta tinguj muzikë gjeniale veprojnë ligjet e fizikës! — tha profesor Koti më një pamje pompoze, sikur të fliste me vete.

Rrezarti që vështroi nga ekranit i televizorit përfytyroi figurën e Bethovenit duke dirigjuar orkestrën simfonike ash-tu me atë pamjen e tij sic e kishte përshkruar Fan Noli në librin kritik «Revolucioni Francez dhe Bethoveni» dhe, duke u përkulur nga Sofija, tha me zë të ulët aq sa e dëgjoi edhe Zana që mbajti vesh!

— Bethoveni, sa madhështor dhe i bukur në muzikë, aq i shëmtuar në fytyrë.

— Këtë më mirë sikur të mos e kishte thënë Fan Noli! — ia pati Sofija.

— Objektivitetit nuk i shmangemi! — tha Rrezarti.

Me të mbaruar një pjesë e muzikës, i zoti i shtëpisë mori gotën e verës dhe u uroi mirëseardhjen të ftuarve. Përveç antipastave në pjatat e vogla prej porcelani kishte shishqebap me mish viçi dhe pjata me sallata të ndryshme, me patëllxhane, domate e tranguj të vegjel

turshi. Një copë herë nuk foli njeri. Sëcili hante për të shijuar mezet e pijet.

— E, si thoni, miq? — thirri pas një copë here xha Llazi. — A ta bëj thela-thela e t'ia hedh secilit në pjata këtë krapin këtu?

— Prit dhe ca! — tha i zoti i shtëpisë. — Për atë peshkun tënd kam një verë të vjetër që ma ka sjellë një mik nga bregdeti. — U ngrit dhe doli. E pas një copë here u kthyesh me dy shishe verë të kuqe në dorë. Sofija dhe Zana u mbushën burrave gotat me verë të vjetër pesëmbëdhjetëvjeçare që shkumëzonte si shampanjë.

Xha Llazi e ndau peshkun nëpër pjata.

— Prisni! — u thotë ai duke ngritur dorën lart. — Kapi në tjequll hahet me muzikë! — dhe i tha në vesh Sofijes që të vinte shiritin e muzikës popullore.

Pas pak u dëgjuat kori i djemve të Institutit të Lartë të Arteve.

— Tashti a mund ta hamë peshkun? — pyeti profesor Koti me një bûzëqeshje të vaktit.

— Bile krapin duhet ta kishit ngrënë të parin dhe pastaj mishin e vicijt — qeshi xha Llazi pa të keq dhe futi në gojë një copë mish të bardhë nga bishti i peshkut. Të gjithë nisen të hanin fetat e peshkut duke dëgjuar këngë popullore.

— Kjo Hafsa!

— tha papritmas Rrezi. Sofija, që u ngrit e para nga tryesa, e ftoi Rrezartin që t'i shkonte pas dhe po të njëjtën shenjë me kokë i bëri edhe Zanës. Profesor Koti me bishtë të syrit ndoqi largimin e të rinjve në dhomën e pritjes.

— Uf..., — ia bëri duke mbajtur barkun me dorë Zana, — plasëm së ngrënë. Unë për veten time në darkë havetëm një pjatë kos dhe asgjë tjetër.

— E po sonte bëhet përfjashtimi — tha Rrezarti.

— Nuk ma keni prezantuar ndonjëherë dhe bile as që më keni folur për këtë mik! — i tha Zana shqesë së saj duke e vështruar Rrezartin sikur studionte anatominë e një pacienti.

— Po nuk ka rënë fjala, — iu përgjigj Sofija e buzëqeshur duke ngritur pakëz qerpiqët e ngrirë. — Besoj se

do tē bëhem udhëheqëse e temës së diplomës së tij! — shtoi ajo pa ia hequr sytë fytyrës së hijshme të Rrezartit.

Rrezarti ngriti supet dhe vuri buzën në gaz.

— Çfarë temash do tē keni në diplomë? — pyeti Zana më interes dhe vazhdoi: — Unë jam mjeke dhe po specializohem për bombardimin e kancerit tē tumoreve me ato rrrezet tuaja tē padukshme të kobaltit.

— Kurse unë merrem me përdorimin e rrzeve tē padukshme në industri, — tha me zë tē ulët Rrezarti.

— Shumë interesante është e dobishme për prodhimin! — ia pati Zana.

Rrezarti nuk e përmbylli habinë. Ai u çudit që mendimet e Zanës nuk përkonin me ato tē atit tē saj.

— Ato janë tema, tē rëndomta teknike që u përkasin njerezve tē prodhimit, kurse Rrezarti ka prirje përfshirë tē çarë në rrugën e shkencës së madhel — tha Sofija duke u ulur në stolin e pianofortës pa ia hequr vështrimin kandidatit diplomant. — Ja përfshembull, ai mund tē merret fare mirë me një temë tē shkencës fondamentale siç është ajo e studimit tē rrzeve kozmike, siç propozoi edhe profesor Koti përfshirë temën e diplomës së tij... — Dhe atë çast Sofija i ra pianos.

Zana nga shprehja e fytyrës e kuptoi se diç ziente midis tyre.

— Unë do tē dëshiroja që Rrezarti e shokët e tij fizikanë bërthamorë tē shpiknimit apo tē zbulonin ndonjë rrze që shëron plotësisht edhe kanceret femra, — buzë-iqeshi ajo.

Dë të ishte një zbulim shumë i dobishëm, — u përgjigji ajo.

— Jo... jo... belbëzoi Sofija, ju nuk jeni kompetente, Zana, mos e ngatërroni punën, se këtu kemi të bëjmë me një problem! Serioz që ka disa ditë që vlon në katedër dhe bile ka plasur edhe sherr...

Ajo rrudhi buzët kur tha atë fjalën e fundit «sherr», e vështroi Rrezartin në sy. Nga vera që kishte pirë, asistentja e ndiente veten pakëz tē turbulluar dhe atë çast kur nisi të luante në piano një melodi të kompozitori

shqiptar, mendoi me vete sikur të ishte vetëm për vetëm me Rrezartin dhe t'ia hidhte duart në qafë.

— Shkencë,... shkencë e madhe, — ia bëri me dorë Zana pa ia nxjerrë kokën mendimit.

Rrezarti i hodhi një vështrim ekranit të televizorit aty përballë dhe vuri re rrezet e llambave elektrike të abazhurit prej kristali që krijonin ca figura të papërcaktuara në xhamin e tij.

— Një shoku im shkrimitar ka sh'kruar një skenar për një film fantastiko-shkencor, — tha ai dhe priti pakëz nëse ngjallte interes biseda e tij dhe, kur pa se të dyja vajzat ngritën sytë nga ai, vazhdoi: — Bile fabulën ia kam dhënë unë.

— Dhe ky fakt e përforcon më shumë mendimin e profesor Kotit për prirjen tuaj..., — tha Sofija. — Ti interesohesh për letërsinë fantastike.

— Nuk jam kundër librave fantastiko-shkencorë, — vi-
oji Rrezarti duke e parë Sofijen që rrinte ulur me duar të shtrira mbi tastierën e pianos pak si e habitur, — se ato nxisin imagjinatën 'e pionierëve dhe të të rinjve, por ne duhet të kapemi pas asaj shkencë që i shërben prodhimit! — Fjalët e fundit ai i shqiptoi me vendosmëri. Kur ktheu kokën anash, kryqëzoi vështrimin me të profesor Kotit që kishte një copë herë që rrinte aty mbështetur te biblioteka dhe dëgjonte bisedën e tij. Ai lëshonte rrezen e shikimit të syve mbi syzet dhe luante kokën me një buzëqeshje të hidhur në fytyrën e tij të buhavitur e të bardhë si qu-mësht.

— Mos thoni asgjë, asgjël — belbëzol ai. — E kuptoj gjendjen tuaj shpirtërore, djalosh. Jua ka marrë mendjen jeta e prodhimit dhe e keni të vështirë të largoheni nga praktikat e rëndomta dhe të dilni në rrugën e shkencës të madhe.

— Profesor, — tha Rrezarti, — gjendja ime shpirtërore është e mrekullueshme, por...

Sofija u ngrit nga pianoja dhe nga mënyra se si i bëri gjestet, u kuptua se atë e mbërtheu një ndjenjë nervozizmi.

Profesor Koti, që kishte ditë i turbulluar në shpirt

nga kundërshtimet që kishte pasur në katedër, sidomos prej vërejtjeve të ashpra të bëra nga kolegu i tij, fizikani profesor Gurra, përpinqej me çdo kusht t'i dilte e tija. Profesor Koti i kishte varur shpresat tek asistente Sofija, e cila më në fund do t'ia mbushte mendjen këtij kandidati diplomant që vinte drejtpërdrejt nga radhët e punëtorëve, për të pranuar vetë temën shkencore që diktonte ai. Por po bindej se pënpjekjet e tij po treteshin si kripa në ujë. Profesori u habit dhe me qëndrimin e së bijës. Prej vitesh ajo sillej me të atin si e huaj dhe ata të dy nuk bisedonin kurrë shtruar me njëri-tjetrin. Megjithatë, ai mendoi të mos dorëzohej dhe aty për aty vendosi t'i jepte bisedës një karakter shakaje.

— Të kam lëshuar rrezen e padukshme kozmike që e kam absorbuar ja këtu në këtë gur special diamanti, — qeshi profesori duke i treguar gishtin me unazën me gur që ndriste. — Kjo lloj rrezeje kozmike radioaktive me frekuencë krejtësisht të tjera të elementeve radioaktive të tokës sonë, ka veticë të zbulojë dhe të fshehtat e ndërgjegjes së njerëzve. Bile kjo rreze reflekton edhe jetën e banorëve të tokës sonë që janë në udhëtim në kozmos prej qindra e mijëra vjetësh.

Mënyra se si fliste ai, dukej se kishte bindje të verbër në ato që thoshte.

— Edhe ky tregimi yt, baba, qenka zbavitës, — tha Zana. — Jepjani ndonjë shkrimitari ta bëjë skenar për televizor.

Pas këtyre fjalëve gjendja u rëndua. Profesor Koti diç deshi t'i thoshte së bijës.

— Sofija në pianol — thirri profesor Ervini dhe bëri nga ajo për ta ulur mbi tastierën e pianos.

— Më janë kallikanosur gishtërinjtël — ia pati papritmas Sofija me një shprehje mëzie në fytyrë.

— Hajde, bijë e xhaxhait, na luaj në piano diçka të bukur e të gëzueshimel — e ftoi xha Llazi me gotën e vërës në njëren dorë dhe me tjetrën shtynte kushërirën e re nga pianoja.

— Më falni, por me të vërtetë nuk mundem, — tha ajo duke kryqëzuar vështrimin me të atin që dukej

sikur e qortonte. — Nuk mundem... — belbëzoi përsëri dhe u largua nga pianoja.

Rrezarti vështroi mysafirët e pezmaçuar dhe e mori me mend se ai ishte shkaktari që aty ra mërzia. Atë çast i vajtën sytë te një kitarë e vjetër që varej në cep të bibliotekës, si një send antik. Mori kitaren dhe, si u kthyte te pianoja ku ishin grumbulluar mysafirët, tha:

— Atëherë më lejoni t'ju këndo unë një këngë me kitarel — dhe menjëherë, ashtu siç ishte mbështetur mbi mobiljen e zezë me shkëlqim të pianos, duke vështruar lëvizjen e gishterinjve, ia nisi një këngë të njojur kushtuar montatorëve shtegtarë. Ajo kishte një melodi të këndshme e të lehtë, sipas motiveve të këngës populllore të Isuf Myzyrit. Zëri i tij midis tenorit e baritonit u përhap në sallon dhe dukej sikur dilte përtetje dritares e bashkohej diku larg në dallgët e detit.

Zana e qeshur vështronë Sofijen, fytyra e së cilës shprehte habi. Profesor Koti që kishte zënë vend prapa etimologut që mbante për krahu gruan e tij të heshtur që pothuajse atë mbërëmje nuk e kishte hapur gojën fare, ia nguliti sytë enkas asistentes dhe me mendje i transmetante si me telepati mendimin dhe sikur i thoshte: «Ja, ky është ai shkencëtari që mbaje shpresën til!»

Kur mbaroi kënga, mysafirët e duartrokiten; veçanë, risht dëgjoheshin më shumë përplasjet e duarve të xha Llazit. Ai tha:

— More, ti qenke dreqi vetë! Për besë na kënaqel Na këndo edhe një tjeter çfarë të duash til!

— Me kaq..., — qeshi Rrezarti dhe shkoi te vendi ku mori kitarën. E vari atë në një kunj druri të përthyer dhe u kthyte tek i zoti i shtëpisë që po e vështronë me njëfarë habie.

— Të lumtë goja, — e përgëzoi miqësisht profesor Heta.

— Ju falënderoj për pritjen e përzemërt! — tha Rrezarti dhe vuri dorën në zemër. — Tani, po të më lejonin...

— Urojmë të mos jetë vizita e fundit! — tha befas e ëma e Sofijes.

Rezarti u dha dorën të gjithë mysafirëve me radhë

dhe më në fund ia zgjati dhe profesor Kotit. Atij iu duk se sytë, nën syzet e trasha, e vështruan tërë mllef.

— Natën e mirë, — u tha Rrezarti tërë respekt e cil-tërsi mysafirëve dhe të zotëve të shtëpisë duke u kthyer për herën e fundit pak si skicë në pragun e sallonit të pritjes.

Sofija e shoqëroi Rrezartin pa fjalë deri te dera e jashtme e oborrit. Kur hapi derën e drurit me kangjella, ajo i tha:

- Do të bisedojmë rreth përshtypjeve të mysafirëve ndaj tejel

Rrezarti mblodhi supet, rrudhi buzët dhe helbëzoj:

- Më duket se nuk isha në ndonjë shfagje cirkullare.

Në fjalët e tij u ndje njëfarë zemërimi

— Natën e mirël — i tha Sofija me sytë ulur përtokë dhe me njëfarë nervozizmi tërroqi pas derën.

KAPITULLI VI

Sekretarja e katedrës, asistente Sofija, i dorëzoi Rrezartit një zarf me dy shikresa zyrtare; njëra ishte urdhri që lëshonte Ministria për ta nisur në kombinatin metallurgjik për dy javë punë të posaçme në një linjë të fabrikës numër 12 dhe tjetra ishte urdhri i shërbimit që lëshonte katedra e fizikës e Universitetit. Ajo nuk e vështroi në sy, duke u sjellë me atë sikur të kishte të bënte me një njeri të panjohur. Rrezarti e mori me mend se çfarë bluan Sofija dhe me ndjenjën e njëfarë krenerie, u hoq edhe ai sikur kishte të bënte thjesht me një zyrtare. Futi zarfin në çantë dhe, pasi përshëndeti ftotë vetëm me kokë, doli jashtë në korridorin e gjatë të fakultetit. Para se të zbriste shkallët, qëndroi një çast para auditorit dhe përfytyroi ditën kur do të hynte në atë sallë që i përngjante një amfiteatri. Pikërisht aty para komisionit do të mbronte diplomën. Iu duk e largët dhe e pakapshme ajo ditë. Dhe pavarësisht nga mendimi vlerësues që kishte për të profesor Buron Gurra, prapë-prapë ekzistonin pengesa. Profesor Diosten Koti, i cili ende mbahej si autoritet i shkencave të fizikës, ishte anë-

tar i komisionit të diplomimit. Me siguri do të përpinqej ta pengonte saldatorin që të mos e merrte titullin e fizikanit. Rrezarti nuk e dëgjoi këshillën e tij për t'u marrë me shkencën fondamentale.

* * *

— Pse u vonove? — e pyeti Rrezin si me qortim portieri babaxhan. — Do të udhëtoni me helikopter.

— Heu..., — ia pat befas Rezi duke vështuar shokët që ishin grumbulluar përpara derës së hapur të helikopterit. — Me sa duket qenka punë urgjente vajtja jonë!

— dhe u largua nga portieri pa ia vënë më veshin.

— Mirëmëngjes! — përshtëndeti Rrezarti një saldator të panjohur.

— Dielli po i ngjitet zenitit dhe ti thua mirëmëngjes!

— qeshi tjetri dhe nisi të ekte drejt derës së helikopterit.

— Hajde, djema, zini vendet! — bërtiti piloti i ulur pranë timonit. Ai kishte nxjerrë kokën përjashta dritares së kabинës.

— Ta hajë dreqi! — ia pati ai saldatori i panjohur ngjitur me Rrezartin. — Më mirë të kisha udhëtar me tren. Mua më zë udhëtimi në ajër.

— Shpejtësia, shpejtësia, shok, është vendimtare përrimentimin e lartë, — tha buzagaz Rrezarti.

— Meqë të zë fluturimi, zbriteni Don Kishotin, — u hodh një shoku i tij përballë. — Le të udhëtojë me kolin gërdallë. Bile mos harro të marrësh me vete dhe ushtën, — ia plasi ai të qeshurit dhe pas tij qeshën edhe të tjetrët.

— Lërini shakatël! — thirri piloti i dytë duke kthyer kokën nga pasagjerët. — Ej ti, mbylli derën! Ktheje dhe sigurecën. Hajt, djema, udha mbarë!

Helikopteri nisi të uturinte. Brenda në kabinë ndihej një zhurmë monotone e mbytur dhe të rrashurat e helikës si fletët e një shpendi që përpëllitet për t'u shkëputur nga toka, drejt qiellit. Rrezarti hodhi sytë nga dritarja dhe pa se këmbët e makinës nisën të ngjiteshin verti-

kalisht, dhe kjo vazhdoi një copë herë të vogël, derisa helikopteri u ngrit mbi kodrën më të lartë që qëndronte si karakoll mbi detin e kaltër e të qetë si vaj. Pastaj makina nisi të ecë horizontalisht buzë detit që ndriste nga rëra e bardhë.

— Tetëqind metra lartësil — ia pati inxhinier Besniku që deri atëherë s'kishte hapur gojë.

— E ku di ti? — pyeti ai saldatori që tha se e zinte udhëtimi në ajër duke hequr njérën dorë nga tëmthi.

— E shikoj nga nivelmetri! — tha Besniku duke treguar me sy nga aparati i vogël që mbante në dorë.

Piloti i dytë, pasi pa treguesin e makinës nën timonin e shokut, ktheu kokën i habitur nga pasaçjerët dhe tha:

— More, i ke rënë në tël!

— Shkencat e aplikuara! — ia pati Rrezarti duke treguar me dorë nga aparati që kishte ndërtuar inxhinier Besniku.

Piloti i dytë u afrua tek udhëtarët, ia mori aparatin Besnikut, dhe u habit kur pa agrepin e vogël te numri tetëqind.

Kur helikopteri bëri të ngjitej edhe njëqind metra lartësi, Rrezarti ndjeu një dhembje therëse te timbri i veshëve, por ajo therje kaloi shpejt. «Më kanë kalitur zhytjet në thellësitë e detit që e duroj presionin e ajrit!» — mendoi me vete. Pastaj ai ia hodhi shikimin qilllit të kaltër që ndriste nga rrezet e diellit.

Të gjithë vështronin horizontin, detin dhe tokën. Brengu i detit që niši të largohej nga pamja e tyre, nga prapa dukej si një vijë e bardhë që shquhej në sfondin e kaltër të ujit pa masë. Pak më tej u hap një spektakël me lloj-lloj ngjyrash: fusha e sistemuar, e ndarë në kuarde, me kanalet ujitëse që e përshkonin kryq e têrthor dhe brezat pyjorë që e rrëthonin si me kurorë tërë fushën. Helikopteri çante me shpejtësinë maksimale drejt qilllit. Rrezarti bluante me mendjen e tij mrekullitë e natyrës: «Ja, dy lëndët themelore e kushtëzuese për jetën e qenieve të gjalla shtazore e bimore, ujet dhe ajri. Në planetet nuk paska jetë. Po në galaktikat e largëta të gjithësisë? Patjetër duhet të ketë jetë!» — belbëzoi ai me bindje

që i kishte formuar nga leximet shkencore që bënte edhe në fushën e kozmosit. «Por kjo dûhet vërtetuar, o profesor Koti,» — qeshi me vete Rrezarti me kokën mbështetur te xhami i drifteve.

— Ej, sâldatori fizikán! — i thirri inxhinier Besniku duke e prekur befas me dorë në sup. — Vështron poshtë gjigantin e metalurgjisë sonë!

— Ja edhe fabrika numër 121 — ia bëri me dorë Rrezarti duke treguar një kuti të vogël të rrëthuar me sféra midis furnnaltave që shfrynin tym të zi të përzier me flakë të kuqe që përhapej mbi lumin e Shkumbinit.

— Aty do të saldojmë? — pyeti ai soldatori tjetër që tha se nuk e duronte dot fluturimin në ajër.

— Atyl — iu përgjigj Rrezarti pa e vështruar në sy.

Helikopteri nisi të ulej perpendikular në një fushë pak të mënjanuar, ngjitur me kombinatin metalurgjik. Mallet e târaccuara, të veshurë me pyje, mbetën pas. Tani filluan të shquheshin jo vetëm automjetet, vinçat, vagonat e trenave, që shembellenin si damarë, por dukeshin edhe punëtorët metalurgë që lëvrinin si rruazat e gjakut poshtë e lart për t'i dhënë jetë asaj organizme vigane ndërtuar prej hekuri, prej betoni dhe prej tullash, të kuqe.

— Ej, Pirro, Pirrol! — e shkundi shoku ngjitur atë soldatorin tjetër. — Mblidhe veten! Arritëm...

Pirroja hapi me vështirësi sytë dhe tha me gjysmë zëri:

— Me të vërtetë mbërritëm!.. E po ta dini se kjo është hera e fundit që unë udhëtoj në ajër!

— Shohim e bëjmë! — qeshi Rrezarti.

Helikopteri kishte vënë përsëri këmbët me rrata në tokën e shtruar me cimento. Helika dalngadalë i pakësoi rrrotullimet rrëth boshtit të vet derisa Rrezarti shqoi fletë e saj që ranë në qetësi.

* * *

Rrezartin, inxhinier Besnikun dhe dy soldatorët i rregulluan në pallatin e beqarëve, në një dhomë me gjashtë

krevate. Pasi sistemuan çantat dhe sendet personale në për komodinat e tyre dhe po bëheshin gati të dilnin ja-shtë, në dhomë ia behu një djalosh trupmadh, me një valixhe në dorë e me ca sy të zinj që i shndrishin.

— Ne jemi bijtë e shekullit të ril — thirri ai me një zë tingellues duke tërhequr vemendjen e shokëve të panjohur që në atë kohë po merreshin me sistemimin e plaqave. Pirroja ende me kokën e turbullt nga udhëtimi, ishte shtrirë në sustën e krevatit për të rimarrë energjitet e nevojshme.

Rrezarti ia nguli sytë të sapoardhurit dhe, si e njohu, brofi në këmbë:

— Ti je, o Mustafa, saldatori me patentë ndërkombëtarë!

— Po ti nga mbive, Rrezil — u hodh ai dhe e përqafoi shokun e vjetër, me të cilin kishin salduar dikur për disa muaj në fabrikën e llambave neon në Vlorë. — E pasqë lënë fakultetin?

— E kam ndërrprerë përkohësisht! — i tha Rrezarti.

— Do t'i saldojmë sferat e çelikut për mrekulli, — tha Mustafai.

— Do t'i qëndisim që të mos duken fare shenjat e qepjes, — ia ktheu Rrezarti i gjallëruar, duke i rënë miqësisht në sup shokut.

— Me ngadalë, ore derëzi, se ma ke atë shputë si mashë hekuril — dhe, si u tërhoq paq, shtoi: — Po kush do t'i bëjë ata filmat «spiun» që të vërtetojnë ngjitjen në zemër të çelikut?

— Rezet e padukshmel — tha Rrezarti.

— Eh..., ku i kemi ne ato, o derëzi... — u hodh Mustafai duke tundur grushtin në ajër sikur do t'i qëllonte.

— Hajt dalim njëherë, se po na presin shokët! Me të parë e me të bërë! Rrezarti nuk i tha Mustafait se, krahas mësimeve, kishte punuar së bashku me një grup shokësh për të prodhuar apartin e defektoskopisë dhe se këtë aparat e kishin marrë me vete për ta provuar.

Vullnetarët saldatorë dolën nga pallati dhe u nisën për në sheshin e saldimeve të fabrikës nr. 12. Doli dhe Rrezarti me Mustafanë. Prapa tyre shkonin shokët e tjerë

të grupit, inxhinier Besniku, asistenti fizikan dhe dy sal-datorët vullnetarë nga qyteti industrial bregdetar D. Inxhi-nier Besniku ecte pas gjurmëve të Rrezartit dhe Mustafait duke mbajtur vesh se mos kapte ndonjë nga bisedat e tyre të shkëputura. Më në fund mbërritën te sheshi i sal-dimeve. Tani Rrezartit i dukeshin furrnaltat si gypa gjigantë dhe godinat që shtriheshin deri poshtë brigjeve të Shkumbinit si kuba të stërmëdhenj që nxirrin avuj të bar-dhë nga mushkëritë e tyre. Aty brenda ziente jeta nga njerëzit e veshur me kapuçeta dhe me xhupa duke ngac-muar me shufra rrjedhjen e metalit si lëng i trashë i kuq prej gjaku. Rrezarti dhe Mustafai ecën një copë herë pranë e pranë. Kur dolën te sheshi i saldimeve, Rrezartin dhe shokët e vet i priten kryeinxhinieri i fabrikës nr. 12 dhe njerëz të tjerë. Midis tyre ai njozu edhe usta Salën që rrintë pakisi i mënjanuar.

Ata u përqafuan më shokët e metallurgjisë.

Usta Sala e zuri nga prapa Rrezartin dhe, si e për-qafoi, e pyeti:

— Erdhe të saldosh? Po unë i thashë drejtori...

— Zanati byzylyk floriri! — qeshi ai.

— Po, po, — dhe si e vështroi një copë herë në sy, pa ia lëshuar krahun, vazhdoi: — A bëtë gjë me atë aparatin zbulues?

— E kemi filluar. Mund ta mbarojmë këtu, — u përgjigj me gjysmë zëri Rezi: — Sa veta kanë ardhur vull-netarë nga fabrika janë këtu?

— Kanë ardhur disa! — u përgjigj usta Sala që e kup-toi se ai donte të ndërronte bisedën. Si e pa një copë herë në sy, ia hodhi fjalën papritmas që të mos e dë-gjonin të tjerët aty përrreth: — Nuk e shikon edhe Mer-itën atje midis atyre shoqeve?

Rrezarti hodhi sytë nga shoqet e veshura me komi-noshe që diç bisedonin me njëra-tjetren dhe, kur vështrimi i ndeshi me sytë e zinj të Meritës, iu duk sikur t'i shkëpu-tej ndonjë venë e zemrës nga emocioni i befasishëm. Deshi të bënte një hap, por nuk pati mundësi atë çast, pasi drejtori i madh, sic thoshin metallurgët, i shoqëruar nga një grup shokësh, ia behu aty në mesin e tyre dhe për-

krah tij profesori Butoni Gurra: Njerëzit bënë një rrëth. Rrezartit e humbi Mëritën, ndjenja e dashurisë ndaj saj ia traizonte shpirtin.

— Drejtori i metalurgjisë, një burrë i thyer në moshë, me flokë aty-këtu të thinjur, me cati sy plot gjallëri e me një pamje serioze, tërroqi vëmendjen e të gjithë atyre saldatorëve e mekanikëve saldatorë. Ai vështroi profesorin fizikan që trinte i heshtur me atë shprehjen e qetë dhë të menduar të syvë tjetrij. Pastaj iu drejtua inxhinierit të montimeve:

— Hë, inxhinier! — Kam bërë një gblim të pafalshëm! — u përgjigj me gjysmë zëri inxhinieri mekanik duke vështruar me sinqeritet punëtorët rrëth e përqdrk tij. Pa s një heshtjeje të vogël shtoi: — Do të bëj një iautokritikë para puñonjësve dhe para Partisë për atë zotim të shpejtuar dhe të pallogaritur shkencërisht. Bile pranoj me ndërgjegje të merren edhe masa të rrepta shtetërore ndaj meje!

— Nuk po marr vesh gjë! — tha papritmës saldatori buçko me fytyrë të kuqe sikur t'i kishin vënë hekur të nxeh të në faqe. Dhe, pa pritür përgjigje, vazhdoi: — Mos e ke fjalën se ne saldatorët shqiptarë nuk dimë të bëjmë atë lloj saldimi special siç e bëjnë specialistët e huaj? Mos u bëj merak për këtë! Ne do t'ia dalim në krye!

Usta Sala doli pakëz përparrë Rrezartit e ndërhixhi:

— Nuk është fjala për saldim special! Patentat ndërkombëtare i kemi ja këtu, të shkruara në mollëzat e gishterinje, — dhe ai çoi dorën në sisën e majtë, — ja këtu në zemër. Është fjala, more shok, për atë aparatin zbulues që ka kontrollon cilësinë e saldimit, që nxjerr në pëllëmbë të dorës ndërgjegjen e secilit prej nesh. Atij si t'ia bëjmë. Këtë shokun që punonte për të e sollën këtu.

— Aha.. këtu ke të drejtë... Pas saldimeve është i domosdoshëm kontrolli i ngjitjeve të sakta të enëve nën presion; Pa atë nuk bëjmë. — Mustafai i pikëlluar uli sytë përtokë.

— E po ja ku po them unë! — shpërtheu befas drejtori duke iu marrë pakëz goja. Dhe, si i hodhi krahun prò-

fesor Buronit që e nxishte pranë, shtoi: — Profesori dhe shokët e tij fizikanë do ta ndërtojnë edhe atë aparatin e gamadefektoskopisë. Prandaj kanë ardhur këtu të gjithë, edhe profesori, edhe inxhinier Besniku, edhe shoku Rrezart... Por çështja qëndron në një pikë tjetër: Shokët saldatorë dhe novatorë lypset ta shkurtojnë afatin e saldimit të sferave të çelikut së paku tridhjetë përqind të kohës! Duhet ta kuptoni, shokët e shoqë punëtore, se vënia në shfrytëzim qoftë edhe disa ditë përparrë e linjës së dytë të fabrikës paraqet një leverdi të madhe ekonomike për shtetin dhe do të thosha, në radhë të parë është një fitore politike e rëndësishme për vendin tonë socialist.

Profesor Gurre, me një buzëqeshje të lehtë që i ndeji në buzet e holla të mavjosura, zgjati dorën nga Rrezarti, dher me shenjën që bëri e thirri të afrohej pranë tij. Ai, pasi i vuri dorën në sup, tha: — Tu jeni drejt që i bëni... Ju kemi sjellë një saldator flori! — Edhe profesori vështroi në sy kandidatin diplomant të fizikës. Është zbuluar, — Mirë, mirë... — ia pati drejtori, — saldatorët ri kemi duarartë, por...

— Rrezja e Padukshmë! — ia pati usta Saladhëtia shkollësyrin nxënësit të tij pasi e mori me mend shenjicë të rëndësishme ishte matur të thoshte profesor Buron Gurre.

— Ne, — tha profesori fizikan me ton të ülët, — në Laboratorin Bërthamor D. 6 në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierët, sipas projektidësë së saldatorit fizikan, shokut tuaj Rrezart Detit, e ndërtua aparatin e gama-defektoskopisë dhe e kemi sjellë këtu midis jush. Por, parësisht nga eksperimenti që kemi bërë në laboratör, ky aparat do ta thotë fjalën e tij këtu, në praktikën e punës suaj.

— ...Ne punuam nën udhëheqjen shkencore të profesor Buron Gurre! — ndërhyri Rrezarti.

— Ju uroj suksese, profesor, — i tha drejtori dhëni zgjati dorën Rrezartit. — Të lumtë!

— E padukshmja në pëllëmbë të dorës! — u hodh e tha usta Sala.

— More, ti qenke asistenti i këtij?! — qeshi drejtori duke e vështruar Salën në sy.

— Jo! Ky është çiraku im, se unë ia kam mësuar zanatin e saldatorit, — tha usta Sala duke treguar me gisht Rrezartin.

Punëtorët aty përreth qeshën.

— Për kush do ta përdorë aparatin? — pyeti kryein-xhinieri i montimit me një pamje paksa të druajtur që e kishte harruar tanë atë autokritikën.

— Njëri ngä autorët, saldatori fizikan, — u përgjigj profesori.

— Punëtorët vështruan nga Rrezarti si të habitur.

— More, të lumtë! — shpërtheu saldatori Mete dhe, pasi i hodhi duart në qafë, shtoi: — Ti qenke dreqi vetë! Le të na marrin të keqen armiqtë. Në do t'i qepim me tegel sferat e çelikut që të mos i luajë as topi dhe jo me presionet e larta!

— Atëherë le të nisim nga puna! — tha drejtori i «Çelikut të Partisë» me një ton entuziast. Dhe, pa e zgjatur më, filloj t'u jepte dorën saldatorëve dhe secilit i uronte sukses në punë.

— Soldimet do t'i bëjmë dhjetë ditë para afatit! — tha kryeinxinieri i montimeve kur po ia shtrëngonte dorën drejtori.

— Po autokritikën e harrove? — e pyeti seriozisht drejtori. — Atë duhet ta bësh me ndërgjegje të lartë, inxhinier, bile edhe ti, usta Sala, — iu drejtua ai saldatorit të vjetër aty ngjitur me inxhinierin.

— Unë... të bëj autokritikë! — tha i habitur usta Sala.

Drejtori qeshi.

— More, ti sikur na paske përgjuar! — qeshi usta Sala.

— E pra edhe një herë ju uroj punë të mbarë e faqe të bardhë! — thirri drejtori duke tundur grushtin në ajër me buzën në gaz. Dhe, pasi zuri për krahu profesorin, u largua.

Saldatorët dhe montatorët u shpërndanë secili në vendin e punës që i kishte caktuar inxhinieri mekanik sipas

grafikut të ndarjes që u kishte bërë qysh nga zyrat e byrosë teknike. Disa prej tyre vendosën në fytyrë maskat mbrojtëse me xham kobalti dhe me tubat e oksigjenit në-për duar nisën të saldonin.

Rrezarti, usta Sala dhe saldatori Mete, të kërrusur mbi tri pika të sferës, saldonin në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin ritëm copat e sferës prej çeliku. Duart e tyre lëviznin tubin e oksigjenit nga poshtë lart sikur të ishin të sinkronizuara. Rrezatimet e forta të oksigjenit që penetraton nxehtësi të temperaturave të larta deri në zemër të çelikut, i ngjitnin si me tegel copat e kurbuara të kupolës. Shkëndijat e saldimëve që përhapeshin aty rrrotull vinin deri te këpucët me qafa të saldatorit fizikan. Ai ndiente ato çaste gjëzimi në shpirt dhe i dukej vetja me të vërtetë sikur ishte në një nga betejat legjendare të Luftës Nacionaçlirimtare që lexonte nëpër romanet. Kishte kaluar gati dy orë punë pa ndërprerje, kur saldatori Mete hoqi maskën nga fytyra dhe, kur pa që edhe Rrezarti e usta Sala bënë të njëjtën lëvizje, ai thirri:

— Mbarovë! — Djersët i rriddhnin çurg ballit e qafës së kuqe që tani kishte marrë ngjyrë si të bronzit.

— Mbarova! — belbëzoj edhe Rrezarti buzagaz. Dhe atë çast që hoqi maskën, duke e vendosur përtokë, pa profesor Buronin që rrinte në këmbë nga dy hapa mbi kokën e tyre me vështrim nga kupola e sferës prej çeliku që ata e kishin ngjitur.

— Bukur keni punuar! — i përgëzoj profesori me një shprehje dashamirësie duke bërë përparrë drejt studentit të tij.

— Ju këtu, profesor?!

Rrezarti paksa i habitur hapi krahët dhe deshi të thoshte që nuk ishte nevoja që ai të qëndronte e të lodej duke ndenjur në këmbë e duke soditur ato rreze të kuqe verbuese që të prishnin sytë.

— Kam ndier një kënaqësi..., — tha ai duke i ardhur rrrotull sferës së salduar.

— Është shkencë të saldosh pajisjet nën presione të larta! — ia pat saldatori Mete duke vështruar me një pam-

je naiviteti profesorin näse ai do t'ia vlerësonte punën e tij kështu si e mendonte ai.

— Vërtet është shkencë të saldosh me saktësi këto detaje çeliku për të ndërtuar sferën që do të punojë nën pesëqind atmosferë!

Profesori ia zgjati dorën e tij me qime ështërmadhe e të thatë dhe shtrëngoi dorën e saldatorit Mete të bu-havitur, me kallo, e të djegur vende-vende.

— Dikur një nga saldatorët e huaj që vinin përtej detit në uzinën e plehrave azotike më tha: «Nuk e bën ti këtë punë! Kjo është punë shkencore. Duhet të pajisesh me patentë ndërkombëtare.» Pastaj, për të kontrolluar saktësinë e ngjitjeve të përsosura të çeliqeve, përdorte aparatin e ultratingujve dhe atë defektoskopinë... «E shiko! — më zgërdhihej. — Ju nuk i keni këto aparatet dhe as që dini t'i përdorni! Këto janë patenta sekrete!» Unë i thashë shqip: «Mos i qaj hallin kalorësit që i varen këmbët.»

Profesor Gurra i rrahu miqësisht supin atij punëtori duarartë dhe me mendje të mprehtë. Pastaj iu drejtua studentit të tij, kandidatit diplomant:

— Po, po, është punë shkencore saldimi!

— Kârëndësi, profesor — shtoi usta Salë, — të mos të dridhët dóra fare! Kërkon durim të madh dhe nerva shumë të qeta. Lëvizja e dörës duhet të bëhet me një shpejtësi të njëtrajtshme gjatë gjithë tegelit, po ashtu duhet të punojnë paralelisht e me të njëjtin ritëm edhe shokët përkundrejt.

— Tani e kanë radhën mekanikët! — ndërhyri saldatori Mete që nuk linte Salën të vazhdonte me ndërhyrjet e tij.

— Hajt, pra, shpjegoje til! — i thirri me të thumbuar usta Sala. — Por mos e bëj tërkuzë, se profesori i kpton.

— Ej ti, shoqe! — i thirri ai Meritës që qëndronte në këmbë disa hapa larg tyre. — Pastroji mirë e mirë këto sferat nga skoriet që kanë lënë gjurmët e saldimeve tonë!

Meritë shtypi butonin e kompresorit të ajrit dhe, si erdhë aty pranë tyre, me anën e një tubi nisi të frynte fort

mbi tegelat e veshur me skorie. Ajo kokulur vështronte me kujdes vendet e ngjitjeve në sferë. Si bëri këtë proces, e la përtokë tubin dhe me letër zmerilio nisi të pastronte e të lëmonte tegelat e saldimit të sferës.

— Hë, Merital Tani pastroja mirë e mirë edhe skoriet e kokës këtij bandillit! — tha papritmas usta Sala që kishte një copë herë që mendohej ta thoshte apo jo këtë fjalë.

Merita u bë lulëkuqe në fytyrë. Ajo i hodhi një vështrim të rreptë e qortues usta Salës. Nuk dinte si të vepronte. Diç e mundonte në shpirt dhe kjo kuptohej qartë nga pamja e saj. Ajo nuk e kishte shkuar fare në mend se aty në metalurgji do të vinte vullnetar edhe Rrezarti. «Mos vallë ai mendon se i jam ngjitur prapa si rrondhe?» Ky mendim ia brente shpirtin si me turjelë. Atë çast aty te sfera e tyre erdhi drejtori i metalurgjisë dhe kryeininxinieri i montimeve.

— Hë, profesor, paskeni ardhur? — pyeti ai dhe me që buzëqeshjen që ia rrudhët edhe më tepër buzët e vogla, shtoi: — Më duket se erdhi çast! — Ai vështroi Rrezartin dhe ia bëri me shenjë që të merrte aparatin e të niste nga puna. Profesori, kur ktheu kokën nga prapa, pa Meritën që po largohej dhe nga pas usta Salën që e shoqëronte dhe diç po i thoshte.

— Saldimet e tri sferave kanë përfunduar! — raportoi kryeininxinieri.

— Po. Kanë përfunduar, se kemi qysh dje që punojmë me këtol — iu përgjigj saldotori Mete duke fshirë fytyrën e djersit me një shami të kuqe që mbante në qafë, me gjithëse dielli kishte perënduar, dhe vetëm rrezet e kuqërrëmta qëllonin furrnaltat e godinat e kombinatit si shigjetë.

Rrezarti, inxhinieri mekanik dhe një nga laborantët e fabrikës, një fizikan i sapodiplomuar, përgatitën aparatin e gamadefektoskopisë për të zhvilluar eksperimentin. Në fillim e vendosën te sfera prej çeliku numër 3. Drejtori, profesor Gurra dhe kryeininxinieri i montimeve qëndronin tok së bashku si më afër objektit të rrethuar nga saldotorët, dhe montatorët e heshtur që e vështronin sferën e

çeliktë të njitur, sikur të ishte një «pacient» i çuditshëm që priste t'i bëhej diagnoza.

— Nisim, Rrezart, — tha me zë të ulët profesori duke ngritur sytë e ngathët. Dhe, si vuri pak 'buzën në gaz, shtoi: — Sahati i hairit, thoshte Babë Myslymi kur niste sulmin e befasishëm atyre gërxheve mbi ushtrinë push-tuese nazifashiste.

Drejtori e pa në sy me një pamje ngazëlliyese profesorin e Universitetit, të cilin po e takonte për herë të parë këtu në frontin e prodhimit; megjithëse kishte dëgjuar për punën e tij të shqar në fushën e fizikës bërthamore.

— Po! — tha Rrezarti dhe shtypi butonin e parë të aparatit. Pastaj diç bëri me ata çelësat që lidhnin pjesët e ndryshme gamadefektoskopisë. I përqëndruar në punën e tij, nuk vështronë asnjeri në sy, as edhe Meritën që mbiu atë çast fare pranë tij. Në ballin e rrudhur ca bula djerse i ndrisnin si të ishin margaritarë të vegjël fosfori. Vetullat e zeza hark qenë shtrënguar rreth syve dhe të-rë pamja e tij kishte marrë një shprehje të tendosur që vihej re më qartë nga nervi në tëmthet që dridhej sikur të ishin nën ndikimin e ndonjë rryme elektromagnetike.

— Kjo është radioskopia e aftësive dhe e ndërgjegjes sonë në punë! — tha befas usta Salë duke e prishur atë heshtjen që kishte pllakosur ato çaste aty përreth.

— Saldatorët në fillim ndenjën me një pamje të pa-përcaktuar, po, kur panë ca gjeste të usta Salës, nisën të qeshnin.

— Mirë e tha usta Salë! — tërroqi vëmendjen drejtori.

— Rrezatimi i padukshëm gama tanë po penetron në zemrën e çelikut, — tha fizikani laborant duke parë pjerr-tazi saldatorin Meto që ishte në kllapinë e ankthit të punës së tij.

— Secili saldator ka numrin e tij në film, — ia pat Rrezarti. — Dhe të mos bëhet merak asnjeri se nuk i hahet haku.

Sekondat dukeshin minuta dhe minutat orë të tëra. Të gjithë prisin vlerësimin e punës së tyre.

— E, djema, si ndiheni? — pyeti befas saldatori Mete shokët përqark duke ngacmuar me bërryl një saldator që

kishtë ardhur vullnetar nga Shkodra. — Bile habitem se si ky nuk e ka hapur gojën fare, — shtoi ai.

— Nuk jam vendasl Jam i ardhur në Shkodër nga Tropoja, — u përgjigj ai me naivitet.

Saldatorëve u plasi gazi.

Merita, e tërhequr si me magnet, nuk ia hiqte vështrimin fytyrës së tendosur e plot hijeshi të Rrezartit. Ai me një ndjenjë dhimbjeje në shpirt që nuk e kuptonte se nga i vinte dhe me një frysëmarrje të vështirë që i rëndonte gjithnjë e më shumë priste rezultatet e atij aparati të çuditshëm. Për Rrezartin kishte dëgjuar mjaft mendime edhe nga të tjerët si në fabrikë ashtu edhe jashtë saj. E vlerësonin si njeri të vullnetshëm, studiues dhe shprehnin bindje se një ditë ai do të bëhej, ndoshta, edhe shkencëtar. Tani ai ishte vënë në kudrën e provës! Po si kur gjithë kjo punë të mos kurorëzohej me sukses? Rrezarti do të mbulohej me turp dhe jo vetëm që do të kthehej përsëri në fabrikë, por shokët do ta quanin një saldator lapangjoz që matej me hijen e mbrëmjes!

Befas laboranti fizikan thirri:

— Eksperimenti mbaroi! — Midis saldatorëve u dëgjuan një pëshpëritje e papercaktuar sikur u çliruan nga një barre e rëndë që mbanin në supe.

Profesori mori në dorë filmat e shënuar poshtë me numra të bardhë. Ai i mbante ata në cep dhe, pasi i vështronte me kujdes, ia jepte Rrezartit, i cili, pasi bënte të njëjtin veprim, ia kalonte laborantit fizikan. Në fund i vështronte edhe inxhinieri konstruktor, Besniku.

— Cili është saldatori numër 12? — pyeti profesori fizikan që mbante filmin në dorë pasi e kishin kaluar nëpër duar kolegët e tij dhe kishin dhënë mendimin e tyre. Ai vështronte saldatorët që atë çast kishin një pamje si të hutuar.

— Unë... Mete Kaninal! — belbëzoi saldatori.

— Të lumtë! Ke salduar për mrekulli! Ja, vështroje filmin tënd! — i tha profesori duke ia vënë filmin para syve.

— Asnjë gjurmë vrimash nuk e ke lënë gjatë tegelit të qepjes së çeliqeve!

— Kësaj i thonë punë! — thirri drejtori dhe zgjati do-

rën e ia shtrëngoi saldatorit, të cilit nisi t'i çelej fytyra si ajo maja e malit, që, kur i davariten retë, zbulon pamjen e tij të qeshur. Atë e uruan edhe shokët.

— Profesor! — tha me zë të lartë e papritmas Rrezarti duke i dorëzuar filmin numër 2 mësuesit të tij të fizikës. — Vështroje filmin numër 2, është imi.

— Njëlloj si filmi i parë! — u hodh e tha profesor Burron Gurra duke u kthyer nga Rrezarti me një buzëqeshje të papërmabjatur. — Duar të arta ke! — dhe pastaj ai ia afroi filmin usta Salës. — A e shikon se nuk dallohet asnjë impresionim më i vogël i rrezeve të padukshme? Kjo tregon se tegeli i qepjes së çelikut nuk ka lënë asnjë boshillëk.

— Zanati byzylyk florëri! — thirri i gëzuar usta Sala dhe i rënë me grusht lehtë në gjoks Rrezit. — E kam thënë unë...

— I kujt është filmi numër 4? — pyeti laboranti.

— Imi..., — tha me gjysmë zëri një saldator me moshë të papërcaktuar me ca-sy të kuq sikur kullonin gjak dhe me një fytyrë me rrudha, me një kokë të stërgjatur e me ca flokë të pakrehur gjysmë të rënë.

— Vështrojeni vetël — tha fizikani laborant. — Ja dy zgavra dhe nën to dy vrima!

— Kjo ngjitje e keqe shkakton hedhjen në erë të sfères kur të punojë nën presion të lartë! — thirri me zemërim inxhinieri mekanik.

— Hë, Sefer, a të kam thënë që të heqësh dorë nga alkooli? — e pyeti një shoku i tij që duhej të ishte brigadieri i asaj brigade saldatorësh në metalurgji. — Nuk mund të saldosh me duar që dridhen si purteka ulliri!

Seferi hapte e mbyllte qepallat e syve me një ngathësi sikur dikush ia ngrinte dhe ia ulte me dorë dhe bënte me gjeste sikur ishte penduar.

— Ndoshta... aparati nuk ka treguar..., — tha ai ca fjalë që ranë si plumb midis saldatorëve. Ai dyshonte për aparatin.

— Ti, o Sefer, shko e shtrohu në spital dhe, pasi të shërohesh nga alkoolizmi, ec e puno saldator për pajisjet nën presion! — tha drejtori me një pamje hijerëndë dhe i vendosur për atë që thoshte.

— Mirël — tha profesori i menduar. — E zëmë se dyshojmë për saktësinë e aparatit. E përsërisim kontrollin. Aparati u vu përsëri në punë. Sa të hapje e të mbyllje sytë dilnin nga xhepi i tij njëri pas tjetrit filmat e gatshëm.

Të pranishmit të pushtuar nga një heshtje e rëndë si plumb, nuk pipëtin fare dhe dukej sikur mbanin frysë marrjen që të mos prishej qetësia.

Filmat edhe herën e dytë treguan të njëjtin rezultat.

— Këto, o Sefer, janë zgavrat e lëna në gjoksin e çelikut nga saldimi i keq që ke bërël — tha saldatori Mete që kishte përvjë me kontrolllet që u kishin bërë kushedi sa herë saldimeve të tij specjalistët e huaj në azotik, superfosfat, në Krekingun e Ballshit, në sodën kaustike e në objekte të tjera ku kishte punuar. — Dhe «syri magjik» i aparatit që shikon edhe në brendësi të metalit t'i nxjerr në shesh... Po, thuaj shqyr që na e sollën shokët këtë aparat, se me sy, aha, me sy, nuk i zbulon dot ato.

— As me sy, as me dylbi, qeshi usta Sala i gëzuar që tegeli i tij skishte pasur asnjë defekt.

— Ju përgëzoj, shokë të shkencës! — tha befas drejtori. — Nuk ka më asnjë dyshim se aparat i gamadefekto-skopisë, i ndërtuar me forcat tuaja, është plotësisht i sakta, dhei bazuar në të dhënët tekniko-shkencore. — Ai përqafoi profesorin, Rrezartin, inxhinierin konstruktor, Besnikun, Petritin, dhe laborantin fizikan.

Pas drejtorit u turrën t'u shtrëngonin duart punonjësve të shkencës edhe saldatorët e montatorët e metallurgjisë. — Kjo është një punë e vogël, shokë! Është një nismë madestë, në fushën e aplikimeve të burimeve radioaktive në industri. Por na prësin punë më të mëdha e të ndërlikuara, — tha profesori ndërkohë që punëtorët ia shtrëngonin dorën, dhe le uronin përsuksesë të reja.

— Kurse këtë saldimin' e Seferit e ujdis unë! — tha saldatori Mete duke i rënë me çekic, me sa fuqi që kishte, tegelit të saldimit të keq të sferës numër 3.

— Po jo tani... Tani në mensë! — tha drejtori dhe ia bëri me dorë që ta ndiqnin nga pas.

Rrezarti hapi sytë të kapte vështrimin e Meritës, pör

ajo ishte zhdukur, sikur ta kishte përpirë toka. Ai e mori me mend se çfarë duhej të kishte ngjarë në shpirtin e saj dhe me ndjenjë të papërcaktuar pikëllimi që përzihej me atë ndjenjën e ngazëllimit të suksesit që kishin arritur u nis për në mensë me grupin e punëtorëve saldatorë e monitorë.

Derisa perëndoi dielli, Rrezarti saldoi sferat e çelikut, me usta Salën dhe Meten. Dhe, së bashku me fizikanin e ri të laboratorit të metalurgjisë kontrolluan punën e tyre dhe të shokëve të tjerë saldatorë. Dita kaloi shpejt dhe vendin e saj po e zinte nata. Njerëzit punonin me vrull e tension dhe kjo vërehej ngado që hidhje sytë. Në mbrëmje Rrezarti kaloi disa orë në bibliotekën e byrosë së projekteve të metalurgjisë ku punohej me turne. Atje u njoh me nja dy inxhinierë, të cilët treguan interes të veçantë për futjen e metodave radioaktive në metalurgji dhe herë pas here i bënин pyetje. Një kimist i propozoi që të studionin bashkë mundësinë e analizave ekspres të aliazhevë me anën e përdorimit të spektroanalizës që bazohej në burimet radioaktive.

Si doli nga biblioteka, u veçua nga shokët. Donte të ishte vetëm. U nis në drejtim të lumit. Gjeti një copë shkëmb që ngrihet si kalë i gurtë mbi një pellg të madh dhe aty vendosi të qëndronte. Ai mendoi atë çast me vete se ndoshta do të kishte mundësi me anën e rrezeve të padukshme të studiohej dhe të përcaktohej edhe viti i formimit të këtij shkëmbi. Pastaj nisi të vështronte sipërfaqen e ujit që nën reflektimin e rezatimit të hënës shembollente si pasqyrë që vinte në ngjyrë të përhime si shtresë plumbi. Për një çast iu përfytyrua në pellgun e qetë që dukej sikur nuk lëvizte ftyra e Meritës. Pse iu duk ashtu e zbehtë dhe e trishtuar?! Ai qeshi me hidhërim dhe nisi të belbëzonte me vete: «Po ta kisha këtu, do t'ia hidhja duart në qafë dhe nuk do ta pyesja fare, por do ta puthja me mall! Pastaj do t'i thosha: «Të dua, të dua! Hajt të martoheni dhe të mos ndahemi më kurrë!» Atë çast u rrokullisën nën këmbët e tij ca thërrime shkëmbinjsh dhe ranë

në pellg. Ujët u trazua dhe figura e së dashurës u zhduk. Ai buzëqeshi përsëri me vete dhe nuk e zgjati më vendimin që kishte marrë, vendosi të lahej në lumë. U zhvesh dhe u hodh me kokë në pellgun që ishtë dy a tre metra thellësi. U zhyt i téri. Nën ujë nuk pa gjë veçse errësirë. Në fillim një të ftohtë ia përshkoi tërë trupin dhe iu bënë mornica, por, kur notoi disa metra përpara drejt rrymës, u ambientua dhe nuk ndjeu më shqetësim. Nxori kokën dhe, si bëri edhe pak përpara, pa se po i afrohej cektinës me guraçokë, u kthye prapa dhe nisi të notonte me shpinë. Notoi poshtë e lart pellgut gati rrëth dhjetë minuta. U zhyt dhe nja dy herë nën ujë. Mendoi se peshqit dhe bretkosat që nuk pipëtinin duhej të ishin struktur zgavrave të shkëmbit. Doli nga ujët në zallin me zhavorr me një ndjenjë kënaqësie. Trupi dhe koka iu dukën sikur i ishin lehtësuar. «Kjo është një shenjë e mirë, kur njeriu nuk ndien rëndësinë e trupit të tij!» — tha ai me vete. Dhe si u vesh, hyri në territorin e fabrikave. Aty dëgjoi fishkëllimën e një lokomotive që po tërhoiqte me rënkim disa dhjetëra vagona të ngarkuar me shtylla betoni të tensionit të lartë, kurse ato të fundit ishin ngarkuar me koksin e vendit. U kthye në fjetoren e tij dhe pa u ndier u shtri në krevat.

— E ku ishe, more? — e pyeti përgjumësh saldatori Mete, i kthyer skic me fytyrë nga ai. — U bëra merak!

— Sonte do të bëj gjumë të rehatshëm! — qeshi Rrezarti dhe, si u mbulua me çarçafin e bardhë që mbante erë sapun, mbylli sytë dhe e lëshoi tërë qenien e tij nën pushtetin e gjumit.

* * *

Ishte dita e gjashtë që Rrezarti qëndronte në metalurgji duke salduar sferat prej çeliku të fabrikës së re. Tri ditët e fundit ai ishte marrë më shumë me kontrollin e saldimeve e me instruktimin e përdorimit të aparatit të gamadefektoskopisë nga ana e fizikanit të laboratorit dhe inxhinierit mekanik të montimeve në atë fabrikë të kombinatit metalurgjik. Profesor Gurra ishte kthyer në qytetin e

tij dhe bashkë me atë në veturë kishte marrë dhe asistentin e tij, Petritin dhe inxhinierin konstruktor të oficinës së radiologjisë. Merita nuk dukej gjékundi. Atë mbrëmje Rrezarti dhe saldatori Mete, vajtën në klubin e kombinatit. Në një dhomë përballë ca punëtorë bënin zhurmë dhe gajasëshin të kërrusur mbi tryezat e shahut e të dominosë duke bërë sehir shokët e tyre që lozni. Në një sallë të mënjnuar, që ndriste nga dritat e llambave neon, një turmë punëtorësh, të përqendruar para ekranit televiziv, dëgjonin një program me muzikë popullore nga disa këngëtarë të zgjedhur.

— Jo andej! — i thirri Metja duke e zënë nga dora Rrezartin. — Vemi në bufë të pimë një gotë, se më është tharë gurmazi.

— Po... po, edhe unë dua të pi një raki sot, — qeshi Rezi. — Bile aty na pret edhe usta Sala.

Rrezarti hodhi një vështrim nga dritarja e madhe me xham dhe pa përjashta furrnaltat dhe ambientet industriale që shquheshin nga dritat midis errësirës së asaj nate pa hënë dhe me qelli të mbuluar me re.

— Erdhët?... — tha usta Sala me gotën e rakisë përrpara dhe me meze pulë të pjekur. — Uluni! Më nxorët telashe duke ruajtur vendet! Ju prezantonj me këtë shökun... — Ai nuk ia kishte mësuar akoma emrin, sepse për herë të parë në jetën e tij takohet me atë njeri.

I panjohuri, një burrë i bëshëm që rrinte mbështetur si qiri në karrigen e tij, me ca flokë kaçurrel vende-vende të thinjur buzëqeshi miqësish duke picërruar sytë e thellë e si të perënduar.

— Jam Fari Erzeni! — belbzoi ai. — Punoj në Universitet.

— Rrezart Deti! — u prezantua ai duke ia kthyer përshtendetjen po ashtu si bëri i panjohuri, me lëvizjen e lehtë të kokës.

— Mua më thonë Mete saldatori! — tha Mustafai. Dhe u ul fill pas Rrezartit në karrigjet e rezervuara nga usta Sala.

Kamerieri, që u kaloi pranë, si i përshëndeti me një buzëqeshje të përzemërt, nxitoi drejt tryezës së tyre.

— Qenka dreqi vetë! — tha usta Sala. — Me sâ duket e njohu shkencëtarin e rrezeve dhe do që ta nderojë!

— Ju... jeni ai novatori i aparatit të gamadefektoskopisë! — ia pat i panjohuri. Fytyra e tij e heshtur dhe si e dyshimtë atë çast nisi të gjallërohej.

— Bashkë me shokët e ndërtuan, — iu përgjigj Rezarti.

Atë kohë erdhi kamerieri. Solli gatat e rakisë dhe me kujdes i vendosi në tryezën e tyre. Pastaj duke vështruar klientët në sy, mori porosinë dhe u largua pa thënë asgjë.

Ndërkaq profesor Fahriu tregoi për qëllimin e ardhjes së tij në metalurgji. Ai, në bashkëpunim me inxhinierët e byrosë teknologjike, aty, kishin diskutuar mbi vendosjen në prodhimin në seri të detajeve të traktorit «Shqiponja» që kishin të bënin me modifikime origjinale për të kursyer karburantin gjatë punimit të motorëve që do të mantohej në kombinatin e autotraktorëve. Pastaj ai tregoi për gjërat kryesore që ishin diskutuar në sesionin shkencor të organizuar në metalurgji me iniciativën e Institutit Kërkimore Mekanikës dhe të Fakultetit të Inxhinierisë.

Rezarti i foli për studimin që kishte bërë në përdorimin e izotopit radioaktiv të kobaltit në furrnaltat e metallurgjisë, që, sipas tij, paraqisin një leverdi ekonomike të madhe dhe një interes për sigurimin teknik e mbrojtjen në punë të punëtorëve nga rreziqet që mund të ndodhnin. Ai tha se me këtë metodë furrnalta i nënshtrohet radioskopisë së plotë dhe kontrollit të dorës së njeriut për çdo gjë që ndodh aty brenda, në atë vullkan metalem të shkrira të krijuar artificialisht nga njeriu.

Saldatori Mete dhe usta Sala, paksë të habitur dhe me një vëmendje të përqëndruar, për të munduar të kapnin tërë ato biseda shkencore që u zhvilluan në atë tryezë të klubit të metallurgjisë midis profesorit të inxhinierisë mekanike dhe shokut të tyre që po ngrihej para syve të klasës në një shkencëtar të vërtetë, harruan fare mezet dhe gotat e rakisë, që i kishte sjellë me kohë kamerieri. Shfaqte shëshit habinë për Rezartin sidomos saldatori Mete. «Ç'bën studimi, — tha ai me vete. — Sa ka ndryshuar

ky djalë. Ishte i druajtur, dy fjalë mezi i lidhte, kurse tani... Shiko si bisedon me shkencëtarin, sikur bisedon me mua dhe me usta Salën. I lumtë.»

— Pa shkencën, ore vëllezër, nuk ecet përpara! — tha saldatori Mete, sikur t'u vinte pikë gjithë atyre mendimeve që kishte tjerrur me vete.

— Dhe tani le të rrëkellejmë nga një raki! — ndërhyri usta Sala duke marrë gotën në dorë. — Për nder pije më fisnike se rakia jonë e rrushit nuk ka në botë, — shtoi ai dhe i dha fund gotës. Shkencëtar i madh duhet të ketë qenë ai që ka shpikur rakinë, o Rezi.

— I madh, i madh ka qenë, — tha Rezi duke qeshur, — po ka lënë një porosi...

— E ç'porosi paska lënë? — pyeti usta Sala me vetulla të vrenjtura.

— Pije rakinë, ka thënë, të bëftë mirë, po pije ama jo të të pijë ajo, se pastaj dalin zgavra në radiografi...

Metja qeshi me të madhe se iu kujtuán zgavrat e saldator Seferit.

— Ore Rezi, po mos më ngacmo, është bir, se s'jam si Seferi unë, — tha usta Sala duke qeshur dhe vetë. Pastaj i shpjegoi pedagogut të Universitetit se ç'u kishte ndodhur kur kishin provuar aparatin e defektoskopisë.

— Ja ku e ke, usta, po ngadalë, se po të dëgjon, — tha Rezarti, duke kafshuar buzën. Atë çast që ktheu kokën dhe pa Seferin që vinte drejt tyre, duke u përplasur sa në një anë, në anën tjetër të tryezave.

— Qenka bërë xurxull Seferi! — shtoi Rezarti.

Seferi, me sytë e skuqur si spec djegës, nisi të përshëndeste Meten, Rezartin dhe usta Salën pastaj qëndroi duke vështruar një copë herë profesor Fahriun.

— Këtë shokun nuk e njoh! — tha ai duke i zgjatur fjalët që mezi shqiptoheshin nga buzet e trashura nga alkooli i tepërt.

— Është një shoku ynë! — iu përgjigj ftohtë Rezarti dhe bëri të çohej nga tryesa.

— Prisni, ore, prisni të pini edhe nga një verë, se duhet larë rakia.

Profesori, Rrezarti, usta Sala dhe saldatori Mete, pasi paguan bashkarisht çfarë kishin ngrënë e pirë, u nisën të largoheshin nga klubi.

— Po shkojmë të pimë ujë gline dhe kafe ekspres! — thirri nga pragu i derës së klubit saldatori Mete duke u drejtuar nga Seferi dhe kamerieri që mbetën si dy kërcunj para tryezës së boshatisur.

— Ka edhe të tillë akoma midis nesh që duhen rreztuar mirë! — u tha Rrezarti shokëve kur dolën në ajër të pastër.

KAPITULLI VII

Pasi Rrezarti u kthye nga metallurgjia dhe vuri në jetë me sukses aparatin e gamadefektoskopisë ndërtuar në laboratorët e ofiçinat e vendit, drejtoria e kombinatit të material-ndërtimit «Arbëria» jo vetëm i kishte akorduar lejen e shkollës për t'u përgatitur për mbrojtjen e diplomës, por me porosi të Ministrisë e lejonte të punonte në Laboratorin Bërthamor D6 për të studiuar mundësitë e mëtejshme të zbatimeve të burimeve radioaktive në fushën e teknologjisë së prodhimit të material-ndërtimit. Ai ndiente një kënaqësi për hapin e parë që pas kaq shumë përpjekjesh kishte bërë për të hyrë në rrugën e eksperimentimeve shkencore. Profesor Buron Gurra i kishte dhënë dy ditë leje që të pushonte pas asaj pune të lodhshme dhe tërë mundime që kishin bërë për vënien në jetë të defektoskopit në praktikën e saldimeve të sferave prej çeliku në fabrikën numër 12. Atë mëngjes vendosi ta kalonte buzë detit dhe të gjuante peshk.

* * *

Rrezarti u nis në laborator. Me çantën e lëkurës në sisetull ai ecte bullevardit të gjerë duke bluar me mend temat kryesore të punës së diplomës. Dhe, ajo që ia mbu-

shtet shpirtin me gjësim e hare, ishte se eksperimentet që po bënte në fushën e fizikës bërthamore do t'i shërbën edhe prodhimit. Kur doli jashtë bllokut të pallateve në kthesën drejt godinës në formë U-je që ngrihej në plajën e një kodre të gjelbëruar, takoi dy shokë dhe një shoqë nga të fabrikës. Ai i përshëndeti ata me kokë dhe u më-dysh që t'i ndalonte për t'i pyetur se si shkonin punët në fabrikë tanë që kishin përmbysur pothuajse krejtësisht procesin e vjetër të prodhimit dhe e kishin zëvendësuar me proceset e reja teknologjike bazuar në shkencë. Ata ecnin aq shpejt, sa dukej sikur vraponin. «Kushedi se çfarë pune të rëndësishme duhet të kenë,» — mendoi ai me vete. Si bëri dhe ca rrugë pa takuar njeri të njojur, qëndroi para portës së madhe të hekurt të Laboratorit Bërthamor D 6. Nuk dëgjoi asnjë zë me përjashtim të një bilbili që ia kiste marrë një këngë të përvajshme, i fshehur në drurët e gjelbëruar.

Trokiti.

U hap qepeni i kabinës së rojës aty në cep të portës me kangjella dhe xha Sadiku, roja, nxori kokën.

— Erdhe? — pyeti.

— Po, erdhali — buzëqeshi Rrezarti.

— Fletëhyrjen?! — ia pati bëfas xha Sadiku dhe zgjati dorën përtëj kamarës me një qëndrim sikur për herë të parë tákohet me punonjësin Rrezart Deti.

Rojë, pëasi i hodhi një vështrim të kujdeshshëm fletë-hyrjes, ia ktheu përsëri atij duke ngulitur edhe një herë vështrimin te fotografia ngjitur në kartoçinë. Rrezarti rrini dhe shikonte atë plak të rrahur me vaj e më uthull nga jetë duke e pasur zili që tregohej aq vigjilent.

— Vështro mirë, — qeshi Rrezarti, — se mos bëhem njeriu i padukshëmi!

— Hajd hyr, hyr brenda! — thirri miqësisht xha Sadiku dhe ndërkaq shtypi butonin në qoshe të tryezës. Porta nisi të lëvizte mbi shinat e vendosura.

— Mirëmëngjes! — i tha Rezi kur hyri brenda pragut të kabinës dhe i shtriu dorën pa i mbajtur inat.

— Mirëmëngjes! — iu përgjigj ai duke hequr syzet nga

sytë, anash të cilëve ishin formuar rrudha. — Mos ma merr për keq, detyra detyrë! — shtoi dhe qeshi pakëz si hidhur. — Kam jetuar unë lloj-lloj kohërash, shumë të vështira, dhe vigjilencën e kam pasur shok besnik të jetës. Jua këshilloj edhe juve të rinxje të mos e harroni kurrë vigjilencën... he... he...

— Ka ardhur profesor Buroni? — pyeti Rrezarti.

— Është akoma herët! Ulu këtu të presësh! — ia bëri me dorë xha Sadiku duke i afrouar karrigen e vetme që kishte të lirë aty në kabinë.

— Më ka dhënë çelësin e kabinetit..., — i tha Rrezarti dhe ia tregoi xha Sadikut aty para syve.

— More... shpejt ua rrëmbeve zemrën! Mirë, shkol!

— Tunjat..., — e përshëndeti Rrezarti duke ngritur do-rën dhe me një pamje hijerëndë u nis drejt godinës së përgjumur të Laboratorit Bërthamor me ndjenjën e një përgjegjësie që i ziente në shpirt për besimin që i kishin dhënë duke e radhitur midis punonjësve shkencor. Si përshkoi pa e ndier oborrin që kundërmonte nga lulet shumëllojëshe, u gjend para derës së laboratorit që përngjante si derë kasaforte. Shtypi dy herë radhazi një buton në ngjyrë të gjelbër. Pastaj çelësin «special» që mbante në dorë horizontalisht me vrimën e bravës së derës, e tundi poshtë e lartë disa herë. Dhe pas pak sekondash dera elektro-nike u hap. Rrezarti nisi të ecë korridorit të shtruar me linoleum me një hap të ngadalshëm. I dukej sikur sholla e këpucës tërhiqej nga ndonjë fushë e lehtë magnetike që lëshonte dyshemeja. «Ja, më në fund, — belbëzoi me njëfarë krenarie e me një ndjenjë kënaqësie, — hyra në Laboratorin Bërthamor, por lypset ta justifikoj». Ai qëndroi te dera numër 5 dhe përsëri po me atë çelës që hapi derën e jashtme, hapi edhe atë. Sapo hodhi pragun, i vajtën sytë te xhami i raftit «special» ku ruhej kapsula e plumbtë e ngarkuar me lëndën radioaktive dhe fare padashur iu kujtua profesor Koti. Ai i qëndronte rëndë. Herë-herë bënte sikur nuk e vinte re. Kështu i ndodhi një ditë, kur shkoi në laboratorin e fakultetit për të sqaruar diçka. Profesor Koti ishte ulur e diç po shkruante. Vazhdoi punën sikur të mos kishte ndodhur gjë edhe pasi Rrezarti tha: «Mirëmën-

gjesi!» Po Rrezarti këmbënguli, i shkoi fare pranë dhe që-droi para tij.

— Oh... ti qenke?... Mirëmëngjes! — u hodh e tha si pa frysë profesor Koti, i kthyer nga ai me një pamje të hutuar nën syzet me numër të lartë që ia fshihnin vështrimin e turbullt atë çast. Pastaj profesori, me njëfarë siguri, pasi e quante veten në «shtëpinë e tij», vazhdoi ta shikonte në heshtje.

— Unë e dija..., — tha Koti pas një pauze dhe pakëz i çelur në fytyrë, — se ju do të vinit sot këtu për të marrë pjesë në eksperimentimet e matjeve të induksionit radioaktiv në lëndët e ndryshme. Por nuk e mendova se do të kishit kaq zell sa të vinit kaq herët pa dalë ende rrezja e diellit, — qeshi si me pahir ai.

— Jua tha asistente Sofijal — tha Rrezarti dhe e vësh-troi në sy profesorin.

Koti ngriti me gishtin tregues syzet dhe tha si i shpen-guar:

— Unë mjerisht nuk kam mundësi të marr pjesë në këto eksperimente, se jam i zënë me një leksion teorik në Universitet, por desha të bisedoj edhe një herë me ju kokë më kokë për temën e diplomës suaj. — Heshti pak si për të hetuar se c'përshtypje i bënë këto fjalë Rrezartit, pastaj vazhdoi: — Ju i mbani mend këshillat e mia për të hyrë në rrugën e shkencës së madhe?! — Rrezarti buzëqeshi. — Unë ju përgëzoj për suksesin që arritët në ndërtimin e gamadefektoskopit, por kjo është një vogëlimë përparrë atyre zbulimeve që duhet të bëjë një shkencëtar i vërtetë. Aplikimet le t'i bëjnë po të duan laboratorët e njerëzit e prodhimit dhe jo Universiteti e Akademia. Prandaj varet nga ju të zgjidhni rrugën e shkencës së madhe dhe, po të qëndroni ju në tuajën, profesor Gurra do të detyrohet të heqë dorë nga prakticizmi i tij... Dëgjomëni mua sa nuk është vonë! — Fjalët e fundit ai i tha sikur i lutej.

— Asgjë nuk të çon kaq në konflikt dhe në shkelje të mirësjelljes, sesa këmbëngulja në një pohim të një teze, — u përgjigji Rrezarti dhe qeshi sinqerisht.

— Këtë e ka thënë një fizikan i madh..., — tha i hutuar

profesor Koti me qëllim që t'ia ndërronte drejtimin bisedës.

— Nuk po më kujtohet se kush.

— Sido që të thuhen e kushdo që t'i thotë, fjalët e urta e të mençura janë pronë e popullit.

— Djalosh, qenkeni kokëfortë! Po e shoh me sytë e mi se Sofija ka gabuar në qykimin e saj ndaj jush.

— Dhe unë qëndroi e do të qëndroj në mbrojtje të tezës së Partisë sonë se duhet të kapemi pas atyre studimeve shkencore që i shërbejnë shtimit të prodhimit të industrisë dhe përgjithësisht zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste në stadin që iemi...

Profesor Koti ishte naritur nga vendi dhe po qëndronte pranë drifores së madhe me xhamin e myllur dhe atë çast i zuri syri kolequn e tij, profesor Gurrën, dhe përkrah tij dy laborantët, atë të akselatorit, dhe të dozimetrisë që diç bisedonin midis tyre duke bërë dhe aieste me duar. Një ndjenjë e hidhur ia shpoi zemrën. Kur u kthye t'i jepte përgjigje këtii djaloshi kryeneç e të rëndomtë, tha me vete: «Këto kohët e fundit dita-ditës ky Buron Gurra po më sfidon.»

— Dëgjo, djalosh! Atëherë midis nesh nuk mbetet më çfarë të bisedojmë! U përhoq a përtë mirën tënde dhe për shkencën, por më kot! Lamtumirë, — dhe fjalën e fundit profesori e shqiptoi në të ikur, sikur po ndaheshin përfjetë. Mylli derën menjadalë dhe u largua.

Që atë ditë Rrezarti nuk e pati takuar më. Po tanë valle përsë iu kujtua?

Rrezarti ndenji një copë herë i menduar duke vështruar pajisjet e laboratorit, ato sende që dukeshin si pa jetë, por së shpejti do ta çonin në fshehtësinë e ndonjë fenomeni të panjohur prej tij deri tanë. Já, dora mekanike nën xhamin e trashë, dedektorët, aparati, i dozimetrisë dhe ca tuba specialë të mbledhur e të mbështjellë me një letër të zezë të lustruar.

— Mirëmëngjes, Rrezart Deti! — dëaioi në çast. Ishte profesor Gurra që i fliste me një ton të përzemërt ku shqueshin nota optimiste.

— Mirëmëngjes! — u përgjigj Rrezarti me zemër të leh-tësuar pasi u vonua pakëz.

— Paske ardhur herët? — pyeti laboranti fizikan, Petriti.

— Më doli gjumi herët! — u përgjigj me çiltërsi. Rrezarti pa e përbajtur gëzimin që ndiente se po hynte në radhët e atyre punonjësve shkencorë që merreshin me studime të holla si këto në fushën bërthamore.

— Dëgjoni, djema! — thirri profesor Buroni me një entuziazëm që rrallëherë shpërtente në natyrën e tij të heshtur e fjalëpakë. Si mbërtheu kopsën e fundit të bluzës së bardhë, vazhdoi me të njëjtin ton: — E keni nisur punën mirë. Le të kapemi pas atyre studimeve dhe eksperimenteve shkencore që ndihmojnë përsosjen e teknologjisë, rritjen e rendimenteve dhe rritjen e cilësisë së prodhimeve industriale, bujqësore e blegtoriale. Natyrisht nuk do të heqim dorë edhe nga studimet perspektive. Revolucioni ynë tekniko-shkencor që ka nisur lypset të thellohet gjithnjë e më shumë dhe ai duhet të sjellë transformime rrënjosore në teknologji dhe përgjithësisht në ekonominë tonë socialistë. Ndryshe, shokë, po të kapemi pas cikërrimave dhe po të hallakatemi në teorira e teorizime përrrugën e shkencës në vendin tonë, dijeni se do të mbetemi prapa të tjerëve dhe Partia dhe populli nuk do të na e falin.

Rrezarti mbeti pak si i hutuar dhe iu duk sikur profesor Buron Gurra kishte dëgjuar bisedat e tij me profesor Kotin.

— Shumë drejt, profesor, — tha fizikani laborant.

— E po dalçim faqebardhë! — ia pat profesori me një ton të çiltër. — Fillojmë nga eksperimentet! — iu drejtua ai Rrezartit dhe, kur vuri re njëfarë tundimi në pamjen e tij, shtoi: — Saldatori fizikan, për besë, e gjallëroi kabinetin tonë eksperimental! Një rrugë e dy punë. Tezat e diplomës së tij që ai i solli nga fabrika, nuk do të shkojnë kot, ato do t'i shërbejnë edhe prodhimit. Ky është një kombinim i mrekullueshëm. Iniciativave të kolektivave punonjëse që po punojnë përvendosjen e teknologjive të reja të bazuara në shkencat teknike moderne në fabrikat e çimentove me furra rrotulluese në fabrikat e tullave të kuqe, në fabrikat e paneleve prej betonesh, në furrnaltat e metalurgjisë, në ndërtimet e portave detare, në puset e naftës, dhe degë

të tjera të industrisë, laboratori ynë bërthamor do t'u vi-jë në ndihmë shkencore e teknike për aplikimet e metodave radioaktive në këto teknike.

Rrezarti, i kërrusur në një nga aparatet e dozimetrisë, ndërsa lidhte ca fije kontakti me panelin e regjistrimeye të intensitetit të rrezeve gama, dëgjonte me një ndjenjë kë-naqësie pikëpamjet e profesor Buron Gurrës është përputhe-shin me tezat ideologjike dhe shkencore të Partisë.

— Shtypë atë bútonin e verdhë! — thirri profesor Gura duke ngritur sytë nga Rrezarti. — Edhe ti, Petrit, — iu kthyesh me zë të ulët asistentit ngjitur, — takoje kontaktin e detektorit.

Secili nga anëtarët e grüpuit të punës bënин një punë të caktuar dhe me hervë të tendosura kryenin porositë e profesorit.

— Mbi këto shifra ndërtó grafikun, — e porositi profesori Rrezartin, — se kështu do të kesh në pëllëmbë të do-rës tërë zhvillimin e koncentruar të eksperimentit.

Rrezarti e vështroi me bisht të syrit profesorin me një ndjenjë dashamirësie për tërë ato përpjekje dhe atë kuj-desje që tregonte ai për punën shkencore në dobi të pro-dhimit. Madje nuk kishin munguar dhe këshillat e tij deri edhe për jetën intime. Buroni atë çast ia bëri me shenjë që Rrezarti të dilte te kabina me xhamillék special ku ru-hej lënda radioaktive në një kapsulë plumbi që nuk le-jonte të penetronin rrezet e padukshme, ashtu siç bënин në metale të tjera. Ai, ndërsa po bëhej gati të zgjaste krahun për të kapur dorën mekanike, hodhi papritmas vështrimin nga tryezat, ku ishin objektet e eksperimentit. Një tub prej qelqi, aparatit regjistrues i intensiteteve të rrezatimit, ka-shme, rafti i xhamit, kapsula me lëndë radioaktive dhe bloqet e shënimëve përpara, ishin objektet në ato tryeza druri të zeza.

— Mbaje distancën e lejueshme ndaj ekranit mbrojtës! — thirri asistenti fizikan nga prapë Rrezartit që kishte nisur të luante dorën mekanike. Mekanizmi brenda kupo-lës lëvizte sipas komandimit që i bënte kësaj dore të çu-ditshme fizikani. U hapën gishtat e saj dhe me kujdes ho-

qën kapakun e kapsulës prej plumbi. Pastaj lënda radioaktive e ambalazhuar në një tabletë, si u ngrit pakëz lart, u ul përsëri duke ngarkuar folenë e një tubi që ishte vendosur nën të. Mirëpo tabletë e ngarkuar nuk rana në folenë e tubit, por aty në dyshemenë prej qelqj brenda raftit. Asistent Petriti instinktivisht me një shprehje të llah-tarshme të syve të shqyer, u tërroq mbrapsht dy a tri hapë duke u përplasur në qoshen e murit. Professor Gurra, që nuk i shpëtonte as detaji më i vogël, me një gjakftoh-tësi u afrua nga Rrezarti dhe, duke i bërë me shenjë, i dha të kuptonte se duhej të mos e humbte pusullën. Saldatori fizikan përsëri manovroi me dorën mekanike dhe, si e kapi tabletën me dy gishtërinjtë e saj, e vendosi atë në folenë e tubit. Profesor Gurrës i ishte mbushur balli me bulë djerse dhe një nerv i tendosur i tëmthit çohet e ulej me rrahjet e tiktakut të orës.

— Ca rreze i morel — qeshi profesori. — Por s'ka gjë, Rrezartl Doza e tyre është e papërfillshme. Duhet përpikëri në veprime, i dashur, përpikëri e madhe. — Profesori e ndihmoi Rrezartin të vendoste lëndën radioaktive në folenë e tubit. Pastaj shkeli një sustë, edhe një tjetër dhe...

— Eksperimenti përfundoil — thirri asistenti fizikan duke parë në sy profesorin që kishte hequr syzet, dhe me një shami të bardhë fshinte djersët.

Atë çast në kabinet hyri me një frysë, një vajzë laborante, pak e dobët dhe me një shprehje shqetësimi thirri:

— Është hapur dera e bodrumit, të akselatorit!

— Është shndërruar sinjali i kuq, në të gjelbërt? — pyeti profesori.

— Po. Sinjali vjen i gjelbërembi derën e korridorit!

— Si është e mundur?

— Profesori vështroi asistentin e tij, që rrinte i gozhduar me duart prapa, një rafti aty në qoshen e derës.

— Rrezikl, — i pati profesori dhënkur pa Rrezartin që mori të dilte jashtë kabinetit, e zuri nga krahu dhe thirri:

— Prisni! Pas mejelos do i bëj... — Gjatë kësaj orë, —

— Ata dolën në korridor. Printe profesori dhe pas tij Rrezarti, fizikani laborant, dhe dy punonjësit e tjerë shkën-

corë. Qëndruan një çast para garderobës. Sinjali i gjelbër mbi derën e korridorit të katit të poshtëm ndizej e shuhej. Nuk kishte më asnje dyshim se dera e bodrumit që i përngjante derës së një kasaforte, duhej të ishte hapur.

— Të lajmërojmë shokët sipër! — tha radiokimisti.
— Më parë të zhdukim avarinë!

Profesor Buroni vështroi bashkëpunëtorët e rrethonin. Ishte një shikim plot kuptim që zëvendësonë fialët e tepërtë në ato çaste kur duhej vepruar. Hapi raftin e garderobës. Mori nga varësja një kostum mbrojtës kundër rezatimeve radioaktive dhe nisi ta vishte.

— Shkoj unë! — u hodhi Rrezarti dhe me një vendosmëri të patundur ia kapi nga duart kostumin mbrojtës profesorit dhe e veshi shpejt e shpejt pa i lënë kohë tjetrit të hapte gojën. Doli nga garderoba në korridorin e poshtëm të laboratorit. Pastaj bëri përparrë brenda rrugicës së shtruar me linoleum. Dhomat e punonjësve që merreshin me eksperimentet e fundit të përdorimit të izotopeve si gjurmues radioaktivë në përcaktimin e lëvizjes së rërërave të fundit të detit, qëndronin të mbyllura me një pamje të zymtë. Para se të zbriste shkallët, djathtas për në bodrum ktheu kokën nga hyrja e korridorit ndoshta të infektuar nga rrezatimi dhe ua bëri me shenjë profesorit e shokëve të tjerë që të largoheshin. Pastaj kërrusi kokën dhe, si zbriti disa shkallë poshtë pa i vajtur fare ndër mend që t'i nudhe qëndroi vetëm pak sekonda. Pa derën e trashë prej betonarmeje speciale që nuk ishte plotësisht e puthitur në shputë ariu nga doreza mbrojtëse shtyu derën që atë çasti atë me murin. Bëri një kthesë dhe nisi të ekte përsëri të tyre, ngriti sytë lart dhe nëpërmjet xhamit të trashë të kokores, vuri re qartë shndërrimin e sinjalit nga i gjelbër në ngjyrë të kuqe që ndizej e shuhej pa ndërprerje, sikur të ishte një yll shumë i largët. Doli korridoreve të braktisura nga njerëzit dhe hyri menjëherë në banjat speciale të larjes nga lëndët radioaktive. Kur nisi të zhvishte «ska-

fandrën» e mbrojtjes radioaktive, mendoi: «Këto rreze të padukshme janë aq të dobishme për shkencat në shërbim të njeriut, sa edhe të rrezikshme për jetën e njerëzimit. Hoxhi rrrobat dhe i vari në një raft të veçantë, pastaj hapi dushin dhe filloj të lahej me ujë të vakët. Pas pak Rrezarti, me një ndjenjë të ngrohtë në shpir, u kthye te shokët që e prisin në sallonin e poshtëm të kontrollit. Atë çast iu kujtuani tërë ato lexime dhe tregime të veteranëve, dhjetëra heroizma të partizanëve trima shqiptarë që jepnin jetën për të shpëtuar shokët e tyre nga rrethimi armik, për të çliruar popullin nga zgjedha e pushtuesve të huaj, për t'i dhuruar atdheut lirinë.

Te dera e prisin shokët.

— Të lumtë! — thirri profesori dhe i zgjati dorën Rrezartit. — Ti je edhe trim.

— Nuk dihet, profesor, ndoshta kam marrë rreze.., — i tha ai si për t'u shfajësuar që kishte hyrë në dash.

— Edhe sikur të kishe marrë, nuk të prishin punë ato doza... E kontrollova korridordin me indikator dhe rezultoi se ato ishin fare të papërfillshme.

Ndërkaq profesorin e lajmëruan se dikush e kërkonte. Profesori ktheu kokën nga i porsaardhuri dhe njohu operativin e Sigurimit të Shtetit që merrej pothuajse vetëm me sektorët e shkencës. Ai ishte një fizikan që kishte mbrojtur diplomën katër vjet më parë.

— A, ti qenke, Behar! — shpuri buzën në gaz profesori dhe ia zgjati dorën miqësisht.

— Tungjatjeta, profesor! — i tha ai dhe ia shtrëngoi fort dorën e hollë. Pastaj përshëndeti édhë të tjerët që ishin aty përreth.

— Si ndodhi? — pyeti operativi hapur punonjësit e laboritorit.

— Enigmë! — lu përgjigji profesori pas heshtjes së kollegëve të tij.

— Mos është paku jdesi? — vazhdoi pyetjet operativi i Sigurimit me një ton të ciltër.

— Jo... kjo nuk duhet të ndodhjet — tha befas laboranti i sektorit të akselatorit. — Kur e mbylla derën e «kasafortës», ishte me mua edhe shoku Arben. Apo jo? — pyeti

ai shokun që rrinte përkundrejt tij, një djalosh trupngjeshur që dukej si mundës.

— Ashtu është! Ishim të dy kur e mbyllëm derën e bodrumit të hinkës së akselatorit. Bile, kur dolëm në korridor, kontrolluan mirë sinjalin që ndizej e shuhej kuq si gjaku. Pastaj u ngjitëm lart për të marrë pjesë në eksperimentin me profesor Zakon.

— Po di të herët si ta shpjegojmë? — pyeti oficeri i Sigurimit me një pamje të vrenjur.

Profesor Buroni rrudhi supet.

— Ta studiojmë më me hollësi tërë këtë avarit — tha ai duke e vështruar në sy operativin, ish-studentin e tij të dikurshëm.

— Po profesor Zakoja ku është? — pyeti operativi.

— Ai vazhdon eksperimentin... — iu përgjigj vajza me trup të dobët. — Kur unë pashë sinjalin në njyrë të gjelbër, vajta me shpejtësi në kabinetin e profesor Buronit dhe e njoftova menjëherë!

— Përse nuk njoftuat profesor Zakon?

— Në derën e tij të kyçur ishte sinjali i kuq dhe, kur ata eksperimentojnë në akselator, është e ndaluar rreptësisht hyrja.

— Shoqja Alma bëri shumë mirë që më njoftoi mya dhe kjo është plotësisht e mjartueshme, — ndërhyri profesor Gurra.

— Shkojmë, profesor, tek ai..., — ia bëri me shenjë operativi, duke ngritur sytë lart shkallëve.

— Edhe unë ashtu po mendoja. — Profesori ua bëri me dorë Rrezartit dhe dy laborantëve që ta ndiqnin nga pas.

Para derës së dhomës së akselatorit profesor Gurra qëndroi një çast duke parë dritën që skuqte si shkëndijë. Afroi dorën dhe shtypi butonin e ziles.

Nuk kaluan as dy minuta dhe derave dyfishtë e dhomës së akselatorit u hap. Në prag ia behu profesor Zakoja, një burrë që i kishte kaluar të pesëdhjetat. Me vështrim të shqetësuar pyeti:

- Çfarë ka ndodhur, koleg?
- Dera e bunkerit poshtë akselatorit tuaj u gjend e hapur!
- E pamundur! — thirri papritmas profesor Zakoja dhe me sy të shqyer iu drejtua laborantëve të tij.
- Ne jemi fare të sigurt që e kemi puthisur derën! — thanë ata të dy njëri pas tjetrit duke përsëritur të njëjtat fjalë.
- Hyni, hyni brenda! — tha shefi i akselatorit, një fizikan me përvjohje që ua kishte kushtuar tërë jetën zbulimeve në fizikën bërthamore.

Rrezarti i hënës vështrim hetues akselatorit, këtij aparati të ndërlidhur me lloj-lloj fijesh llambash e tubash specialë. Ende pompat dukeshin sikur gulçonin duke shtyrë ajrin nga dhoma e vakuumit. Llambat e skuqura nga puna, panelat, detektori, aparatet regjistruuese të intensitetit të rrezatimeve që prodhonte ajo pajisje nën ndikimin e frekuencave të larta elektrike i dukeshin Rrezartit si karakollë që rrinë në gatishmëri për të vrojtuar secili tre-vën e tij të veprimit. Profesor Zakoja, që e vuri re hëtimin e fizikanit të ri, me të cilin e kishte njojur në një nga kolokiumet e fizikës bërthamore në Universitet kolegu i tij, profesor Gurra, iu afroa dhe nisi t'i shpjegonte në vija të përgjithshme esencën e eksperimentit të zhvilluar për rrezatimin e farsës së grurit G 62 dhe të patates rrezekonseruese.

— Me këtë farë të rrezatuar bujqit tanë lypset të marrin patjetër 62 kuintalë grurë për hektar. Pa dyshim, krahës farës së zgjedhur, lypset të kryejmë më saktësi shkençore të gjitha shërbimet agroteknike; punimin e tokës, plehrimin e saj racional, kullimin e vaditjen e të tjera e të tjera. Patatet e rrezatuara me këtë dozë nuk janë fare të dëmshme për jetën e njeriut, por amë këtë jetojnë sa të duash pa u prishur në depo të zakonshme. E, në bazë të këtij eksperimenti, do të projektohet impianti industrial i konservimit të patateve.

— Profesor, çfarë mendoni ju për derën e bodrumit të akselatorit që u gjet e hapur? — pyeti sy në sy operativi i Sigurimit.

— E po më fal, more shok, se e humba nga këto të shkreta eksperimente që i kam në mendje ditë e natë, — tha profesor Zakoja dhe, si e mbloodi veten, shtoi: — Do ta zbulojmë patjetër. Dhe për këtë do të përdorim gjurmuesit radioaktivë, — qeshi ai hidhur.

Operativit i pëlqeu shakaja e profesorit dhe kjo i dha shkas të mendonte për saktësinë e propozimit që ai i kishte bërë shefit të tij për të përpunuuar një metodë radioaktive për zbulime të krimeve. Bile këtë çast atij iu përforcua më shumë mendimi që të kërkonte bashkëpunimin e këtyre shkencëtarëve.

— E po mirë! — tha pas një pauze operativi dhe, pa e zgjatur më, ia shtriu dorën profesor Zakos e të tjerëve dhe, i shoqëruar nga Gurra, u largua nga laboratori. Para se të ndaheshin, ata të dy diç biseduan aty para kabinës së rojës dhe pastaj u ndanë miqësisht. Roja, që rrinte pakëz larg tyre, kur my safiri hodhi pragun e portës së madhe, e nderoi atë sipas zakonit të luftës, me grusht.

Rrezarti doli pas pak nga dhoma e kontrollit të ndotjeve radioaktive dhe zbriti shkallët e laboratorit me një ndjenjë kënaqësie sikur po largohej fitimtar nga fusha e betejës. Doli në oborrin që kundërmonte nga aroma e luleve dhe një çast mori frysë thellë duke ushtruar mushkëritë e tij të shëndosha që ia frynin gjoksin e gjerë që vinte e ngushtohej nga mesi i trupit të lidhur e të drejtë si lis. Te hyrja e dhomave të radiokimisë pa automjetin me mbishkrimin: «Transport lëndësh radioaktive.» Atë çast nga kabina e shoferit u hodh përtokë si sorkadhe e trembur një vajzë me bluzë të bardhë. Ajo, sa e pa, i thirri, duke hapur krahët:

— Uh... saldatori fizikan!

— Aha, Zana! — qeshi Rrezarti dhe shtrëngoi miqësisht dorën e saj të zgjatur.

— Çfarë ere të solli këtej? — pyeti pastaj Rrezarti.

— Do të tërheqim kobaltin radioaktiv! — iu përgjigj mjekja e re që merrej me rrezatimin e tumoreve.

Nga kabina e rojës Rrezartin e thirri një shok i tij:

— Po vjen apo të iki unë!

— Erdha! — ia pati Rezi duke zgjatur kokën mbi tru-

pin e Zanës. Pastaj ia dha dorën mjekes dhe me një qëndrim shoqëror u shkëput prej saj duke i thënë:

— Lamtumirë!

— Lamtumirë! — i tha Zana nga pas.

Rrezarti dhe laboranti fizikan, si morën kthesën në të majtë, zbritën poshtë rrugës së asfaltuar. Dielli po fshihej tej kodrave, duke përskuqur me shigjetat e kuqërremta ato re të bardha si borë që endeshin mbi ato kodra të blerta. Ecën një copë herë të zhytur në mendime. Pastaj e theu heshtjen asistenti fizikan:

— Ku e njeh ti Zanën?

— Jam njohur te një shoqja ime, — u përgjigj Rrezarti pa e parë shokun në sy.

— E di që është vajza e atij mikut tënd, profesor Kotit?

— E di.

— Por ajo është antipodi i të atit!

— Ja që ndodh edhe kështul

— Është e mirë..., — i tha laboranti fizikan dhe kësaj hëre ia lëshoi vështrimin shokut si shigjetë.

— Po të pëlqeu, vërju pas, kushedi i tërheq vëmendjen dhe ajo shtie dashuri me tullën tëndel — qeshi Rrezarti duk parë majën e kokës pa flokë të shokut të vet.

— Mos kujto se nuk i ndjek lëvizjet e saj, por kam mbetur aty dhe nuk kam mundur të zbuloj natyrën e atyre lloj lëvizjeve.

— Mos harro se baza materiale e dashurisë është, gjithashtu, sipas mendjes sime, edhe një fenomen fiziko-kimik Lëvizja e kombinuar me valencat kimike të molekulave...

— Të falemnderit për shpjegimin shkencor, — tha laboranti fizikan dhe, si përshëndeti me dorë, u kthyte pritmas drejt ca shkallëve buzë trotuarit.

— Mos m'u zemëro, ore, se bëj shaka unë, — tha Rezi që mbajti këmbët dy a tri sekonda.

— More, shiko atë thëllëzën tënde, se mos ta rrëmbejë tjetër njeril — ia pati në krye të shkallëve laboranti fizikan dhe e përshëndeti me dorë sikur ndodhej mbi kuvrtën e një anijeje e do të udhëtonte tej deteve.

Rrezarti vazhdoi rrugën. Në fillim fjalët e shokut iu dukën një shaka zbavitëse, por, kur eci edhe disa hapa, truri nisi ta përpunonte atë mendim. «Për cilën thëllëzë e ka fjalën? E ku i ditka ai «sekretet» e zemrës sime? Unë nuk kam folur ndonjëherë me atë! Mër po, njerëzit, shpeshherë të përgjojnë pa e kuptuar dhe t'i mësojnë të fshehtat e shpirtit. Mos vallë ky mendon për Sofijen? Apo i ka thënë gjë për Meritën usta Sala kur ishim në metalurgji dhe saldonim sferat prej çeliku? Nuk besoj, ndoshta ia këputi kот së koti dhe unë i bie fyellit pa nota kuturu! «Si mbaroi rruga e asfaltuar, Rrezarti nisi të fishkëllente një melodi popullore që kishte dëgjuar në një koncert para disa javësh në kryeqytet nga një trupë artistike kosovare. Era e jugut që nisi të frynte ia përkëdhelte fytyrën e flokët. I shkrepit një mendim: Të vinte e të lahej në det. E kishte fare pranë. Asgjë nuk e çlodhte më tepër se noti në ujë të ftohtë. U la çantën dhe rrobat ca fëmijëve që po zinin peshk dhe u fut në ujë.

Kur doli nga ujet, Rrezarti e ndjeu veten si pupël të lehtë, fare të çlodhur. U vesh, falënderoi fëmijët dhe u nis të shkonte në shtëpi.

KAPITULLI VIII

Kishin kaluar dy javë nga dita që profesor Koti ia dorëzoi mendimin e tij me shkrim dekanatit të fakultetit. Bëhej fjalë për argumentet shkencore për të hedhur poshtë temën e rëndomtë që kishte miratuar profesor Buron Gurra për punën e diplomës të kandidatit fizikan Rrezart Deti. Por akoma nuk po ia kthenin përsëri me punën e diplomës së saldatorit që kishte hyrë si pykë në jetën e tij dhe si pas mendimit që i ishte fiksuar, këtu luhej me fatin e karrierës së tij. Në kokë i zienin projektet për teleskopin astronomik, por nuk i shqiteshin nga mendja edhe pikëpamjet filozofike për rrugën e të konceptuarit të shkencës, konceptë që në praktikën e punës së tij po ia thërrmonte grimca-grimca ai djaloshi i fabrikës dhe do të bëhej shkas për ta goditur mu-në zemër nga ana e kundërshtarëve (dhe rivalëve të tij si profesor Gurra dhe fizikanë të tjera. Çuditej më veten e tij se sa e afërt kishte nisur t'i dukej koha kur kishte studiuar në Universitetin e Parisit dhe tërë ato leksione speciale filozofike në lidhje me të konceptuarit e shkençave të fizikës. Në njëren dorë mbante çantën dhe me dorën

tjetër, në të cilën i varej çadra, hapë derën e zyrës së mikut të tij, nëpunësit të Institutit.

— Mirëmëngjes! — belbëzoi profesor Koti me një buzëqeshje të frikshme që fshihej si gjithnjë nën syzet e trasha dhe nën strehën e kapelës së rrasur në kokë gjë te rrëza e veshëve.

Nëpunësi me receptorin e telefonit në dorë u ngrit pakëz nga kolltuku prej lëkure duke mbështetur njërin bërryl mbi trvezën me xham kristali dhe, si ia bëri me dorë mysafirit që të zinte vend në një kanape aty pranë, vazhdoi bisedën telefonike me tjetrin përtel fillit.

— Besoi se jua shpiegova qartë. Po e përsëris edhe një herë: Shefi i katedrës përfizikën nuk ka të drejtë të fusë në laboratorin e Akademisë pa shkresë zyrtare nga ne kandidatin diplomant dhe as ta inkadrojë në grupet e punës eksperimentale! Dhe, për sa i përket temës së diplomës, ajo duhet të ketë karakter mësimor teorik... Si thatë? E ka dërquar dikasteri shkresën... dhe ata janë marrë vesh me deaën shkencore të Akademisë... ka udhëzime nga lart njerëzit që këtë lloji bashkëounimi... Por, meajithatë! Kurse përfemën nuk e keni iu? Atv qëndron buna. Në qoftë se ai nuk i krven eksperimentet vetveti, bie poshtë tema e tij... dhe qëndron ajo që ka përcaktuar shkencërisht profesor Koti! . . . Mirë, mirë, bisedoleni; po përgjigjen e dua naarti... dhe ti duhet të bësh çfarë varet nga Ju që të vendoset kështu siç po të them. . . Mirupafshim!

Si uli receptorin mbi varësen e aparatit, nëpunësi ungarit në këmbë dhe ia shtrënaqoi dorën miqësisht profesor Kotit, i cili nuk lëvizti nga kolltuku.

— E dëqiova. . . e dëqiova me veshët e mi! — tha profesor Koti duke tundur në olë pëllëmbën e bardhë të dorës. — Kaq duhei. Nië sacmë ndonjëherë e rrëzon tjetrin përtokë, se varet ku qëllon! Besoj se me kaq çështja do të mbyllët!

— Edhe unë mendoi se ky mikroproblem do të asajësohet nga defteri pa lënë gjurmë, — ia bëri me dorë nëpunësi duke fshirë xhamin e tryezës.

— Modus operandi, — tha befas profesori dhe shtoi

me zë të ulët: – Atij djaloshit të fabrikës do t'i bëhet mirë! Do të heqë dorë nga andrallat e eksperimentimeve dhe do të hyjë në sferën e pedagogjisë shkencore teorike.

– Po Sofija? – pyeti nëpunësi. Fytyra e tij si e mavisur mori një shprehje të veçantë ligësie dhe, kur vuri re që profesori nuk po thoshte gjë, shtoi: – Shtrydheni, shtrydheni, profesor, atë rreze të venitur dhe merrni prej saj atë që na duhet!

Nëpunësi qeshte me njëfarë ironie që e bëri profesorin të tkurrej në kollukun e gjerë. Ai tanimë ishte ngritur në këmbë dhe ecte varavinga zyrës luksoze të shtruar me qilim. Fytyra iu mpi, vetëm sytë i lëshonin një rreze ligësie. Bluante me vete plane që do të ngrinin jo vetëm personalitetin e tij, por do t'i jepnin edhe kënaqësitë fizike. I vinte inat me veten kur shkonte ndër mend dështimin e tij si fizikan, dhe urrente tjetrin që dilte nga vajrat e fabrikës dhe hynte në dyert e shkencës. Si shpërblim për bashkëpunimin dhe punën që po bënte, ai kërkonte nga profesor Koti që t'i jepte për grua të bijën, Zanën! Mjekja e re ishte e burkur dhe do t'i jepte mundësi të hynte serbes në rrethet intelektuale dhe të zinte një pozitë administrative më të larëtë. «Sa për Sofijen, profesori të bëjë si të dojë, në dac ta fusë në kurthin e tij, në dac t'ia japë atij saldatorit fizikan, aq më bën muai!» Ai u kthye në karrigen e zyrës dhe, si vuri dorën mbi dorë ashtu sic e kishte zakon kur merrte ndonjë vendim me rëndësi, ia nguli sytë e shpëlarë Kotit dhe tha me ton solemn:

– Fati na ndiftë të dyvel!

Profesor Koti, sikur të zgjohet nga kllapia e ën-drrave, ngriti sytë nga ai dhe belbëzoj:

– Ashtu qoftë! Ime bijë, me rastin e mbarimit të docenturës mbi origjinën e tumoreve dhe shërimin e tyre me rrezatimin e izotopit të kobaltit radioaktiv, sonte shtron një banket modest. Në këtë mbrëmje ka ftuar Sofijën me të atin, kandidatin diplomat, Rezart Detin, dhe ju.

– Më ka ftuar Zana? – pyeti nëpunësi me një qëndrim hetues. – Apo është dëshira juaj, profesor?

– Zëri i prindit, zëri i të plotfuqishmit! – foli profesori me një ton kishtar.

— Nuk më mbetet gjë tjetër përveç të jap falënderimet paraprake për dorën e miqësisë që po më zgjat profesor Koti, miku im i shtrenjtë.

Profesor Koti ia hodhi vështrimin fytyrës së tij që u shndërrua atë çast nga mavi në bojë gjaku dhe i mori një shprehje egërsie. Iu duk që ai po i ndillte fatkeqësi. Atij iu drodh zemra, kur mendoi të bijën në krahët e këtij nëpunësi të pazot e të prirë për intriga dhe kurthe. Mirëpo ishte tepër vonë të kthente rrugë. Në fund të fundit akoma ishte i ri dhe zotëronte një pozitë të mirë nëpunësie me perspektivë që të ngjitej edhe më lart. Nga ana tjetër do të kishte një përkrahës për ato synimet e tij intelektualiste.

Kur profesori deshi të largohej nga zyra e tij, dikush trokiti në derë dhe pas pak e hapi pa pritur urdhrin e zyrarit.

— Ah, qenke ti? — tha nëpunësi kur pa korrierin, një babush me mustaqe që kishte zakon të futej në zyrat e tyre si në shtëpi të tij.

— Të kam sjellë rrezet e Partisë! — buzëqeshi korrieri babaxhan duke vendosur pakon në tryezën që shkëllente nga një shigjetë diellore që futej në të çarën e perdes damask.

— Kështu u thotë ky materialeve që vijnë nga Komiteti Qendror i Partisë, — u zgërdhi nëpunësi dhe ia bëri me dorë korrièrit që të largohej nga zyra, kinse kishte biseda zyrtare të rëndësishme me mysafrin.

— Po, për besë, — qeshi ai duke dredhur një anë të mustaqeve, — këto janë rreze që të ngrohin dhe rreze që të përvëlojnë! E kam fjalën për disa që lajthisin. Vdekje fashizmit! — thirri ai dhe doli nga zyra.

— Qenka nishan! Kështu e kemi edhe ne xha Sadikun që, kur hyjmë e dalim, nuk harron kurrë të nderojë me grusht, — tha profesori. — Po edhe unë po largohem. Ju presim, Misi — i foli profesori në emër nëpunësit.

Nëpunësi i shtriu dorën dhe ia shtrëngoi për të dytën herë duke e falënderuar.

Profesor Koti, kur po zbriste shkallët e Institutit, ndjeu se balli i ishte djersitur. Nxori shaminë e bardhë të mën-

dafshëtë dhe, si hoqi një çast syzet, fshiu sytë e pastaj qafën e qullur.

— Në të dalë të godinës u ndesh me profesor Ervinin.

— Oh, miku im! — thirri tërë gjësim e hare profesor Ervini duke i rënë në sup miqësisht. — Po si jeni me shëndet? Mos jeni gjë i sëmurë?

— Jo, jo . . . jam mirë, asgjë nuk kam, por ndihem i loddhur, — u përgjigj Koti pa mundur të fshihte gjendjen e tij të trondituri.

— Hajdeni ndonjëherë me mua të gjuajmë peshk! — i tha profesor Ervini që kishte një natyrë të butë. — Që kur nisë të dal shitetje të gjatë, më beso se ndihem më mirë me shëndet dhe astma ka filluar të më largohet.

— A e dërguat për botim studimin tuaj të fundit mbi etimologjinë e gjuhës shqipe? Më tha Sofija se kishit zbuluar një pergamenë të lashtë të shkruar me fjalë shqipe?!

— Oh, miku im. Më dole në shteg. Zbulimi im do të ndryshket, në qoftë se ju fizikanët bërt hamore nuk ma saktësoni shkencërisht vjetërsinë e këtij dokumenti, — tha Ervini.

Profesor Kotit i ngriu atë çast ftyra. «Ja, edhe ky albanolog, ngaqë nuk ka haber nga shkenca e fizikës. . . i ngatërron fijet midis asaj që quhet shkencë e madhe dhe metodave teknike të zbatimit të saj.»

— Ka. . . ka vërtet një metodë praktike për përcaktimin e vjetërsisë së shkëmbinjve dhe ndoshta edhe të asaj pergamenës sate! Me anën e rrezatimit radioaktiv, — qësh hidhur Koti.

— Kjo do të ishte një punë e madhe shkencore! — thirri me entuziazëm albanologu. — Ndryshe e kam të vështirë të jap për botim studimin tim të fundit që i kalon caqet e fushës gjuhësore, sepse ka të bëjë me vlerat e kulturës shqiptare.

— Ika. . . se më presin në katedër për një konsultim, — tha befas Koti dhe, duke u çliruar nga dora e tij që e kishte zënë për krahu, bëri përparrë duke hedhur këmbën nga shkalla e fundit në asfalt. — Mos harro të vish sonte në banketin e Zanës! Mirë ardhsh! — thirri ai duke ngritur kapelen, me kokën ende të kthyer nga miku i tij.

— Do të vij, do të vij patjetërl Dhe e vazhdojmë bisedën gjatë mbrëmjes.

Profesor Ervini mbeti një copë herë në vend duke vështruar të ecurit e topitur të mikut të tij që iu duk shpirterisht më i vrarë se herët e tjera. Pastaj u kthye nga hyrja e Akademisë duke tundur kokën më vete. Iu ngjit shkallëve dhe, si përshkoi korridorin, qëndroi para një dere të madhe. Zuri me kujdes dorezën e larë me flori dhe, pasi e uli poshtë, hapi derën pa pikë zhurme. Në bibliotekën e Akademisë qëndronin raftet ku kishin vendosur mijëra volume të historisë së njerëzimit tërë luftëra të përgjakshme që nga koha e gurit, e shigjetave dhe e topave zhurmëmëdhënëj dhe deri në ditët tona. Profesor Ervini u ul në vendlindin e tij pranë një historiani të zymtë që merrej prej disa vjetësh me historinë e përdorimit dhe të prodhimit të ar-mëve shqiptare. «Ja se çfarë ndodhi në këtë tokë që nuk është gjë tjetër në univers përvçese një kristal i ndritur!» E kishte fjalën përtërata libra e volume që e rrethonin, ku shkruhej historia e dhimbshme e njerëzimit. Kur nisi të shfletonte një enciklopedi gjermane që bënte fjalë përi etimologjinë e gjuhës shqipe si një nga gjuhët e vjetra kulture të Evropës, atij i shkoi edhe një herë në mend turbullimi i mikut të tij, profesorit të fizikës, Kotit, që çuditërisht nuk e kishte vënë re më përpara. Dhe, para se të qëndronte në një shkrim «Çfarë gjuhe kanë folur ilirët», atij i shkrepi një mendim. Dikur në godinën e Akademisë së Shkencave kishte jetuar i ashtuquajturi mbret i shqiptarëve, Zogoli, mbeturina e fundit e feudalizmit mesjetar.

Nga dera prej xhami e sallonit, profesor Koti, i zhytur në kolitkun e butë me shilte puplash, herë pas here hidhëte vështrimin miop nga veranda. Rreth tryezës së shtruar e bija, që i kishte kthyer shpinën Misit, diç i thoshte në vesh Sofijes. Ajo dëgjonte dhe fshihte me dorë buzëqeshjen ironike që i endej në fytyrën e zbehtë ovale. Prisnin të vinte edhe saldatori fizikan që profesor Kotit i dukej si

tenjë, ngaqë po ia brente shpirtin e tij, të trazuar. Përpara, në tryezë, shfletonte një libër të trashë në gjuhën frëngje, një përbledhje. Kjo me pjesë nga filozofët idealistë: Kant, Dekarti, Spenser, Niçja dhe deri te Sarti. Filozofia idealiste, të cilën profesor Koti e lexonte shpesh, e bënte atë që çdo ditë e më tepër të fundosej në humnerën e mjegulluar, dhe jorrallë e fuste në botën e errët të dëshpërimit, dyshimit, e frikës për çdo gjë të jetës së gjallë e për çdo fenomen objektiv të natyrës. Ai i studionte pikëpamjet filozofike të tyre me një bindje të verbër. Pas çdo studimi që bënte rreth kapitujve të veçantë të fizikës klasike dhe asaj relativiste të Ajnshtajnit, pëshpëristë çaste të tëra: «Nihil... nihil...». Nuk e thoshte kuptimin e fjalës shqipe «asgjë... asgjë...», se nuk i tingëllonte madhërishëm si gjuha latine apo ajo greke e vjetër. I pëlgente të belbëozntë me vete përkufizimin e Niçes. Ai vinte buzën në gaz me pikëllim në zemër kur detyrohej të shkruante formulat fizike të lidhjeve të masës me shpejtësinë e kohës dhe ua këpuste shprehjeve tallëse veçanërisht për të ashtuquajturat realizime shkencore, në praktikat e prodhimit që referohen në diskutohen në përshtatje sesionet shkencore në Akademi, në institute kërkimore e akoma më qesharake i dukeshin ato që bëhen në qendrat e prodhimit, Koti zgërdhihej kur merrte ndonjëherë në dorë ndonjë punim shkencor, bille edhe krijime letrare të autorëve bashkatdhetarë. Sapo lexonte faqen e parë apo të fundit të një referati apo kumtese, e kapte materialin me majat e gishtërinjve të gjatë, me thonj të kruar dhe e flakte përtëj me një ndjenjë përbuzjeje. Kohët e fundit e revoltonin kthesat e mëdha që kishin ndodhur në katedrat e Universitetit, në institutet kërkimore, dhe në qendrat e prodhimit në renditjen e punimeve shkencore-teknike në dobi të prodhimit dhe të përbysjeve të teknologjive të prapambetura në teknologji të përparuar e moderne. Ai nuk e quante si punë shkencore studimin dhe ngritjen e linjave të reja të prodhimit me teknologji të përparuar që bënë punëtorët, inxhinierët e specialistët e ndërmarrjeve ekonomike industriale. Po kështu mohonte si punë shkencore arritjet e rendimenteve të larta të grurit, misrit apo panxhar sheqerit nga brigatë.

dat e agronomët e kooperativave bujqësore e të fermave shtetërore. Edhe, ndërtimin e projektimit në kushtet e vëçanta të terrenit të hidrocentralit gjigant mbi lumin Drin ai e kategorizonte si një punë thjesht teknike. Kursé sipas koncepteve të tija, grumbullimi i të dhënave teknike të reliefit tokave, quhen punë shkencore. Madje edhe zbatimet e burimeve radioaktive në fushat e ndryshme të teknikës e të tjera. Kati i përjashtonte si punë kërkimore shkencore. Për tezat teorike filozofike që referoheshin e diskutoheshin nëpër auditorët e Universitetit, apo në sesionet shkencore të prodhimit se revolucionin tekniko-shkencor e bëjnë masat dhe jo disa njerëz të mësuar si dhë mjaft nocione të tjera dialektike materialiste, kishte neveri dhë i vinte plasja ngâ inati, ngaqë e ndiente veten të vetmuar dhe të humbur në vorbullën e filozofisë idealiste e të koncepteve të huaja për zhvillimin e shkencës në vend. Atë, Rrezart Detin, fizikanin e ri me atë trup të ngjeshur, të fortë e të shëndetshëm, që ishte ngritur nga balta e fabrikës me ato mendime të guximishme, me atë besim të patundur në eksperimentet që kryente për aplikimet e metodave bërrhamore në teknikë, e urrente me gjithë forcën e shpirtit. Përsë e kishte ftuar atë e bijd sonë? Ja, ai u fùt në verdindë dhe po ia shtrëngonte dorën Sofijes dhe pastaj nëpunësit të Institutit, Misi Vangjos, që ishte çuar në këmbë të priste mysafirin e vonuar, të ftuar për darkë. U ngrit dhe profesori:

— Mirë se erdhët, koleg! — qeshi i zoti i shtëpisë dhe i zgjati dorën ta përshëndeste.

— Tungjatjeta, profesor! Më falni, së u vonova ca, në pamundësi të trëgohem korrekt në takime ashtu siç e kam pér natyrë, — dhe me një pamje të papercaktuar për profesorin, tërroqi dorën prej tij.

— Uluni këtu! — i afroi karrigen Sofija pranë vetes me një qëndrim miqësor, sikur i kishte harruar ato sjelljet e pahiqishme e të ftohta të tijat në takimet e tyre të fundit në katedër.

— Isha në dekanat dhe aty u zgjata me një diskutim të papëlqyeshëm, të pakuptim..., — tha Rrezarti kur po

Irregullohej në vendin e tij duke vështruar saksinë e madhe të begonjës që i varesin lulet ngjyra-nga ngjyra.

I zoti i shtëpisë, nën syzet me xham konkav, e vështroi me bisht të syrit Sofijen, dhe nga qëndrimi i saj e mori me mend se një ndjenjë e hidhur ia mundonte shpirtin. Në tòrin e fjalëve të atij djaloshi të padruajtur ndiheshin qartë notat e një zemërimi të brendshëm dhe ai sillej i shpenguari pa ruajtur jetketën. Për të kapërcyer gjendjen e nderë që u vendos midis tyre, u ngrit në këmbë dhe, si mori gotën e verës në dorë, tha:

— Le ta ngrimë këtë dolli pér shëndetin e miqve që nënderuan në këtë gasti modeste me rastin e laurimit docente të bijës sime, të dashur, Zanës! — Si u hodhi një buzëqeshje të pranishmëve, duke e ndalur vështrimin te sytë e së bijës që ndrisnin nga gjëzimi, ktheu gotën e verës dhe e piu me fund.

Shëndet, Zana! — ia pat Rrezarti dhe e rrëkelleu edherai gotën e verës në shembullin e të zotit të shtëpisë.

— Sukses dhe fat! — belbëzoi Misi duke u mënjanuar pakëz nga Zana me njëfarë intimiteti të shtirë. — Dhe, si kapërdiu dy a tri gllënjkë verë, e hoqi gotën nga buzët dhe e vendosi aty midis pjatave të mëzeve.

— Zana! — thirri Sofija sikur të zgjohet nga gjumi. — Megjithëse unë nuk jam alkooliste, por sone do të pi, bile edhe do të dehem nga gjëzimi i shqes sime, që hyri në rrugën e shkencës së madhe. — Dhe, si i hodhi, një vështrim pjerrtazi të papercaktuar Rrezartit, e plu gotën e verës me fund. — Shumë e mirë qenkal! — tha duke shpërthyer një buzëqeshje mirësie dhe me një sjellje fare të lirë që u bëri përshtypje të gjithëve, kapi me gishtërinjtë e hollë, një thelë peshku të ngronjtë dhe e futi në gojë. — Shumë peshk i shijshëm..., — tha ajo duke lëpirë buzët e holla.

Rrezarti ngriti përsëri gotën e verës dhe çukiti tring... tring... me të zotin e shtëpisë, me Zanën dhe Sofijen.

— Kurse me ty nuk e përplas! — i tha me thumb Misit.

— Ju duheni dënuar, se nuk pranuat dollin e dollibashit që ta pinit me fund gotën e verës.

— Pije! — ia pat papritmas Zana sikur po e qortonte.

— Nuk mundem... nuk mundem, për nder nuk mundem! Vuaj nga ulçera kronike, — u ngërdhesh Misi Vangoja duke vënë dorën mbi gotën e verës.

— Mos u bëj merak, se nuk ta japid ta pish me zor! — qeshi Rrezi dhe, duke vështruar në sy Zanën, shtoi me një ton therës: — Zana, rrezatoja këtij mikut tënd ulçerën që herën tjetër të pijë verë!

— Kurrë..., — u hodh e tha Misi i trembur sikur me të vërtetë do të rrezatohej atë çast. — Bile, — shtoi ai, — jua kam frikë dhe juve se mos më infektoni me rrezet që keni marrë!

Zana, duke përfituar nga batuta e tij e pagoditur, la gotën e verës që kishte në dorë në tryezë dhe ia lëshoi përgjigjen si shigjetë:

— Po atëherë çfarë kërkoni këtu kur keni frikë nga rrezet?

Misi qeshi me zor si guak. Nuk diti nga t'la mbante. Nuk tha dot asnjë fjalë, përvèç ca belbëzime që nuk kuptoheshin fare.

Një copë herë ata hëngrën mezet e peshkut që u shijonin kaq shumë dhe pinin herë pas herë verë. Zana mbushi gotën e zbrazët të Rrezartit. Aty-këtu këmbenin ndonjë vështrim apo ndonjë fjalë të shkëputur duke lavdëruar gjellët dhe verën.

— Për shëndetin tënd! — tha Sofija me zë të ulët e mënjanuar pak nga Rrezarti, duke vështruar qafën e tij të gjatë dhe buzët e lagura me verë. Pastaj vazhdoi duke e ngritur zërin: — Për suksesin në diplomimin e fizikanit të talentuar...

Rrezarti, si e lëshoi gotën nga dora në pjatën e porcelanit, vrenjti pakëz vetullat dhe tha me një notë zemërimi të përbajtur:

— Tema e diplomës më është refuzuar. Ajo që dua unë. Laboratori m'i mylli dyert, eksperimentet mbetën në gjysmë të rrugës. Temat e tjera s'më interesojnë. Nesër do të kthehem përsëri në fabrikë dhe do të kap pincëtën e dashur të saldatorit.

Shprehjen e fundit e tha me një notë entuziaste që nuk linte asnjë dyshim se atij nuk i vinte keq që do të

kthéhej, përsëri pranë shokëve të fabrikës dhe do të niste punën e saldatorit që ai e donte me shpirt.

Pas këtyre fjalëve Sofija dukej si e kallkanosur në karrigen me shpinë të lartë të gdhendur me ca motive orientale. Profesor Koti e vështri me bisht të syrit asisten-ten e re që iu shndërrua ngjyra e fytyrës. Atij i shkuat atë çast sytë te thelat e limonit anës pjatës dhe iu duk se edhe fytyra e Sofijes ishte e verdhë si ato. Nëpunësi Misi Vangjo me buzët e rrudhura i binte me gishtërinj cipit të tryezës dhe mbahej më të madh duke ia hedhur ndonjëherë tinazi vështrimin profesorit, sikur i thoshte: «Ja, e shikon si ta mbarova punën! Haptashti më jep shpërbli-mlin!» Zana e mori me mend se aty po i hiqej fitili bombës dhe nga çasti në çast do të ndodhë shpërthimi. Ajo i lidhi dhe i zbërtheu vetëtimthi gjithë tato biseda të shkëputura që kishte dëgjuar nga Sofija dhe më pak nga i ati. Si e mbloodi veten dhe e vendosur se si duhej të sillej, iu drejtua Rrezartit me një buzëqeshje të çiltër.

— Më mbushni edhe mua një gotë rakin!

— Zanal — thirri i habitur i ati. — Ti do të pish rakin? — Zana nuk ia vuri veshin pyetjes së tij, ngriti gotën në ajër dhe thirri:

— Po. Edhe një herë lehta pimë dhe të ngremë dollin përklasën tonë punëtore që i jep tonin tërë jetës sonë! Ta pimë përshtëndetin dhë suksesin në shkencë të saldatorit Rrezart Dëtil. Në pushtetin tonë, me këtë Parti që kemi në ballë, s'ka forcë që ta lërë punëtorin me vullnet në mes të rrugës.

— Përsëri plakosi një heshtje e zymtë.

— Do të rregullohët kjo punël — belbëzoi nëpunësi Misil Vangjó sikur fliste me vete. — Do ta rregullojmë... Si ndodh ndonjëherë. Po-ti, shoku saldator, mos u mërzit. Do të rregullohet!

Rrezarti nuk ia vari fare. Ai mori me lugë majonezë nga pjatanca në mesin e tryezës dhe e shodhi në pjatën e tij.

— Rrezart! — i thirri befas në emrë e me një ton intimiteti profesori si të ishte djalë i shtëpisë. — Mua, edhe pse më vjen keq që s'të interesojnë temat që të kam pro-

pozuar, nuk më mbushet mendja se ti do të thyhesh. Me vullnetin e talentin që ke do të ngjitesh majës së thepisur të shkencës. Dhe mos dysho, unë nuk të lë në gjysmë të rrugës...

— E di, profesor! — qeshi hidhur Rrezarti dhe përsëri kapi gotën e rakisë e piu vjetëm një gllënjkë.

— Megjithëse, po të më kishit dëgjuar mua, dekanati do t'ju aprovonte dhe ju do të paraqiteshit në auditor me dinjitet shkencore. Unë...

— Baba!... — thirrile habitur Zana. — Keni bërë gosti të festoni suksesin e vajzës suaj, apo të zhvilloni bisedime shkencore? Hajde, miq tëpëngremë dolli, të dëgjojmë muzikë e të hedhim një valle! — dhe ndërkaq shtypi butonin e një magnetofoni. Tingujt e një muzike të lehtë u përhapën në verandë, në xhamat e së cilës pikat e shiut kishin nisur të shpeshoheshin duke çukitur si gushëkuqi në lëkurëni e lisit.

— Për shëndetin tënd, Rrezart; — tha Zana dhe ngriti gotën e rakisë në drejtimin e tij, duke e vështruar ngultas në sy.

Rrezarti ia ktheu përshëndetjen me ngritjen e një dollie dhe me një ndjenjë çiltërsie hapi krahët dhe pas pak e zuri vajzën nga mesi e nisi të danconte një tango. Si erdhën rrotull tryezës, nja dy a tri herë, ai rrahu lehtë shuplakat dhe u kthye në vendin e tija. Me mirësjellje iu drejtua profesorit që rrinte me një pamjentë pezmatuar dhe i tha:

— Me gjithë dëshirë, profesor, do ta dëgjoja këshillën tuaj sikur të mos i njihja nevojat e prodhimit. Shokët e më punës, profesor, dhe shokët e tyre në qendrat e tjera presin nga shkenca t'i ndihmojë, që të prodhojnë më shumë, më lirë, më mirë dhe mundësish, të lodhen më pak e të kenë kohë, të merren me studime.

— Kjo u kthye në një mbrëmje pune! — tha Zana përsëri e pakënaqrur. — Baba, ju më premtuat se do të bën fiti dhe jo... Këto gjëra mund t'i shqyrtoni në katedër.

Profesor Koti qëndroi një hop dhe ktheu kokën nga e bija me një shikim hetues.

— Nuk ka gjë, le ta zhvillojmë këtë debat! — buzë-qeshi Rezi, duke iu drejtuar Zanës që e kishte pranë atë

çast... — Gjatë ngrënies dhe dollive le të shkëmbejmë edhe mendime.

— Jo, pra, jo! Sonte do të pimë, do të vallëzojmë, do të këndojmë. Nesër...

— Profesor! Zana ka të drejtë! — ia pat nëpunësi Misi Vangjo, kur po zinin vendet rrëth tryezës. Ishte ndoshta hera e parë në këtë mbrëmje që ai po mbante anën e Zanës.

Profesori e shikoi me një pamje të habitur dhe me mendjen e tij përpiquej të kapte synimet e këtij nëpunësi me dy ftyra. Por nuk pati kohë të merrej me analizën e tij nga ndërhyrja që bëri Rrezartit.

— Nesër secili do të shkojë në punë të vet. Shkencëtarët në kabinete; punëtorët në kantiere.

Profesor Koti uli shtë përtokë dhe i ngjashëm që mbajti u kuptua se shigjetë qëllonte imbi të.

Ishte kjo arsyja gjatë gjithë asaj mbrëmjeje që ai, duke folur për studimet shkencore dhe zbatimet teknike që kryheshin nga katedrat e Universitetit, institucionet kërkimore dhe grupet e punës shkencore, shpesh binte në kundërshtim me vetyeten për shkak se lidhjet mendime të turbullta. Por hasi në kundërshtime të hapura nga saldotari fizikan dhe herë pas here edhe nga e bija që mbante kryekëpüt anën e Rrezartit. Kurse asistente Sofija me heshtjen e saj të plotë dukej që mbante anën e profesor Kotit. Ajo e donte Rrezin shkencëtar, shkencëtar të dëgjuar... Nëpunësi Misi Vangjo me ato buzëqeshjet në mëdyshje dhe ironike shtirej si asnjanës dhe sikur i shmarginj atij debati. Gjatë tërës kohës ai qëronte mollë dherë si e priste thelathtela të holla, i përtptyte me vështirësi dhe më një zhurmë të mbytur. Zana e vështronte me bisht të syrit. Ajo e mori me mend se ai duhej t'i kishte dhëmbët e parë të vënë. Tani po e kuptonte akoma më qartë qëllimin e të atit që jo vetëm shqërohej shpesh me këtë Misin, por kishtë filluar ta sillte edhe për vizita në shtëpi. Si u bë Zana! Gdo gjeشت, çdo pjesë e ftyrës së tij dhe çdo fjalë që thoshte ai, e bënин neryoze dhe i krijonin një ndjenjë neverie, që sa vinte e rritej në shpirtin e saj. Nga ana tjetër nisi të mendonte keq edhe për të atin që kishte lidhur mijësi me atë

njeri dhe jo vetëm kaq, por i ofronte edhe të bijën për grua. Po, po, me siguri këtu e ka qëllimin. Ndryshe përsë do ta afronte kaq shumë, përsë do ta ftonte? Por më shumë e nervozonin Zanën pikëpamjet e gabuara të të atit për shkencën dhe prodhimin. Koti e ndante me thikë punën shkencore nga puna teknike. Punëtorët, specialistët dhe inxhinierët e prodhimit, thoshten ai, kryejnë një punë mekanike, kurse shkencëtarët e ndihmësit e tyre bëjnë argumentimin e kësaj praktike të prodhimit, bëjnë pra një punë krijuese shkençore duke formular ligjësimet teorike. Nga ky koncept nisej ai edhe në përcaktimin e temës së diplomës së Rrezart Detit. Sipas kuptimeve që u jepet ai fjalëve, nënkuptohej se ky saldator që vinte nga balta e pluhuri i fabrikës duhet të shkëputet nga ambienti dhe njerëzit e fabrikës si dhei nga botëkuptimi i rëndomtë për shkençën. Ndryshe aludonte Koti, Rrezarti nuk mund të radhitej në plejadën e njerëzve të shkençës që natyra i ka pajisur me dhunitë të veçanta të trurit të tyre, specialist. Koti mbronte tezën se shkencëtarët e vërtetë duhet t'i kushtohen në tërë veprimtarinë e tyre, me anën e abstraksioneve, krijimit të ligjësive teorike që drejtojnë tërë veprimtarinë e prodhimit në sferat e tij të ndryshme. Bile ai e ftonte Rrezartin që të mos ia vinte veshin profesor Gurrës dhe kolegëve që e personin, të cilët po e fusnin talentin e tij të veçantë në një udhë të gabuar.

Sa më shumë fliste profesor Koti, aq më shumë Zanës po i bëhej e qartë se në çfarë ujërash të turbullta notonte iati, i cili, ashtu si i myturi pa shpresë, përpiqet të tërheqë edhe të tjerë në vorbullën e tij. Asaj i dukej e çuditshme se si ky profesor, asistente Sofija edhe ndonjë tjetër koleg i tyre, nuk i paskëshin përvetësuar fare argumentimet shkençore që jepeshin nga Partia dhe që ishin zbërthyer me detaje nga botimet e sesionit shkençor universitar e akademik në lidhje me botëkuptimin dialektik marksist dhe rrugët që duhet të ndiqte revolucionari tekniko-shkençor si pjesë integrale e revolucionit të përgjithshëm socialist. Asaj po i pëlqenin gjithmonë e më shumë mendimet e Rrezartit. Ai, jo vetëm që kishte studiuar shumë materiale ideologjike dhe filozofike të Partisë dhe të klasikëve të mar-

ksizëm-lininizmit, por në përgatitjen e filozofisë që do të jepte si provim gjatë mbrojtjes së diplomës kishte nxjerrë edhe mjaft shembuj nga jeta e tij dhe e shokëve të tjerë punëtorë e teknikë në praktikën e prodhimit për t'i ilustruar ato me argumente bindëse e konkrete. Asaj tani po i pëlgente debati dhe u pendua që kishte mbajtur atë qëndrim. «Sa bukur flet», — tha me vete. Në atë çast Rrezarti po i thoshtë profesorit: — Duhet të kapemi fort edhe në thelb te tezat parimore ideologjike e filozofike të marksizëm-lininizmit që i zbërthen në kushtet konkrete të vendit Partiajonë. Stadi aktual i zhvillimit të vendit tonë dhe detyrat e mëdha ekonomiko-shoqërore që kemi përpara, kërkojnë që tehun e studimeve dhe të kërkimeve shkencore ta drejtojmë për zgjidhjen e problemeve aktuale e perspektive të ndërtimit të socializmit dhe të mbrojtjes së vendit. Në çdo hap të punës sonë lypset të na paraprijë mendimi shkencor.

Zana, duke miratuar me kokë, mbështete pikëpamjet e tij të qarta. Profesor Koti dukej si i humbur me atë dorën që e mbante te nofulla që i fërgëllonte. Sofija i hidhte një vështrim ëndërrues Rrezarit. Ajo harroi se çfarë kishte thënë profesori, habitej me thellësinë e mendimeve të studentit. Bile nisi të bluante në mendje se nuk do të ishte keq sikur të hidhej nga katedra në punët eksperimentale që kryente Rrezarti. Mbështetje do t'i afrohej...

Rrezarti buzëqeshi kur vuri re se profesor Koti bënte gjeste të papërcaktuara. Ai me një pamje të drobitur heshtë. Atëherë Rrezarti e pa me vend se duhej të jepte ndonjë shembull për ta plotësuar edhe më qartë mendimin e tij.

— E si mund të pranohet... Të grumbullosh të dhëna e të shkruash për një yll të largët, quhet punë shkencore. Kurse rritja e rendimentit të grurit në zonat malore e kodrinore nga 30 kuintalë për hektar në 60 kuintalë për hektar, u konsideroka teknikë! Të përshkruash lulet e nivx krahine, ose të hartosh hartën gjeologjike të një zone është punë shkencore; ndërsa të bësh shpimin e një pusi rië gjashë mijë metra e të rritësh efikasitetin trefish të shfrytëzimit të naftës përsëri quhet teknikë! Të shkruash ca të dhëna meteorologjike e të bësh matje topografike, është shke-

ncë e të ndërtosh disa hidrocentrale e diga gjigante mbi Jumin Drin apo mbi lumenjtë e tjerë të vendit, duke zgjdhur një mijë e një probleme të ndërikuara, na qenka teknikë! Këto koncepte idealiste për ndarjen e shkencës me thikë nga teknika në fund të fundit kanë synimin politik e ideologjik të ndarjes midis klasës punëtore nga inteligjencia me «tru special». Kjo është ideologji e rendit të shoqërisë me klasa, e rendit të shfrytëzimit të njeriut prej njeriut...

— E po me kaq, — ndërhyri nëpunësi Misi Vangjo sikur të zgjohet nga gjumi, — i dhatë fund debatit.

— Jo, o «mik», — ia priti Rrezarti duke e vështruar pjerrtazi me një gjest të papërmbaritur thumbues. — Debatit apo ka nisur! Po, në qoftë se ju jeni lodhur duke bërë shkencë dhe tanë doni të dëfreni, unë jam gati të kërcejmë me Zanën vallen që do të zgjedhë ajo, — ia preu Rrezarti.

— Mirë, mirë, kërcejmë, — tha Zana. — Debatin do ta vazhdojmë, kur të vijë profesor Ervini...

— Paska qenë ftuar në gosti edhe babai..., — belbëzoi Sofija me një zë të shuar. — Po ai ka shkuar në Krujë. Shoqëron atë linguistin austriak.

— Epo prandaj e ka të justifikuar edhe vonesën, moj bijë, — tha Koti. — Po të ishte ndryshe, do të zemëroheshim.

Ndërkaq Zana dhe Rrezarti po vallëzonin. Misi ftoi në valle Sofijen, por ajo iu lut ta falte se nuk po e ndiente vëten mirë. Atëherë ai u ul dhe filloi të qëronte një mollë.

— Rrezart, mos e lër diplomën pa mbrojtur në asnjë mënyrë. Ngul këmbë dhe ke për të fituar...

— Rrezarti i buzëqeshi me mirënjojhe. Rrezart, kërce edhe një herë me Sofijen. Ajo u gëzua shumë kur mori vesh se të kisha ftuar. Ajo ka respekt të madh për ty, edhe sepse ti nganjëherë, fare padashur, e fyen...

Rrezarti prapë buzëqeshi dhe s'foli.

«Sa djalë i matur, — tha me vete Zana. — Nuk e nxjerr që nuk e nxjerr fjalën nga goja.» Ndërkaq iu desh të ndërpriste jo vetëm mendimet, por edhe vallëzimin. Kishte ardhur profesor Ervini. Ai, si gjithnjë, i hareshëm, duke bërë përpjekje të mposhtte vitet e pleqërisë që sa vinin

dhe i rëndonin mbi supe, hyri në verandë, duke folur me zë të lartë.

— Mos e prishni hiç qetësinë! Kështu e kanë këto punë. Mjafton që edhe për mua ka mbetur ndonjë gjë. Ja, tortë paska ca, — tha ai duke parë nga tryesa. — Dhe një gotë verë paska mbetur! — dhe qeshi.

— More, verë kam edhe dy shishe të pahapura — tha miqësisht i zoti i shtëpisë që bëri vend aty ngjitur, pranë së bijës.

Më vjen keq, profesor Ervin, por unë duhet të largohem, pasi jemi këtu prej tri orësh, — qeshi Rrezarti patakeq.

— Mor djalë, po unë ty të desha më shumë. Kam nevojë për ty. — Futi dorën në çantën e ngarkuar dhe nxori, pergamenën e vjetër të mbështjellë me një letër të trashë me lustër të zezë nga ato që përdoren për filmat. — Ja, kjo është pergamina me shkrim të vjetër ilir. Kjo do të jetë bombë atomike, — qeshi ai me gjithë zemër duke tundur zarfin në ajër. — Dua, profesor, të përcaktioni me metoda shkencore vjetërsinë e saktë të kësaj pergamene, — tha ai duke ju drejtuar Kotit. — Më tha profesor Gurrë se në këtë punë, përvèç Rrezart Detit, asnjë tjetër s'mund të më ndihmojë.. Më tha kështu, moj bijë, apo jo?

Sofija pohoi me kokë.

— I falem nderit profesor Gurrës dhe juvë gjithashtu, — tha Rrezarti dhe vuri buzën në gaz me një pamje therëse. — Po unë nuk merrem me shkencël!

— Si? — ia ktheu Ervini. — Ju, po të kryeni këtë proces, keni bërë një punë të madhe shkencore që është shumë e dobishme për shkencën e gjuhësisë, bile kjo i kalon edhe caqet e gjuhësisë...

— Mirë atëherë, profesor, e marr përsipër, por me kusht që ky nëpunësi i Institutit të japë urdhër që të më kthejnë përsëri në Laboratorin Bërthamor DZ 6 me grupet eksperimentale të rrezatimeve.

— Kjo nuk varet nga unë! — tha Misi Vangjoja. — Ç'keni me mua?

— Nuk po marr vesh gjë! — belbëzoi Ervini.

— Do të zgjidhet edhe problemi i pergamenës suaj,

— buzëqeshi Rezi që ishte ngritur në këmbë për t'u larguar.

— Do t'i drejtohem degës shkencore të Akademisë — tha Ervini ndërsa fuste zarfin me pergamenën në një dosje.

— Ju falem nderit për gostinë dhe për gjithçka! Natën e mirë! — I dha dorën Zanës dhe të zotit të shtëpisë. Të tjerët i përshëndeti me kokë.

— Natën e mirë! — belbëzoi ftohtë Sofija pa lëvizur nga vendi. Pse po largohesh kaq shpejt Rrezart?

— Natën..., — tha me zë të ulët Misi Vangjoja duke e vështruar si me dyshim.

Zana, shoqëroje mysafirin! — thirri profesor Koti.

— Dëgjo, djalosh! Unë do të vij në laborator dhe do të kërkoj që ta bëni personalisht ju këtë punë shkencore!

— Profesor Ervini ishte kthyer nga dera dhe kishte ngritur të dyja duart nga Rezi sikur të lutej.

— Në laborator nuk më gjeni!

— Pse?

— Për psenë pyesni Misi Vangjon. Por më gjeni në fabrikë. Ejani, profesor, dhe do t'ju jem mirënjoës po të më jepni mundësinë të merrem përsëri me eksperimente. Natën e mirë edhe një herë.

— Natën e mirë!

Rrezart Deti doli i shoqëruar në oborr nga Zana. Ajo tani heshtte e kredhur në mendime. Kur hapi portën, i tha:

— Natën e mirë, Rrezart, dhe mos u fyeni!

— Ju e patë mirë se këtu sone nuk ishte gostil Më vjen keq, por ky është realiteti.

— Ke të drejtë!

— Mirupafshim!

Zana mbylli derën dhe me ngathtësi u kthye në verandë. Ajo tha me vete: «Im atë është zhytur thelli, në batak, nuk e kisha vënë re.»

KAPITULLI IX

Aty nga fillimi i javës së tretë të shtatorit profesor Gurra kishte dalë jashtë shtetit. Në Athinë organizohej një konferencë ndërkontinentare me pjesëmarrjen e shkencëtarëve të vendeve të Mesdheut për problemen e ndotjeve reaktive të ujërave të këtij pellgu dhe për masat mbrojtëse që duheshin marrëndaj këtyre ndotjeve. Ai shoqërohej nga asistenti i tij Petrit Shkëmbi dhe nga docenti, ihtiologu Nila, i cili pas konferencës së Athinës do të nisej në një vend arab për të demonstruar studimin e tij mbi gjuetinë e saredeles brigjeve të Mesdheut. Duke perfituar nga mungesa e profesor Gurrës në katedër, dhe nga rutina e punëve të ndryshme që i kishte rrëmbyer fizikanët e tjera, aty i ecte fjala tanë për tanë më tepër se kujtdo profesor Kotit. Sekretarja e dekanit mekanikisht kishte sjellë në katedër mendimin e nepunësit të Institutit, Misi Vangjos, se eksperimentet për punën e diplomës së kandidatit diplomant fizikan, Rrezart Detit, ishin një kohë e humbur për Laboratorin Bërthamor DZ 6, pasi tema e tij duhej të kishte karakter teorik shkencor dhe për këtë mund të vendoste v-

tëm profesor Koti. Efektivisht edhe grupi i eksperimenteve dhe zbatimeve të metodave radioaktive në degën e industrisë të material-ndërtimëve nuk mund të vazhdonte punën nga mungesa e dy shokëve kryesorë, e profesor Gurrës dhe asistent Petrit Shkëmbit. Në këto kushte Rrezart Deti u kthye në fabrikën ku vazhdoi punën si saldator i kategorisë së gjashtë. Para oficinës, në një shesh rrethuar me lloj-lloj makinerish e pjesësh ndërrimi të sjella për rigjenerim, në një qoshe të sheshit nga ana e magazinës ai po mbushet me saldim dhëmbët e konsumuar të një korone prej gize. Me maskën e xhamit të kobaltit në fytyrë, i kërrusur mbi objektin, ishte i përqendruar në punën e tij me tërë energjitet. Edhe mbushja e dhëmbëve kërkonte saktësi, pavarësisht se aty do të punonin edhe axhustatorët.

Usta Sala, me xhaketën hedhur në sup, erdhi atë ditë në punë me një orë vonesë. Atë e kishin thirrur në Bashkimet Profesionale të qytetit për të këmbyer ca mendime rreth një shtojce që mendohej t'u bëhej masave mbrojtëse të saldatorëve.

— Hë, pëllumbi im, u ktheve në bazë?

Rrezarti hoqi maskën nga fytyra dhe ashtu siç ishte, i kërrusur mbi koronën, ngriti sytë nga ai dhe i buzëqeshi. Pastaj iu përgjigj:

— U ktheva midis shokëve të vjetër!

— Të kisha thënë unë se zanati byzylyk floriri! — qeshi ustai dhe e zuri për veshi me përkëdheli.

— Hej, më këpüte veshin! Pse kështu pritet shoku? — u ngrys pakëz Rrezarti i shtirë si i zémëruar.

— Hëm... hëm... po tashti që na u mbush neve mendja se «Rrezja e padukshme» i ditka të fshehtat e kësaj shkence që e çon prodhimin përpëra, që di të ndërtojë aparatet si gamadefektoskopin, nuk të lëmë ne të heqësh dorë! Dëgjove! E atij burokrati e teknokrati, i thuaj si të duash, që pengon shokun tonë të merret me shkencë kur ai është i zoti, atë e sharrojmë ne, bile e saldojmë që t'i zihet fryma që ç'ke me të! Ja, shikoje këtë gazeten «Metalurgu». — la shpalosi para syve dhe i tregoi me gisht fotografinë e brigadës novatore që kishte ndërtuar defektoskopin. Midis tyre ishte dhe ai, Rrezi.

— Mirë, mirë! — vuri buzën në gaz Rrezarti dhe nisi përsëri saldimin.

— Do të mbrosh medoemos diplomën me ato temat shkencore në dobi të prodhimit! — i tha në vesh usta Sala.

Rrezarti u kthye nga ai dhe e pyeti duke nxjerrë fjalët nën maskën mbrojtëse.

— E kush ta tha ty?

— Unë them! — ia pati usta Sala duke i rënë gjoksit me grusht.

— A e kupton ti si qëndron puna? Ma kanë ndërruar temën e diplomës! — shpuri hidhur buzën në gaz Rezi.

Tek ata u afrua edhe inxhinieri teknolog i fabrikës, Artani. Sala iu drejtua atij dhe, pa e lënë të përshëndetetë me Rrezin, shpejtoi t'i thoshte për atë që kishte ndodhur.

— E di e dil — tundi kokën inxhinier Artani. — Me punën e «Rrezes së padukshme» po merret vetë sekretari i partisë i byrosë të kombinatit. Do t'i dalë diku tymi kësaj punë... Lëre mos ia ngacmo nervat tjetrit, — i tha ai usta Salës duke e zënë nga krahu.

— Tungjatjetë! — ia ktheu Rrezarti inxhinierit dhe, si hoqi me njérën dorë maskën e saldimit, ia zgjati dorën tjetër shokut.

— Sala nuk do ta lirojë «çirakun», por ti, Rrezart, nuk do të heqësh dorë nga puna shkencore dhe eksperimentet.

— E kush të tha ty se nuk e lë të largohet? — pyeti i habitur usta Sala. — Unë kam një copë herë që po e qortoj, kurse zotrote...

— Zanati byzlyk floriri, këtë di të thuash ti. Pse, puna shkencore nuk është byzlyk floriri?

— Ka ndërruar mendje edhe Sala, — qeshi Rrezarti për t'i dalë në mbrojtje ustait të vjetër që i kishte mësuar dikur zanatin e saldatorit.

— E po mirë, — ia priti inxhinieri.

Ai ngriti dorën në shenjë përshëndetjeje dhe u largua nga sheshi i saldimeve.

Rrezarti vuri maskën në fytyrë dhe nisi prapë të sal-donte koronën. Pranë tij ia filloi punës edhe usta Sala ashtu si herët e tjera.

Në pushimin e vogël të paradites saldatorët u ulën në një lëndinë midis hekurishteve dhe hengrën mëngjesin që kishin sjellë me vete. Si ngahera shkëmbenin biseda të ndryshme dhë pa lidhje njëra me tjetrën: flisnin mbi ndeshjet e kampionatit të futbollit, ngacmonin tifozët e sëmurë, flisnin për planin e mbrëmjes. Dikush thoshte se do të shkonte në kinema, një tjetër kishte blerë dy bileta për në teatër, kurse usta *Sala* kishte zbuluar një lokal ku servirej raki e vjetër rrushi nga e Milotit dhe meze fërgesë me gabzherrë e mëlçi. Pastaj filloi puna përsëri dhe secili, i përqëndruar në objektin e caktuar nga mjeshtri, nuk e çonte kokën derisa të binte sirena e fabrikës që lajmëronte pushimin e madh të drekës. Saldatorët u përzien me shokët e tjerë të fabrikës dhe tok së bashku u drejtuan nga mensa që ishte në katin e parë të pallatit të kulturës të kombinatit. Mensa ishte plot drithë; në të dy anët e fasadës dritatet e mëdha me xhamai krijojnë përshtypjen se përvëç kolonave prej betoni nuk kishte fare mëre tullash. Rrezarti u ul në tryezën e tij bashkë me usta *Salën* dhe një dy mekanikë të tjerë të remontit, njëri prej të cilëve punonëtë me Meritën. Ata e përshëndetën saldatorin; por nuk u bënë fare kureshtarë të pyesnin përsë ishte kthyer përsëri në fabrikë. Gjatë drekës Rrezarti vështronë me bisht të syrit shokun e punës të Meritës se mos i thoshte gjë për të, pasi i dinte marrëdhëniet e tyre të dikurshme, por ai mbillaçiste makaronat me gjalpjë dhe nuk ia hidhët fare sytë atij. Rrezartit, nga qëndrimi i heshtur që mbante ai, i dukej sikur e qortonte për sjelljen e tij të ftotë ndaj Meritës. Ai si hengri me një frymë të gjithë pjatën e makaronave dhe piu me fund gotën e verës, nisi t'i fliste shokut njitur për rezultatet e punës.

Rrezarti, pas çdo kafshate që përtyste, hidhët herë pas here vështrimin nga tryezat se mos shquante diku në mesin e punëtorëve dhe punëtoreve që gumëzhinin si koshëre bletësh të dashurën e tij. Po më kot, ajo nuk dukej gjökundi.

Usta *Sala* e mori me mend shqetësimin e «çirakut» të vet dhe bluante të zbulonte si qëndronte e vërteta në marrëdhëniet e tyre. As ai dhe as Merita nuk i thoshin prej

kohësh asgjë për njëri-tjetrin askujt prej shokëve të vjetër të fabrikës. Sala vendosi me vete, që, sapo të gjente rastin, do ta pyëste Rrezartin se ku e kishte syrin e pushkës. Salës nuk i pëlqenin fare dhe i urrente ca djem aty në fabrikë që silleshin padenjësish me shoqet e tyre. U premtonin në fillim për martesë dhe pas një kohe u kthenin shpinën duke flutuar në lule të tjera. Ai belbëzoi me vete: «Kjo është poshtërsi! Imorale», — dhe përsëri mendoi: «Para se t'i japësh fjalën tjetrës për martesë duhet ta peshosh mirë.»

— Çohemi! — i tha Rrezarti që nuk kishte hapur gojën fare gjatë tërë drekës.

— Çohemi! — u përgjigj i menduar usta Sala.

Dhe të dy shokët përkrah njëri-tjetrit, në vargun e punëtorëve u ktheyen përsëri në sheshin e punës.

Ra sirena e mbarimit të punës së turnit të parë. Rrezarti hoqi maskën. Dhe, si pastroi vendin e punës dhe pajisjet, u nis nga garderoba. Pas pak ia mbërriti edhe usta Sala.

— Më në fund banjat qenkan rregulluar! — i tha Rrezarti shokut që ishte zhveshur në të mbathura.

Avulli i dusheve e kishte bërë vendin tërë mjegull aq sa, ata mezi shquanin trupat e njëri-tjetrit.

— E po banjat janë kultura e fabrikës! — ia pat usta Sala duke hequr me dorë shkumën e sapunit nga koka.

Si bënë dushin dhe u veshën, ndjenjën edhe pak minuta në korridorin e garderobës që të mësoheshin me temperaturën e ambientit të jashtëm. Pastaj dolën në oborrin e fabrikës. Plepat nisën të fëshférin nga një erë e lehtë. Prej tyre binin fletë ngjyrë ndryshku që përhapeshin aty përreth. Vjeshta kishte filluar të ndryshonte ngjyrat e malit në lindje të qytetit dhe të parqeve me lloj-lloj drurësh dekorativë.

Kur Rrezarti me usta Salën që nuk i shqitej po dilnin nga porta e madhe e fabrikës, roja zgjati dorën dhe i thirri atij:

— Oh, Rrezja e Padukshme qenka kthyer! Toke dorën!
Të uroj për titullin e novatorit.

Rrezarti qëndroi një çast dhe me buzën në gaz ia shtrëngoi dorën rojës që ndryshonte nga ai i laboratorit bërthamor. Ky ishte një nga punëtorët e vjetër invalidë, me një natyrë që nuk linte njeri pa ngacmuar.

— Hë..., — i tha ai duke u zgjatur nga Rrezarti, — tani lëshoja rrezet thëllëzës, se për besë do ta qëllojnë të tjetrët më përparrë...

Rrezarti u drodh nga fjalët therëse që i tha roja që diç dinte për të dashurën e tij, Meritën. Dhe, me një pamje nervoze u largua nga porta duke ndjekur nga pas usta Salën.

Usta Sala donte të gjente rastin të ishin vetëm dhe t'i thoshte ndonjë fjalë rreth Meritës, mirëpo nuk po i linin shokët që u ngjiteshin nga pas dhe këmbenin biseda të shkurtra me atë. Edhe, kur hipën në autobus, njerëzit ishin ngjeshur njëri me tjetrin dhe ai nuk gjeti rast të fliste me Rrezartin.

— Do të vemi bashkë të rrëkellejmë nga një gotë..., — i thirri usta Sala Rrezartit që ishte ngjeshur pas bankinës së fatorinos.

— Njëherë tjetër! — qeshi Rrezarti.

— Si të duash! — belbëzoit tjetri.

Në stacionin numër 3 Rrezarti zbriti nga autobusi. Dhe, kur vuri këmbët në tokë, u kthye nga dritaret e «fizarmonikës Shkodra» dhe ia bëri me dorë usta Salës që qëndronte me faqe të shtypur në xham duke krijuar një portret qesharak.

Rrezarti, i kredhur në mendime, u nis drejt e në shtëpi. Pavarësisht nga telashet që i kishin nxjerrë për ndryshimin e temës, ai e ndiente se nuk mund t'i shmangej më rrugës që kishte nisur. Lloj-lloj formulash dhe abstraksionesh të teorive shkencore të fizikës bërthamore i zienin në kokë dhe nuk e linin të qetë. Duhej të përvetësonte më mirë natyrën e rrezatimit të kobaltit dhe të izotopit Lantan 140 dhe përshtatshmërinë e përdorimit të tyre në eksperimentet

në furrnaltat dhe në furrat rrrotulluese të ciméntos. Por edhe biseda që kishte bërë me një inxhinier konstruktur të digave gjigante të hidrocentraleve që po ndërtoheshin njëri pas tjetrit mbi lumenjtë e rrëmbyeshëm të vendit, ia brente trurin. Ai kërkonte zbatimin e një gjurmuesi radioaktiv që të kontrollonte saktësinë e digave që nuk duhej fare të filtronin ujin qoftë edhe nga kapilaret. Kishte tërhequr nga biblioteka një libër anglisht mbi këto tema dhe mallkonte veten që nuk ia kishte vënë veshin me kohë përvetësimit sa duhej të gjuhës së huaj. Ja, tani ai e parashikonte se do të haste vështirësi në të lexuarit lirshëm të literaturës teknike. Kur u gjend para shtëpisë së vet, pasi ngjiti shkallët shpejt e shpejt, duke menduar për kohën që i dukej sikur po i fluturonit nga duart, hapi derën e apartamentit të tij dhe gëndroi një çast në korridor i befasuar, Përtej xhamlliékut të derës së dhomës së pritjes pa të ëmën që diç bisedonte me një vajzë që e kishte kthyer shpinën. «Cila të jetë ajo vajzë?» — belbëzoi ai me vete. Dhe atë çast ndjeu t'i rrihte zemra. I shkoi ndër mend Meritai «Jol Ajo nuk vjen!» — u përgjigji po më mendje. Atëherë zuri dorezën, dhe, si e uli poshtë me ngadalë, hyri brenda në dhomë. Vështrimi i tij i habitur u ndesh me sytë e Sofijes që atë çast ktheu kokën prapa.

— Mirëdital — belbëzoi me zë të mekët Rrezarti.

— Ah, mirëdita, Rrezart! — u përgjigj ajo pa lëvizur nga kollitku me një pamje të druajtur.

Pastaj Rrezarti ia shtrëngoi dorën që ia kishte zgjatur ajo dhe u ul në një poltronë pranë saj.

— A u lodhe, Rrezart? — e pyeti e éma që vuri re hutimin e të birit.

— Të punosh e të mos lodhesh..., — buzëqeshi Rrezarti duke e vështruar të ëmën në sy.

— Shoqja Sofije më tregoi se çfarë ka ndodhuri! Dhe ajo ka ardhur të të ndihmojë. Ti duhet ta falënderosh përkujdesin që tregon ajo.

— Ti e di, nënë, se unë mirënjojen e konsideroj një virtyt të njeriut.

— Të kam sjellë komplet dorëshkrimin e temës së re... e pas mbrojtjes së diplomës si fizikan i lauruar shohim e

bëjmë! – dhe me një buzëqeshje të ngrirë ajo i zgjati një dosje të re në ngjyrë të gjelbër.

– Shoqja asistente! – tha me mirësjellje Rrezarti. – Më falni që do t'ju kundërshtoj. Nuk kam ndër mend të tregohem ai që nuk jam. Unë u jam zotuar shokëve të fabrikës se tezat e diplomës do të jenë ato që njëkohësisht zgjidhin edhe problemet e progresit të prodhimit, – dhe ndërkohë, pa hezitim, ia ktheu dosjen, duke e vendosur në tryezën e rrumbullakët me xham para saj.

– Profesor Koti... mbeçi kryetar i komisionit të diplomës. Ky është një favor për ju. Dhe mendoj se nuk duhet t'i kundërviheni fatit që po ju buzëqesh...! – belbzoi ajo pa lëvizur qepallat e mëdha me qerpike të zinj.

– Shoqja Sofije, njerëzit me dinjitet një herë flasin! Do t'ju pres në shtëpi si mysafire. Kurse, siç thotë një proverb populor, kësaj historie më mirë i hedhim gunën...

– Më ndieni atëherë për guximin që kam marrë! – ngriti pakëz zérin ajo dhe bëri të ngrihej nga kolltuku.

– Zakoni i shqiptarit e kërkon që të mos dilni nga shtëpia e tjeterit pa u gostitur! Doni t'ju nxjerr gliko me mandarina që kam bërë vetë? Apo dëshironi amareta me arra? – Nëna e Rrezartit ndërkaq u çua në këmbë dhe, duke vështruar e pikelluar të birin me bisht të syrit, shkoi në kuzhinë.

– Paskeni nënë shumë të mirël – tha ajo për të thyer heshtjen e zymtë që pllakosi kur ata mbetën një copë herë vetëm.

– Të gjitha nënët janë të mira, – u përgjigj duke vë- në buzën në gaz Rrezarti.

Përsëri ra heshtja. As njëri dhe as tjetri nuk kishin më se çfarë të thoshin. Peri ishte këputur.

Pas pak në dhomën e pritjes u kthyte e ëma me një tabaka në dorë me pjata qelqi me gliko dhe amareta. Si ua vuri të dyve përpara pjatat, vetë u ul në kanapenë rrë- zë dritares. Ajo vështronte me njëfarë adhurimi Sofijen dhe diç bluante me mendjen e saj që i biri ia lexonte në ballë.

– Qenkan të shijshme! – tha Sofija me një buzëqesh- je të përzemërt.

— Të bëftë mirë, bijë e nënës! — qeshi më dhembshuri e zonja e shtëpisë dhe u ngrit përsëri e doli jashtë. Kësaj here nuk vonoi as edhe pesë sekonda. Solli dy gota me ujë në një tabaka tjetër.

— Ju falem nderit! — tha Sofija pasi piu ujin dheshiu lehtë buzët e holla me pecetën e bardhë që mori nga tabakaja. Kur ajo u ngrit për t'u larguar, Rrezarti përsëri ia shtrëngoi dorën me mirësellje dhe i tha:

— Lamtumirë!

— Lamtumirë! — belbëzoi ajo akull e ftohtë dhe doli nga dhoma e shoqëruar nga e zonja e shtëpisë që e përcolli deri te kryet e shkallëve përjashta apartamentit.

Rrezarti e priti të ëmën në kuzhinë i kërrusur mbi teknik anglisht që kishte planifikuar të studionte:

— Rrezart, nuk e kuptoj përsë u solle kaq ftohtë. Kjo qenka goxha vajzë! — i tha e ëma duke i vënë dorën në sup.

Ai ktheu kokën nga ajo dhe ia zuri me dashuri dorën, atë dorë të rreshkur dhe iu përgjijaq me zë të butë:

— Nënë... ti nuk mund tâ dish së sa të ngatërruara janë këto punë! Ki besim tek yt bir që nuk shkel në dërrasë të kalbur! — dhe nuk e zgjati më, por uli sytë në libër.

E ëma u largua, e la vetëm të zhytur në librat që nukoi hiqte nga dora.

* * *

Ishte java e dytë që Rrezarti kishte filluar përsëri punën e saldatorit. Inxhinier Arta Shkëmbi i kishte ngarkuar të bënte saldimin e kapikordave dhe të kontakteve speciale të një paneli komandues që do të zëvendësonte kuadrin e vjetër të furrës së ré tunel që ishte projektuar të punonte automatisht në kryerjen e tërë operacioneve të projektes së tjegullave prej gresi qeramik të porositura përzonat e Veriut me ngrica e acar gjatë stinës së dimrit. Ai e bënte punën me kujdes dhe si gjithnjë me atë pasionin e saldatorit. Pa si mbante tatorëshin, hidhët xhaketën në

sup dhe herë-herë i vëtmuar, i kërghur në studimet e ditës së kaluar që përpinqej t'i bluante, kthehej në shtëpi. Ai e dinte se Meritën, pasi mbaroi maturën në shkollën e mbrëmjes në degën e mekanikës, e kishin transferuar si dezinjatore pranë një grapi pune në uzinën e automjeteve që merrej me ndërtimin e një motori me konstruksion të modifikuar nga doktori i shkencave mekanike Sherif Meta. Ai e kishte kuptuar me kohë se Merita kishte talent të veçantë përvizatim teknik. Jo vetëm që tregohej e pastër në punime, por bënte punë me saktësi, bile ndonjëherë edhe korrigjonte skicat që ia dorëzonin shpejt e shpejt teknikët. Atë natën para festave të Nëntorit atij i shkrepit në mendje të shkonte drejt e në shtëpinë e saj dhe të kërkonte të bisedonte shtruar me të.

Mori rrugën e njohur. Si kapërceu bregun e Sodës, vendosi të ulej në një stol druri tërë myshk e kripë që ia kishin ngulur këmbët në rërë. Një copë herë vështroi kolonat e klorit e të hipokloritit. Ai ishte impianti i ri i elektrolizës i ndërtuar nga novatorët me vendosmëri e në luftë kundër armiqve të klasës. Atë çast i shkrepit në mendje qëndrimi që mbante profesor Koti ndaj eksperimenteve që kishin nisur me rastin e punës së diplomës së tij për përdorimin e burimeve radioaktive në fushën e industrisë. «Mos vallë edhe ky është një sabotator dhe asistente Sofija është bërë vegël qorre e ndikimit të personalitetit të tij shkencor? Mos prapa tyre fshihet nëpunësi Misi Vangjoja? Si nuk më ka shkuar ndonjëherë mendja për këto gjëra?» Kështu nisi ai të bluante me vete ndërsa vështronte perëndimin e diellit që kishte mbetur vetëm një si thelë portokalli mbi kodrën në perëndim. Dhe nuk vonoi edhe ajo copë e vogël e kuqe u zhyt plotësisht nën ujin e largët të kaltër. Menjëherë ndërroi ngjyra në horizont dhe një si vello tyli e përhime u duk sikur mbuloi vendin. Përsëri truri i trazuar nisi të thurte mendime pas mendimesh. «Për avarinë e hapjes së derës prej betoni të bodrumit të akseleatorit, nuk është folur më në laboratori! Përse vallë kjo he-shtje! Mos ishte pakujdesi tekniqe? Por edhe pa gjurmë nuk është! Tërë ky vrull pune shkencore, tërë ky marshim i madh revolucionar i ndërtimëve socialiste, tërë kjo luftë klasash!...

Edhe në fushën e eksperimenteve të mia koha do të tregojë se çfarë natyre kanë këto lloje grimcash; janë të ngarkuar me koncepte idealiste-metafizike, apo transmetojnë sedër të sëmurë intelektualiste, apo ndoshta janë me ngarkesa frenuese armiqësore? Ai vendosi se duhej të informohej Partia për t'i dhënë rrugë tërë këtij lëmshi. U ngrit nga stoli dhe u nis për në shtëpinë e Meritës.

— Mirëmbërëma, — i tha befas dikush nga prapa.
Rrezarti ktheu kokën.

— Aha..., ti qenke, usta Sala? Më je bërë rrodhe. Nga mbive si kërpudha pas shiut? — qeshi ai duke i rënë shokut miqësish me grusht në gjoks.

— Të kapa me grep, o peshku i dajës! Ç'do këtej?

— Dua të takohem me Meritën! — tha me zë të ulët Rrezarti pa ia fshehur shokut të vjetër ndjenjën e dashurisë për Meritën.

— Të kisha thënë se si ajo nuk gjen gjëkundi edhe sikur të kërkosh e të bredhësh me këpucë hekuri anembanë!

— Pse... mos është vonë? — pyeti i tronditur Rrezarti duke vështruar sytë e Salës që shndrisnin në errësirë nga një rreze drite që vinte pjerrtazi si shigjetë nga llamba neon që varej në një shtyllë majë kodrës

— Nuk e di..., — iu përgjigj usta Sala duke tundur kokinë në mëdyshje jo pa qëllim. — Por, megjithatë, nëse ti më ngarkon me këtë detyrë, unë, për shoqërinë që kemi, do të flas me Meritën, bile edhe me prindërit e saj.

— È si më kujton ti mua? — pyeti Rrezarti duke e zënë nga krahu. — Mos jam vallë ndonjë djalë i kohës së baba-qemos që të martohem me shkesllëk!

— E po mirë pra, bëje vetël — thirri si me inat.

— Do ta bëj që ç'ke me tël!

— E po ja ku po ta tregoj «sekretin»! Nesër që bëhet inaugurimi i linjës së re të varféruesve qeramikë, e di me siguri që do të vijë edhe ajo. Atje ke rast të takohesh. Tashti hajde po të duash në shtëpinë time të pish një gotë raki nga racioni im! — qeshi usta Sala dhe nisi të largohej prej tij.

— Unë do të shkoj që tani në shtëpinë e saj dhe do të ulem këmbëkryq me atë dhe prindërit e saj.

— Bëj çfarë të duash! — thirri në errësirë në të languard, usta Sala. — Por veç qëlljoje me reze thëllëzën para se ta gjuajnë të tjerët me pushkë me barut... Hi... hi... hi..., — qeshi ai duke humbur përmes kopshtit që dilte në anën tjetër ku ai kishte shtëpinë. Ishte një pallat me tulla të bardha silikate ndërtuar me kontribut vullnetar nga fabrika e tyre pesë vjet më parë.

Rrezarti u his drejt shtëpisë së Meritës, një shtëpi dykatëshe me strehë të gjera. Atij i rrahu zemra fort kur shtypi butonin e një zilejë që dëgjohej deri jashtë. Priti me ankth një copë herë. Askush nuk po dilte. Sapo bëri të langohej, u hap dera dhe ia behu një djalë me shall të kuq në qafë. Ai ia hodhi sytë vizitorit paksa i habitur.

— A është Merita në shtëpi? — e pyeti Rrezarti.

— Jo, nuk ka ardhur akoma, — iu përgjigj ai pa ia shqitur sytë.

— E po mirë. Do të vij njëherë tjetër, — ia ktheu i çliruar Rrezi.

— Po cili jeni ju, xhaxhi, që e kërkoni?

— Një shok i saj i punës. Nuk ka gjë, do të vij përsëri! — buzëqeshi Rrezarti dhe, si e përkëdheli djalin në kokë, u largua.

KAPITULLI X

Në laboratorin e fabrikës drejtoria e kombinatit të material-ndërtimit emëroi në laborator fizikanin me përvojë, Ilir Shkallën. Atë nuk është krejtësisht nga puna pedagogjike, por vetëm ia reduktuan orët e mësimit që t'i linin kohë që të merrej edhe me punën eksperimentale e praktike në laboratorin e fabrikës. Ai, përveç disa analizave të tjera fizike, nisi të bënte edhe matjet e dendësisë së tullave me anën e aparatit të ri që ndërtuan dhe eksperimentuan në Laboratorin Bërthamor D. 6. Ja, ata novatorët më kryesorë të fabrikës me në ballë inxhinierin teknolog, Artan Shkëmbin, ishin mbledhur kokë më kokë në byronë teknologjike dhe po vështronin mbi disa vizatime teknike të vendosura në një tryezë të madhe. Rrezarti zgjati kokën nga xhami dhe, kur ndeshi vështrimin e inxhinier Artanit që ia bëri me shenjë të shkonte tek ata, vuri buzën në gaz dhe u nis nga ana tjetër, e byrosë teknologjike që e kishte derën me xham të puthitur me tërë fasadën po prej xhami. Kështu që njerëzit që vinin aty në të rrallë mezi e gjenin hyrjen. Inxhinier Artani i bëri vend Rrezartit dhe

nisi menjëherë t'i shpjegonte skicë-idenë e një linje tjetër të re të prodhimit të tubave gres ku pothuajse të tëra nyjat e procesit ishin të mekanizuara, përvèç asaj të zmaltimit. Ai tha:

— Në radhë të parë ka rëndësi krijimi i koncepteve të reja shkencore për teknologjinë. Ja, — shënoi me gisht ai në letrën e milimetruar: — Argjilat me formacion gjellogjik gjysmëshkëmbor duhen zërbyer në pluhur që të bëgen mekanike dhe atë gjysmë të njomë. E kjo teknologji mineralogjike dhe kokrrizometrike...

Rrezarti gëzohej me krijimet e shokëve të tij në fudukshme, tek ai sistemi i zbatimit të gjurmuesit radioaktiv në furrat rrotulluese të çimentos.

— E kuptoj se për çfarë bluan! — ia ktheu befas Artani sikur t'ia lexonte mendimet në ballë.

— Mendimi shkencor, bile edhe ai më i thjeshti, kur vihet në jetë, shndërrohet në një vepër materiale të dobishme.

Këtë mendim Rrezarti e hodhi aty midis shokëve. Atij i punonte truri tërë ato formula dhe ekuacione matematike që zërthenin lidhjet midis rrezatimit dhe lëndës.

— Erdhën! — tha befas Artani duke u zgjatur nga dritarja e madhe me xham që i lejonte rrezet e dritës të përhapeshin në tërë sallën.

— Cilët? — pyeti Rezi dhe e hodhi vështrimin jash-të, në oborrin e fabrikës. U shtang kur pa profesor Buron Gurrën që diç bisedonte përzemërsisht me sekretarin e Komitetit të Partisë të Rrethit. «Qenka kthyer profesori?» — belbëzoi ai me vete dhe ndjeu njëfarë shqetësimi ashtu të kishte ardhur për punën e tij. Pastaj e largoi mendimin duke arsyetuar se ai, sekretari i Komitetit të Partisë, vinte përiaugurimin e linjave të reja që kishin ndërtuar punëtorët e inxhinierët me forcat e tyre. Në fabrikë po vinin shokë të ndëruar që do të merrnin pjesë në inaugurimin e linjave të

reja. Mysafirët, apo iu afruan hyrjes së godinës së administratës, u pritën nga drejtori i kombinatit, përgjegjësi i fabrikës, sekretari i partisë i fabrikës, mekaniku i remontit. Rrezarti u habit kur pa edhe usta Salën që mbiu aty në rrëthim e mysafirëve duke u shtrënguar dorën sekretarit të Komitetit të Partisë të Rrethit. Ai me një buzëqeshje të gjuar i binte në sup ustait të tij që diç i thoshte duke bërë gjeste me duar e me sy. Me të vërtetë Rrezarti nuk kishte imagjinatë të mendonte se çfarë ndodhë midis tyre dhe përsë bisedonin me aq zjarr. Ai nuk kishte dëgjuar ndonjëherë nga usta Sala t'i fliste për ndonjë shoqëri apo miqësi të vjetër me sekretarin e partisë të rrëthit. Mysafirët, të shoqëruar nga të zotët e shtëpisë, u nisën drejt sallës së byrosë teknologjike dhe të projektimeve të fabrikës. Dhe ajo që e dërrmoi përfytyrimin e Rrezartit, ishte hyrja e një motociklete me zhurmë në oborrin e fabrikës fill pas tyre. Profesori i shkencave mekanike që ai kishte njobur në metalurgji dhe Merita zbritën nga motoçikleta dhe pa humbur kohë shkuar te mysafirët e tjerë që tanimë po e cniñ drejt korridorit përballe tyre. «Edhe sikur të improvizojë ndonjë skenë të rëndomtë të ndonjë drame, nuk mund të ndodhë një kombinim i tillë!» – belbëzoi Rrezarti me vete. Por nuk pati më kohë të thurrte supozime, se ata ja mbërritën në byronë e projektimeve të fabrikës. Inxhiner Artani u doli përpara dhe, duke buzëqeshur, u bë gati të përshëndeste mysafirët.

Rrezarti kishte qëndruar në cep të tryezës nga qoshja e murit ku ishte vendosur një raft me libra e manuale teknike. Atij i zuri yeshi një shprehje entuziaste që lëshoi sekretari i partisë duke iu përgjigjur ndoshta ndonjë bisede të nisur qysh më parë me profesor Buronin.

– Është koha e mendimeve dhe e veprave të mëdha, profesor! – tha sekretari.

Profesor Buroni pohoi me kokë. Fytyra e tij e bardhë tregonte sikur të mos e kishte zënë dielli kushedi prej sa kohësh.

— E cili është? — belbëzoi sekretari duke vështruar në sy profesorin që i rrinte pranë.

— Ja, ai është Rrezja e Padukshme, — tha usta Sala duke zgjatur gishtin tregues nga Rrezarti.

Profesor Buroni bëri një hap përpara duke parakaluar mekanikun e remontit dhe i zgjati dorën Rrezartit.

— Si je? — e pyeti ai miqësish me një ndjenjë dashamirësie që u ra në sy të gjithëve.

— Mirë se erdhe, profesori! — belbëzoi Rrezarti dhe u zgjat nga ai për ta përqafuar.

Tani nuk kishte më dyshim se usta Sala dhe profesor Buroni kushedi se çfarë i kishin thënë për të sekretarit të partisë. Ky i fundit, një burrë i bëshëm, me një pamje të çiltër, me fytyrë të mprehtë, me t'ia lëshuar dorën profesori, u përqafua me Rrezartin, sikur ta kishte djalin e vet që i kthejë në shtëpi pas një kohe të gjatë.

— Hë, saldatori fizikan! — qeshi ai. — Mora vesh se je frikësuar nga ca rreze kozmikel Më tha usta Sala që e ke përfunduar punën e diplomës mbi zbatimet e burimeve radioaktive në fushën e industrisë të material ndërtimit. U gëzova shumë! Ja, erdhì fillimi i muajit të japësh provimin e diplomës.

Profesor Gurra e kuptoi hutimin e Rrezartit dhe, duke e bërë të natyrshme bisedën e tij, u ul aty pranë tryezës dhe hodhi vështrimin nga planimetrija e linjave të reja që ishin vendosur me mjeshtëri në lidhje me repartet e vjetra ekzistuese.

— Por saldatori fizikan, — ia priti sekretari, — do të dijë të përgjigjet në komisionin e provimit të diplomës edhe për natyrën e rrezeve kozmike. — Ai vuri buzën në gaz duke e vështruar me respekt Rrezartin.

— E si nuk i ditka ky rrezet kozmikel... ehu sa herë më ka folur për lloj-lloj rrezesh të dukshme e të padukshme, — ia bëri me dorë usta Sala duke buzëqeshur. — Të kam thënë që nuk të lëmë ne të heqësh dorë nga rrezet! Ja ku doli fjala ime.

Rrezarti qëndronte i heshtur e pak si i trullosur. Buzëqeshja i mbeti si e ngrirë në fytyrën bojë gruri. I dukej si

një ëndërrim e tërë ajo që po njiste para syve të tij. «Partia ditka me hollësi tërë ngjarjen, bila ajo qenka futur aq thellë si ato rrezet gama në zëmërën e çelikut», — mendoi ai më vete duke hedhur atë çast vështrimin në një cep të letires së milimetruar te një shigjetë e kusqë që tregonte një ekuacion diferencial. Atij iu duk se tani nuk kishte më si të fshihte ndjenjat e tij të mirënjoyjes për Partinë dhe shokët e fabrikes që e nxorën në rrugën e madhe të shkencës. Tashti i përkiste atij të shumëfishonte forcat mëndore e fizike që t'i vihej punës: më parë të jep-te provimin e diplomës dhe pastaj t'u përvisej eksperimenteve për vënien në jetë të atyre projekteve që ëndërronte.

— Mos keni gjë për të thënë? — e pyeti profesor Gurrë.

— Po. Të falënderoj nga zemra... — dhe më atë çili-tërsinë e tij që e karakterizonte i hodhi duart në qafë sekretarit të partisë. Pastaj u kërrus nga profesori dhe, kur priti pakëz që ai të çohej nga karrigia, e përqafoi edhe atë.

— Po mua? — pyeti befas usta Sala. — Nuk do të më përqafosh? Më ke pasur usta, o dreq i rrezeve të padukshme!

Rrezarti u kthye nga ai dhe me buzëqeshjen e gjallëruar ia shtrëngoi dorën ustait të tij, e përqafoi me atë mënyrën e zakonshme duke e goditur me grusht dy a tri herë në gjoks.

— Eh, çfarë kohërash kanë ardhur! — tundte kokën usta Sala duke dashur me atë shprehje të thoshte aq shumë, sa nuk ia lejonte momenti.

— Tani si thoni? — pyeti profesori. — Vemi të shohim se ç'gjëra të reja kanë ndërtuar shkencëtarët e fabrikës?

— Vemil — tha sekretari dhe, si e zuri nga krahu profesorin, u nisën të dilnin nga byroja teknologjike e projekteve. Pas tyre filluan të dilnin edhe të tjerët. Rrezarti mbeti aty në cepin e tryezës në qoshe të sallës sikur ta kishte gozhduar në vend ndonjë nga ato rrezet kozmike. Merita me një pamje mahnitëse, me ata sytë e zez të shndritshëm që i lëvizte pakëz me një buzëqeshje të

hirshme, me flokët lidhur me kordele nga pas vështronte me ngulm Rrezartin. Ajo matej të thoshte diçka, por, me sa kuptohej, nuk dinte se nga ta niste.

— Lëvizja është ligji thelbësor i mikrobotës dhe makrobotës! — tha Rrezarti me zë të ulët dhe, si heshti pak i menduar, shtoi: — Edhe kur duket se objekti qëndron në vend i palëvizur, kjo është një qetësi relative, kurse lëvizja e tyre përgjithësisht është absolute!

— Këtë deshe të më thuash? — pyeti ajo.

— Oh, — psherëtiu Rrezarti, — kam për të thënë shumë, shumë gjëra!

— E po mirë! Edhe unë do të të dëgjoj!

— Atëherë takohemi pas inaugurimit.

— Mirë, — tha ajo me një buzëqeshje dhe doli jashtë për të zënë vizitorët që morën kthesën e korridorit të gjatë që të dilnin në sheshin e fabrikës.

KAPITULLI XI

«Më në fund erdhi dita për të hyrë në provimin e diplomës! — tha me vete Rrezarti atë mëngjes të freskët e me qilli të kthjellët kur kaloi pragun e shtëpisë dhe me çantë nën sqetull u nis drejt universitetit. — Më duket vetja si kjo batica e zbatica e detit, — mendoi ai, kur po vështronë me vëmendje dallgët e trazuara të detit që vinin njëra pas tjetërës dhe përkëdhelnin bregun duke shtyrë leshterikun e rërrën e ngjeshur. Rrezet e ndritshme që vinin nga dhjetëra miliona kilometra largësi nga Dielli në Tokë krijonin aty para syve të tij ngjyra mahnitëse dhe miliona e miliona margaritarë që ndizeshin e shuheshin. «Kauza movens¹), — tha ai me vete duke sjellë ndër mend këtë shprehje në gju-

1) Shkak lëvizës

hën e vjetër latine. — Ma ha mendja se profesor Koti nuk do të heqë dorë nga rrezet kozmikel! Ai do të më gremisë, ja, si ata gurët që u rrokullisën nga shpërthimi i dinamitit atje majë malit.» I vajtën sytë atë çast përtëj bregut lindor ku nxirrej guri për fabrikën e cimentos. Tymi i bardhë si kordon ngjitej deri në njëfarë vendi në qill dhe pastaj zhdukej.

Tek ecte, mendonte: «Ja këtu brenda në këtë çantë kam dorëshkrimin e punës së diplomës. Çdo rresht e çdo faqe është shkruar me mund e djersë. Tema «Zbatimi i burimeve radioaktive në teknikë». Për të bërë tërë ato studime, iu desh të hynte në të fshehtat e shkencës bërthamore, të vriste mendjen ditë e net të tëra për të kuptuar e zbërthyer formulat e ekuacionet matematike, puna eksperimentale... Kishte ecur në rrugë të vështira herë me zigzage, herë me pengesa. Edhe tani nuk i shqitej nga mendja profesor Koti, asistente Sofija dhe kohët e fundit nëpunësi indiferent e enigmatik. «Mos vallë do të më hedhë në greminë ai Koti?» Por, kur mendoi tërë atë përkrahje që i kishte dhënë Laboratori Bërthamor D6, veçanërisht mbështetjen e organizatës-bazë të Partisë dhe të punëtorëve të fabrikës iu mbush zemra plot ngrohtësi. «Do të çaj edhe nëpër lartësitë e rrezeve kozmike, o profesor Koti!» — buzëqeshi me vete.

* * *

Nuk i hipi autobusit. Mendoi që atë copë rrugë afro një kilometër e gjysmë ta bënte në këmbë.

Njerëzit i parakalonin, po Rrezarti nuk e kishte mendjen tek ata, se ishte i kredhur në botën e dijeve të fizikës. Nuk dinte nëse do ta pranonin apo jo në atë llogore të jetës ku kishte llogaritur të provonte forcat e tij. Dielli lëshonte reze të ngrrohta. I hodhi një vështrim Muzeut Kombëtar. Ishte madhështor. Rrezarti ngriti kokën dhe vuri dorën si strehë për të parë më mirë, kur papri-

tur u gjend ballë për ballë me një turist të moshuar që ishte shkëputur nga grupei i tij. Ai e pyeti anglisht:

— Zotëri, a mund të më tregoni se ku gjendet magazina e filatelisë?

Rrezarti u trondit në fillim kur vuri re se turisti i shembellente çuditërisht profesor Kotit, por në çast e mblodhi veten dhe iu përgjigj në anglisht. I huaji falënderoi me kokë dhe u largua. Rrezarti vazhdoi të ekte drejt vijave të bardha të sheshit të madh të asfaltuar përkundrejt Monumentit të Skënderbeut. «Morë, ishte profesor Koti në vend!» — belbëzoi me vete kur pô zbriste shkallët në një lulishtë rrethuar me pisha të mëdha.

«Ja tek arrita», — tha ai me vete pasi qëndroi një çast nën portën e madhe të hapur dykanatësh. Aty hynin e dilnin studentët e ardhur nga të gjitha krahinat e vendit. Ai u takua me një shokun e tij të fabrikës që studionte në vitin e tretë të Fakultetit të Historisë dhe të Letërsisë dhe që ishte treguar talent në fushën e prozës si tregimtar. Rrezarti e dinte se në bankat e universitetit ishin ulur dhe vinin vazhdimi shqiptar edhe drejtpërdrejt nga radhët e punëtorëve dhe të kooperativistëve, djem e vajza të talentuara që canin me këmbëngulje përpëra.

Si u ngjit në katin e dytë, eci edhe ca hapa drejt korridorit plot me studentë dhe hyri në auditorin që për njante si amfiteatër. Nëpër shkallët e sallës ishin ulur dëgjues nga radhët e studentëve dhe prindër që kishin ardhur përfundimtar të fëmijëve të tyre. Rrezarti, si e hetoi ashtu shpejt e shpejt auditorin, e ndali vështrimin një copë herë nga kreu i sallës ku ishte vendosur një tryezë e gjatë e zezë me dru të rëndë me ca karrige me shpinë të lartë dhe të gdhendura me motive popullore, si ato të qilimave. Pastaj me shikim të përqëndruar nisi të shquante anëtarët e komisionit. Në mesin e tyre i zuri syri profesor Kotin. Një çast iu drodh zemra. Koti ishte ulur kokën me atë vështrimin e tij karakteristik nën syzet. Vallë e pa ai Rrezartin. Jo, jo, në atë largësi dhe me atë pamje prej miopi nuk ishte mundësi që Koti ta dallonte.

Pas Kotit qëndronte profesor Buron Gurra i kthyer

anash nga tabela e zezë duke ndjekur zhvillimin e formulave që bënte një nga kandidatët diplomantë. Në një tryezë të veçantë, nën atë kryesoren, ai njoju nga flokët të lidhur si topuz asistente Sofijen që diç po shënonë në librin e regjistrat të kursit të pestë të fizikës bërthamore. Pasi e mori veten, Rrezarti u ul katër shkallë më poshtë dhe zuri vend nga mesi i rreshtit në një karrige bosh afër një studenti të njojur të kursit të tij. «Pushka t'u bëftë top», — tha me vete.

— Erdhel — e pyeti shoku.

— Erdhal — iu përgjigj Rezi duke çuar pakëz buzën në gaz.

— A je përgatitur mirë, Rrezart, për ato formulat e shpejtësive të rrezeve? Për besë të sharroj ai verdhacuku. — E kishte fjalën për profesor Kotin. — Shikoje, shikoje si rri si mace hileqare...

— Lëri llafet! — e qortoi Rrezarti me zë të ulët duke u zgjatur nga ai.

— More, trim po tregohet saldatori ynë fizikan! — ia ktheu tjetri me shpoti. — Ti mund të jesh praktik, por këtu nuk pyesin fort për duart sesa për teorinë.

— Mbylle de të shkretën, — ia ktheu Rrezarti duke ia kërcitur dhëmbët si me shaka. — E fundit, po qe se nuk më diplomojnë, unë nuk ia kam frikën punës. Kthehem dhe kap përsëri saldatriçen. Po ti, që nuk të zë dora asgjë, more derdimen...

— Bëhem nëpunës në ndonjë katedër, — belbëzoi tjetri me një buzëqeshje ironike.

— Hëhë, nuk ka më ashtu. Prandaj nuk i duhet futur një pune që nuk ia del mbanë.

— Mirë... mirë, mos më trego kufijtë.

— Atëherë mbylle po të them, se, për besë, kur të dalim jashtë, do të t'i bëj turinjtë përshest, — qeshi Rrezarti. — E mban mend para dy vjetësh kur bënim stërvitjen ushtarakë se si ta vura shpinën në tokë?

Studenti fjalaman nuk foli më. Rrezarti ktheu kokën prapa nga shoku që i ra në sup me gishtin tregues. Ishte mjeshtri i furrës tunel.

— Të erdhi mikesha de... Merita! — i tha ai në vesh duke u zgjatur si urë përtëj bankës nga ai.

— Erdhi Merita? — pyeti i emocionuar Rrezarti dhe ktheu kokën nga dera e auditorit për të parë. Me të vërtetë Merita me shoqen e saj të fabrikës, me të cilën shembëllente si binjake, po ngjiteshin shkallëve të auditorit.

Usta Sala ia bënte me dorë që të shkonin e të uteshin afër tij. Ato zunë vend në rreshtin e fundit prapa usta Salës. Rrezartit i zuri syri inxhinier Artanin, bile pranë tij dhe drejtorin e fabrikës.

«Paskan ardhur shokët e fabrikës», — tha me vete Rrezarti me një ndjenjë gëzimi që ia rriti besimin për të përballuar betejën që kishte përpara. Pas pak e ktheu kokën prapa i fshehur nga kurrizi i shokut ngjitur për të parë më mirë se kush tjetër kishte ardhur nga shokët e tij. U habit kur pa kokën e zbehtë të s'ëmës në qoshe të murit pranë sekretarit të partisë të organizatës-bazë të fabrikës, që kishte marrë një pamje plot dinjitet. Kur kryqëzoj vështrimin me atë të Rrezartit, kapi kokën e nënës me njëren dorë dhe tjetrën, si e mylli grusht; e tundi në ajër duke iu drejtuar Rrezartit sikur t'i thoshte: «Ja, këtu jemi të gjithë, pranë teje!» Nga cepi tjetër i rreshtit edhe usta Sala ia bënte me dorë që ta merrte vesh se kishte ardhur edhe ai. Tani ishte e qartë për Rrezartin se shokët, bashkë me të, ëmën, kishin bërë marrëveshje më përpara që të vinin në universitet pa e ditur ai.

— U lutemi shokëve edhe shoqeve në sallë të mbajnë qetësi! Edhe një herë lutemi mbani qetësi! — thirri dikush nga altoparlanti me një zë të trashë.

Auditori u krohdh në një heshtje të plotë aq sa dëgjojë zukatja e një blete të hutuar që gabimisht, e ndarë nga tufa, kishte hyrë nga këlyshi i dritares dhe sillej aty qark e hutuar.

Kandidati i parë ishte larguar nga dërrasa e zezë, Kryetari i komisionit, një fizikan nga të kryeqytetit, ia bëri me shenjë Sofijes. Ajo diç pa në regjistër dhe, si u ngrit në këmbë me ngathtësi, vështroi nga mesi i sallës dhe thirri me zë të mekët:

— Kandidati Rrezart Sami Deti le tē paraqitet pér tē mbrojtur diplomën! — dhe si e topitur, me një vështrim si tē humbur u ul në vendin e saj pranë një tryze tē mënjanuar nga ajo e komisionit.

Rrezart Deti u ngrit në këmbë dhe, si qëndroi një çast ashtu pa lëvizur, doli anash auditorit. Pastaj nisi tē hidhte këmbët me një hap tē ngadalshëm derisa mbërriti në podiumin para komisionit.

Kryetari i komisionit ktheu fytyrën nga sekretarja ulur pakëz më poshtë në një tryezë me lustër në cepin e djathtë tē tyre, sikur deshi t'i thoshte: «Fillo!»

Asistente Sofija u kërrus lehtë mbi dosjen e punës së diplomës tē kandidat Rrezart Detit dhe me gjishtërinjtë e gjatë e tē hollë nisi tē zgjidhje fjongan. Pastaj shfletoi faqen e parë ku ishin shënuar vlerësimet e udhëheqësit shkencor, profesor Buron Gurrës, dhe ati i opONENTIT. Të dy «shkëlqyeshëm». Ndjeu ca emocione tē forta që ia shponin zemrën si me thikë. Por e mblodhi veten shpejt dhe me sytë që i shkëlqyen atë çast ngriti kokën nga vizitorët që rrinin tē vëmendshëm si në një shfaqje:

— Shokë tē komisionit tē laurimit tē diplomës universitare. — Si mbajti pak frysht, vazhdoi: — Miq tē ftuar! Puna e diplomës e kandidatit fizikan Rrezart Deti me temë «Aplikimet e metodave bërthamore në teknikë», — dhe ajo shtoi nga vetja e saj ca hollësira, — në zgjidhjen e disa problemeve tē rëndësishme në dobi tē prodhimit industrial tē vendit tonë është vlerësuar si nga udhëheqësit shkençorë ashtu edhe nga oponenti me notën dhjetë, shkëlqyeshëm. — Fjalën e fundit ajo e shqiptoi me një ton tē vëçantë sikur po reciton.

Profesor Koti mbeti si i kallkanosur. Kishte vënë bërrylin në tryezë dhe me njëren dorë shtrëngonte nofullën me kockë tē dalë që tē fshihte fërgëllimin e saj nga tē tjerët. Endiente veten tē vetmuar e tē vrarë shpirtërisht. Tani i kishte mbetur vetëm Misi Vangjoja ai që e nxiste në rrugën e zbatimit tē konceptit idealist në shkencë. Dhe kur përfytyroi takimin e tij tē fundit vetëm pér vetëm në kabinetin e punës në shtëpi, Kotit iu drodh zemra dhe frika ia

pushtoi tërë qenien. Bashkë me frikën përzihej edhe ndjenja e turpit. Nëpunësi Misi Vango ia kishte thënë troç pikëpamjen e tij politike: «Diversioni i shkencës dhe kulturës perëndimore do ta hedhin në erë sistemin e sotëm të padurueshëm. Ju, profesor Koti, — kishte vazhduar Misi Vangoja, — do të jepni kontributin tuaj në këto fusha të shkencës ashtu siç e keni nisur me ndërrimin e temës së diplomës të atij lapangjozi të fabrikës, Rrezart Detit. Më vonë na presin detyra të tjera më të rëndësishme!» E çfarë detyrash më të rëndësishme e prisin atë? Ai e kishte marrë me mend se Misi Vangoja ishte një nga ata përbindësha që kanë fshehur thikën, dhe presin çastin e volitshëm tanxjerrin dhe t'ua ngulin pas shpine të tjerëve që i pengojnë në rrugën e tyre. Pikërisht këtë thikë nxori ai atë mbrëmje dhe, si e vendosi mbi tryezën e profesorit, u zgërdhi e tha: «Ja, profesor, kjo majë thike për shembullë është e lyer me një dozë helmi të fortë. Pak të godit kjo dhe çdo gjë përblyset. Po të dëshironi, kam edhe një të dytë si kjo. Mbajeni këtë! »Profesor Kotit i vinte të vriste veten edhe tanj kur mendoi se ishte treguar aq miop sa të binte në kurthin e një krimineli ordiner që fshihej nën petkun e një nëpunësi. Kishte menduar kushedi sa herë, bile netët e fundit nuk kishte fjetur fare, por megjithatë nuk vendoste që të hapte gojë dhe ta denonconte atë gjarpër të mbledhur kulaç. U përmend kur kollegu ngjitur i ra me bërryl.

— Profesor! Do t'i bëni pyetje kandidatit? — i belbëzoi ai në vesh.

— Posi jo! — u hodh Koti përpjetë sikur të zgohej nga një gjumë i trazuar me lloj-lloj ëndrrash të trishtuara. Pyetjet ai i kishte përgatitur më përpëra dhe nuk hiqte dorë nga ato. Ai kishte mendimet e bindjet e veta për punën shkencore në universitet dhe në Akademi. Si leksi edhe një herë pyetjet, ngriti kokën dhe nën syzet hodhi një vështrim nga auditori pa e kuptuar përsë. Ai kapi shikimin zhbirues të Meritës, të asaj punëtoret që kishte njojur në fabrikë. Kjo diç bisedonte me një shokun e saj të punës dhe ky ishte saldator Metja. Profesorit i shkrepi në mendje të dinte se çfarë dërdëllisnin ata punëtorë atë çast. Ai nuk e merrte me mend përsë ata shqetësoheshin aq shumël

— Më vjen të përplas duart! — i thoshte Meritës saldator Sala.

— Prit se dardha e ka bishtin prapa! — iu përgjigj Merita dhe, duke e zënë për krahun, vijoi: — Mbaj qetësi, se po na qorton profesori. A e shikon se si na i ka hedhur sytë?

— Nuk e di përsë nuk më pëlqen ky njeri! Më duket si profesor borgjez, — i tha saldator Sala.

— Të duket ashtu, se është plakur, por te ne nuk ka profesorë borgjezë, — iu përgjigj Merita.

— Hë... hë... nuk ka profesorë borgjezë, por ndonjëri si ky... I ngatërron edhe... — Sala nuk arriti ta përfundonte mendimin deri në fund, se zëri i altoparlantit tha befas dy herë: «Qetësi... qetësi... në sallë!»

Profesor Koti ishte drejtuar nga Rrezarti dhe, si e shikoi në sy, e pyeti:

— Shoku kandidat, do t'ju bëj vetëm tri pyetje dhe vetëm tri pyetje. Mori një pamje ngërdheshëse. I shkrepni një mendim: «Tani do të shohim sa të vlen lëkura në dijet teorike shkencore në fushën e atomit!»

— Cilat janë llojet e rrezatimeve dhe karakteristikat e tyre kryesore që përfshihen në familjen e madhe të valëve elektromagnetike? Dhe, vaçanërisht do të më thuash ndryshimin esencial midis rrezeve të diellit e rrezeve radioaktive. Pjetja e dytë: Si matet masa e bërthamës? Po elektronet çfarë përmasa kanë? «Këtu do të gabosh se...», tha ai me vete dhe priti derisa kandidati të shkruante pyetjen. — Dhe, pyetja e tretë është demonstrimi matematik i formulës së Ajnshtajnit $E = m c^2$. Kaq kam. Ju, të dashur kolegë, keni ndonjë pyetje? — iu drejtua anëtarëve të komisionit.

— Nuk kam..., — belbëzoi laboranti fizikant.

— Jo... jo... as unë, — tha duke ia bërë me dorë kolegu tjetër, një docent i fizikës bërthamore që punonte në IFB, kurse pedagogu i matematikës, një burrë me moshë të thyer, bëri me shenjë se nuk kishte gjë për të pyetur, pastaj i tha në vesh profesor Buronit: «Në matematikë ky student është nga të rrallët që m'i zbërtente tërë formulat e fizi-

kës me anën e ekuacioneve të derivateve. Bile në praktikët që kemi bërë në qendrën elektronike llogaritëse dinte të formulonte edhe problemin e dhënë për trurin elektroteknik.»

— Edhe unë nuk kam pyetje! — tha pedagogu i filozofisë. Provat për lidhjen e shkencave të fizikës dhe vëcanërisht të teorisë së fizikës moderne relativiste të Ajnshajnit me botëkuptimin marksist-dialektik kandidati diplomat Rrezart Deti i dha tek unë shkëlqyeshëm, — tha ai me zë të lartë duke iu drejtuar enkas auditorit. Dhe, kur vështroi profesor Kotin që u thartua në fytyrë dhe picërrroi sytë si të shqarthit, vazhdoi me një ton lavdërues. — Bile kandidati Rrezart Deti demonstroi pikëpamjet filozofike të Engelsit dhe të Leninit për përkufizimet shkencore filozofike të zbulimeve të reja që ata parashikuan edhe për shkujt e ardhshëm edhe këtu qëndron gjenialiteti i tyre, se janë të pavdekshëm dhe gjithmonë aktualë...

Kryetari i komisionit, një burrë me pamje fisnike, iu drejtua kolegëve të tij:

Atëherë kandidati le t'u përgjigjet pyetjeve të profesor Kotit.

— Më falni! Kam edhe unë nga dy pyetje, — thirri profesor Buron Gurra duke ngritur dorën sikur kërkonte leje nga auditori. — Pyetje brenda temës së diplomës, sepse ne kemi vendosur në katedër që kandidati Rrezart Deti si pas rregullave të bëjë punë diplome dhe këtë e ka bërë shumë mirë, bile me bereqet, sepse eksperimentet e kryera janë në dobi të prodhimit, siç është ndërtimi i gama-defektoskopisë, ndërtimi i densimetrit radioaktiv, që tanimë janë vënë në jetë.

Saldator Sala nisi të përplaste duart. Dhe pas tij edhe disa punëtorë të tjera nga radhët e fundit të auditorit. Studentët e rreshtave të parë kthyen kokën të habitur për këtë gjest të punëtorëve.

Profesor Koti ngriti dorën për të vendosur qetësi. Altoparlanti përsëri bëri thirrje që të mbahej qetësi.

— Ju lutem mbani qetësi..., — tha profesor Buroni me një, buzëqeshje nqazëlllyese që i endej në fytyrën e tij të rreshkët që u gjallërua ato çaste. — Mbani shënim, shoku

kandidat, — iu drejtua ai Rrezartit, Shkruani pyetjet plotësuesë apo më mirë sqaruese që kanë të bëjnë me punën e diplomës suaj. Në përshkruani cilat janë katër fenomenet fizike, mbi të cilat bazohen kryesisht zbatimet e përdorimeve të metodave bërthamore në teknikë. Shkurt!

Pas një heshtjeje që pllakosi në sallë, sytë e të gjithëve ishin drejtuar nga Rrezart Deti që rrinte para tyre me një qëndrim të lirshëm dhe shembellente me një aktor teatri me përvojë.

— Po u përgjigjëm pyetjeve, — tha Rrezarti. — Bile, po të më lejohet, — vuri buzën në gaz ai, — mund të flas ca edhe për dijet që kam në fushën e rrezatimit kozmik, për të cilat kam punuar me asistenten e profesor Kotit, me shoqen Sofije. — Dhe atë çast ai i hodhi një vështrim dashamirës sekretares së komisionit që po e vështronë e habitur me ata sy të mëdhenj të shqyer, të rrethuar me qerpiqët si të ngrirë.

Profesor Gurra vështroi pjerrtazi pamjen e tulatur të Kotit. Ai heshtte. Atij iu bë një si nyjë në gurmaz dhe mendonte me vete se i kishte humbur tingulli i fjalës. «Si qëndron e vërteta? — pyeti ai vetveten. — Është bindur ky djall saldotori për atë konceptin se me se duhet të merren shkencëtarët e vërtetë? Apo më bën sfidë! E unë t'i them shkencëtarët e vërtetë? Apo më bën sfidë! E unë t'i them jo, nuk ia them dot, se pikërisht këtë temë kam kërkuar prej tij. T'i them po, do ta teproj me pyetjet jashtë temës së diplomës. Më mirë po hesht!»

— Përgjigjuni pyetjeve! — tha kryetari duke ia drejtuar vështrimin dashamirës Rrezartit.

Kandidati diplomant mori shkumësin dhe zuri të shkruante në tabelën e zezë ekuacione diferenciale, formula fizike dhe përkufizime. Shkroi edhe dy diagrame. Shkrimi ishte i qartë dhe me shkronja të mëdha të dukshme për një sy normal nga largësi pesëmbëdhjetë metra. I pushtuar dhe i rrëmbyer nga tensioni i punës krijuese shkencore, ai zhvillonte shkallë-shkallë mendimin e shprehur me matematikë e formula fizike të argumentuara. Ishte i rrjedhshëm në demonstrimin e fenomeneve të fizikës bërthamore dhe i rrëshqiste dora me njëfarë lehtësie që binte në sy te të gjithë. Pasi shkroi në tabelë rreth një çerek ore, la shkyp-

mësin dhe u kthye me një pamje të qetë nga auditori që kishte rënë në ankthi e pritjes se çfarë vlerësimi do t'i jepete komisioni.

— Një rreze nga ato të diellit ka shpejtësinë $c = 299,795$ km në sekondë... — Rrezarti lëviz i pakëz trupin duke u kthyer skicë nga komisioni i diplomës. Ai vazhdai: — Edhe llojet e tjera të valëve elektromagnetike, pavarësisht nga ndryshimet që kanë në frekuencë, shpejtësinë e kanë të njëjtë me atë të dritës. Dhe kjo shpejtësi e rrezes së dritës është e këtyre valëve elektromagnetike përfaqëson kufirin e sipërm të shpejtësive, me të cilat mund të lëvizë një trup, — dhe për ta argumentuar vuri gishtin te formula e Ajnshtajnit. — Në bazë të teorisë së relativitetit rrjedh se masa ndryshon me shpejtësinë e saj. Ka dallim midis masës në prehje dhë asaj në lëvizje. Ajnshtajni vërtetoi se energjia ka natyrë materiale dhe kjo vërteton tezën fondamentale të materializmit dialektik. Ligjet e ruajtjes së masës dhe të energjisë ruajnë si më parë vlerat e tyre... Rrezet e diellit, kur ndeshen në lëndë, jąpin ngrontësi e dritës ndryshe nga rrezatimi i padukshëm radioaktiv gama. Ai shpuri buzën në gjaz kur mendoi trukun e kësaj pyetjeje që i kishte bërë Koti. Pastaj ai foli mbi kapërcimet e krizës së fizikës klasike në atë të fizikës moderne relativiste të zbuluar nga gjeni i shekullit të njëzetë, Ajnshtajni. Pas çdo pyetjeje ai qëndronte pakëz dhe mbante vesh e bënte sytë pishë për të kapur reagimin e profesorëve e të pedagogëve të komisionit. Profesor Koti me dörën shtrënguar te nofulla e tij që herë-herë i dridhej, dukej si i humbur, sikur nuk e kishte farrë mendjen se çfarë thuhej aty. Kurse profesor Gurra tundte kokën në shenjë miratimi. Pastaj vuri gishtin te një ekuacion derivatesh që kishte të bënte me përllogaritjet e ngarkesave të bërthamës së atomit. Dhe, papritmas, belbëzoj: — Mos kam harruar diçka... ndonjë shumëfishin e ergut? — dhe u kthye pjerrtazi nga asistente Sofija që po e ndiqte me vëmendje demonstrimin e tij hap pas hapi. — Keni harruar? E po..., — u hodh përpjetë profesor Koti sikur ta kishte zënë gjarpri. Doli nga vendi i tij dhe iu afroa tabelës së zezë duke parë fare nga afër zhvillimin

e ekuacionit derivat se mos kapte ndonjë gabim të Rrezart Detit.

— Nuk keni asnje gabim! — ia pati nga tryesa e saj asistente Sofija me një zë të qetë, por të hollë e tingëllues. — Shumëfishi i ergut dhe tërë ekuacioni është shkruar saktë! — thirri ajo duke treguar faqen e tekstit shqip të fizikës bërthamore.

Në sallë u dëgjua një pëshpëritje. Profesor Koti e vështroi vëngër Sofijen dhe diç mendoi me veten e tij, por nuk kishte kohë të merrej me atë, se kishte ujkun përpëra. Ktheu befas kokën nga kandidati dhe e pyeti me njëfarë mënyre sikur t'i lëshonte shigjetë në pabesi:

— Na llogarit përmasat e elektronit.

— Më falni, profesor, — buzëqeshi Rrezarti, — me sa di unë, qofsha i gabuar, problemi i përmasave të elektrodit është ende i pazgjidhur. Po të jetë ndryshe, do të isha kureshtar ta mësoja nga ju.

Në sallë shpërtheu ilaritet. Profesor Koti u kthye në karrigen e tij po në atë qëndrim që kishte qenë më parë. Kësaj here nuk i dridhej më asnje muskul i nofullës. Përrnjante si mumje egjiptiane. Në sallë ra heshtja. Profesor Gurra u zgjat nga kandidati dhe tha me zë aq të lartë, sa të dëgjohej nga të gjithë të pranishmit:

— Deri tani të gjitha pyetjeve u është përgjigjur saktë!

— A mund të vazhdoj përgjigjen e fundit? — pyeti Rrezarti që kishte marrë zemër. Dhe atë çast kapi vështrimin e Meritës. Kësaj here atij iu duk se ajo po e shikonte me njëfarë indiferentizmi. I theri në zemër kur mendoi se mos në shpirtin e saj kishte zënë vend ndjenja e xhelozisë.

— Vazhdoni! — tha Gurra.

Rrezarti u kthye nga tabela e zezë dhe, si i hodhi një sy diagramës që tregonte karakteristikat kryesore të tri llojeve të rrezeve radioakteive; rrezet gama, rrezet beta dhe rrezet alfa, nisi të shpjegonte përbledhtas se ku bazohen shkencërisht metodat e përdorimit të metodave bërthamore në dobi të prodhimit.

— Ja katër fenomene të fizikës ku bazohen ato; në përdorimin e izotopeve me cilësinë e gjurmuesve radioak-

tivë ose të atomeve të shënuara. Ë dyta: në ndryshimin që pëson rrezatimi duke depërtuar nëpër lëndë. E treta: në ndryshimin që pëson lënda nga depërtimi i rrezatimit. Dhe, e fundit, në shfrytëzimin e formave të ndryshme të aktivitetit të induktuar.

— Shumë saktë i thatël — thirri pedagogu, asistent Petriti, me një ton sikur propozonte t'u jepeshin fund pyetjeve. Mirëpo asnjeri nga anëtarët e komisionit nuk iu përgjigj mendimit të tij për ta mbyllur.

Rrezarti vazhdoi të ilustronte me shembuj praktikë përdorimin e dobinë e tyre në fusha të ndryshme të industrisë, pa lënë pas dore disa shpjegime rreth përdorimit të izotopeve radioaktive në shërimin e ca lloje tumoreve në klinikat e spitaleve të vendit.

— Mendoj se mjaftoni! — tha profesor Koti me zë të ulët me një tonacion të zymtë.

— Kam edhe diçka për të thënël — tha kandidati diplomat dhe papritur nisi të fliste po me atë ton e po me atë siguri. — Nëpërmjet rrezatimit kozmik që vjen në Tokën tonë, një ditë shkenca do të arrijë zgjidhjen e anës praktike të projektit të tyre në ekranin telekozmik. — Këtë emërtim e sajoi ai vetë aty për aty dhe, kur vuri re përshtypjen që bëri në auditor, ai shpuri buzën në gaz. E mori me mend që vizitorët do të çlodheshin nga shpjegimet e tij fantastiko-shkencore. — Atëherë ne mund të kemi mundësi të shohim si në pëllëmbë të dorës proceset e ngjarjet që ndodhin edhe në trupat qiellorë të galaktikave të largëta të universit. Gjithashtu mund të arrijmë nëpërmjet ligjit fizik të optikës që rrezja që reflektohet nga Toka jonë në trupat e tjerë qiellorë të kthehet, ose më mirë të kapet përsëri nga telekozmiku dhe ne do të shohim si të gjallë zhvillimin e jetës sonë nga koha e dardanëve, pellazgëve, llirëve dhe më vonë.

Në sallë shpërtheu ilaritet dhe të qeshura. Usta Sala thirri nga vendi:

— Kjo qenka mrekulli! Do të pakam gjyshin e gjyshen! Eh, sa më ka marrë malli për ta!...

Përsëri vizitorët e studentët dhe ca anëtarë të komisionit nisën të qeshnin. Profesor Koti, i tulatur, u vrenjt në

fytyrë dhe ia hodhi vështrimin tërë mllif asistente Sofijes.

Sekretarja e mori me mend se çfarë bluante profesor Koti. Ajo uli kokën dhe bënte sikur diç regjistronte në procesverbalin që po mbante. Tanimë nuk kishte dyshim për çoroditjen dhe ligësinë e profesor Kotit që sipas saj vinte pikërisht nga tërë ato koncepte të gabuara që kishte ai për shkencën dhe përgjithësisht për zhvillimin e shoqërisë së re socialiste në kushtet historike e materiale të kombit shqiptar. Mbrojtja e diplomës së Rrezart Detit dhe tërë reagimet e pedagogëve të tjerë dhe të vizitorëve, deri tek ato ndërhyrjet me lezet të shokëve të tij të fabrikës, jo vetëm ia kishin grisur maskën profesor Kotit, por nga ana tjetër ajo e ndiente veten si të liruar nga tërë ato mendime të zymta e të turbullta të transmetuara nga ai pikë për pikë. Dhe ajo atë çast tha me vete: «Pika e ujit e shpon gurin.» Iu kujtua atë çast gryka e malit të Pëllumbasit ku ujët e lumi të Erzenit prej disa miliona vjetësh e kishte shpuar shkëmbin, si tunel dhe dilte përtëj luginave të bukura e të bleruara deri në rrjedhën e tij te Bishti i Pallës në Durrës. Ajo kishte qenë në një piknik para dy javësh me kolektivin e administratës së fakultetit te liqeni i troftave prapa malit të Pëllumbasit, në grykën e të cilit, duke i dhënë lehtësi natyra, ishte ndërtuar një hidrocentral me pesëfishin e atij të Selitës. Ky piknik i kishte lënë mbresë. «Pikat e ujit e shpojnë gurin vërtet, por kjo varet nga përbajtja që kanë!» — qeshi ajo hidhur duke menduar me vete tërë atë kohë të humbur nën ndikimin e dërdëllitjeve të veshura me varak të profesor Kotit.

— I japim fund! — tha sikur fliste me vetveten profesor Koti. Kryetari i komisionit u ngrit në këmbë. Hoqi syzet dhe i vendosi mbi tavolinë. Pastaj vështroi me radhë anëtarët e komisionit që e miratonin me lëvizjet e kokës. I hodhi një shikim edhe profesor Kotit që rrinte ashtu si në fillim i humbur brenda guaskës së tij. «Si njeriu në këllëf i Çehovit», — mendoi atë çast ai. Dhe, me një pamje që shprehte gëzim e kënaqësi të papërbajtur tha:

— Rezart Deti e mbrojti diplomën e fizikanit me notën shkëlqyeshmë. Ai diplomohet fizikan i Universitetit Shtetëror të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. I uroj-

më suksese në punën e tij fisnike në dobi të shoqërisë e të Atdheut të shtrenjtë e të dashur socialist.

Pastaj ai nën duartrokitjet që shpërthyen në sallë ia zgjati dorën fizikanit të ri të lauruar dhe me një buzëqeshje të përzemërt e dashamirëse e përqafoi shqiptarçë. Rrezarti, si u shkëput nga kryetari, ua dha dorën me radhë edhe anëtarëve të tjerë të komisionit. Kur preku dorën e profesor Kotit, iu duk se në dejet e tij nuk lëvrinte fare gjak, e ftohtë si dora e një të vdekuri. Laboranti fizikan u ngrit nga vendi i tij dhe, si e zuri nga krahu Rrezartin, diç deshi të thoshte, por shokët e fabrikës duartrokisnin dhe uronin me zë shokun e tyre të diplomuar. Kur po zbriste nga podiumi i ngritur tri shkallë nga dyshemeja e auditorit, ai qëndroi para tyrezës së sekretares dhe me një buzëqeshje të lodhur përshtëndeti asistente Sofijen me kokë dhe i tha me zë të ulët:

— Të falem nderit!

- Urime, Rrezart, dhe paç lumturi e suksese në jetë!
— ia ktheu ajo dhe, si vështroi një hop nga ai, belbëzoi:
— Më fal, Rrezart!

Fizikani i ri i hodhi një shikim plot keqardhje dhe, i tërhequr nga shenjat që ia bënин shokët e fabrikës, nuk pati më kohë t'i përgjigjej. Nga pas dëgjoi zërin e saj: «Të paraqitet kandidatja Mimika Shuferi!» Një vajzë e hollë, e zbehëtë në fytyrë, si të ishte pa gjak, parakaloi në krahun e tij të majtë duke hedhur hapin në shkallët e podiumit. Ajo uroi shokun e lauruar:

— Urime, Rrezart Deti!

— Së shpejti në kokën tënde! — qeshi Rrezarti dhe u nis të dilte jashtë nga auditori. Në hollin e fakultetit atë e rrethuan shokët e fabrikës. Ata ia shtrëngonin me radhë dorën, e përqafonin dhe i uronin suksese. Sekretari i partisë, drejtori i fabrikës, dhe usta Sala i hidhni romuze pas që e kishte zënë nga krahu Merita. Rrezarti mbeti si i shushatur kur pa nënën me Meritën që diç bisëdonin të gëzuara sikur të kishin ndonjë miqësi të vjetër. E ëma hapi krahët dhe ai tërë emocione, sikur të ishte i vogël, uturr drejt saj dhe e pushtoi në gjoksin e tij të gjërë. Pas-

taj u shqit prej s'ëmës e qëndroi një hop përballë Meritës. Ia shtrëngoi dorën. Atë çast ndjeu një të shtyrë nga prapa dhe ai bëri ashtu si edhe me shokët e tjerë të punës, e përqafoi Meritën.

Merita e kuptoi gjendjen e tij dhe pakëz si e turpëruar tha:

— Rrezart, të uroj nga zemra përlaurimin... — Zëri i saj dridhej dhe ajo e ndjeu se midis tyre ishte përtërirë dashuria, një dashuri e sinqertë, e zjarrtë.

— E kisha thënë unë që ky qerratuc do të bëhet njeri i madh, shkencëtar! — thirri usta Sala duke iu drejtuar nënës së Rrezartit që rrinte si e shushatur nga gjëzimet e asaj dite të paharruar.

— Kështu siç jeni dua të më vini sonte në shtëpil — tha nëna e Rrezartit kur pa se shokët e të birit u bënë gati të largoheshin.

— Do ta lagim që ç'ke me të! — ia pati usta Sala. — Dhe ruhu se mos ftohesh nga unë, more vesh! Se, çfarëdo që të bëhesh, unë jam ustai yt i parë.

Shokët qeshën. Ata i premtuan nënës së Rrezartit se do t'i shkonin në mbrëmje në shtëpi për urime. Dhe, sa-kaq, me radhë edhe një herë u shtrënguan dorën Rrezartit dhe nënës së tij duke u lënë lamtumirën.

Rrezarti, Merita dhe nëna mbetën vetëm. Ata ecën bulevardit një copë rrugë pa hapur gojën. Kur arritën në sheshin «Skënderbej», papritmas e ëma qëndroi dhe u tha të dyve:

— Meqë jam kaq pranë shtëpisë, do t'i bëj një vizitë motrës sime. Mirupafshim! — dhe, si pëershëndeti me kokë, u largua. — Merita, të pres për darkë, bijë. Po munde, eja pak më parë të më ndihmosh...

Rrezarti dhe Merita vështruan njëri-tjetrin një copë herë aty në buzë të trotuarit nën shtyllën metalike me fjongo neon sipër.

— Sot qenka një ditë e mrekullueshme me dielli! — tha Rrezarti.

Merita i buzëqeshi. Pastaj i tha befas:

— Bëjmë një shëtitje? Ke nevojë të çlodhesh!

— Propozim i shkëlqyeshëm!

- Nga tē vemi?
- Shkojmë nga liqeni? – e pyeti Rrezarti, i kthyer nga ajo.
- Ku tē duash!
- Nisemil – dhe pa thënë gjë ia futi krahun.

Ajo deshi tē thoshte diçka, por një turmë nxënësish tē shoqëruar nga një mësuese e moshuar hynë në rrethin e tyre. Dhe Rrezarti nisi ta shtrëngonte më fort nga krahu që tē mos shkëputeshin nga përplasjet e lehta me fëmi-jët që iknin si me vrap duke qeshur e duke luajtur me njëri -tjetrin.

- Zbresim parkut! – tha Rrezarti.
- Të thashë njëherë, nga tē duash.
- Kam për tē tē thënë shumë gjëra, Merita!

Ajo heshti. Dhe ashtu për krahu përshkuani parkun me pisha deti derisa iu ngjitën kodrës së pyllëzuar. Rrezarti nuk ia lëshonte krahus. Dhe Merita nuk kundërshtoi më siç tentoi në fillim. Liqeni midis kodrave me vreshtha, rrethuar nga e majta me pallate, dukej si pasqyrë.

- Ulemi atje tek ajo lëndina nën mimozat? – e pyeti Rrezarti.
- Ku, tek ai stoli i fshehur? Rrimë më mirë në barin e butë, ashtu shesh. E kam qejf natyrën.
- Mirë.

Ata hynë nën mimozat e shpeshta që kishin lëshuar degët deri në tokë dhe u shtrinë përballë njëri-tjetrit.

- Nuk tē thashë se këtu është bukur? – e pyeti Rrezarti.
- Shumë bukur është.
- Merita, a është nevoja tē bëjmë sqarime?
- Nuk është nevoja fare.
- Flasin ndjenjat!
- Ashtu është. Pastaj tek unë ka ardhur Sofija dhe m'i ka thënë tē gjitha.
- Me ty ka biseduar Sofija? – pyeti i habitur Rrezarti.
- Ajo në thelb ishte vajzë e mirë dhe e sinqertë. Bile me mua u tregua shumë e hapët dhe e çiltër.

— Atë e kishte turbulluar ndikimi i personalitetit shkencor të profesor Kotit.

— Edhe për atë më foli.

— Duket se është penduar! — tha Rrezi. — Sot ajo u tregua jo vetëm dashamirëse me mua, por më dha të kup-toj se ishte çliruar nga ato konceptet filozofike të huaja që ia kishin trazuar shpirtin.

— E lëmë Sofijen dhe profesor Kotin! — qeshi Merita dhe me buzën pakëz të hapur e vështroi Rrezartin si dikur kur jepeshin në krahët e njëri-tjetrit në zjarrin e dashurisë.

— Merita! — bëlbëzoi Rrezarti. — Unë të kam dashruar gjithmonë dhe të dashuroj si diellin, ajrin e ujin! — tha ai dhe zgjati dorën nga qafa e saj. — Do të martohemi, Merita! Kam nevojë për një shoqe trime dhe të besës.

— Martohemi! — qeshi ajo dhe e vështroi në sy e përdëllyer. Ai u zgjat nga ajo dhe afroi buzët e tij me të sajat. E puthi me dashuri dhe më një ndjenjë të ngrontë besnikërie të patundur.

— Të dy bashkë, Merita, do të çajmë pa frikë në dallgët e jetës, do të dimë të fluturojmë shtigjeve dhe majave të shkencës.

— Do të fluturojmë! — qeshi përsëri ajo.

— Ti je e mrekullueshme, Merita! — i tha Rrezarti dhe më një ndjenjë dashurie që ia digjte kraharonin si prush, ai e përfshiu me krahët e tij të fuqishëm dhe qëndruan ashtu një copë herë mbi barin e gjelbër e të butë si sfun-gjer...

KAPITULLI XII

Pas diplomimit si fizikan, Rrezarti u emërua nga Akademia e Shkencave punonjës shkencor në Laboratorin Bërtamor D 6 në një nga qytetet bregdetarë më të bukur të vendit. Atë e caktuan në grupin e punës të eksperimentimeve të metodave bërtamore në teknikë. Midis punonjësve të kësaj bërtame, siç e quanin atë në laborator, ishte më i riu. Rrezarti ishte në dijeni të debatit midis profesor Kotit dhe shefit të sektorit eksperimental të laboratorit, fizikan Buron Gurrës. Sipas mendimit të profesor Kotit në rrethet shkencore akademike duhej të vinin njerëz më flokë të thinjur, me përvojë e personalitet në fushën e shkencës. Kurse profesor Buroni e argumentonte emërimin e tij duke treguar shembuj edhe nga fizikanët e vjetër klasikë që nisnin nga Njutoni deri tek Ajnshtajni, të cilët zbulimet e tyre në fushën e fizikës i bënë në moshë të rinisë. Ai e miratonte atë mendim shkencor zyrtar që në institucionë shkencore duheshin pranuar punonjës shkencorë me moshë të re që kishin mbaruar fakultetet me diploma ari, njerëz të talentuar e të apasionuar për atë degë shkencë, ose puno-

njës shkencorë që gjatë punës studimore kishin kryer punime të shquara në punimet e diplomës dhe premtimin përnjë të ardhme të krijimtarisë së tyre. Profesor Buron Gurra e pranonte tezën se në rrethet shkencore akademike mund të vinin punonjës të moshuar që kishin treguar gjatë jetës së tyre me vepra se ishin krijues, të cilët mund të sillnin përvojën e tyre në institucionet kërkimore e shkencore akademike. Pas një diskutimi në katedër ku kishin marrë pjesë edhe shefat e sektorëve të Laboratorit Bërthamor D 6 të dozimetrisë dhe radiokimisë i ishte bërë propozim Komitetit të Partisë për aprovimin e Rrezartit fizikan në atë laborator.

Rrezarti jo vetëm në punën e diplomës gjatë disa eksperimenteve të përdorimit të metodave bërthamore në teknikë kishte treguar aftësi shkencore, intuitë e talent, por tanimë ishte i njojur edhe në interpretimin e hollë që i bënte ai fizikës klasike nëpërmjet teorisë relativiste të krijuar nga Ajnshtajni si dhe të argumentimit të saj nëpërmjet filozofisë dhe dialektikës materialiste marksiste-leniniste.

Erdhi edhe dita që ai saldatori fizikan të hynte në portën e Laboratorit Bërthamor të Akademisë së Shkencave. Atë mëngjes me diell dhe me qiell të kthjellët si kristal, fizikani i ri mori çantën nën sjetull dhe u nis buzës së detit, rrugës së asfaltuar për në Laboratorin Bërthamor D6.

Xha Sadiku hapi derën e kabinës së rojës dhe doli nga deriçka para portës. Ngriti grushtin mbi kokë dhe buzagaz tha:

— Mirë se erdhe!

— Të thashë se do të kthehem! — ia ktheu me të qershura Rrezarti.

— I mora vesh të gjithal! — iu përgjigj roja që prej disa javësh ishte miqësuar me Rrezartin kur ai vinte në laborator për punët e diplomës. Xha Sadiku hiqej se çdo gjë që ndodhte në rrethet e laboratorit e merrte vesh.

— Ka ardhur shefi? — pyeti Rrezarti dhe bëri përparrë duke kapërcyer pragun e derës së Laboratorit Bërthamor.

— Jo akoma! — iu përgjigji xha Sadiku dhe zgjati dorën dhe e zuri nga çanta. Nuk më the kur do të shkojmë tek ai miku im në fshatin e Qafëmalit?

- Do tē vemi pas një muaji.
- E pse jo më shpejt? Ai më ka dërguar haber dhe na pret tashti para se tē mbarohet rrushi.
- Sepse do tē martohem.
- Me tē vërtetë do tē martohesh?
- E pse tē mos martohem? – qeshi Rrezarti.
- Paska pér tē t'i marrë mendtë fare! E ku ia ka nge-në shkencëtarë tē merret me gruan? – u gajas xha Sadiku kur vuri re habinë e fizikanit tē ri.
- I ke tē huajtura apo nga xhepi yt?
- E pse, si më kujton ti mua se nuk i njoh njerëzit?

Si shpejt më duket...

- E kur tē martohem, kur tē bëhem dyzet vjeç?
- Falemnderit, xha Sadik.
- Meqë e ke vendosur, tē trashëgohesh!
- Hajt pra, paç këmbën e mbarë e faqe tē bardhël – e uroi xha Sadiku fizikanin e ri që nisi tē largohej oborrit me lule drejt hyrjes së godinës së laboratorit bërthamor.

Rrezarti ishte i njojur me ambientet e laboratorit. Por, kur po u ngjitej shkallëve shtruar me linoleum pér në katin e parë ku ishin sallat e grupit tē punës tē eksperimentimeve, ai ndjeu sikur po i rëndohej hapi. Mbi supet e tij tanë mbante peshën e përgjegjësisë së shkencëtarit. Hapi derën dhe hyri brenda.

– Mirëmëngjes! – tha ai duke iu drejtuar gjithë shokëve tē grupit tē punës. Secili bënte përllogaritjet e rezultateve tē eksperimenteve tē ditës së kaluar.

– Ou... érdhi «saldatori fizikan»! – tha laboranti fizikan.

– Mirëmëngjes! – tha me zë tē ulët duke ngritur kokën një fizikan i dózimetrisë.

Rrezarti e vështroi atë djalosh tē pispillosur me një-farë vrejtjeje tē veçantë. Ai ishte një ndër shokët e afërt tē asistente Sofijes dhe kohët e fundit Rrezarti kishte vënë re që është e kishin trashur miqësinë. Një natë, kur po shkonte tē gjuante peshk, i kishte parë tē dy ulur në një tryezë duke pirë birrë në lulishten «Kurora e pishës».

Radiokimisti që mërrej me trajtimin kimik tē përgatitjeve tē solucioneve me lëndë radioaktive ktheu kokën dhe i buzëqeshi me përzemërsi pa nxjerrë fjalë nga goja.

— Ja, ajo është tryeza jote! — ia bëri me dorë Petriti i kthyer nga ai pa lëvizur nga karrigia.

Rrezarti përshkoi sallën e gjatë që ishte një pesmbëdhjetë metra, tërë dritare që bënin dritë në të gjitha tryezat e punës të eksperimentuesve fizikanë bërthamorë. Aty ku mbaronte tryeza, në qoshe të murit, ishte vendosur një raft. Ai zuri vend në tryezën e tij të punës dhe atë çast ia përçoi tërë qenien ndjenja e përgjegjësisë. «Erdha deri këtu, por e rëndësishme është që ta mëritoj e ta mbaj vete. Hapi sirtarin e madh dhe nxori një dosje me letër shkrimi. Disa prej tyre ishin të milimetruara. Me stilografin e tij të ri që ia kishte dhuruar Merita atë mbrëmje që mbrojti diplomën shkroi me germa shtypi: «Rrezart Deti. Ditari i rezultateve shkencore të eksperimenteve.» Atë çast ia behu Petriti. Pastaj, si i vuri dorën miqësisht në sup dhe i makinë shkrimi, i tha:

— Rrezart, derisa të vijë profesori, po të dëshirosh, njihu me programin e punës të eksperimenteve që synon laboratori ynë në fushën e mundësive të përdorimit të rrezzitimeve bërthamore e izotopeve radioaktive.

Rrezarti nisi të lexonte me vëmendje. Në këtë program pune shkencore edhe ai në një radhë me punonjësit shkencorë në fushën e fizikës kishte detyrat e tij. Më tepër i tërhoqën vëmendjen synimet në zbatimin e metodave bërthamore në disa sfera të rëndësishme të prodhimit, siç ishin ato për një shfrytëzim më racional të puseve të naftës të gërshtuara me tërë programin e punës së kërkimeve gjeologjike, të përsosjes së teknikës së shfrytëzimit dhe të vendosjes së teknologjisë së përpunimit të produkteve të naftës në baza shkencore etj. Në fushën e industriës kimike aplikimi i metodave ekspres të analizave që do të kryhen në disa sekonda dhe me saktësi shkencore do të japë mundësinë e zbulimeve të rezervave të mëdha dhe të rritjes së rendimenteve të prodhimit të tyre... Kur nisi të lexonte kapitullin e studimeve hidrogjeologjike e veçanërisht përdorimin e metodave bërthamore në përsosjen e cilësisë së projektive hidroteknike si hidrocentralat e

njëpasnjëshme mbi lumin Drin e lumenjtë e tjera të vendit, ai bëri disa shënime në bllokun e vet. Në aplikimet shkencore të gjurmuesve radioaktivë për të kontrolluar fil-trimin e ujërave nëpër digat gjigante të ndërtuara e që po ndërtohen, sendimentologjia bërthamore që studion lëvizjen e rërërave, llumrave e gurëve të fundit të detrave ishte eksperimentuar me sukses në vendin tonë ku kishte nisur punimet për projektimin e një porti të madh në shkallën e skelave mesdhetare si dhe të porteve të tjera ekzistuese. Atij i tërroqën vëmendjen programet shkencore edhe në fushën e radioparazitologjisë në krijimin e vaksinave kundër qimzës, sëmundje e dëmshme për gjënë e gjallë e të tjera... Aty kishte edhe përdorime të metodave radioaktive në fushën e gjeologjisë dhe të kulturës. Për mbrojtjen e shëndetit të popullit dhe konkretnisht për metodat radioaktive në mjekësi flitej në një kapitull të veçantë. Në këtë program të shkencëtarëve të fizikës bërthamore ishte vënë theksi edhe për studimet e perspektivës së energjitetës bërthamore...

Rrezarti, duke lexuar këtë program pune të zhvillimit të shkencave bërthamore që i propozohet Akademisë së Shkencave, bluanë me mendjen e tij punën e madhe e menaum që ata kishin përpara, përpjekjet që duhet të bënin për të përvetësuar këto disiplina shkencore, organizimin dhe kooperimin për një bashkëpunim të ngushtë me qendrat e prodhimit e të ekonomisë dhe e merrte me mend luftën që duhej të bëhej kundër vështirësive dhe aty-këtu kundër shfaqjeve të huaja frenuese. Por ai e ndiente thellë në ndërgjegje se çelësi për të ecur në shfigjet e shkencave ishte përvetësimi nga të gjithë i filozofisë dhe i dialektikës materialiste të sintetizuara në ideologjinë e Partisë. Ai zotohej me vete se do të ndiqte hap pas hapi vijën e Partisë në shkencë dhe kjo ndjenjë e mbushte me besim e optimizëm.

— Erdhi profesori! — tha njëri nga shokët.

Rrezarti ktheu kokën dhe pa profesor Buronin që po vinte drejt tij. Atë e shoqëronte inxhinier Artan Shkëmbi.

— Tungjatjeta, profesor! — e përshtëndeti Rrezarti profesorin që i zgjati dorën.

— Të uroj suksese në detyrën e re dhe shëndet! — tha profesori.

E përshëndeti dhe inxhinier Artani.

— Do të bashkëpunojmë bashkë, më tha profesori, — tha ai.

— Me gjithë qejf.

— Atëherë fizikan Rrezarti me grupin e tij do të vijë në fabrikën e cimentos ashtu siç u vendos në Ministri? — pyeti inxhinier Artani sikur donte të sigurohej që profesori nuk e ndryshonte afatin e nisjes në Elbasan.

— Po, po! — ia priti profesori. — Ia kam dhënë fjalën ministrit. Dikasteri po na jep një ndihmë të madhe për ta realizuar eksperimentin. Po tani për tani do ta mbajmë Rrezartin në laborator, se kemi ca eksperimente urgjente.

Profesor Buroni u ul pranë Rrezartit dhe, si nxori nga çanta një dosje të shkruar me dorë mbi ca të dhëna teorike në lidhje me eksperimentin në përdorimin e gjurmuesve radioaktivë e veçanërisht në lidhje me zajedhjen e llojeve më të përshtatshme të izotopeve radioaktive, nisi të jepte disa shpjegime shkencore. Rrezarti i bëri ca pyetje. Profesori i përgjigjej qetë e me dëshirë. Dukej se ata të dy merreshin vesh fare mirë.

Në mbrëmje Rrezarti, u kthye në shtëpi i lodhur, por i kënaqur. Si pushoi pak, doli nga shtëpia dhe shkoi të takohet me Meritën. Atë mbrëmje ata kishin vendosur të bënin banjë në det, megjithëse uji ishte i freskët. Kishin marrë me vete edhe peshqirë që, sapo të dilnin nga uji, të fshiheshin menjëherë. Si bënë not deri te fuçia që ishte njëqind metra larg bregut, u kthyen pranë e pranë njërit-tjetrit duke notuar herë not krol, herë duke u kthyer prapta. Pastaj, si u veshën, vajtën të hanin darkën në restorantin «Peshkatari». Morën kocë të fërguar dhe dy gotaverë. Klinetët ishin rralluar dhe ata e ndienin veten lirshëm.

— Kam kërkuar në Komitetin Ekzekutiv të Lagjes zgjerrim, — tha Rrezarti. Pse ta ngushtojmë nënën?

— Nëna jote është shumë e mirë.

— Ajo të do shumë!

— E pse të mos më dojë? — pyeti ajo buzëqeshur. —

Jam nusja e djalit të vetëm dhe unë do të sillem mirë gjithë jetën. Nënët duhen respektuar. Na kanë bërë kokën.

Edhe unë do t'i dua babanë dhe vëllanë tënd, — i tha Rezzi.

— Ah, sa nënë të dashur që kam pasur! — pëshpëriti e pikëlluar Merita.

Rezarti ia shtrëngoi dorën me dhembshuri, u zgjat pakëz nga ajo dhe ia puthi flokët.

— Merita, kam një dashuri të madhe dhe dua të të kem gjithnjë pranë.

— Unë do të kujdesem për ty.

— Do të më frymëzosh? — qeshi ai.

— Nuk e di... Por, për një gjë jam e sigurt, që nuk do të të pengoj currë të ecësh përpara.

— Merita, a e di se njeriu i vërtetë nuk mund të rrojë denjësisht pa punën krijuese dhe pa dashurinë e pastëri si kristali?

Ajo heshti një hop, pastaj tha:

— Vemi nesër mbrëma në teatër të shohim premierën «Dashuria e madhe»

— Shkojmë.

Si bënë një bisedë intime, u ngritën nga restoranti dhe vajtën e ndenjën një copë herë te stolat nën portokallet e lulishtes. Nata ishte e bukur. Ata kishin shumë gjëra për të biseduar bashkë...



Erdhi dita që Rrezarti të nisej në fabrikën e cimentos për të vënë në jetë metodën e gjurmimit radioaktiv në furrat rrotulluese. I tërë projekti i zbatimit tanimë ishte në pëllimbë të dorës, por megjithatë rezultatet yareshin nga puna dhe mirëkuptimi i specialistëve dhe punëtorëve të fabrikës.

Tërë shokët e grupit të punës po merreshin me përgatitjet e aparaturave dhe të materialeve të tjera që u du heshin me vete për të zhvilluar eksperimentin. Profesor Bu-

roni akoma nuk kishte ardhur në laborator. Rrezarti, Petriti dhe Artani, ai i radiokimisë, nisën të sillnin në mikrobus sendet që i kishin ambalazhuar nëpër kuti prej kartoni dhe në ca arka të vogla prej kompensate. Shoferi u ndihmonte që t'i sistemonin në bagazhin e makinës.

— Ende s'i ka dalë gjumi mjeshtrit, — qeshi Petroja.

— Jo, ore, atij i del gjumi apo nisin gjelat të këndojojnë,

— ia pati Artani i radiokimisë, një burrë ky i hollë, që, kur ecte, dukej sikur po e merrete era. — Ai tani duhet të jetë kthyer nga shëtitja në kopshtin botanik dhe ka nisur të psonisë nëpër dyqanet e qumshtit e të mishit.

— Ja ku po vjen! — tha Rrezarti që hodhi atë çast sytë nga hyrja e laboratorit dhe ndoqi një copë herë profesor Buronin që diç bisedonte me rojën, xha Sadikun.

Petroja, asistenti laborant që i njihet mirë zakonet e Gurrës, si hodhi në makinë dedektorin, ktheu kokën prapa dhe tha:

— Me siguri po i heq vërejtjen që ka lejuar të këputen lulet. Atij i vjen plasja kur shikon që dikush ia këput lulet nga kopshti.

— Lulet edhe duhet të këputen! — ia ktheu radiokimisti duke ngritur vetullat hark me një pamje pakëz të habitur.

— Duhen lulet për në kopsht, për në saksi, por edhe përt'ua dërguar të fejuarave, — dhe ia shkeli syrin Rrezartit.

— Po të marrë vesh se dikush lulet e kopshtit të laboratorit ia ka dërguar dashnores, ai bën kiametin, — tha laboranti fizikan.

Rrezarti u skuq në fytyrë si spec. Xha Sadiku i kishte dhuruar një buketë me lule të freskëta dhe nuk ishte hera e parë që ai e bënte këtë. Merita ishte mahnitur nga bururia e ngjyrave dhe nga aroma e trëndafilave, veçanërisht e karafilave.

— Hë, djema, jeni gati? — thirri profesori dhe u hodhi një sy aparaturave të ambalazhuara. — Mos harruat gjë-kafshë? — pyeti ai duke u kthyer nga Rrezarti.

— Të gjitha i kemi marrë, profesor! — u përgjigj Rrezarti.

— Sapo të marr ca dosje, u ktheva, — tha profesori duke iu ngjitur shkallëve të laboratorit.

— Në mëngjes mjeshtri është i freskët dhe i gjallë si

fëmijë, — tha asistenti i tij, Petriti, që ia njihte mirë huqet. Por, kur dielli hipën në zenit, profesori plogështohet dhe nuk i bëjnë këmbët.

— Mos ia qaj hallet profesorit, — ia pati shoferi që deri atë kohë nuk e kishte hapur gojën. — Ai e ka shpirtin të ri. Në vend që të qahet bualli, qahet qerrja, — shtoi ai dhe, pa pritur përgjigjen e fizikanëve, ia hipi makinës dhe vuri duart në timon.

I tërë grupi i ekspeditës kishte zënë vend në mikrobus dhe secili, i kredhur në mendimet e veta, priste që të vinte profesor Buroni. Shoferi mbushte dokumentet e udhëtimit duke shkruar me laps kopjativ emrat e udhëtarëve.

Dikush po trokiste me çokën e dorës në xhamin e dritarës së makinës. Rrezarti ktheu kokën dhe pa xha Sadikun që ishte afruar aty pranë pa u vënë re. Roja babaxhan ia bënte me shenjë që të zbriste nga makina, se diç kishte për t'i thënë.

— Hë, xha Sadik? — e pyeti Rrezarti.

— Dëgjo! Të dielën që shkoi erdhi tek unë ai miku im nga Qafëmali... Na pret! Qysh kur i kam folur për ty, atij i është ngritur mendja. Prandaj më premto se do të shkojmë tek ata gurët që lëshojnë rreze.

— Do të vij patjetër! — i tha Rrezarti me një pamje serioze që nuk linte më dyshim. Kur pa profesorin që po dilte nga dera e laboratorit në oborr, ai u nda nga roja dhe hipi shpejt në mikrobus. Hipi dhe profesor Buroni me çantë në dorë. Ia bëri me dorë shoferit që të niseshin.

*

*

*

Mikrobusi i boshatisur qëndroi para godinës së dreitorisë. Automjeti me lëndë radioaktive u ndal në një shesh të vogël të veçuar anash administratës. Kur u hap dera e makinës, u dëgjuat një zhurmë e pandërpërre që përhapej në tërë atë ambient. Ishte një zhurmim i mbytur, që shkaktohej nga rrötullimi i furrës së gjatë mbi një-

qind metra që vërtitej mbi ingranazhet e mëdha tërë dhëmbë të iyer me graso e vaj dhe nga mullinjtë me sfera çeliku që bluanin pa pushim si miell klinkerin e pjekur në temperaturatë larta. «Ja këtu prodhohet buka e ndërtimit», — tha Rrezarti me vete dhe u ngjit shkallëve të godinës së drejtorisë fill pas profesor Buronit. Hynë në laboratorin e fabrikës. Aty ishin ulur rreth një tryeze të gjatë disa specialistë të fabrikës. Në krye të tryezës qëndronte drejtori me një pamje që Rrezartit iu duk pakëz fudulle. «Ndonështë ka pamjen», — tha me vete Rrezarti. Ai u ngrit në këmbë dhe ia zgjati dorën miqësisht profesorit e pastaj të gjithëve me radhë.

— E, shoku Rrezart! — i tha drejtori i fabrikës me një ton shoqëror sikur të njiheshin prej kohësh. — Do të na e bëni furren transparente që të shohim me sytë tanë se çfarë ndodh aty brenda? — qeshi ai dhe, i kthyer nga fizikani i ri, shtoi: — Të shohim lavën e vullkanit se si pëqet dhe si rrjedh gjatë tubit të blinduar nga metali dhe tullat zjarrduruese.

— Furrës suaj do t'i bëjmë radioskopil —u hodh Rrezarti. — Dhe ata «mjekët» tuaj teknologë t'i japin ilaçet e duhura.

Drejtori rrudhi buzët dhe qëndroi një hop si i shastisur, duke mos e kuptuar menjëherë humorin e fizikanit.

— Ju qenkeni dhe hokatar! — tha ai duke buzëqeshur.

Profesor Buroni, që e vuri re hutimin e drejtorit, ndërhyri duke treguar me dorë nga maketi i furrës rrotulluese të cimentos që kishin përpara në tryezë:

— Fillojmë! — tha ai. — Rrezi, tani e keni fjalën ju!

Rrezarti u tregoi shokëve të grupit të studimeve shkencore të fabrikës disa nga karakteristikat më kryesore të aparaturës, me të cilën do të zhvillonin eksperimentin. Bërrthama shkencore e fabrikës kishte hartuar një program pune të gjerë pesëvjeçar për progresin teknik të prodhimit që përbëlidhej në disa drejtime kryesore: në përsosjen e teknologjisë dhe vënien e saj në baza shkencore; në rritjen e rendimentit të prodhimit; në mekanizimin e automatizimin e proceseve të linjave të prodhimit; në krimin e kushteve lehtësuese dhe mbrojtjen e shëndetit

konform standarteve të përparuara ndërkombejtare e të tjerë tregues tekniko-ekonomikë. Këto synime të bërthamës shkencore të fabrikës së cimentos ishin përgjithësisht të njëjtë me ato të bërthamave shkencore në fabrikat e tjera të cimentos të vendit. Pothuajse në çdo rreth ku kishte me bollëk lëndë të parë shkëmbinj gëlqerorë, ishin ndërtuar fabrika cimentoje. Në bërthamën e kësaj fabrike ishin dymbëdhjetë punonjës, por për detyrën e eksperimentit radioaktiv kryeinshinieri kishte ngarkuar vetëm pesë prej tyre që kryen operacione teknologjike në përgatitjen e recepturës së materialit dhe në pjekjen e klinkerit në furrë. Dy prej tyre ishin pjesë me përvojë në tipat e rinjtë furrave rrotulluese të cimentos.

— E përse duhet të vendosen dedektorët kaq ngjitur me furrën? — pyeti mjeshtri që i mbahej ca goja dhe «s»-ënë e shqiptonte «sh».

— E kuptoj se ku e keni hallin! — shpuri buzën në gaz Rrezarti. — Ju ia keni frikën furrës që nuk ftohet njëlloj në çdo centimetër katorr në zonën e pjekjes, ngaqë tullat zjarrduruese janë konsumuar diku më pak e diku më shumë. Por eksperimenti ynë e kérkon këtë, sepse rezet që penetrojnë veshjen zjarrduruese dhe blindazhin metalik të furrës lypset të thithen nga dedektorët me intensitetin e tyre të saktë. E, pra, ju teknologët duhet të operoni me anën e shtimit të dushit me ujë të ftohtë në vendet më delikate.

— E, pasi të përfundojmë eksperimentin radioaktiv, ju të fabrikës lypset të operoni për të shpejtuar rrotullimet e furrës për minutë dhe eventualisht zgjerimin e zonës së zinxhirëve. Me shpejtimin e ecjes teknologjike të klinkerit në furrën rrotulluese, do të rritet rendimenti i prodhimit të saj, — ndërhyri profesori.

Rrezarti vuri re me bisht të syrit një tendosje të nervit në ballin e lartë të drejtorit të fabrikës.

— Kjo është puna jonë, profesor! — u përgjigj ai pasi u mendua pak.

— Jo, shoku drejtor. Kjo është puna e të dy palëve kontraktuese, e institucionit shkencor, që kryen studimin e eksperimentimin, dhe e qendrës së prodhimit, që është e

detyruar ta vërë në jetë dhe të vjelë rezultatet e punës shkencore. Ndryshe te ne s'kë se si të bëhet shkenca efikase dhe e dobishme për ekonominë socialiste.

Profesori i tha këto fjalë me një ton të qetë e të natyrshëm dhe ndenji një copë herë.

— Keni të drejtë! — u përgjigj pas një ngurrimi drejtori i fabrikës.

Rezart Deti shikonte sa njërin e sa tjetrin, duke shtrydhur mendjen të depërtonte përtëj rrudhave të ballit të profesorit dhe drejtorit të fabrikës që i kishte picërruar sytë sikur të mos kishte fjetur disa net. «Këtu është thembra e Akilit, — tha ai me mendje. — Mendimi shkencor zien gjithandej. Bëhen studime shkencore dhe projektohen në bazë të tyre objekte pas objektesh, Hartohen plane në letër. Puna qëndron se si të vihen në jetë. Dhe të zbatuarit e disciplinave shkencore në çdo fushë të industrisë e të bujqësisë është një shkencë dhe art më vete». Pastaj atij i vajti mendja te jeta personale që bënte profesori. Kohën më të madhe ai e kalonte nëpër laboratore, në sallat e bibliotekës së Universitetit, në mbledhjet e katedrës, në leksionet e auditorit dhe nëpër sesionet shkencore. Nuk mungonin edhe ftesat për të marrë pjesë në konferencat ndërkombëtare që bëheshin në lëmin e fizikës bërthamore. E, mbi të gjitha, profesori merrte piesë edhe në grupet e punës eksperimentale në fabrika. E shoqja, e mësuar me jetën e tij, kur qëllonte që dilnin së bashku në shëtitje ose shkonin në teatër, qëzohej pa masë, si fëmijë. Dy djemtë e tij që kishtin dalë në jetë, njëri mësues fizkulture dhe tjetri arkeolog, në të rrallë takoheshin me të atin, sikur të ishin my-safirë në atë shtëpi. Këto hollësi Rrezarti i kishte mësuar nga shoferi i mikrobusit, nga ai djaloshi fjalëbok që dukej si mundës e kishte një aftësi të çuditshme të mësonte mbi jetën personale të njerëzve. Bile shoferi i kishte folur me hollësi Rrezartit edhe mbi jetën intime të Bethovenit e të Napoleon Bonapartit.

Pas një heshtjeje drejtori, duke vënë njëren dorë në supin e laborantit fizikan me vështrimin ngulitur profesorit, tha:

— Për ne punonjësit e fabrikës së cimentos ka qenë

ëndërr të përcaktonim saktësisht shpejtësinë e ecjes së materialit në çdo zonë të furrës rrotulluese.

– Atëherë s'kemi ç'presim, nisim nga prova! – tha profesor Buroni. Ai mori kapelen republikë nga tryesa dhe me dorën tjeter çantën dhe u ngrit. Pas tij dolën me radhë nga laboratori shokët e grupit të punës. Në fytyrat e tyre vihej re një tendosje nervash sikur po shkonin në betejë. Rezarti ndiente emocione, se e dinte që dështimi i këtij eksperimenti në praktikë do të shkaktonte një çoroditje në radhët e punëtorëve që e prisnin me ankth prej kohësh këtë eksperiment. Ata kishin bërë propozime të vyera për zgjemin e nyjeve të ngushta në procesin e prodhimit, gjë që hapte rrugën për shtimin e kapacitetit ekzistues të fabrikës me ca shtesa e investime të vogla të leverdishme ekonomikisht.

KAPITULLI XIII

Fizikanët, të ndihmuar nga specialistët e fabrikës, punonin si në ethe. Ditën e dytë ata pothuajse i montuan aparatet në vendet e caktuara. Nëpër mbajtëse metalike u vendosën nga dy dedektorë për çdo zonë të furrës. Pastaj u shtrinë kabllo që lidhnin dedektorët me aparatin e regjistrimit të rrezatimit. Në sheshin e furrës, një njëzet metra larg nga vendi i punës, u ndërtua enkas një kabinë me pllaka fibre. Nga ana e furrës u vendos një xham katër me tre që lejonte eksperimentuesin të shikonte tërë vendin e punës. Rrezarti punonte në montimin e aparaturës, por edhe u jepte udhëzime shokëve për t'i vendosur gjérat sa më mirë teknikisht. Profesor Buroni ditën e dytë u largua nga fabrika për një kryeqytet me makinën e transportit të lëndëve radioaktive. Ai duhej të merrte pjesë në një takim që bëhej në Laboratorin Bërthamor D6 me një fizikan që vinte i dërguar nga organizata ndërkombëtare e Uneskos mbi problemet e studimit të lëvizjes së rërërave të fundit të detrave sipas një marrëveshjeje që ishte nënshkruar një

vit më parë midis dy palëve. Rrezarti e përçolli profesorin deri në të dalë të fabrikës.

— Do të kthehem pasnesër! — i tha profesori pasi shkëmbjen edhe ca mendime rreth zbatimit të eksperimentit në praktikën e fabrikës.

— Mirë ardhsh! — iu përgjigj fizikani i ri. Si ia shtrëngoi dorën miqësisht profesorit, ai doli nga ana tjetër e kabinës së makinës dhe i dha një letër shoferit për Meritën me porosi që t'ia dorëzonte në vendrojën e filiales së Institutit të Studimeve Mekanike.

— Mos u bëj merak! — tha shoferi. — Do ta shpie letra. — Rrezarti qëndroi disa sekonda te hyrja e fabrikës derisa makina mori kthesën nga rruga kryesore. Pastaj u kthye në sheshin para furrës. Te kabina ku ishte montuar aparati i regjistrimeve të rrezatimit ishin grumbulluar ca punëtorë që vështronin me kureshtje akrepat e heshtur mbi rrulin e letrës së milimetruar. Ata, kur panë fizikanin, i hapën rrugë. Njëri prej tyre, një muratori i furrës, me ca sy të zinj me vetulla të trasha e mustaqe i tha:

— O shoku fizikan! Nuk më mbushet mendja se ajo rreza jote mund të përshkojë atë mur të trashë që kam ndërtuar me duart e mia përqark atij cilindri metalik dhe të vijë deri këtu te ky aparat.

Rrezarti ktheu kokën nga ai dhe me një buzëqeshje të çiltër iu përgjigj:

— Ajo rreze e padukshme që lëshon izotopi radioaktiv sa një aspirinë, penetron edhe një plakë çeliku pesë-dhjetë centimetra.

— Hë... po ajo aspirinë, kur të bjerë në kontakt me lavën vullkanike që ka një nxehësi prej një mijë e gjashtë-qind gradë celsius, do të shkatërrrohet pa nam e pa nishan, — tha muratori mustaqezi.

— Ai izotopi radioaktiv Lantan 140 i duron temperaturat më të larta sesa ai klinkeri juaj, — qeshi Rrezarti duke i rënë me pëllëmbë në sup muratorit.

— E kësaj i thonë shkencë, ore vëllezërl — ia pati ai duke çuar dorën te mustaqja.

Njëri nga ata u hodh:

— Po qenka me rreziqe kjo punë! Ai izotopi juaj do të bluhet bashkë me çimenton dhe mjerë ata ustallarë që do të punojnë betonin... do të vriten nga rrezja e padukshme, — dhe, kur e tha atë fjalën e fundit fytyra e tij mori një shprehje të pezmatuar.

— Mos u bëj merak! — ia ktheu asistent Petriti që po merrej me lidhjen e ca fijeve që hynin në aparat. — Koha e përgjysmimit të këtij izotopi merr fund brenda tri ditëve. Kështu që ai pushon së emetuarri rreze.

— Kur të mbarojmë eksperimentin, do të bëjmë një session të vogël shkencor me tërë punëtorët e fabrikës, — tha Rrezarti, — dhe do të shpjegojmë me hollësi tërë këto të panjohura.

— Tani na lini rehat! — thirri inxhinieri teknolog i fabrikës me një ton miqësor që të mos i fyente njerëzit kur reshtarë që vështronin.

Pas pushimit të mëngjesit tërë aparatura ishte gati. Laboranti fizikan i veshur me ca rroba speciale antiradioaktive mori kapsulën prej plumbi të depozituar në një raft xhami të laboratorit dhe u nis i veçuar për te hyrja e furrës që vërtitej vazhdimisht si dollap kafeje i stërmadh. Materiali i bluar, i quillët si pelte, derdhei në gojën e furrës. Ai hapi kapsulën e plumbtë dhe zgjati dorën. Tableta si aspirinë me lëndën radioaktive brenda ra në vorbullën e shlicherit. Zinxhirët e montuar te muret e cilindrit metalik zhurmonin pa ndërprerje si një traktor në rrugën me kalldrëm. Petriti hodhi edhe një herë vështrimin nga qulli që përpri tabletën radioaktive që nisi të shtyhej drejt furrës rrotulluese. Ai tha me vete: «Çimento. Pallatet e lumburisë njerëzore dhe Mbrojtja e Atdheut të shtrenjtë e të dashur socialist.» Pastaj u tërroq nga vendi ku hodhi izotopin radioaktiv. Kur erdhë para sprucatorëve të qomyrit pluhur, vështroi vorbullën e zezë që, sapo ndeshej me zjarrin, shndërrrohej në ngjyrë të kuqe, si grimca lulëkuqesh që i vërtit cikloni i një ere të tërbuar.

Rrezarti kishte shtypur butonin që komandonte tërë sistemin e lidhjeve të dedektorëve që varesin si llambaneon mbi furrën cilindër. Nga xhami i kabinës vështron-

jashtë cilindrin e zi metalik që vërtitej nga fuqia e elektromotorëve që e shndërronin trymën elektrike në energji mekanike. Aty përqark nuk dukej këmbë njeriu.

«Nisi eksperimentil» — tha ai me vete. Inxhinieri teknolog dhe ai specialisti pjekës me përvojë që qëndronin prapa tij në kabinë me sytë ngulur në aparat prisnin me ankth nëse do të fillonin të lëviznin akrepat.

— Po ecën gjurmuesi radioaktiv! — tha ai me një ton ngazellëyes i kërrusur mbi aparatin regjistrues të atyre rrezeve të padukshme që ishin aq të ndjeshme.

— Kaloi në zonën e parangrohjes! — belbëzoi laboranti fizikan.

— Këtu po ecën më shpejt! — tha Rrezarti pa ua shqitur sytë akrepave. — Hë, inxhinier, mos u habit! Ja, për pak orë do të të japim në pëllëmbë të dorës çfarë ndodh brenda në atë tank të blinduar. Ja, në zonën e zinxhirëve shlikeri ecën pesëmbëdhjetë metra në minutë.

— Bobo! — tha inxhinieri dhe zuri kokën me të dyja duart. — Kjo është shpejtësi breshke. Këtu duhet të kemi dyfishin e kësaj ecuriel

— A mud të operosh përtarritur? — e pyeti laboranti fizikan.

— Po si jo! — tha ai befas dhe u largua menjëherë nga kabina.

— Mos iu afro furrës! — i thiri nga prapa Rrezarti.

Inxhinieri teknolog vajti të mekanikët në një kthinë. Rrezarti ndiqte lëvizjen e tij dhe të dy mekanikëve që e shqëronin me ca çelësa nëpër duar. Ai diç u thoshte me duar e me këmbë. Mekanikët lëshuan pesë zinxhirë që qëndronin të mbledhur në kanxhat ngjitur tamburës. Pastaj u larguan. Inxhinieri teknolog duke kthyer kokën herë pas here nga goja e stërmadhe e furrës erdhi përsëri në kabinë.

— Errita dyfish sipërfaqen e zinxhirëvel — tha ai.

— Atëherë kjo i përgjigjet dyfish rritjes së shpejtësisë, — iu përgjigj Rrezarti pa ua hequr sytë akrepave që shënonin rrezatimin në zonën e pjekjes.

— Edhe këtu materiali ecën ngadalë, — tha Rrezarti.

— Është krijuar skorie rreth tubit! — tha pjekësi. — Aha... tani atë fytin e saj të qelbëzuar ia hap unë! — qeshi ai me njëfarë zemërimi. Doli nga kabina dhe vajti te zjarrtarët që operonin hedhjen e lëndës djegëse si gjyryk në gojën me dhëmbë të zinj të furrës. Ai u dha udhëzime shokëve të tij që të zgjasnin gjuhën e lavës së kuqe dy metra më tutje derisa ta shkrinte atë skorien që i ishte veshur furrës.

Më në fund Rrezarti kishte përllogaritur të gjitha shpejtësitet e ecjes të materialit në furre e gjatë rrotulluese dhe rezultatet e këtij parametri teknologjik tanimë ishin në pëllëmbën e dorës të teknologut dhe të punëtorëve që operonin proceset e saj. Laboranti fizikan rikontrollonte përllogaritjet që kishte bërë fizikani i ri dhe, duke miratuar me kokë, thirri:

— Të lumtë! Nuk ka asnjë gabim.

Inxhinieri teknolog kokë më kokë me mjeshtrit e prodhimit bënë planet se si të shpejtonin dy xhiro në minutë më shumë, të shtonin edhe katër zinxhirë të tjera në zonën e transportit të shlicherit dhe të rrisin flakën dy metra më tutje. Të gjithë u vunë në lëvizje. Shpejtësia e ecjes mesatare të furrës u rrit në shkallën e saj optimale. Klinkeri që doli brenda orës ishte njëzet e pësë për qind më shumë se katër orë përpara. Reparti i bluarjes vuri në shfrytëzim edhe mullirin e tretë që mbahej në gatishmëri.

Në kabinë erdhi edhe drejtori i fabrikës. Ai kishte marrë një pamje krenare duke harruar fare dyshimet që kishte ca orë më parë.

— U lumtë shkencëtarëve! — thirri ai dhe, duke ua shtrënguar me radhë dorën fizikanëve, shtoi: — Ky është revolucion në fabrikat e çimentos.

Rrezarti foli në telefon me profesor Buronin. Ai i tregoi mbi rezultatin e eksperimentit radioaktiv dhe mbi vënien në jetë të operimeve teknologjike.

Profesori e uroi Rrezartin për suksesin dhe i tha që t'u jepte të fala edhe shokëve të fabrikës. Pastaj shtoi me një ton plot dashamirësi:

— Alo, alo! A dëgjon, Rrezart! Dikush na ndërpreeu.

– Prit edhe ca, shoqja centraliste! – htoi: – Jam shumë e
ri me një zë të zgjatur.

– Tani dëgjoj mirë, profesor! – u përgjigji i në-koduke e shtypur veshin me receptorin e telefonit. „koll-

– Të dielën, Rrezart, të fton ime shoqe për drekë! Të vish me gjithë atë Meritën, me të fejuarën tënde de? Si? Do të vish patjetër! More vesh!

– Të falem nderit, të falem nderit, profesor! I bëni të fala bashkëshortes suaj! – i tha me zë të ulët Rrezarti dhe la ngadalë receptorin.

KAPITULLI XIV

Asistentja e katedrës, Sofija, një kopje të informacionit që jepte Rrezart Deti mbi zhvillimet me sukses të metodave radioaktive në industrinë e çimentos dhe për përgatitjen e zbatimit të atomeve të shënuara në furrënalat e metalurgjisë e të gjurmuesve radioaktivë në kontrollin e digave të hidrocentraleve e vuri në dosje për t'ia dërguar profesor Kotit në shtëpi. Profesori prëj disa ditësh nuk dilte në punë, as në katedrën e fakultetit dhe as edhe në laborator. Ankohej nga një dhimbje e fortë veshkash dhe kurohej me ca barna popullere.

Ajo mori çantën nën sqetull dhe doli nga fakulteti për t'i bërë një vizitë në shtëpi profesorit. Gjysmë ore më parë i telefonoi Zanës që po nisej tek ata. Aty te porta e shtëpisë së profesorit qëndroi një copë herë e kredhur në një mendim pikëllues për profesorin. Ishte mësuar kaq vite si sekretare e asistente e tij, por tani i dukej njeri fare i huaj. Pas pak u hap dera dhe ia behu Zana.

— Sa mirë bëre që erdhe! — i tha ajo dhe, kur po

zgjaste dorën për tâ përshëndetur, shtoi: — Jam shumë e mërzitur, Sofijel

Mysafirja, me një buzëqeshje të hidhur, duke ecur me një hap të shkurtër e me gjunjët si të thyer, hyri në korridor. Ato të dyja u ulën përkundrejt njëra-tjetrës në kolltukët e veshur me lëkurë të butë.

— Si është profesori? — pyeti Sofija.

— Ja, — tregoi Zana me dorë nga kthina ngjitur ku ai kishte kabinetin e tij të punës, — tërë ditën deri në orët e vona të natës gru i mbyllur duke eksperimentuar teleskopin e tij kozmik. Shkruan orë të tëra në bllok dhe pastaj i kyç ato në sirtar. Me mua rrallëherë këmbe ndonjë bisedë rreth punëve të shtëpisë. Dhe, asgjë tjetër.

— Po kur të martohesh ti? — tha befas Sofija duke i ternerhequr fjalët zvarrë. — Si do t'i vejë halli profesorit?

Zana pas një muaji kishte vendosur të martohej.

— Hë, moj Sofije... largimi im nuk e shqetëson atë. Ndoshta mund të sjellë ndonjë ndryshim të ri në jetën e tij.

— Ti e hoqe qafe atë nëpunësin e bezdisshëm, Misi Vangjon, por ai ka nisur të më vardiset mua. Më ka ardhur dy herë për vizitë në shtëpi. Babai nuk e duron fare, bile herën e fundit gati ishte duke e përzënë.

Sofija e vështroi në sy shoqen për të parë efektin që do të bënin fjalët e saj të ciltra.

— Dëgjo! — i tha befas Zana dhe zgjati dorën miqësishët në prehrin e shoqes — Ky bandill i pështirë vjen pothuajse çdo muaj edhe tek im atë, megjithëse unë ia kam thënë haptazë që të mos mbajë shpresë as edhe një mijë vjet. Këtë ai e di mirë dhe ka hëqur dorë nga ky pretendim. Kurse me tim atë mbyllen me orë të tëra në kabinetin e tij dhe seçillomotisin, as unë nuk e di.

— Më duket se ai është njëri i helmatisur! — tha si e menduar Sofija. — Kurse unë jam treguar mendjelehtë dhe fare indiferente ndaj sjelljeve të tij si ndaj meje, ashtu edhe ndaj profesorit. Atij nu i përkasin fare tërë këto ndërrhyrje që bën rreth problemeve mësimore dhe provimeve të studentëve.

— Nuk thua keq!

– Duhet shporrur ai njeri nga shtëpitë tonë! – ngriti zërin Sofija me një ton zemërimi.

– Çfarë ke në atë dosje? – pyeti Zana kur mysafirja nxori nga çanta tërë ato letra të lidhura dhe ia vuri përparrë në tryezë.

– Janë dorëshkrimet e profesorit rrëth tekstit të ri të fizikës bërthamore që ia ka kthyer Shtëpia Botuese. Këtu ka edhe një recension të këshillit shkencor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës për disa vërejtje esenciale në kuptimin filozofik.

– Pra ia kanë refuzuar botimin? – pyeti e bija.

– Ja se çfarë shkruhet në letrën zyrtare shoqëruese, – tha Sofija duke nxjerrë nga dosja shkresën për t'i a treguar shoqes së vet.

Zana lexoi rreshtat e fundit që ia tregonte me gisht marksiste dhe në materializmin dialektik. Përshkohet nga një frysë idealiste, metafizike. Për këtë arsyen është i pa-

ndier një zagushi në shpirt.

– Flitet në rrethet e fakultetit... se nuk i ka punët mirë, – tha Sofija.

– E ç'mund të bëj unë e gjora? A kam unë aq ndikim mbi atë sa të ndryshoj karakterin e tij hermetik? – Zana me një pamje të trishtuar u ngrit nga kolltuku dhe vajti të lajmëronte të atin për vizitën e asistente Sofijes. Kur hapi derën, i ati u hodh përpjetë si i zënë në befasi. Ishte kërrusur mbi aparatet e tij në errësirën e dhomës të myllur me grila. Vetëm një llambë e vogël elektrike lëshonte një rreze të zbehtë.

– Ka ardhur Sofija! – i tha ajo pa e lëshuar nga dora dorezën e derës, të pranuar me argjend.

– Uh..., – nxori ai ashtu papritmas një pasthirrmë. – Ja, sa të mbaroj këtë punë që kam në dorë, do ta thë-U kërrus përsëri mbi aparatin e tij me ca llamba e lenta konkave të futura në një tub qelqi.

– Zana tërhoqi derën dhe e la përsëri të vetmuar, të

zhytur në studimet e tij. Ajo u kthye te mysafirja është i tha se duhej të priste, pasi profesori ishte i zënë.

— Po shkoj vetë në kabinetin e profesorit! — tha befas Sofija.

— Mirë e mendove, — qeshi Zana. Ajo e dinte se asistentja kishte njëfarë familjariteti me të atin, pasi punonin në katedër prej vjetësh. Dhe profesori deri ca kohë përparrë ushtronte një ndikim absolut mbi jetën dhe konceptet e asistente's së tij. Këtë e kishte vënë re mirë edhe Zana në disa takime. I ati ia kishte lavdëruar Sofijen duke e karakterizuar të urtë e të bindur si manare. Por ja që edhe kjo «manare» nuk po ecte më në gjurmët e fizikanit të çoroditur.

Sofija trokiti dy a tri herë me çokë në derën që ishte në fund të korridorit. Nga brenda nuk po përgjigjej njeri. Atëherë sekretarja e hapi derën me ngadalë dhe hyri në kabinet pa u dëgjuar, si hije. Qëndroi anash profesorit që ishte zhytur mbi teleskopin kozmik që e quante shpikjen e tij origjinale. Ai kishte imazhin se kapte rrezet kozmike që vinin në Tokë nga trupat qiellorë të galaktikave të largëta. Diç belbëzonte me vete.

— Profesor! — thirri asistentja me atë ton që përdorte prej vitesh kur hynte në zyrën e tij për ta njoftuar përdicë. — Jam unë, Sofija. Ju kam sjellë një dosje dhe ca relacione nga katedra. Tungjatjeta!

— Ah... Ju qenkeni! — u hodh ai dhe bëri një dy hapa drejt saj. Pastaj qëndroi fëre pranë saj me sytë e shqyer.

— Si jeni, profesor? — e pyeti ajo me mirësjellje.

— Mirë... mirë..., — qeshi ai si me vete. Dhe, si ia zgjati dorën asistentes së tij që shpeshherë i thoshte «bija ime», i tha: — Ulunil!

— Ju kam sjellë një dosje! — tha Sofija dhe ia vuri materialin përparrë.

Profesori shtypi butoni n e abazhurit dhe drita e fortë e tij ra si projektor mbi letrat e shkruara. Ai nisi të lexonte përgjigjen që i dërgonte Shtëpia Botuese. Pastaj informacionin e shkurtër që kishte dëguar në katedër fizikani i ri Rrezart Deti. Dhe ajo që i tërhoqi vëmendjen në atë informacion ishte njoftimi mbi eksperimentin që do të bëhej

me gjurmues radioaktivë në digën e Hidrocentralit nr. 5, në krahun e majtë të së cilës dyshohej se filtronte uji. Ai e dinte se për këtë shkak kishte plasur një sherr i madh midis projektuesve dhe zbatuesve të veprës dhe çështja kishte shkuar deri në qeveri. Dhe ata që do të ndanin shapin nga shegeri do të ishin fizikanët. Por atë çast ai tha me vete: «Nuk e realizojnë kurrë ata këtë eksperiment të vështirë. Kësaj here do t'u plasë bomba në duar.»

— Ja, kështu ma punuan! — tha ai më në fund duke iu drejtuar asistentes që rrinte përkundrejt tij si mumje.

— Fajin e keni ju, profesor! — belbëzoi Sofija.

Profesor Koti u trondit nga mendimi që tha sekretarja e tij. Zëri i saj që dridhej iu duk sikur vinte kushedi sa larg Në kabinet atë çast hyri edhe e bija me filxhanin e kafes në dorë. Ajo ia vuri kafen përpëra. Zana e dëgjoi përgjigjen e Sofijës dhe, duke qëndruar në këmbë pranë saj, po vështronte ngulmas të atin që vazhdonte të rrinte i heshtur pa ditur se çfarë të thoshte. Dukej qarfe pamja e tij e tronditur dhe në mëdyshje.

— Paskam marrë fund! — belbëzoi me sytë përtokë Dionis Koti.

Zanës i pikëllói në zemër për gjendjen e rëndë shpirterore të të atit që dukej sikur po rrëzohej në një humnërrë. Dhe i erdhì keq.

— Baba! — thirri ajo e shqetësuar. — Edhe mua shpesh nuk më janë dukur të drejta mendimet e tua për rrugën që duhet të ndjekë shkenca jonë. Duhen ndryshuar mendimet, baba...

— Edhe ti? — e pyeti ai të bijën.

— Po. Këtë ta thotë haptazi bija jote e vetme dhe e dashur që ke në këtë jetë. Se ajo ta do të mirën.

Profesori u lëshua në karrige i drobítur shpirterisht e fizikisht. Ndenji ashtu një copë herë dhe, si e mblođhi veten, ngriti sytë e lodhur nga asistentja e tij që rrinte gjithnjë e ngrirë pa ia shqitur vështrimin.

— Profesor! — tha Sofija befas. — Unë i lexova vërejtjet dhe tekstin tuaj me vëmendje të veçantë. Kapitujt e shkencës bërthamore në tekstin tuaj janë me të vërtetë të

mbuluar nga një mjegull e filozofisë idealiste. Bile edhe unë duhet të pastrohem mirë nga ky infekzion.

— Me sa po kuptoj unë..., — belbëzoi ai me një fije zëri, — ju keni rënë në kurthin e atij djaloshi të çartur, Rrezart Deti. Ai ju ka folur kundër meje!

Koti i mbante sytë ulur dhe dukej sikur fliste me figurat gjeometrike të sikhadesë persiane që kishte nën këmbë.

— Baba, duhet të mbledhësh veten! — tha me një ton zemërimi Zana. — Rrezart Deti është një nga ata mijëra të rinj me vullnet e talent që vjen drejtëpërdrejt nga klasa punëtore. Dhe, ja tek po ta them unë, jot bijë, që ai fizikan i ri me mendimet dhe rrugën që ndjek për zhvillimin e shkencës së fizikës zbaton vijën e Partisë në shkencë.

— Kurse ai miku që na keni prezantuar ju, profesor Misi Vangjoja, i cili herë i vardiset Zanës dhe herë muq, është njeri i dyshimtë.

— Është me dy faqe! — ia priti befas Zana.

— Ai është edhe intrigant! — plotësoi Sofija. — Atë e kanë demaskuar rëndë dy ditë përpara. Doli se ka shpër-doruar pozitën zyrtare duke gënjer se gjoja ishte mendimi i katedrés që t'i ndërrohej tema e diplomës kandidatit Rrezart Deti. Dhe, pasi u diplomua, ishte po Misi Vangjoja që kishte thënë se filiali i Akademisë nuk është dakord që ky fizikan praktik të emërohet në Laboratorin Bërrhamor D6.

Koti, i tkurrur në karrigen e tij, me sytë gjysmë të mbyllur nën syzet, rrinte i heshtur dhe fjalët e së bijës dhe të asistentes i dukeshin si thika në zemër. Fytyra i qe tre-tur e zbehur nga llifi. Me mendjen e tij bluante lloj-lloj mendimesh që binin në kundërshtim me njëri-tjetrin. Por mendimi se ai po merrej me shkencën e rezatimit kozmik dhe se leksionet e dhëna përgjithësisht si pedagog për kapitujt e fizikës klasike kohët e fundit edhe për fizikën bërrhamore, e bënte që të mos hiqte dorë nga e tija. Si e kuptoi që ishte e kotë të fliste më gjatë me të bijën dhe asistenten, ngriti pakëz sytë nga ato dhe tha:

Ju falem nderit për këshillat. Mund të largoheni!

Kam nevojë për vetmi! — Pastaj rrrotulloi sytë e çakërdisur dhe bëri sikur po lexonte diçka mbi një enciklopedi fizike hapur aty mbi tryezë.

— Baba! — thirri Zana, e fyer që i ati po e dëbonte nga kabineti i tij. — Ti vetë më ke treguar që dikur, në ko-hën e luftës kundër pushtuesit nazist gjerman, kundërshtoje qëndrimin indiferent të babait tënd, mjek i spitalit civil që nuk pranonte të mjekonte ilegalët dhe partizanët. Tani...

Profesori nuk nxori më asnjë fjalë. Zana dhe Sofija, si kryqëzuan një çast vështrimet, dolën nga dhoma e tij. Ai ndezi një cigare dhe nisi të pinte kafen e ftohur...

KAPITULLI XV

Në oborrin e Laboratorit Bërthamor D6 kishte lëvizje të madhe. Fusha e volejbollit ishte kthyer në një aero-drom të vogël. Dy manovratorët hynin e dilnin në helikopterin që shembellente në mes atij kopshti të lulëzuar si një gaforre e madhe. Xha Sadiku qëndronte në cep të portës dhe herë pas here nderonte me grusht punonjësit shkencorë që vinin për të filluar punën e ditës së re. Pastaj erdhi një teknik i elektronikës me një bicikletë të kthyer me vetë forcat e tij në motoçikletë. Roja e qortoi duke tundur grushtin në ajër, sepse ai ecte me shpejtësi të madhe. Fill pas motoçikletës u duk mikrobusi bojë portokalli që ia behu pa zhurmë para laboratorit. Grupi i eksperimentuesve, të udhëhequr nga fizikani Rrezart Deti, zbritën nga automjeti. Me ata ishin edhe dy vajza, njëren nga të cilat xha Sadiku nuk e njihte. Kurse mjeken Zana Ervini ai e shihte herë pas here kur vinte me automjetin special për të marrë kobaltin radioaktiv, me të cilin bombardonin tumoret.

— Mirëmëngjes, xha Sadik!, — e nderoi më parë me grusht Rrezarti.

— Mirëmëngjes! — u përgjigj roja me buzën në gaz. Ai deshi të thoshte diçka, por fizikani i ri i ra në sup miqësish dhe i tha:

— E di çfarë do të thuash! Nuk kam harruar. Sapo të kthehem nga Hidrocentrali Nr. 5, do të vemi në fshatin tënd.

— Epo mirë, — qeshi xha Sadiku, dhe vështroi vajzën përkrah tij.

— Është e fejuara ime, Merita, për të cilën të kam folur, — i tha Rrezarti që e mori me mend se çfarë bluanë si.

Xha Sadiku ia zgjati dorën vajzës dhe e uroi:

— Të trashëgoheni! Kalofshi jetë të lumtur e me nder!

— Të falem nderit, xha Sadik, — ia ktheu Merita sikur të njihej shumë kohë më parë me të.

— Paske ditur të zgjedhësh, ore Rreza e Padukshmel

— qeshi xha Sadiku. — E paske të bukur nga fytyra e të bukur nga shpirti, — tha ai.

— More, po qenke poet til! — ia plasi gazit Rrezarti.

Xha Sadiku e dinte se grupi i punës shkonte për të bërë eksperimente me gjurmues radioaktivë për të verifi-kuar nëse filtron apo nuk filtron diga gjigante mbi lumen Drin. Ai ishte i lidhur ngushtë me shokët shkencëtarë. Si komunist merrete pjesë në mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë ku bisedohej haptazi dhe ku drejtohej e tërë kjo punë shkencore. Në këto mbledhje ai tregohej i pjekur dhe kurrë nuk fliste gjëra të pamatura.

Merita dhe Zana, të zëna për krahu, diç bisedonin e qeshnin me njëra-tjetrën, kurse laboranti fizikan dhe radiokimisti kishin arritur pranë makinës me helikë mbi kokë dhe po bisedonin miqësish me pilotin e parë.

— E, djema, — u thirri fizikani i ri me buzën në gaz. — A jeni gati?

— Aparaturat i vendosëm brenda, — tha njëri nga punonjësit e laboratorit, një teknik që merrej me ruajtjen e tyre.

Piloti hapi krahët dhe me një pamje të qetë, duke rrë-

tulluar sytë nga vajzat që sodisnin helikopterin, u hodh e tha:

- Si shqiponjë do të fluturojë atje mbi Drin.
- Shqiponjë me fletë çeliku! — ia ktheu Merita.
Rrezarti shpuri buzën në gaz.

Merita dhe Zana u ulën në një stol aty në anë të fu-
shës ku niste brezi i luleve. Ato kishin ardhur të përcillnin
të fejuarit e tyre.

Rrezarti dhe radiokimisti u nisen për në laborator për
të marrë lëndën radioaktive që u duhej për eksperimentin.

— Ka ardhur profesori? — pyeti Rrezarti një shokun e
dozimetrisë në të hyrë të shkallëve.

- Është lart në korridor! — u përgjigj ai.

Rrezarti dhe radiokimisti u ngjitën në katin e parë.
Në fund të korridorit profesor Buroni dhe shefi i sektorit
diç bisedonin me zë të ulët para kabinetit të radiokimisë.

— Mirëmëngjes, profesor! — tha Rrezarti duke e vësh-
truar me vëmendje.

- Mirëmëngjes!
- Mbrëmë është hapur dera e radiokimisë — tha she-
fi me fytyrë të ngrysur duke parë me kujdes bravën e zhdy-
llosur.

— E kush e ka hapur? — pyeti befas radiokimisti me
sytë e shqyer nga habia.
Profesori rrudhi supet, pastaj urdhëroi:

— Largohuni që këtu. Ti, shoku Saimir, — iu drejtua
ai shefit të radiokimisë, — qëndro në krye të korridorit dhe
mos lejo asnje nga punonjësit të futet nëpër kabinetet
derisa të kthehem unë. — Pastaj ia bëri me shenjë Rrezar-
tit që ta ndiqte nga pas. Zbritën në katin e poshtëm dhe
hynë në zyrën e administratës. Një shoqe u ngrit nga
karrigia në shenjë respekti.

— Ju lutemi, shoqja Ermira, a mund të na lini dy mi-
nuta vetëm. Kemi një telefon me rëndësi! — Ajo pak e
habitur rrudhi buzët e vogla dhe u largua pa thënë asnje
fjalë.

Profesori iu drejtua Rrezartit:

— Është e dyta avari e rëndë që po na ndodh në
laborator brenda tre muajve.

Rrezartit iu bë nyje në fyt kur mori me mend se çfarë domethënje kishin fjalët e profesorit.

Pas një heshtjeje të trishtuar iu drejtua profesorit:

- Duhet të bashkëpunojmë me shokët e Sigurimit!
- Atë them edhe unë.
- Bile pa vonesë.

Profesori mori receptorin në dorë dhe u ra katër numrave rresht, dy të parët ishin përsëritje, kurse dy të dytët ndërronin nga njëri-tjetri.

- Alo... Alo... Jam profesor Buron Gurra në Laboratorin Bërthamor D6. Desha të bisedoj me shokun Behar Stralla. Po pres.... Ju jeni, Behar? Tungjatjeta! Kemi një ngjarje në laborator dhe desha të vinit këtu mundësish mundësish menjëherë. Hollësirat jua tregoj kur të vini këtu. Mirë? Falemnderit. Po. Me mua është këtu pranë telefonit vetëm fizikani Rrezart Deti.. Mirë ardhsh!

Profesori dhe Rrezarti dolën në oborr. Rrezarti u largua një copë herë nga ai dhe vajti te Merita dhe Zana; të ulura aty te stoli pranë helikopterit. Ai u tha vajzave që duhej të largoheshin, se fluturimi do të vonohej së paku edhe një orë. Rrezarti u përpooq të tregohej i qetë që ato të mos kuptionin asgjë nga ajo që kishte ndodhur në laboratori.

Operativi i Sigurimit erdhi në çast.

- Shkojmë në zyrën time? - i tha Buroni me t'u përshtendetur. Behari e ndoqi profesorin pa thënë asnjë fjalë. Pas tyre vajtën edhe Rrezarti me Petritin. Profesor Gurra nisi të tregonte se çfarë kishte ndodhur. Operativi shënonë në bllokun e tij.

- A është ndotur me rrezatim radioaktiv korridori? - pyeti Behari me një pamje fare të qetë.

- Solucioni radioaktiv është me dozë të vogël. Në korridor nuk ka gjurmë...

- Në dhomën e radiokimisë hyj unë! - tha me ton të vendosur Rrezarti.

- Do të futemi bashkë, u hodh operativi.

- Atëherë shkojmë në garderobë, - tha Rrezarti dhe u ngrit, duke mos lënë më vend që të ndërhyhej nga profesori.

Pas një copë here ai dhe operativi, të veshur me rrobat speciale antiradioaktive, siç i quanin fizikanët bërthamorë, qëndruan para derës së dhomës së radiokimisë, pastaj hynë brenda njëri pas tjetrit. Operativi e mbylli mëreth kabinetit. Çdo gjë dukej në vendin e vet. Pastaj fizikani i ri nxori nga xhepi i përparëses prej plumbi një stilodozimetër. Sipas shenjave që dha ai ambienti aty ishte plotësisht i ndotur nga rrezatimi radioaktiv. Operativi e kuptoi fare qartë nga lëvizja e duarve që bënte Rrezarti se aty në kabinet paraqitej rreziku i infektimit nga rrezja e padukshme që të asgjëson ngadalë, por pa mëshirë.

Rrezarti me sytë e ngulur mbi kapsulën e ngarkuar me solucion radioaktiv, vuri re se kapaku i saj qëndronte në zgrip. Ishte pakëz i hapur. Ai nisi të operonte me dometali dhe, si e lëvizi përpëra, e puthiti mirë mbi kapsulën e raftit, nxori jashtë kapsulën dhe e futi në një kuti plumbi të vendosur aty mbi tryezë. Operativi e dinte se duhej kopter pér t'u përdorur pér eksperimentin në digën e hidrocentralit mbi Drin. Ai po habitej me gjaktohtësinë dhe zotësinë e tij në fushën e shkencës bërthamore. Dhe ja tek takohet tani me të në kushtet e një avarie të rëndë.

Rrezarti tregonte me shenja se dikush e kishte nxjekishin rënë në dysheme. Kështu ishte ndotur ambienti me rrezatimin radioaktiv. «Ai që ka hyrë në kabinetin e radio-Përse ka hyrë? Duke derdhur pika solucioni mbi dysheme dhe duke mos e puthitur kapakun e kapsulës, ai ka vrakohësish vrasje dhe vetëvrasje. Kjo është një-vrasë veten?»

Operativi sillej rrötull tryezave. Dukej sikur kërkonte diçka të humbur. Pastaj iu afrua xhamit të raftit. U kërrus nën tryezën. U kthye nga Rrezarti që qëndronte në këmbë

me kapsulen radioaktive në dorë në anën tjetër të dhomës dhe i bëri shenjë që të afrohej. Dukej i gjuar nga gjestet që bënte sikur të kishte zbuluar ndonjë gjë me shumë rëndësi.

Rrezarti vuri re se Behari, pasi u afrua, mori një copë letër nga sirtari i tryezës dhe e përdori si lopatkë. Ka pi dy fije floku të bardha. E palosi letrën mirë e mirë dhe e futi në xhep. Rrezarti buzëqeshi plot kuptim nën maskën mbrojtëse.

I pari doli Behari dhe pas tij Rrezarti, që mbante në dorë kapsulen prej plumbi me solucion radioaktiv. Në kryët e shkallëve priste profesor Gurra dhe laboranti fizikan. Ata i hapën rrugë Rrezartit që shkoi tek helikopteri dhe, i ndihmuar nga piloti i parë, e vendosi kapsulen me lëndë radioaktive, që u duhej për eksperimentin, në një arkë plumbi në qoshe të makinës fluturake.

Rrezarti u kthyte përsëri në godinën e laboratorit. Hyri në banjën e dezinfektimit. Pastaj vajti në zyrën e profesor Buronit. Aty po priste edhe operativi i Sigurimit. Atë këmbyen disa mendime rreth ngjarjes.

— Dikush ka hyrë brenda fshehurazi dhe ka hapur kapsulen me solucion radioaktiv. Dy a tri pikë që kanë rënë në dysheme kanë ndotur ambientin. Kapaku është lënnë i paputhitur. Kjo është një punë armiqësore prej idiotil — qeshi hidhur Behari.

Rrezarti miratonte me kokë.

— Ky duhet të jetë i brendshëm! — u hodh profesoril — Atij iu kërleshën vetullat e trasha, vende-vende të thinjura. — Dhe, ma merr mendja se, po ai që ka hapur derën e bodrumit të akselaratorit, ka bërë edhe këtë aktin e dytë, — shtoi me një pamje që e tregonte tepër të mërzitur.

— Po si ta shpjegojmë? Njeriu i brendshëm e di që ky lloj veprimi rrezikon edhe jetën e tij, — foli me fjalë të shkoqura mirë Rrezarti.

— A gjetët ndonjë gjurmë? — pyeti me zë të ulët profesor Buroni.

— Dy fije floku! — tha Behari, në fytyrën e të cilit endej një buzëqeshje therëse.

— Ku i gjetët? — pyeti profesori dhe brofi në këmbë.

— Njëren fije në tryezë, kurse këtë tjetrën, — Behari e tregoi të palosur në gjysmën e letrës, — e gjeta varur në kllapat e raftit prej xhami.

Rezarti kishte dijeni për përdorimin e një metode radioaktive për fijet e flokut.

— E pra, — u hodh ai, — nëse vërtetohet se qimja në kllapën e raftit të xhamit është e së njëjtës kokë më atë fijen e gjetur në tryezë, nuk ka dyshim se tek ai njeri duhet vënë gishti.

— Ka edhe një metodë tjetër prove krahasuese, — tha befas Behari me sytë që i ndrisnin. — Ne do të analizojmë hollësisht se çfarë qëllimi kishte ai person.

— Bukur! — ia pati Rrezarti duke i rënë në sup miqësisht operativit të Sigurimit, sikur të ishin shokë të vjetër.

— E po ju vazhdoni kërkimet me metodat tuaja! — u hodh profesori. — Ne po nisemi për në Drin.

Behari u ngrit në këmbë dhe ia zgjati dorën profesorit. Duke ia shtrënguar miqësisht, i tha:

— Udhë e mbarë dhe dalçi faqebardhë!

Operativi hipë në veturë dhe makina ia shkeli nëpër oborrin me pllaka. Xha Sadiku si gjithnjë nderoi me grush-tin te koka.

Piloti i parë ua bënte me shenjë që të hipnin në helikopter. Ai qëndronte mbi timon dhe dukej i paduruar për t'u nisur sa më parë... Profesori dhe Rrezarti zunë vendet në stolat që u kishin lënë bosh shokët e tyre. Piloti i dytë tërhoqi shkallët dhe e mbylli derën me forcë. Pastaj i vuri një shul hekuri të madh nga brënda.

— Nisul — thirri ai.

Makina filloi të zhurmonte me ngadalë. Pas ca sekondash fletët e helikopterit e shtuan vërititjen rrëthore dhe zhurmimi bëhej gjithnjë më i fortë e monoton. Makina fluturuese nisi të ngjitej vertikalish dhe kjo vazhdoi një copë herë, ndoshta, sipas hamendjes së Rrezartit, nja dyqind metra, pastaj mori përpara.

* * *

Ajo ishte një nga digat më të mëdha të hidrocentralave të ndërtuara nga projektuesit tanë mbi lumin Drin. Në projektimin e saj ishin derdhur dwersa, mundi e talenti i një morie punonjësish shkencorë e specialistësh.

Rrezarti kishte qëndruar mbi digën e lartë dhe posodiste liqenin e krijuar nga dora e shqiptarit, hidhëtë vështrimin përtëj Alpeve, prapa të cilave niste fusha pa mbërrim. I shkonin nëpër mend copëza të historisë të mbushura me epikë, me hidhërimë, me tragjedira, e deri më rrënoja fshatash e qytetesh.

«Drin i lashtë, Drin i bukur, ja çfarë të bënë punëtorët dhe shkencëtarët e tokës sate, i kthyen valët e tua në rreze drite,» — tha me vete Rrezarti.

Ishte dita e dytë që kishin ardhur në Hidrocentralin mbi Drin. Dedektorët u montuan qysh ditën e parë, në dy pikat të rrezes së digës. Aparatin e regjistrimit të intensitetit të rezatimit të lidhur me dy kabllo të holla e vendosën në një shesh të ngritur në anën e djathë të digës, në një barakë që shërbente për punëtorët e mirëmbajtjes së rrugës.

Kur Rrezarti iu afroa vendit ku ishin vendosur aparatura, vuri re se midis shokëve të grupit eksperimentues kishin ardhur edhe drejtori e kryeinshinieri i hidrocentralit. Ata diç po bisedonin me profesor Buronin që nuk e lëshonte çantën nga dora. Me laborantin fizikan dhe radiokimistin po bisedonin edhe dy shokë të tjera që Rrezarti nuk i kishte parë ndonjëherë.

— Ky është fizikani Rrezart Deti! — ua prezantoi profesori atyre që kishin ardhur për të parë zhvillimin e eksperimentit.

Rrezarti ua shtrëngoi dorën me radhë.

— Ne jemi shumë të shqetësuar! — tha drejtori, një burrë trupmadh që përpinqej të fliste me gjuhë letrare. Ai ishte prej atyre anëve të Veriut ku e kanë të vështirë t'i shmangen dialektit të tyre. Si vështroi shokët e grupit me një pamje prej hetuesi, vazhdoi: — E pra, ne sot duhet ta ndajmë shapin nga sheqeri dhe duhet të dimë se çfarë

të bëjmë. Kush e ka fajin, projektimi apo zbatimi. Këtë le ta zgjidhin shkencëtarët në Institut apo në Akademi.

— Projekti nuk ka avari! — ia ktheu me ton të prerë kryeinshinieri. — Ai mbështetet në kalkulime e përllogaritje të saktë shkencore teorike dhe eksperimentale laboratorike. E, ja ku po jua them, nuk ka më ndonjë sekret, se projektet tona të hidrocentraleve gjigante mbi lumenjtë e rrëmbyeshëm me përmasa kontinentale po zbatohen me sukses edhe në disa vende të tjera të botës.

Ai shoku tjetër, me flokë të rënë, që ishte drejtori i ndërmarrjes së zbatimit të ndërtimit të hidrocentralit, një inxhinier me përvojë që kishte punuar edhe në dy hidrocentrale të tjera mbi Drin, u hodh përpjetë sikur dikush t'ia kishte ngulur shigjetën pas shpine.

— Zbatimi i projektit është bërë nga mijëra punonjës. Disiplinat shkencore e teknike përfshirë çdo hallkë të projektit janë kontrolluar nga inxhinierët e specialistët tanë me rreptësinë më të madhe, duke mos lejuar asnjë lëshim. Dhe përfshirë punimet e tyre e mbaj unë përgjeajësinë mbi shpatullat e mia, qoftë para Partisë, qoftë para shtetit.

Rrezarti e vështroi me bisht të syrit drejtorin, që ishte bërë në fytyrë si spec i kuq. Profesori me pamjen e tij të menduar tha befas:

— Shoku Rrezart! Nisim nga eksperimenti! — dhe u hodhi një sy aparateve të vendosura mbi shtretër llamari ne, rrëzë digës. Pastaj iu drejtua fizikanëve: — Ngjituni mbi digë dhe hidheni gjurmuesin radioaktiv në thellësinë e ujit të ligjenit, mu në rrëzën e murit sa më afër pikave të dyshimit ku mendohet se ndodh penetrimi i ujit nëpër digë. — Si urdhëron, — tha Rrezarti dhënvajti të kontrollonte edhe një herë dedektorët e kabllot, që dilnin prej tyre dhe lidheshin me aparatin regjistrues të rezatimit.

Radiokimisti mori lëndën radicaktive të ambalazhuar me enë plumbi dhe bashkë me një kimist të laboratorit të hidrocentralit që merrej me analizatë fortësisë së ujërave filluan t'i ngjiteshin anës tjetër të digës me shkallë prej betoni.

Profesori ngriti kokën lart dhë me dorën e rreshkur të

vënë si strehë mbi vetullat, vuri re shenjën që dha radio-kimisti.

— U hodh izotopi radioaktiv! — tha me zë profesori dhe, si hoqi dorën nga balli, ktheu vështrimin nga shokët e ndërmarrjes së projektimit e të zbatimit. — Ja, për disa orë uji i rrezatuar, nëse penetrон nëpër kapilarët e digës, duhet medoemos të dalë përtej dhe dedektorët e ndjeshëm do të na e regjistrojnë atë rrezatim të padukshëm.

— Po në qoftë se aparati juaj nuk i kap rrezet e padukshme përkëtej digës, çfarë do të thoni ju shkencëtarët? — pyeti befas një karpentier vendas që kishte punuar në ndërtimin e hidrocentralit e tani shërbente në mirëmbajtje.

Profesor Gurra kryqëzoi vështrimin me Rrezart Detin që rrinte përballë tij.

— Nëse aparati ynë ta zëmë se nuk i kap ato rrezet e padukshme që lëshon në ujë gjurmuesi radioaktiv, atëherë diga nuk filtron!

Fizikani i ri dha mendimet me fjalë të shkoqura dhe me një ton të vendosur të zhveshur nga çdo dyshim.

— E këtë unë e dua të ma jepni me shkrim! — u hodh drejtori i shfrytëzimit të hidrocentralit, me sytë e shqyer nga habia. — E zeza mbi të bardhë! «Diga nuk filtron ujë» ose «diga filtron ujë». Më kuptoni?... Kjo nuk është për të shkarkuar përgjegjësinë time, unë nesër mund të mos jem drejtor...

— Nuk kemi ardhur këtu të bëjmë lodra! — u hodh laboranti fizikan.

Rrezarti me një giest që bëri nuk e la më shokun të thoshte ndonjë fjalë tjetër të nxituar.

— Secili lypset ta bëjë punën të saktë dhe me përgjegjësi. Edhe ne eksperimentin shkencor do ta zhvillojmë me seriozitetin më të madh dhe domosdo do të themi fjalë tonë.

Shokët e grupit të punës ishin shpërndarë secili në vendin e tij. Rrezarti shkonte e vinte nga dedektorët deri te baraka. Kishte kaluar një orë e qiysmë dhe ende aparati regjistrues i rrezatimit radioaktiv nuk bëhej i ajallë. Akrepat rrinin të heshtur nën vështrimin plot ankh të vizitorëve që i mbanin sytë të pandarë nga voltmetri. Aty në

barakë kishin ardhur edhe nja dy gjeologë të një ekspedite që kërkonin minerale të rralla. Njëri prej tyre, ai me një fytyrë të ashpër e me mustaqe, që shembellente si komit malesh, gjashtë muaj përpara kishte përfunduar studimin gjeologjik të një vendburimi krejtësisht të ri të mineralit të bakrit. Ai interesohej të dinte nga profesor Gurra nëse laboratori i tyre bërthamor ishte në gjendje të merrte përsipër eksperimentimin me metoda bërthamore të përcaktimit të moshave të shkëmbinjve, në xhepat e të cilëve gjendej mineral i pastër magnezi. Bile ai kishte mendimin, sipas ca gjurmëve, se aty rrotull mund të kishte edhe uranium.

— Është e mundur, — ia përgjigj profesori. Dhe, si ia shpjegoi shkurt metodën shkencore të përcaktimit të moshave të shkëmbinjve mineralë, shtoi: — Qendra jonë bërthamore është e ngarkuar, bile e tejngarkuar me detyra nga më të ndryshme shkencore. Por ju mund t'i drejtoheni Institutit FB në kryeqytet dhe ata mund t'ju adresojnë në ndonjë bërthamë tjetër.

— Kisha nevojë për një studim të tillë! — ngulte këmbë gjeologu dhe, për të argumentuar kërkesën, nxori nga çanta që e mbante krahaqafë një hartë gjeologjike të zonave të Veriut ku ai kryente kërkime si përgjegjës i një ekspedite. — Ja, — shënoi ai me gisht, — më duhet t'u bëj një plotësim këtyre vendburimeve.

— Kjo është harta gjeologjike e re? — pyeti profesori fizikan, duke i hedhur një vështrim të përgjithshëm asaj.

— Po. Ky është një detal i asaj harte të përgjithshme gjeologjike të vendit tonë.

— Kam lexuar një recensë në një revistë shkencore franceze mbi vlerësimin që i bëhet kësaj harte, —dhe profesor Gurra afroi dorën për të parë orën.

— Profesor, shkojmë të hamë drekë! — tha Rrezarti që erdhi atë çast.

— Shkojmë! — ia ktheu profesori. — Me sa duket rreza ja e padukshme nuk do të përshkojë përtej digës!

Rrezarti ngriti supet dhe tha nëpër dhëmbë:

— Do të presim deri nesër në mëngjes. Në orën shta-

të mbaron edhe koha e përgjysmimit të izotopit tonë radioaktiv.

Profesori nuk tha gjë, por me një gjest që bëri më kokë e miratoi mendimin e tij.

Në mensën e hidrocentralit profesor Buroni, Rrezarti dhe radiokimisti u ftuan të hanin drekën me shokët e projektit dhe të zbatimit. Atë çast aty erdhi edhe drejtori i shfrytëzimit të hidrocentralit. Ai u kerkoi të falur për largimin e tij papritmas. E kishin kérkuar në telefon nga Tiranë. Sipas qendrës së sistemit të centralizuar paralel të shpërndarjes së energjisë elektrike, nga përllogaritjet e bëra nga makinat elektronike dilte se hidrocentrali që drejtonte është kursyer një sasi të madhe energjie elektrike dhe tani i kërkohej që të shtonte planin e shitjes së energjisë elektrike për eksport në një vend evropian që vuante nga kriza energjitike.

— Po unë i kundërshtova tani për tani. Isha i turbulluar nga kjo dreq avarie e shëmtuar. — Drejtori i thoshte fjalët si të ngjitura njëra me tjetrën.

— Jepua, jepua fjalën për shtesë eksportil! — belbëzoit Rrezarti.

Drejtori mbajti vesh dhe me sytë që atë çast sikur shkrepën shkëndija, tundi kokën në shenjë miratimi.

Atë natë mysafirët nga Laboratori Bërthamor D6 pas darkës vajtën në kinema dhe panë një film që u kishte shpëtuar të treve pa e parë në qytetin e tyre. Ishte një nga filmat shqiptarë lauruar me çmimin e artë në festivalin e fundit të filmit evropian.

Para se të merrnin një sy gjumë në dhomën dyshe të hotel «Drinit», Rrezarti me profesor Gurrën këmbyen disa mendime rrith sjelljeve të zymta të Kotit për tërë ato ngjarje që kishin ndodhur në katedër, për punën e teksteve që aty-këtu mund të gjeje frysë idealiste, për çështjen e temës së diplomës dhe këmbënguljen e tij për t'i përdobi të prodhimit si punë shkencore, për hapjen e derës së bodrumit të akselatorit, për ndotjen radioaktive të kabinetit të radiokimisë, për marrëdhëniet e tij me nëpunësin Misi Vangjo, për qëndrimin e papajtueshëm të së bijës,

Zanës, për kthesën që kishte bërë kohët e fundit asistente Sofije Ervini.

Nata u freskua. Profesor Buroni u ngrit pas orës dy të natës dhe e mbylli dritaren që shikonte nga lumi që zhurmonte. Pastaj mori nga rafati dy batanije që ishin aty rezervë dhe ia hodhi njëren fizikanit të ri. Ai e vështroi me kërshëri fytyrën e tij të vënë nën pushtetin e gjumit që ndriste nga një tufë rrezesh të argjendta të Hënës.

* * *

Si hëngrën mëngjesin, grupi eksperimentues shkoi te baraka në bregun e djathë mbi digën. Roja, një kosovar trupvigan, si ata kreshnikët e legjendave, nderoi me grusht. Profesori ia zgjati dorën dhe e pëershëndeti përzemërsisht. Mbas tyre ia behën edhe shokët e tjerë: drejtori i hidrocentralit, ata të projektimit dhe të zbatimit. Midis tyre ishte edhe ai docenti gjeolog që shembellente si komit. Profesori, Rrezarti, laboranti fizikan, radiokimisti njëri pas tjetrit vështruan aparatin. Gjithçka ishte si më parë. Asgjë e re nuk kishte ndodhur. Rrezarti doli nga baraka i heshtur dhe eci drejt kabllove të shtrira përtokë dhe vërejti me kujdes lidhjet e tyre me të dy dedektorët. Çdo gjë ishte në rregull. Ai u kthyte pas pesë minutash në barakë. Aty kishte pllakosur heshtja. Shokët e hidrocentralit, projektuesit dhe drejtori i zbatimit dukeshin si të habitur. Ata tanë e kuptonin se aparati dhe eksperimenti i fizikanëve nuk kishte kapur asnjë gjurmë rrezeje që të kalonte përtëj digës me ujin që filtronte nëpër damarët e «krisur» të saj. «Po ai vendi që rri gjithmonë i njojur tri pëllëmbë më tutje?» – bluan te me vete drejtori i hidrocentralit dhe i dukej se po të njëjtën pyetje lexonte edhe në rrudhat e ballit të shokëve të tjerë të projektimit e zbatimit.

– Diga nuk filtron asnjë grimië ujë! – tha fizikani Rrezart Deti me zë të pakët të ngritur, me një notë besimi në vetvete.

– Diga është projektuar dhe zbatuar me saktësi sipas

disiplinave shkencore nga të gjitha aspektet teknike e gjeologjike. — Profesor Buron Gurra i tha këto fjalë qartë, po me ngadalë, duke i shkruar në letër.

— Edhe unë bashkohem me mendimin tuaj, — ia ktheu laboranti fizikan dhe mori stilografin aty nga tryesa e nënshkroi poshtë përbri firmës së profesor Buron Gurrës dhe Rrezart Detit.

— Rrezatimi radioaktiv është holluar aq shumë, sa është krejtësisht i papërfillshëm. Kurse tableta e izotopit radioaktiv ka pushuar së emetuar rreze gama, — tha radiokimisti me atë fytyrën e tij të thatë dhe vuri firmën në letër.

— Epo fijes së ujit që vazhdon të rrjedhë pas murit të digës lypset t'i gjendet patjetër burimi! — qeshi gjeologu duke dredhur mustaqen e zezë.

— Tani nuk je më komit, por një kërkues shkencëtar, ia priti profesori që nuk e kishte zakon të hidhej ashtu menjëherë në biseda. — Drejt e keni!

— Ti, o usta, — iu drejtua Rrezarti carpentierit gollo bordas, — kur të pyeta dje nëse di se mos në të majtë të digës ka apo jo ndonjë burim, diç belbëzove, por fjalët i ndërmbyte!

— Po. Para prillit të atij tërmeti të fortë ka qenë në atë bregore, pakëz më poshtë atij shkëmbit të ngrënë, një burim i vockël, si hurdhë, — tregoi ai me dorë vendin. — Por lëkundja e tokës ia humbi tobtin, — qeshi ai si pa të keq.

— Ti, Rrezart, ke fantazi dhe intuitë të çuditshmë, — u hodh profesor Buroni. — E ne do t'i biem në të! — shtoi ai duke marrë me mend se çfarë bluante fizikani i ri; ish-nxënësi i tij.

— E gërmoj unë atë vend dhe ia gjej rremën burimit!

— Tha carpentieri. — Bëjeni sot këtë. Nesër hedhim një tabletë radioaktive në atë hurdhë uji, — tha Rrezarti duke hedhur sytë të fija e ujit që buronte në rrëzën e digës.

Të nesërmen në orën dhjetë paradite erdhi automjeti

i transportit radioaktiv dhe solli një tabletë të ngjashme me atë të izotopit radioaktiv që u hodh në liqenin e hidrocentralit. Karpentieri dhe gjeologu mustaqezi e kishin gërmuar vendin dhe sipas parashikimit e gjetën burimin si hurdhë që kishte shkarë nja tridhjetë e pesë centimetra më poshtë, i fshehur nga toka. Me sa u kuptua, uji kishte ndërruar drejtimin e mëparshëm, duke gjetur vrima e damarë të tjerë të tokës. Radiokimisti e hodhi aty izotopin radioaktiv. Nga vendi i burimit të zbuluar dhe deri te rrëza e digës ku rridhte uji si curril i hollë, ishte nja tridhjetë e pesë metra. Në barakë u mblohdhën po ata njerëz që ishin edhe ditën e dytë. Pas një ore e dy minuta akrepat e aparatit nisën të lëviznin dhe të regjistrin rezatimin radioaktiv të ujit të burimit lart në bregore, jashtë digës që e nxirrte kokën si gjuhë nepërke me një skaj përtetj anës tjetër të murit gjigant të hidrocentralit. Rezarti kësaj here nuk e përbajti gjëzimin. U ngrit në këmbë dhe tha me një ton me nota ngazëllimi:

— Diga nuk filtron as edhe një grimë ujë. Gjurmuesit tanë radioaktivë penetruan rrezet e padukshme në aftësitë dhe ndërgjegjen e dhjetëra qindra e mijëra njerëzve: projektuesve, inxhinierëve të zbatimit, karpentierëve dhe punëtorëve të tjerë. Ato, rrezet, vërtetuan shkencërisht ndërgjegjen e lartë socialiste të punonjësve tanë si dhe tezën teorike e praktike se si çdo revolucion tjetër edhe revolucion tekniko-shkencor e bëjnë masat.

Drejtori i hidrocentralit, ai tropojasi me trup vigan, i kishte vënë dorën në sup fizikanit të ri dhe e vështronte me një buzëqeshje adhuruese. Ai u çlirua nga ajo brëngë që e kishte torturuar dalngadalë që prej tridhjet e tri ditësh, që kur ishte shpikur ai djall currili rrëzë digës. Miratonte në thelli të zemrës mendimet që thoshte Rezarti dhe, duke tundur kokën, përsëriste të njëjtën shprehje:

— Ej, bre burra, ja shkenca... ja shkenca.

— Ju lumi! — ia pat profesor Buroni duke i zgjatur dorën kryeinshinierit të byrosë së projekteve të hidrocentralit. — Projekti juaj si edhe zbatimi i tij, — ktheu sytë nga ai i zbatimit, — është një punë shkencore e saktë dhe e mrekullueshme.

Laboranti fizikan, radiokimisti, inxhinieri i zbatimit, drejtori i shfrytëzimit, profesor Buroni dhe shokët e tjerë u përqafuan e ia shtrënguan dorën fort me dashuri dhe me respekt njëri-tjetrit. Fizikani i ri, Rrezart Deti, kishte pushtuar shqiptarët karpentierin gollobordas dhe vazhdimisht i rrihte atij supet. Gjeologu i mineralete të rralla dridhëtë mustaqet dhe qeshte. Ashtu të pushtuar nga ndjenjat e gjëzimit e të haresë, përkrah njëri-tjetrit shkuan në klubin e hidrocentralit dhe ia shtruan për shtatë palë qejfe, si i thonë fjalës. Punëtorët që e morën vesh ngjarjen u afroan te tryezat e tyre dhe filluan të urojnë fizikanët bërthamorë për suksesin e eksperimentit. Një punëtor nga ata të turbinës, një djalosh trupgjatë e bukurosh, me gotën e rakisë në dorë, iu afroa profesorit të fizikës dhe me një zë kumbues prej kreshniku thirri:

— Përplase, o burri i dheut, atë gotë me mua. Le ta pimë, o shokë, këtë gotë për shëndetin e shkencëtarëve shqiptarë! E ja ku po ju thotë baca juve se shqiptarët dinë të shkrepin pushkët, po dinë edhe të bëjnë shkencë!

Të gjithë përplasën gotat. Profesori kryqëzoi vështrimin me Rrezartin. Të dy ishin të gëzuar aty, midis njerëzve të thjeshtë e me zemër bujare.

KAPITULLI XVI

— Analizo qimen nr. 7! — tha Behari që rrinte ulur në një stol të lartë i kërrusur mbi aparatin e gamaspektometrisë:

— Dionis Koti, — tha fizikani eksperimentues ndërko hë që hoqi qimen nga albumi dhe e vendosi në aparat për ta diagnostikuar.

Profesor Buroni atë çast si me magnet kryqëzoi vështirimin e emocionuar me asistentin e tij, Petritin, me të cilin e lidhte një punë intensive sa në katédër e sa në laboratorin bërthamor gjatë disa eksperimenteve të rëndësishme shkencore.

Punonjësi shkencor i kriminalistikës e mbajti një copë herë në dorë filmin Nr. 7 duke bërë krahasimin e tij me filmin IX dhe 2 X. Ai u vrenjt në fytyrë. Një rrudhë vertikale u shfaq nga balli dhe zbriti deri nën lëmën e syrit të majtë që e kishte me shenjë. U ngrit nga karrigia. Ia zgjati të dy filmat Petritit. Nuk i tha asgjë veçse e vështroi pjerrtazi.

— Janë të përngjashme si dy pika uji! — tha me ton të përcaktuar laboranti fizikan.

— Ashtu mendoj edhe unë! — u hodh eksperti kriminalist. — Këto dy fije floku i përkasin të njëjtit lloj me ato të profesor Kotit.

Profesor Buroni ndjeu një si therje në zemër kur i mori në dorë dy filmat. U kërrus me lentë sa te njëra sa te tjetra. Nuk kishte më asnë dyshim, sepse rezet e padushme kishin fiksuar tërë qelizat, nyjet, boshllëqet dhe konstruksionin e atyre dy fijkeve të flokut si dhe ngjyrën e tyre.

— Po. Profesor Koti ka hyrë atë natë në kabinetin e radiokimisë, — tha ai duke ngritur sytë nga operativi i Sigurimit dhe në atë pamje të habitur shpreheshin disa pyetje të heshtura.

— Duke vrarë veten, s'ka pyetur për të tjerët! — u hodh Behari dhe shtoi: — Ju falënderoj për bashkëpunimin e sinqertë dhe të zellshëm.

— Bëjmë detyrën, bir! — u përgjigj me një ton atëror profesori.

— Ne do të japim tërë ndihmën e nevojshme për ta zbuluar të vërtetën deri në rrënë, — vazhdoi profesori. — Unë mendoj se nga bashkëpunimi juaj me fizikanin e ri, Rezart Detin, vajzën e Kotit, Zanën, dhe asistenten, Sofije Ervinin, do të mundemi të hedhim rreze drite deri në thellësi të ndërgjegjes së Kotit për ta zbërthyer çështjen ideologjikisht dhe politikisht.

KAPITULLI XVII

Rrezartit iu dukën muajt e pranverës sikur të ishin ditë, aq shpejt rrëshqitën. Rrezet e diellit nisën të ngroh-nin tokën dhe gruri mori ngjyrën e floririt. Shirat kishin pushuar dhe qelli kaltëronte plot shkëlqim, kurse natën yjet xixëllonin si thëngjij të ndezur.

Sipas një vendimi që ishte marrë në katedër, Rrezarti do të jepte një cikël leksionesh mbi studimet e rezultatet e eksperimentimeve bërthamore në fushën e teknikës. Në këtë sesione shkencore do të merrnin pjesë specialistë, in-xhinierë e punëtorë nga degë të ndryshme të industrisë së qytetit, bile parashikoheshin të ftosheshin edhe nga disa ndërmarrje të tjera të naftës, nga ato kimike dhe gjeologjike të rretheve të tjera. Në atë cikël leksionesh do të vinin shokë fizikanë edhe nga Universiteti dhe Akademia e Shkencave. Kështu që fizikani Rrezart Deti, duke ndier përgjegjësinë, punonte ditë-natë për t'u përgatitur sa më thellë si teorikisht, ashtu edhe me anën e përdorimit të diagrameve e të skicave të projektuara për zbatimin e

këtyre metodave shkencore në degët e larmishme të indus-trisë së vendit.

Të dielën e fundit të atij qershori të ngrohtë kur po binte muzgu i mbrëmjes, Rrezarti e Merita po ktheheteshin në heshtje te gjiri i shkëmbinjve të kuq buzë detit. Ky ishte vindi i dashur i kushedi sa takimeve ku ata, me orë të tëra, të pushtuar nga ndjenjat e dashurisë, thurnin ëndrrat e tyre për të ardhmen.

— Arritëm! — tha befas Merita duke hequr krahun e saj nga ai i Rrezartit dhe u kthye nga ai. Gjiri i vogël me shkëmbinj të kuq dukej i vetmuar dhe si i harruar. Dallgët e detit njëgjysmë ballëshe që përplaseshin mbi cepat e lëmuar të gjirit, ngrinin cikla uji që herë pas here spërkat-nin fytyrat e tyre. Larg, në detin e errësuar, ata shikonin dritat që notonin mbi ujë. Iшин vaporët e motoskafët që hynin e dilnin në portin e zgjeruar.

— Është lumturi për një çift të dashuruar një gji si ky kaq i mrekullueshëm! — tha Rrezarti.

— Ja një romantik! — qeshi në errësirë Merita.

Përsëri aty në gjirin e shkëmbit të kuq ra heshtja e lumtur. Ata u ulën pranë e pranë në shkëmbin e lëmuar si kurriz kali, pa e ndier lagështinë që jepte deti.

— Rrezart, do të më kesh gjithmonë afër, do të ta lehtësoj lodhjen, — e theu heshtjen përsëri Merita.

— Oh, sa mirë që u shprehe, si një poeteshë!

Rrezarti, duke mos e hequr krahun nga supi i vaj-zës, hodhi vështrimin nga qielli xixëllues dhe nga deti që nisi të krijonte miliona margaritarë me rrezet e Hënës së ar-gjendtë që ia behu mbi qafën e maleve andej nga lindja. Ata ndenjën aty një kohë të gjatë. Kur po largoheshin nga gjiri i vogël, biseduan edhe për martesën e shpejtë, për pajisjen e apartamentit të ri etj. etj.

— Për këto gjëra do të merrem unë me nënën tën-de, — i tha Merita duke shpënë buzën në gaz.

Sapo dolën në rrugën kryq, ata qëndruan një copë herë në mëdyshje. Merita e dinte që më parë se ai kishte lënë takim me profesor Buronin në orën tetë në kafe «Arbëria».

— Unë po kthehem në shtëpi! — tha befas ajo duke

e marrë me mend se ata do tē kishin ndonjë bisedë rreth punës së tyre.

Rrezarti e vështroi në sy me dashuri.

— Mirupafshim, Mérital!
— Natën e mirë! — ia ktheu ajo dhe afroi faqen te buzët e tij.

— Bëji tē fala babait dhe puthe nga unë vëllanë çamarrok.

Në kafe «Arbëria», në një tryezë nga qoshja e banakut, profesor Buroni i vetëm; me kafen përpàra dhe një gotë uji mineral tē përgjysmuar, po lexonte një shkrim në revistën «Shkenca e jeta» mbi një punim shkencor në fu-shën e kimisë tē ngjyrave të stofit në kombinatin e tekstileve. Nuk e vuri re fare Rrezartin që iu afroa.

— Mirëmbërëma, profesor! — e përmendi Rrezarti duke i dhënë zërit një tingull tē ngrrohtë.

— Ou, erdhe, Rrezart! — u përgjigj profesori me një ton miqësor duke ia bërë me dorë që tē ulej aty pranë tij. Dhe, kur Rrezarti zuri vend mirë, ai mbylli faqen e revis-tës e vazhdoi tē jepte një përbledhje tē shkurtër tē asaj që po lexonte: — Ja, kjo është një punë shkencore me le-verdi tē madhe ekonomike, — tha profesori.

— Është vënë në prodhim industrial? — pyeti Rrezarti.

— Po. Aty qëndron vlera e studimit teorik, e eksperi-mentimit laboratorik dhe e vënies së teknologjisë në praktikën e prodhimit. Të tillë disertacione shkencore na du-hen.

Ata këmbyen mendime dhe dhanë shembuj tē punimeve shkencore edhe në degë tē tjera tē ekonomisë që i shin vënë në jetë.

— Çfarë do tē marrësh? — e pyeti profesori Rrezartin me një respekt që tē bënte përvete.

— Kafe ekspres dhe një ujë gline, — tha fizikani i ri me mirësjellje.

Kamerieri u largua me një shprehje që tregonte se kë-saj here nuk do tē vonohej tē kthehej tek ata me porosinë e bërë.

Profesori u zgjat pakëz nga Rrezarti dhe me një pamje të qetë me zë tē ulët nisi t'i tregonte atij për çështjen e

Dionis Kotit. Në bisedën që kishte bërë ai me operativin, Behar Strallën, u informua për veprimtarinë armiqësore të nëpunësit, Misi Vangjos, që kishte shpërdoruar pozitën e tij zyrtare duke bërë korrespondencë me një person të huaj që e hiqte veten si profesor fizike. Por prapa tij fshihej një agjenturë spiunazhi e një vendi kapitalist. Qëllimi i asaj agjenture nëpërmjet spiunit të vjetër, Misi Vangjos, ishte të fuste në rrjetën e tyre edhe elementë intelektualë si profesor Koti, të infektuar me koncepte filozofike idealiste e metafizike. Dhe, duke gjetur të krisura në njerëz të sëmurë nga ideologjia, të përhapnin në radhët e shkencëtarëve ide skeptike, amulli për rrugën shkencore, mosbesim dhe nënvleftësim, me synim për t'u hapur shtigjet firmave të monopoleve të huaja të investuara nga imperializmi ndër-kombëtar.

— Po çfarë ndodhi me atë? — pyeti befas Rrezarti.

— Sigurimi i Shtetit e arrestoi, — u përgjigj profesor Buroni. Atë çast kamerieri solli kafen dhe një gotë ujë gline.

— Ja se kush paska qenë prapa profesor Kotit të së-murë nga infekzioni i mikrobeve të asaj botës tjetër që nuk heq dorë kurrë vullnetarisht.

— Vigjilencia... e këtë lypset ta kuptojnë thellë edhe shkencëtarët.

Për një çast ra heshtja. Rrezarti deshi ta shfrytëzonte këtë heshtje dhe t'i njoftonte profesorit se kishte vendosur të martohej. Me këtë rast t'i kërkonte leje, por i erdhi rënë.

Profesori e hapi bisedën vetë.

— Dëgjo, Rrezart. Datën e sesionit shkencor e shtymë. Përveç asaj çështjes së Kotit, mua më është ngarkuar një detyrë e posaçme nga qendra shkencore bërthamore. Në-sër që me mëngjes më duhet të shkoj në mbledhjen përfundimtare ku do të vendoset vendi i ndërtimit të portit të ri të madh me përmasa të një skele ndër-kombëtare.

— Pse, e përfunduan eksperimentin me gjurmues radioaktivë në fushën e sedimentologjisë bërthamore? — pyeti Rrezarti me një ton sa kureshtar, aq edhe të gëzuar. Ai e

dinte se çfarë vlerash kishte përvetësimi i kësaj disipline shkencore.

— Po u përcaktua me saktësi lëvizja e rërës së fundit të detit dhe koha e mbushjes së thellësisë së bregdetit në tri variantet dhe u gjet gjiri më i përshtatshëm për ndërtimin e portit të ri.

Profesori dha disa argumente për leverdinë e madhe ekonomike të zbatimit të kësaj metode bërthamore në përcactimin shkencor të vendit ku do të ndërtohej porti i madh mesdhetar. Për ndërtimin e kësaj skele punonin një ndërmarrje e tërë projektuesish, përpunuesish, specialis-tësh të ndryshëm dhe, përveç fizikanëve, bashkëpunonin ngushtë edhe një grup punonjësish shkencorë të hidrometeorologjisë. Rrezartit në fillim iu duk e habitshme shifra e madhe e investimeve në lekë që ishte planifikuar nga shteti për ndërtimin e këtij objekti të madh të transportit detar. Por edhe investimet për ndërtimin e hekurudhës në veri nuk ishin më të pakta. Ajo do të përshkohej përmes kushesti sa tuneleve. E pastaj do të lidhej me shinat e heku-rudhës ndërkontinentale. Atij i bëhej zemra mal kûr mendonte se në këto projekte dhe zbatime tekniko-shken-core kryenin një punë të dobishme me karakter shkencor edhe kolegët e tij fizikanë.

— Por nuk e kam fjalën këtu, Rrezart. Tani ti i ke të gjitha mundësitë të marrësh lejen dhe, siç ke vendosur, të martohesh. Unë s'kam asnjë kundërshtim. Po kije parasysh veç se më vonë mund të të bëhem pengesë, — tha profesori dhe qeshi. — Dhe tani, — vazhdoi ai, — do të më falësh, Rrezart. I kam premtuar sime shoqeje të bëjmë një vizitë te një kushërrira e saj që e kemi në pallat me rastin e fjesës së vajzës së saj.

Rrezarti u ngrit pas profesorit dhe, si e zuri miqësishët e me respekt për krahu, ecën përmes tryezave me një largësi aq sa i zinte lirisht të dy bashkë.

Ata ecën edhe një copë rrugë bashkë duke ndier fres-kun e mbrëmjes derisa arritën te një palmë disavjeçare në rrëzë të pallatit të bashkimeve profesionale. Këmbyen copa bisedash të ndryshme. Profesori tregoi se kishte lexuar një material të ri mbi teorinë e relativitetit në lidhje me ha-

pësirën, kohën që s'ishin gjë tjetër veçse forma të ekzistencës së materies. Dhe këtë revistë ai ia rekomandoi Rrezartit ta gjente në bibliotekën e qytetit dhe t'i hidhte një sy. Rrezarti i tha se kishte bërë një studim të imët mbi praktikën dhe përdorimin e rezatimit bërthamor që e kishin vërtetuar teorinë e Ajnshtajnit që kur ishte ai gjallë. Kur ia shtrënguan njëri-tjetrit dorën për t'u ndarë, profesori i tha:

— Të uroj gjithë të mirat, Rrezart. Të trashëgohesh. Dhe të më falësh që nuk i përgjigjem dot ftesës. Ti e shikon vetë që s'kam mundësi.

Rrezarti e falenderoi profesorin me një lëvizje të lehta të kokës pa thënë gjë me fjalë.

— Mirupafshim! — tha profesori si ia lëshoi dorën dhe bëri të largohej.

— Mirupafshim, profesor! — ia ktheu Rrezarti.

— Rrezart! — ia pati profesori duke qëndruar në vend me kokën kthyer prapa. Po të dëshironi, mund të udhëtoni bashkë me të fejuarën me mikrobusin tonë deri te porti i ri. Pastaj mund të vazhdoni me autobusin urban që shkon në shtëpinë e pushimit «Perlat e Jonit». Atje më duket se do të shkosh pas dasmës?

— Falemnderit, — tha Rrezarti. — Por, para se të vendos, do ta bisedoj me Meritën.

— Mos e humb rastin të udhëtojmë bashkë.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!

* * *

— Nisemi! — i tha profesori shoferit. — Na pret Rrezarti me nusen.

— Profesor! — i tha shoferi. — Të prezantoj me një shokun tim, shofer Skode. Edhe ky është shkencëtar, dreqi. Merret me studimin e motorëve të naftës.

— Shumë mirë! — tha profesor Buroni ndërkohë që ia shtrëngonte dorën e madhe me kallo e të nxirë nga vajrat shtrëngonte dorën e madhe me kallo e të nxirë nga vajrat

— Ee... e zmadhon, Teli. Çfarë shkencëtar jam unë?

Ja, merrem me një studim modest se si të bëjmë një ndryshim konstruksioni të motorëve me naftë që po prodhohen nga uzinat e vendit për t'iu përshtatur kushteve tepër malore të rrugëve tona.

— Shumë mirë, shumë mirë, djalë. Ja, kështu duhet.

— Po ky shkencëtar im, profesor, ka ndeshur në disa vështirësi. Unë i premtova se mund ta ndihmoni ju. I thashë se s'kemi kohë tani, po kur të kthehem, profesor, mirë?

— Po mirë, o Teli, ti i paske premtuar, ç'më pyet?

Premtimi duhet mbajtur. Dakord, kur të kthehem! Mirupafshim!

Buroni zuri vend në ndjenjësen e mikrobusit prapa shoferit. Teli yuri në lëvizje automjetin. Bulevardi kishte nisur nga ecejaket e qytetarëve, të bicikletave, të veturave dhe autobusëve. Pas pesë minutash, duke qëndruar dy herë te vijat e bardha ku kalonin këmbësorët, mikrobusi ndali para pallatit të bashkimeve profesionale. Profesori ia bëri me gisht tek ajo qoshja ku binte në sy një basorelliev i madh, një punëtor që mbante në një dorë pushkën dhe në tjetrën kazmën dhe mbi kokën e tij një drapër dhe çekan futur në kuadratin e një ylli me pesë cepa. Aty prisnin Rrezarti dhe Merita që diç bisedonin e qeshnin me njëri-tjetrin. Anash tyre një valixhe dhe një çantë e madhe lëkure, lënë buzë trotuarit.

— Ja ku po na presin! — tha profesor Buroni.

— I pashël — u përgjigj shoferi.

— Urdhëroni këtu! — i tha profesori Meritës duke i treguar me dorë ndjenjësen me dy vende përkundrejt tij. Ia shtrëngoi dorën miqësisht dhe, duke e vështruar në sy, shtoi: — Të uroj jetë të lumtur e të trashëgohesh.

— Të falem nderit, profesor! — u përgjigj Merita.

Rrezarti, si vendosi valixhet dhe çantën prapa, erdhi dhe u ul pranë Meritës. Ktheu kokën nga ai dhe e përshtëndeti:

— Mirëmëngjes, profesor! Si jeni me shëndet?

— Mirë jam, derisa reumatizmi ende nuk më ka ngacmuar kockat.

— Profesor! Kam dëgjuar se ato ujërat e nxehtha minrale që janë zbuluar kohët e fundit nën këmbët e Korabit

lëshokan ca rreze që kurokan çdo lloj reumatizmil – tha shoferi. Atë çast në kthesë parakaloi një «Albania»

— Lëri ujërat termale, se nuk ua kam ende nevojën, por vështro timonin, — qeshi profesori.

Teli nuk foli më. Ia shtroi mikrobusit në asfalt duke mbajtur krahun e tij. Dhjetëra e dhjetëra automjete të tonazheve të ndryshme lëviznin si lumë në kahun e tyre të kundërt. Profesori kishte nxjerrë «Zërin e popullit» përparrë dhe lexonte kryeartikullin që bënte fjalë për efikasitetin ekonomik të zbatimit të metodave shkencore në bujqësi. Atij i tërroqi vëmendjen shembulli që jepej në atë shkrim për studimin konkret të një grupi të përzier prej agronomësh dhe ekonomistësh mbi rritjen e rendimenteve të dritërave në kooperativën bujqësore «Çerçiz Topulli» pa lënë pas dore edhe kulturat e tjera bujqësore të asaj ekonomie. Në faqen e dytë të gazetës i zuri syri njoftimin që jepej përdaljen në qarkullim të një botimi të ri: «Efikasiteti ekonomik i përdorimit të metodave bërthamore në disa degë të ekonomisë». Ai u gjallërua kur e mbaroi së lexuari.

— Rrezarti! — thirri ai, duke mos vënë re që kolegu i tij i ri ishte njëshur pas së shoqes dhe diç bisedonte me atë vesh më vesh. — Ja, paska dalë në qarkullim ai studimi ekonomik për zbatimin e rezatimeve në fushat e ndryshme të ekonomisë...

Fizikani i ri u tërroq me takt dhe u lidh me sy e me mendje me profesorin. Ai kishte dijeni për këtë studim. Në disa konsultime e mbledhje të fizikanëve të kooperuar në studime me specialistë të qendrave të ndryshme të prodhit, ishte biseduar edhe për problemet e efikasitetit ekonomik të përdorimit të radioaktivitetit në fushën e teknikës.

— Pa laps nuk ecet më. Ja, këtu në çantë kam një relacion të përbashkët me inxhinierët projektues, — tha profesori. — Nga zbatimi i gjurmuesve radioaktivë për të përcaktuар lëvizjen e rërërave të tabanit të fundit të detrave, qendra llogaritëse elektronike ka nxjerrë me saktësi një leverdi ekonomike shumë të madhe në ndërtimin e portit të ri në Adriatik.

Makina rrëshqiste në asfaltin e lagur. Shoferi hidhte vështrimin herë pas here anash. Ara me grurë. Kanale va-

ditëse. Rezervuarë uji. Stalla dhe kope lopësh laramane që kullošnin në fushën si det i gjelbër. Përtej tarraca me vreshta e agrume. «Kudo dora e njeritut», — tha ai me vete.

Merita ndiqte me vëmendje bisedën e shkëputur të profesorit dhe Rrezartit. Shoferin e mikrobusit për herë të parë po e takonte. Në fillim iu duk një burrë qesharak, por nga mendimet e matura që jepte herë pas here dhe të veshura nga një filozofi popullore, e bënë të ndryshonte mendim.

Shoferi e vështronte Meritën nga pasqyra e makinës. Kur mikrobusi kishte qëndruar para një traktori që po ka-përcente rrugën në anën tjetër të arës, ai ktheu kokën nga ajo dhe tha:

— Mos ma merrni për të keq! Ju kam zili! Mënyra se si vështroi ai, e bëri Meritën që të skuqej si lulëkuqe. Dhe këtë e vuri re profesori e ndërhyri:

— E pse i paske zili, o Telo?

— Sepse merren që të dy me shkencë e me studime! Të tre qeshën.

Rraga ishte e drejtë dhe e sheshtë. Në të dy anët ple-pat e gjatë bënin hije dhe si me thikë prisin dritën e ndezur që lëshonin rrezet e diellit përtej fushës me grurë që kishte nisur të merrete ngjyrën e floririt. Merita vështroi dall-gët e lehta të grurit që i krijonte era e vakët e jugut. Profesori me kokën mbështetur te xhami i makinës po sodiste natyrën, i kredhur në mendime. Po mendonte fatin e Tokës në atë oqean të pafund të qjithësisë që goditej nga rezatimi diellor që i jepte jetë e gjallëri. Papritmas atë çast mikrobusi hyri në një urë të gjatë që kishte vetëm dy këmbë në fillim e në fund, kurse haraet e mbanin pezull mbi lumin që rridhë rrëmbyeshëm përmes luginës. Sapo kaluan dy a tre kilometra përtëi urës, profesorit i zuri syri në buzë të rrugës tabelën: «Parcelë eksperimentale me farë të rezatuar». Ai thirri:

— Teli! Qëndro!

Mikrobusi u ndal para tabelës me shkronja të më-dha ngjyrëbizele.

— Ç'të punuar që i kanë bërë tokës! — ia pati shoferi kur po vështronte nga afër arën me grurë si floriri.

Profesori zbriti nga makina. Pas tij edhe Merita. Rezarti dhe shoferi shkonin nga pas dhe diç bisedonin më zë të ulët me njëri-tjetrin miqësisht.

— Profesor, ky nuk qenka grurë! — thirri papritmas shoferi duke i tundur me dorë kallinjtë. — Bobo, ç'kokrra?

Tek ata ishte afruar një vajzë me kominoshe. Ajo i përshëndeti shkencëtarët.

— Paski grurë të mbarë, — tha profesori.

— Shpresojmë të marrim tetëdhjetë kuintalë për hektar!

— Shumë bukur, shumë bukur! Ju lumtë! — tha Teli dhe tundte kokën.

— E po, po ia vure dorën tokës, ajo të jep flori, o shok i ministrisë! — ia ktheu vajza topolake me tipare të bukura me një shami me ngjyra në kokë. Flokët e zinj i derdheshin mbi qafën e gjatë që kishte marrë ngjyrën e grurit.

— Nuk jam shok i ministrisë, — ia pati Teli duke vështruar me bisht të syrit Rrezartin. — Jam shoferi i makinës.

— Qofsh shëndoshë! — qeshi vajza dhe iu drejtua profesorit. — Ajo parcela tjeter nuk na doli si kjo me farë të rezatuar. — Vajza shtriu dorën për të treguar grurin përej në parcelën tjeter.

Rrezarti dhe vajza e kombajnës qëndruan në buzë të parcelës me farë të seleksionuar, të rezatuar në Laboratorin Bërthamor D6.

— Po të punosh me shkencë, toka bën mrekullira, — u përgjigj ajo buzëqeshur. — Ja, ajo parcela tjeter nuk është si kjo, se aty nuk u përdor shkenca.

Profesori qeshi dhe në shpirt ndjeu një gëzim të përshkruar.

— Kur të vini në qytet, ejani edhe në Laboratorin Bërthamor D6 të na bëni një vizitë, — i tha ai vajzës. — Dhe të na thoni sa kuintalë morët për çdo hektar.

— Me gjithë qejf! — u përgjigj vajza.

Pastaj ajo ia shtrëngoi dorën edhe Rrezartit. Kurse me Meritën u puthën në faqe si shoqe të vjetra. Kooperativistja mbeti vetëm me Telin.

— Mirupafshim! — i tha ajo befas dhe u largua për te kombajna.

Makina u nis drejt qytetit të ri bregdetar. Sapo nisën të zbrisnin një kodre të tarracuar e të veshur me pemë, u shfaq kaltërsia e detit. Rezatimi diellor krijonte shkëlqimin e dallgëve që trazonin atë rezervuar uji të kripur natyral që lidhej me të gjitha detrat e oqeanet me përjashtim të Detit të Vdekur të mbyllur nga ca male të thata diku në thellësi të Kontinentit Aziatik.

KAPITULLI XVIII

Kur Rrezarti dhe Merita nisën etapën e fundit të udhëtimit me autobus për në shtëpinë e pushimit «Perlat e Jonit», rrezatimi i kuqërremtë i diellit i jepte një ngjyrë të ndezur perëndimit. Horizonti magjepsës matanë xhamit të makinës Rrezartit i ndillte një ndjenjë romantike. Merita aty pranë tij kishte hedhur shikimin tutje, brigjeve të detit të veshura me limona, portokalle, ullinj e lloj-lloj drurësh subtropikalë, madje aty-këtu dhe me palma. Drita e shkëlqyeshme e ditës sa vinte e shuhej dhe vendin e saj po e zinte muzgu i mbrëmjes.

— Ja se si po ndërrojnë ngjyrat e natyrës, — tha Merita sikur fliste me vete.

— Mbërritëml — tha befas Rrezarti dhe atë çast u zgjat nga dritarja e autobusit që të vështronte më qartë gjirin që shtrihej poshtë në buzë të Jonit.

Automjeti qëndroi para një sheshi të vogël rrëthuar nga ca vila dykatëshe me ballkone nga deti. Rrezarti vuri re fytyrat e disa prej udhëtarëve që nisën të zbrisnin njëri pas tjetrit me valixhet në dorë. Me ata do të jetonte në

shtëpinë e pushimit për pesëmbëdhjetë ditë me radhë. Midis tyre kishte edhe çifte të sapomartuara si ata. Hetoi disa prej tyre nëse ishin ftyra të para gjëkundi. I zuri syri një mjeshtër novator që një dhjetëvjeçar të tërë kishte punuar për ndërtimin e një serie makinerish krejtësisht origjinale për riparimin e të gjitha llojeve të kushinetave e sidomos të atyre të automjeve të rënda të dhëmbëzuara të bujqësisë. Mjeshtri ishte një burrë thatim dhe me një ftyrë të stërgjatë me një shprehje të habitur e me ca sy të vegjël të futur thellë në ballin me rrudha. Mbante në dorë një valixhe druri të ghendur me ca rrathë të dhëmbëzuar. Kur iu afroa Rrezartit, i qeshi ftyra që njoju njërin nga kampistët. Përhëndeti me kokë dhe me njëfarë druajtjeje ngaqë nuk e njihte Meritën. Ai eci më tutje drejt dritares së hapur në verandën e një shtëpie elbasançe ku administratori shpërndante çelësat e dhomave.

Rrezarti paraqiti fletët e kampit dhe dy letërnjoftimet, të tijen e të Meritës. Administratori, si i shqyrtoi dokumentet e tyre me kujdes, ngriti sytë e tij të mëdhenj dhe me një buzëqeshje të fshehur dinake tha:

— Vila nr. 13, fare në buzë të detit, fshehur midis drunjve do të jetë çerdhja e lumturisë suaj!

— Të falem nderit! — u përgjigj Rrezarti e mori nga ai çelësin.

Meritë, e turpëruar nga humori pa kripë i administratorit, ktheu kokën kinse po vështron te diku nga gjiri i detit.

Ditët rrëshqisnin në shtëpinë e pushimit njëra më e bukur e më e lumtur se tjetra. Faqja e malit me gryka e përrenj që goditej nga erërat e vakëta të jugut, çdo mëngjes dukej sikur i ndërronte ato nuancat e ngjyrave. Ata çdo mëngjes futeshin në det dhe notonin pranë e pranë njëri-tjetrit duke lënë shkumën e bardhë nga prapa. Para tyre shtrihej një ishull i madh dhe anash tij një tjetër më i vogël. Kur hidhnin vështrimin brigjeve të Himarës dhe tutje Sarandës, natyra magjepëse e Rivierës ua mbush-të zemrat me një ndjenjë të nqrohtë e shumë të dashur.

— Sa i bukur, sa i madhërishëm është atdheu ynël — thoshte Rrezarti dhe shpesh shtonte: — Kushedi sa të

vjetër janë këta shkëmbinj. E di, Merita, se me anën e rrezeve mund të përcaktohet me saktësi mosha e tyre? Ndofta me të njëjtën mënyrë duhet bërë përllogaritja e disa formulave fizike për të zbuluar edhe vjetërsinë e atij pergameni të vjetër të shkruar në gjuhën ilire që sjell në laborator profesor Ervini. Merita e shikonte dhe i buzë-qeshte. Herë-herë ajo e pyeste për emrat e fshatrave dhe të maleve që ngriheshin në sfondin e Rivierës që vinte si një brez ngjyra-ngaçra buzë detit diku në lëndinë, diku përmes një lugine dhe diku përbë shkëmbinjtë e lartë që ngriheshin mbi thellësinë e detit nën këmbët e tyre si prej betoni natyral. Asaj i bënин përshtypje se çfarë pune të mundimshme e të zgjuar shekullore kishin bërë himariotët duke shpënë dheun edhe në foletë ndërmjet shkëmbinjve. Kudo lulëzonin limonat, mandarinat, portokallet, ullinjtë, pjergullat e rrushit, fiftë e palmat. Edhe në shkëmb lulëzontejeta e shqiptarit. Tarracat që shkallëzonin faqet e maleve dhe që zbrisnin d'eri buzë detit i shembëllënës si amfiteatrot e qytetërimit të lashtë të atyre anëve.

Ata rrinin në rërë tek ishulli i tyre i vockël (që ditën e dytë Rrezarti e emëroi ishulli «Merita») derisa dielli ngjitej në zenit dhe rrezet e tij të përvëlonin. Pastaj binin në det dhe ktheheshin në breg. Visheshin dhe shkoni pér të ngrënë drekën në mensë. Merita e përgjysmon-te pjatën e saj me makarona duke ia afruar Rrezit, kurse ai në heshtje, duke e kuptuar qëllimin e saj, hiqte nga pjata e tij një copë rostoje e ndonjëherë një copë ramsteku dhe ia vinte përpara, ndërsa krem karamelin Rrezarti ia jepte vazhdimisht Meritës. Atij i pëlqenin tava e kosit me mish qengji dhe bifteku i kripur me vezë përsipër që e gatuanin zakonisht të shtunave pér drekë.

*
* *

Një ditë Rrezarti dhe Merita e morën mëngjesin nga mensa e shtëpisë së pushimit të thatë. Në çantën e saj, amvisa kishte edhe ca ushqime të konservuara që i ki-

shin blerë në dyqanin mikë të shtëpisë së pushimit. Kurse Rezarti në çantën e tij kishte marrë edhe katër shishe birrë të zezë. Ende një pjesë e mirë e punonjësve flinin ose qëndronin nëpër vilat e dhomat e tyre. Me të rintjtë kishin nisur të luanin volejboll e ca të tjerë pingpong.

Ata, burrë e grua, nisën t'i ngjiteshin fshatit me shtëpi të bardha në grykën e maleve të veshura me lloj-lloj drurësh. Ngandonjëherë kthenin kokën prapa dhe vështronin sipërfaqen e sheshtë të detit me njolla të gjelbra, blu, manushaqe dhe me xixa të ndritshme nga shigjetat e rrezeve të diellit që tani binin mbi dallgët e vockla me një kënd të pjerrët thuajse dyzetepesëgradësh. Punëtoret e punëtoret e fermës, të shpërndara plantacioneve të agrumeve e të ullishtave, kishin nisur punën. Ngjyrat e rrobave të tyre dukeshin në sfondin e faunës së krahinës si të piktuvara nga dorë e ndonjë mjeshtri të madh.

Merita qëndronte herë pas here dhe thoshte:

— Oh, sa panoramë e mrekullueshme! Sa të bukur e kemi atdheun!

Pastaj vazhdonte ngjitjen pa e ndier lodhjen. Rezarti herë-herë i afrohej dhe ia shtrëngonte krahun me dashuri dhe, kur rruga ishte e gjerë, ecnin të dy ngjitur e ngjitur.

Befas, në të dalë të pyllit me lisa, panë përpara Kështjellën e Kastriotëve. Aty Gjergji i dytë erdhë për herën e fundit dhe me himariotët trima e bujarë luftoi heroinë kisht kundër reparteve të mercenarëve anadollakë që turrexin si të tërbuar për të vendosur edhe në Evropë flamurin mesjetar të sulltanit që ta ndalonin lëvizjen e Rilindjes në Kontinentin Evropian.

— Pëllëmbë e histori është ky vendi ynë! — tha Merita që atëkohë hoqi sytë nga rrënojat e kështjellës dhe po vështronë poshtë bregut të detit rrënojat e një qytetit të lashtë me kolona e statuja të qytetërimit para erës sonë.

Nën një lis të madh, ndanë një sheshoreje të blertë, shtruan mbi tokën e njomë nga vesa një copë mushama, vendosën ushqimet përpara dhe nisën të hanin mëngjësin.

— Po vjen drejt nesh një njeri! — tha Merita duke ndjekur ecjen e një burri të lartë që dredhonte lisat. Në dorë mbante një sëpatë dhe në sup një pushkë të gjatë. Kur doli në rrugicën drejt tyre, ajo vuri re se i panjohuri me atë shtat të lartë si të kreshnikëve kishte në kokë një kapele me strehë me simbolin e punëtorit të pyjeve. Uniforma e tij dukej e vjetruar dhe ngjyra e gjelbër e stofit kishte nisur të zbardhej vende-vende.

— Qenka pojak pyjesh! — belbëzoi Rrezarti duke mos ia shqitur shikimin njeriut që po afrohej drejt tyre me ca hapa të gjatë duke tundur supet e gjera. — Do ta pyes për fshatin e xha Sadikut, se këtu afër diku e ka, — tha pastaj Rrezarti. — Më la porosi ta kërkoj. Do të vinte edhe ai me leje. I ka mbetur merak ajo puna e gurrevë që të kam thënë...

— Ju bëftë mirë! — tha i panjohuri, duke qëndruar para tyre me një vështrim hetues.

— Bujrum! — ia ktheu Rrezarti nga vendi me një buzëqeshje të lehtë.

— Paski dalë piknik? Mirë keni bërë. Jeni të shtëpi-së së pushimit, ju, apo jo? — tha rojtari i pyjeve me një zë të trashë prej baritonit.

— Po, po, — u pëgjigj Rrezarti dhe u ngrit në këmbë. I panjohuri qeshi dhe, si zgjati dorën e trashë e të ashpër për të përshëndetur Rrezartin e Meritën, tha:

— Mirë se erdhët!

— Mirë se ju gjetëm!

— Sipas zakonit u dola miqve përrpara, — tha rojtar i pyjeve, mos ju bezdisa?

— Jo, ç'është ajo! Ne, përkundrazi, donim të takonim ndonjë vendas, se kemi një mikun tonë që ka ardhur për pushime këtu në një fshat afër dhe duam t'i bëjmë një vizitë.

— Mos e quajnë Sadik atë mikun tuaj?

— Xha Sadik, po. Po ju si e kuptuat?

— E po e kuptova, që thoni ju, se edhe ai më pyeti për një çift të ri, andaj... Po të njihemi njëherë, se e bëmë si ata që tregohen në përralla... Më quajnë Thanas Zikori, — tha fshatari që qëndronte në krah të vajzës.

- Rrezart Deti, — u paraqit djali.
- Kurse mua më quajnë Merita Deti, — u përgjigj ajo, duke e marrë me mend se çfarë bluante fshatari.
- Por fshatarët më thérresin Ukl — tha rojtari. — Po atë Sadikun tuaj unë e kam kushëri, që thoni ju. E, kështu... Sa për emrat i kemi të përzier. Kur ia prenë kërthizën, një daja i tij ia vuri emrin Pali, por i ati e regjistroi në gjendjen civile Sadik se nuk i rronin djemtë... Po Sadiku ka disa ditë që po ju pret... Si thoni, do të vini, më u takuam?
- Do të vijmë, do të vijmë patjetërl — foli për të dy Merita.

* * *

- Ecim në këmbë apo presim autobusin? — pyeti po jaku, pasi hëngrën e u çlodhën. — Për një çerek ore vjen autobusi. Ja ku është rruga, nën këmbë e kemi...
- Jo, jo, nuk do të presim autobusin. Do të ecim në këmbë! — tha Rrezarti dhe vështroi të shoqen.
- Edhe unë ashtu them, të ecim në këmbë! Qenka rrugë e mrekullueshme, përmes portokalleve dhe ullinjeve, — tha ajo. Ecën një copë herë të madhe. Merita u skuq si lulëkuqe. Rrezarti i mori leje rojtarit, hoqi këmishën dhe qëndroi me kanotiere. Mbi shpatullat e tij muskuloze i shkëlqente djersa. Si kapërcyen një kodër, hynë përsëri në një pyll lisash, pastaj kaluan një përrua dhe u ngjitën në një kodër tjetër. Atje Thanasi ndaloj.
- Ja ku është dhe shtëpia imel — tha ai duke treguar me dorë një kullë dykatëshe me gurë të gdhendur dhe me dy ballkone. Dritaret ishin të mëdha e me xama. Ai kishte qëndruar i kthyer skic nga mysafirët me një pamje krenare për shtëpinë e tij, që dallonte nga ato ngjitur të tipit elbasançë.
- E paske lënë një frëngji për nishan si të atyre kullave të vjetra, — tha Rrezarti duke kthyer sytë nga po jaku.

— Me tē vërtetë ti qenke dreqi vetë, — tha Thanasi që atë çast çoi dorën te mustaqet. — Ku ta zuri syri atë frén-gji? Atë e kam kujtim nga kulla e vjetër e tē parëve. Brenda e kam moderne, do ta shikosh! — shtoi ai.

— Epo... Urdhéroni! — shtoi ai duke treguar me dorë shkallët prej guri që çonin në dhomën e miqve.

— Epo mirë se ju gjetëm! — ia ktheu Rrezarti dhe i zgjati dorën tē zotit tē shtëpisë.

— Mirë se erdhët! — u përgjigj Thanasi dhe u priu përpara. Merita ecte pas Rrezartit. Qëndroi një çast në verandë duke hedhur vështrimin krahinës së gjelbëruar me burime tē ftohta e vija uji që rridhnin tatëpjetë në përrënj tē betonuar. *Sipërfaqja e detit shëmbëllente* si një pas-qyrë e shtruar nën këmbët e maleve. Dhoma e miqve ishte e shtruar me qilima dhe shilte përreth oxhakut. Në mes kishte një tryezë tē mbuluar me një mbulesë. Karriget ishin me mbështetëse tē larta e tē gdhendura me motive popullore. Merita nxori kokën në dritare dhe menjëherë i zuri syri një varg antenash televizorësh mbi pullazet e shtëpive. Pas pak erdhën në dhomën e miqve e shoqja e Thanasit, një grua shtatlartë dhe e qeshur. Prapa saj me tabaka në dorë një vajzë e shëndetshme me ca gërshtetë tē ngritur si kurorë me një buzëqeshje tē ëmbël e tē ngrohtë sikur priste kushérinjtë e saj. Ajo u serviri Merités dhe Rrezartit mjaltë me hoje, arra tē qëruara dhe dy gota uji tē ftohtë e tē kulluar. E zonja e shtëpisë zuri tē pyeste Rrezartin për gjendjen e tij familjare dhe pastaj iu kthye Merités dhe si me çengel ia nxori se ajo sapo ishte martuar. Pas ca minutash si hëngrën mjaltin me hoje, arrat e qëruara dhe pinë ujët e ftohtë, ia behu në dhomën e miqve xha Sadiku me një kusi me hoje mjalti dhe një shishe raki në dorën tjetër. Me atë erdhën edhe dy nipërit e Thanasit dhe një vëllai i tij që dy vjet më parë kishte ndërtuar shtëpi më vete aty ngjitur kullës së vjetër. Xha Sadiku nisi tē qeshte e tē gëzohej si fëmijë kur pa në kullë fizikanin e ri me tē shoqen. Ai la mënjanë kusinë dhe shishen e rakisë dhe filloj tē pjershëndetëj me mall me my-safirët.

— Ej, ja, ky është Rrezart Deti, ai shkencëtar i rrezeve

të padukshmel – qeshi xha Sadiku. – Kurse kjo shoqja Merita është bashkëshortja e mikut tim.

– Eee... xha Sadiku e zmadhon. Jam një fizikan i ri dhe asgjë tjetër.

Dielli ishte ngjitur në zenit. Shigjetat prej rrezesh të ndritshme e të ngrrohta binin mbi tokë e det pa ndërprerje. Të zotët e shtëpisë shtruan drekën. Tryeza u mbush me pjata, mish pule të pjekur me pilaf, byrek me qumësh, turshi me patëllxhanë, mëlçi të skuqura, djathë me kajmak, pjata me mjaltë. Mysafirëve iu krijuar një ambient aq i ngrrohtë dhe miqësor, sa e ndienin veten si në shtëpi të tyre.

KAPITULLI XIX

E ëma e Rrezartit gjatë kohës që i biri me nusen e reishin në shtëpinë e pushimit, u transferua në apartamenti e ri në hyrjen nr. 2 pallati 32, katër i 4-t, rruga «Mujo Ulqinaku». Ajo, me kursimet që kishin bërë Rrezarti dhe Merita dhe me një shtojcë që tërhoqi nga kursimet e veta përgatiti banesën pothuajse me oriendi e pajisje krejtësisht të reja. Televizorin e vuri në dhomën e pritjes nënjë të ndarë të bufesë së re.

Rezarti dhe Merita ato ditët e para të kthimit në qytet ruarin ende kujtimet e bukura të kohës së pushimeve bregdet. Por me të filluar nga puna shkencore në laborator, nga takimet me punonjësit shkencor të disa qendrave të prodhimit dhe me docentë e pedagogë të katedrës së fizikës, Rezarti u zhyt përsëri në vorbullën e jetës së punës shkencore.

Në fillimin e javës së parë mori një detyrë për t'u nisur me një shok të qendrës llogaritëse elektronike në kombinatin metalurgjik. Atje, te furrnalta e dytë, shokët e tij të eksperimenteve me gjurmues radioaktivë kishin

ditë që përfunduan vendosjen e instalimeve të dedektorëve dhe të aparatit të regjistrimit të rrezatimit gama. Kurse për furrën e parë shtrohej çështja e zgjidhjes së një problemi teknologjik. Njëri nga inxhinierët e prodhimit të furrnaltës ngulte këmbë se veshja e brendshme refrektare e furrës duhej të ishte holluar si letër cigareje dhe nga çasti në çast mund të ndodhë shpimi i saj dhe lava e zjarrtë, po të derdhej jashtë, bënte gjëmën.

Rezarti u kthye në shtëpi pas dy ditë qëndrimi në metalurgji. Merita telefonoi që do të vonohej edhe dy orë, pasi duhej të përfundonte vizatimet teknike të disa disenjave të dojzuara nga doktori i shkencave mekanike mbi konstruksionin e ri të një motori të automjetit shtatëtonësh me naftë. E ëma e Rezartit atë natë tha se do të shkonte mysafire te një kushërima e saj që jetonte në një qendër bujqësore, nja pesë kilometra larg qytetit. Fizikani i ri, si bëri një banjë me dush të nxeh të, hëngri ca gurabije me qumësh me kakao, u myll në studion e tij dhe u kroh në libra. Duhej të përgatitej sa më mirë për sesionin shkencor që do të zhvillohej të pasnesërmen. Nxirrte shënimë dhe hidhët ca formula në copa letrash të bardha. Ndezi një cigare. Dhe ajo që duhej të përvetësohej më mirë ishte demonstrimi i të dhënave teknike dhe shkencore për ndërtimin e reaktorit bërthamor në vend. Për këto probleme dhe shokët e tjerë u mbështetën në referatet që kishin bërë disa vjet më parë një grup pune i kryesuar nga profesor Buroni. Gjithashtu ai duhej të paraqiste edhe ca metoda për shfrytëzimin e lëndëve radioaktive në disa degë të ekonomisë. Për këtë lypsej të bënte argumentime si për dobinë e tyre shkencore ashtu edhe për efikasitetin ekonomik në ato fusha të prodhimit.

Merita hyri në shtëpi në majë të këpucëve. Ajo e dinte që i shoqi, kur niste studimin, kërkonte një qetësi të plotë dhe nuk i pëlqente fare të ndërpritej. U zhvesh në dhomën e saj të fjetjes dhe, siç e kishte zakon, bëri banjën, pastaj doli në kuzhinë. Në tryezë gjeti një copë pusullë: «E dashur Merita, kam ngrënë darkë. Kur të kthehesh në shtëpi, po të duash, më bëj një kafe dhe asgjë

tjetër. Sonte do të studioj deri vonë, ashtu e kam punën. Ti e di, por edhe nuk e di plotësisht, se është shtuar ekzigenca për sesionin shkencor. Do të vijnë mjaft personalitete shkencore edhe nga Tirana. Yti, Rrezi.»

Ajo shpuri buzën në gaz dhe e la letrën në tryezë, aty ku e gjeti. Pastaj hëngri darkë, ca qofte me kos që i mori nga frigoriferi. I pëlqyen ashtu siç ishin, të ftohta. Me makinën ekspres që ia kishte sjellë si kujtim profesor Buroni i zjeu një kafe me pak sheqer, ashtu siç e donte i shoqi. Hapi derën e studjos dhe, duke shkelur në qilimin e butë me pantoflat prej cohe, iu afroa me tabaka në dorë me filxhanin e kafes që nxirrte avuj. Ia vuri përpara, aty mbi tavolinën e punës. Rrezarti ktheu kokën dhe e vështroi bashkëshorten në sytë e bukur.

— Të falem nderit..., — pëshpëriti ai. — Merita, do të më falësh sot, të lutem, s'e nuk të bëj dot shoqëri, — tha ai. — Kam, të paktën edhe nja tri orë punë.

— E po mirë, mos u shqetëso, — i tha ajo. — Unë po vete të lexoj në shtrat.

Rrezarti buzëqeshi. E dinte se së shoqes i pëlqente të shtrihej në dhomën e gjumit e të lexonte.

Pas nja tri orësh, si mbaroi punë, u ngrit e shkoi në dhomën e gjumit. Që nga dera e hapur hodhi sytë te shtrati. Mbi komodinë ndriste faqen e murit abazhuri i kthyer në anën e kundërt të gruas së re të shtrirë në krahun e djathtë, mbuluar me një jorgan atillas. Romani «Dashuria për jetën» me sa dukej i kishte rënë nga dora aty pranë në jastëk. Rrezarti u përkul mbi kokën e së shoqes dhe e mori romanin nga jastëku dhe e vendosi mbi komodinë. Shtypi butonin e abazhurit dhe me kujdes, që të mos e zgjonte, ngriti cepin e jorganit dhe rrëshqiti në dyshekun e ngrrohtë. Ai mendoi atë çast shprehjen e një kimisti që thoshte se dashuria e një çifti është edhe diçka shkencore që ka të bëjë me afinitetin kimik të valencave të elementeve të Mendelejevit dhe nga ajo buron edhe ndjenja e bota shpirtërore e dashurisë njerëzore. Rrezarti qeshi me vete në errësirë dhe, i joshur nga dora që i hodhi e shoqja në qafë, mbylli qepallat e syve. E ndjeu veten të lumtur.

* * *

Nën kolonat e mermerta të Pallatit të madh të Kulturës, Rrezarti hodhi sytë tek një grup njerëzish që po lexonin afishen e shkruar me shkronja dore të dukshme kursive: «Programi i ciklevës shkencore në fushën bërthamore: Temat. — 1. Mbi modelin e Bohrit për atomin e hidrogjenit 2) Bërthamat atomike, radioaktiviteti. Bashkëveprimi i rrezatimit me lëndën. 3) Dozimetria e rrezatimeve bërthamore. Aktiviteti i burimit radioaktiv. 4) Mbi kuantet e dritës dhe mundësitë e përdorimit të tyre në energjitetin industrie. 5) Kriza e fizikës klasike dhe teoria e relativitetit të Ajnshtajnit në përputhje të plotë me dialektikën materialiste. 6) Aktivizimi neutronik... «Sytë e Rrezartit qëndruan një çast më tepër te tema e katërt «Zbatime të izotopeve radioaktive në fusha të ndryshme të prodhimit. Metoda të atomeve të shënuara (gjurmuesit radioaktivë) Referon fizikani bërthamor Rrezart Deti. «Atij, ashtu papritur, iu drodh zemra. Ishin emocionet, por ai e mblođhi shpejt veten. Ishte i sigurt se teoritë në fushën shkencore bërthamore që i kishte studiuar me themel dhe një pjesë të tyre edhe i kishte eksperimentuar, do t'ua komunikonte të tjerëve lirshëm dhe thjesht. Atë çast tha me vete: «Vlera e botëkuptimit shkencor qëndron pikërisht në pasqyrimin e realitetit objektiv.»

— Ej, fizikani saldator! — i thirri nga pas një njeri që ia vuri dorën në sup.

Rrezarti ktheu kokën befas, si ta kishin zënë me lak. Për disa sekonda vështroi i habitur fytyrën e tjetrit.

— Ah... ti qenke! — pëshpëriti ai duke u shtirë sikur e njihte atë njeri. Mendja i shkoi tek ata shokët e tij të fabrikës, por po i vinte inat me veten që e kishin harruar këtë fytyrë. Nisi të dyshonte se mund të ishte ndonjë punëtor i ndonjë fabrike tjetër sepse i thirri ndryshe nga të tjerët që i thoshin «saldatori fizikan».

— Hë... hë, hiqesh se më njeh, por më paske harruar, o shkencëtar i pabesë!

— Prit, ore prit, se po më luan nga mendtë! — i tha Rrezarti dhe e zuri atë nga krahët duke e vështruar me kujdes në fytyrë. — Këtë zë e kam dëgjuar kushedi sa herë!

— He... he..., — i thoshte duke qeshur tjetri dhe tundte kokën.

Aty rrëth tyre ia behën usta Sala, inxhinieri teknolog i tullave, Artani, Merita dhe ajo shoqja e saj e fabrikës, Manushaqja.

— E ku ta njohësh, o Rrezart! la dogji fytyrën flaka shejtanit. Dhe i bënë një operacion plastik me lëkurën e pra..., — tha duke qeshur usta Sala. — Është saldatori Mete!

— E, për nder, e mendova nga zëri se duhej të ishte ai, por nuk ma thoshte goja, se me të vërtetë qenka ndryshuar krejtësisht, — tha Rrezarti me një ton që shprehte keqardhje. E puthi me dashuri vëllazërore.

— E mendova se nuk do të më njohësh! — qeshi saldatori Mete. — Nuk je i pari... Erdhëm të të dëgjojmë, o shkencëtar. Na bëhet zemra mal kur dëgjojmë e të shohim në televizor. U bëre i famshëm.

— Akoma nuk i paske lënë shakatë, o Mete!

— Hajt, hajt! — i tha atë çast laboranti fizikan që i kishte shtënë krahun asistente Sofijes. — Edhe ti ke meritat e tua!

Rrezarti i zgjati dorën Sofijes dhe me një buzëqeshje të ciltër i tha:

— Mora vesh për martesën tuaj dhe u gjëzova shumë! Ju uroj nga zemra lumturi e bardhësi!

Merita u shkëput nga Rrezarti dhe e përgëzoi asistenten duke e puthur në faqe. Sofija nuk i kishte më flokët kurorë dhe as qepallat tëngrira. Sytë e saj bojë qielli dhe tërë pamja e saj e ndryshuar dukej sikur ishte çliruar nga ajo tërheqje e lëkurës nën ndikimin e pomadave të përbërjeve me zhivë e vajra eterike.

Njerëzit e ftuar në sesionin shkencor nisën të vinin dy e nga dy dhe aty — këtu edhe grupe-grupe. Rrezarti në mes të shokëve të tij të fabrikës, hyri në sallonin e

pallatit duke përshëndetur sa majtas-djathtas disa nga vizitorët që e njihnin. E shoja e ndiente veten të lumtur.

Dëgjuesit e sesionit shkencor qëndruan edhe disa caste para derës së madhe me xham të auditorit ku zhvillohen sesionet shkencore.

Aty mënjanë, në një tryezë të gjatë xhami, librashitësja e re truphollë me një fytyrë të lëmuar a shumë tërheqëse, u shiste vizitorëve disa nga botimet e fundit të sesioneve shkencore që ishin bërë në fushat e ndryshme të shkencave shoqërore dhe në ato teknike. Përveç veprave me temë nga Lufta Nacionaçlirimtare, binin në sy ca broshura mbi shkencat e rezistencës së materialeve, mbi ndërtimin e hidrocentraleve dhe të kimisë sintetike nga naftha e gazi metan natyral. Një vend të rëndësishëm zinin edhe botimet shkencore në fushën e bjuqësisë e të blegtorisë shqiptare. Mjaft nga vizitorët interesoheshin për botimet e fundit në fushën e linguistikës dhe të albanologjisë. Në raftin e xhamit në mur, në hyrje të sallës ishin ekspozuar disa nga romanet, vëllimet me tregime e poezi, dramat e libretet e operave të autorëve shqiptarë më në zë.

Njerëzit takoheshin e shkëmbenin biseda me njëri-tjetrin.

Drejtori i organizatës projektuese të portit të ri, një nga inxhinierët me përvojë të ndërtimit, një djalosh i gjatë, me një fytyrë të tërhequr e me flokë të thinjur, pasi u takua me Meritën, i tha:

— Mos ma merrni për kompliment! — dhe buzëqeshi.

— Më vjen mirë që ky fizikan i ri, me pasion e talent, pas ka zgjedhur një grua të bukur e fisnike.

— Oh, mos e tepronil! — u hodh Merita me fytyrën që i mori atë çast një ngjyrë si shegë e kuqe.

— Dëgjo këtu! — ia ktheu me vrull ai. — Një grua e mirë e ngre burrin e saj dhe një grua e keqe e shkatërron.

— Dhe, anasjelltas! — qeshi Merita. Deshi të shtonte edhe diçka, por Rrezarti bëri shenjë që të shkonte pas tij.

— Shokë e shoqe! — thirri xha Sadiku, roja e laboratorit bërthamor që kishte ardhur aty dhe bënte detyrën e portierit. — Kush ka ftesë, le të hyjë!

Portieri babaxhan ia bëri me shenjë Rrezartit. Fizikani i ri ktheu kokën majtas. Sa shumë u gëzua kur pa mbështetur në murin e mermertë pojakun himariot! Ai, i veshur me një uniformë të re të rojtarit të pyllit, qëndronte pakëz i druajtur me një bohçe në dorë duke vështruar shkencëtarët dhe njerëzit që hynin brenda në hollin e pallatit.

Rrezarti bëri ca hapa drejt tij dhe i zgjati dorën.

— Sa mirë që paskeni ardhur! Do t'i bëhet zemra mal edhe Meritës kur të na vish në shtëpi!

— Erdha të dëgjoj! — ia ktheu pojaku buzagaz pa ia lëshuar dorën, — bile të kam sjellë nga ata gurët që lëshojnë rreze! I gjeta më në fund!

Pojaku qeshte dhe, duke ia tundur dorën përzemërsisht, tregonte me sy bohçen me gurë që i varej në krahë.

— Pas sessionit shkencor do të vemi bashkë pér drekë në shtëpinë time!

— Shohim e bëjmë, — tha pojaku.

— Kështu të them! — i mëshoi zërit Rrezarti në të ikur.

— Merri gurët me vete.

Në hyrje të auditorit, fizikani i ri u përplas me një djalosh që ia zuri rrugën si pa dashje.

— Më fal! — qeshi Rrezarti.

— Hapi sytë, o shok! — ia ktheu tjetri.

— Oh... kush qenka! Violinisti virtuoz.

— Ngadalë-ngadalë, mos m'i rrit veshët! — tha Arti.

— E mora vesh se do të japësh koncert me pjesë origjinale të tuat. Do të vijmë me Meritën patjetër në koncertin tënd!

Rrezarti u nda nga shoku i vjetër i fabrikës që merrej me muzikë dhe bëri përpara. Biku dhe e fejuara e tij, Manushaqja, që po kalonin përtetë kolonës veshur me mermer me damarë të kuq, e përshëndetën duke tundur duart në ajër me një pamje të gëzuar.

Auditori i përngjante një amfiteatri modern, por në formën e arkitekturës kishte diçka me të vërtetë kombëtare. Përreth mureve ishin vendosur ca basorelieve të gdhendura në dru me motive popullore me një shije artistike të hollë. Në vende të dukshme ishin varur portretet

e dijetarëve të shqar shqiptarë: Sami Frashëri, Hoxha Tasimi, Atë Gjeçovi, portreti imagjinar i arkitekt Sinanit dhe i disa figurave të tjera të traditës shkencore e kulturore shqiptare.

Salla ishte mbushur plot e përplot me dëgjues të moshave të reja dhe midis tyre dalloheshin edhe mjaft shkençtarë, docentë, doktorë të shkencave teknike, pedagogë të Universitetit dhe një grup punonjësish shkencorë e profesorë nga Kosova.

Sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit diç fliste aty në radhët e para me sekretarin shkencor të Akademisë së Shkencave. Sytë e Rezartit midis gjithë atyre dëgjuesve dalluan edhe kolegët e tij fizikanë të IFB dhe të disa laboratoreve bërthamore të ngritura nëpër qendrat e mëdha të prodhimit. Merita kishte ngritur pakëz kokën mbi atë të usta Salës dhe vështronë përreth. Në rreshthin e tretë, ku ishin ulur Sofija, e cila ishte pranë të shoqit, fare në cep, në një karrige si të veçuar, Rezarti vuri re profesor Kotin. Ai kishte një pamje të mjegulluar dhe dukej si i humbur në mendimet e tij. Ishte tretur çuditërisht dhe me supet e mbledhura kruspull dukej sikur nuk ishte aty, por diku jashtë atij ambienti që ziente nga bisedat e mendimet shkencore që shkëmbenin me zë të ulët. Rezarti qëndronte në këmbë, mbështetur te kolona në cep të auditorit me çantën në dorë, i kthyer nga dëgjuesit, duke pritur çastin që të ngjitej në tribunë. Në ballin e podiumit të auditorit varej tabela e zezë dhe pak më tutje një kuadrat i bardhë prej bezeje. Ky ishte vendi ku projektoheshin filmat.

Profesor Koti ngriti me ngathtësi sytë e turbullt dhe vështroi ish-studentin e tij. Duke parë me ngulm njëri-tjetrin, e të dukej sikur shkëmbenin këtë dialog:

«E gjetët rrugën e shkencës, po i ngjiteni atij mali të thepisur. Por dijeni se një ditë do të gremiseni në humnerën e saj!»

«Jo, kurrë nuk vjen për mua dhe për shokët e mi ai çast që të na mërzitetjeta dhe që lëvizja përpëra të na duket pa kuptim, ashtu si të ka ndodhur ty!»

Në shkallët e katedrës së auditorit ia behu profesor Buron Gurra që tanimë njihej në tërë vendin si një nga fi-

zikanët teoricienë e praktikë nga më të mirët. Ai kishte fituar popullaritet edhe ndër rrethet e inxhinerëve e specialistëve të prodhimit për përkrahjen që u jepte eksperimenteve të përdorimit të metodave bërthamore në dobi të prodhimit dhe të përsosjes së teknologjisë. Profesori me një hap të ngadalshëm me një çantë të zezë prej lëkure nën sqetull doli në tryezën e gjatë ballore dhe vuri syzet. Pastaj nga çanta nxori një dosje dhe e vuri përpara. Diç lexoi dhe me qetësi ngriti sytë nga dëgjuesit dhe tha me një zë të ulët, pak si të ngjirur:

— Sot zhvillojmë temën e fundit të ciklit në fushën e fizikës bërthamore. Bisedën do ta mbajë fizikani Rrezart Deti! — dhe i bëri shenjë me dorë Rrezartit që të ngjitej në tryezën e katedrës. Rrezarti kaloi radhën e parë të auditorit nën vështrimin e të gjithëve. Eci fare lirshëm, hipi lart në podium, pastaj u kthye nga auditori dhe me një vështrim të çiltër tha:

— Nisim nga puna, shoqe dhe shokë! — Atë çast ndeshi vështrimin e një ekonomisteje të re, që ishte ulur në mesin e rreshtit të parë dhe që mbante në prehër një dosje njyrë bizeleje. Ai e dinte që ajo do të referonte mbi efikasitetin ekonomik të përdorimit të metodave bërthamore në disa degë të ekonomisë. As ai nuk e kuptoi përsë Rrezarti vazhdoi: — Pas çdo shpjegimi pres pyetje dhe vërejtje. Debatet dhe kritikat e lira dhe konstruktive, me baza shkencore e të argumentuara, janë premisa që e çojnë gjithnjë përpara revolucionin tonë tekniko-shkencor si pjesë përbërëse e revolucionit të përgjithshëm socialist. — Ai mbajti pak fryshtë. Fjalët e fundit dolën lirshëm e natyrshëm. E kuptoi se ato bënë përshtypje në auditor nga heshtja që pllakosi. Por kjo gjendje nuk vazhdoi gjatë. U dëgjuan pëshpëritje nga radhët e fundit dhe ai e mori me mend se ata që pëshpërisnin duhej të ishin shokët e tij të fabrikës. U buzëqeshi.

— Atëherë më lejoni të vazhdoj, — ngriti zërin fizikani Rrezart Deti, pamja e të cilët impononte respekt në auditor.

— Si përfusat e tjera të shkencave shoqërore e teknike, vendimet e Kongresit të Partisë shtrojnë edhe përpara

shkencës së fizikës bërthamore një varg detyrrash me karakter praktik aktual dhe perspektiv. Për zgjidhjen e vënien e këtyre metodave shkencore në dobi të prodhimit, është vendimtare, në radhë të parë, zhvillimi i mendimit shkencor jo vetëm të një grushti fizikanësh, por të gjithë intellejencies e masave punonjëse të qendrave të prodhimit. Pa një bashkëpunim e renditje të forcave, nuk çahet përrpara. Kjo është e lidhur pa dyshim edhe me krijimin e bazës tekniko-materiale të ngritur me forcat tona.

Pastaj ai foli gjerë e gjatë se ku mund të shtriheshin metodat bërthamore në fushat e ndryshme të teknikës, të bujqësisë, të mjekësisë e në fusha të tjera.

Në ekranin e bardhë, sipas shenjës që bënte Rrezarti, projektoheshin fazat më të rëndësishme të eksperimenteve në praktikën e prodhimit.

Profesor Buron Gurra e ndiqte bisedën e fizikanit Rrezart Deti me fytyrën që i ndriste nga gjëzimi. Ai kënaqej pa masë me logjikën e shëndoshë të ish-studentit të vet. Një nga dëgjuesit që u ngrit nga rreshti i parë, i solli atë çast profesor Buronit një copë letër të palosur që ia dërgonte sekretari shkencor i Akademisë.

Rrezarti e vështroi me bisht të syrit profesor Buronin dhe mendoi me vete se mos ndoshta e kishte zgjatur ligjëratën e tij, prandaj vendosi të fliste më shkurt për temën e fundit, mbi mundësitet e shtrirjes së mëtejshme të metodave bërthamore në aspektet e ndryshme të ekonomisë. Kur zuri të paraqiste argumentet mbi dobinë shkencore dhe ekonomike të ndërtimit, reaktorit me forcat tona, Rrezarti pa se drejt tij po vinte profesor Buron Gurra. Me buzëqeshjen ngazëllyesë ai la në tryezë mbi dosjen pusullën.

Rrezarti, pasi u dha fund shënimive në tabelën e zezë, vajti para tryezës. Aty lexoi këtë shënim. «Profesor Buron Gurra! Bashkëpunëtori juaj, fizikani Rrezart Deti, mund të flasë lirisht në këtë auditor se Komisioni i Planit të Shtetit ka akorduar investimet përkatëse për ndërtimin e reaktorit bërthamor për qëllime shkencore dhe të mbrojtjes së vendit. Bile i thoni se edhe ai është caktuar anëtar i grupit të punës për ngritjen e këtij reaktori.» Rrezarti ndjeu diçka

të paprovuar deri atëherë. Besimi që kishin në personin e tij si shkencëtar bërthamor organet e larta të Akademisë së Shkencave e bëri të ndiente emocione të forta. Ngriti sytë nga auditori dhe befas kapi vështrimin e dashur e të qeshur të Meritës që diç donte t'i thoshte nga vendi. Ai vijoi:

— Punonjësit shkencorë në fushën bërthamore tanë i kanë përvetësuar «të fshehtat» e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të reaktorit bërthamor. Ai do të ndërtohet së shpejti në vendin tonë dhe kështu fizikanët do të kenë në duart e tyre edhe një bazë të fuqishme teknike për ta çuar përpresa edhe këtë shkencë të re në dobi të prodhimit.

Në auditor, papritmas, shpërthyen ovacione. Kjo ishte si përshëndetje e parë për kurorzinë me sukses të arriturve edhe në fushën e shkencave bërthamore.

Sapo në auditor u vendos përsëri heshtja dhe Rezartit po mblidhët letrat e shpérndara nëpër tryezë dhe po i fuste në dosje, befas u ngrit nga vendi i tij profesor Koti dhe tha me zërin e mekur dhe me fytyrën që i ishte nxirë dhe rrudhur si eshkë:

— Unë... — dhe një çast shtangu në vend. Iu duk sikur nuk i dilte zëri nga gryka.

Rezartit i mbetën letrat në dorë. Shtrydhte trurin për të kuptuar arsyet dhe shkaqet që e kishin shtyré profesor Kotin të vinte në sesion shkencor në atë gjendje të mjerueshme që ishte katandisur.

...Kolegë dhe miq! Unë brenda radhëve të shoqërisë socialiste kam qenë tërë jetën një mizantrop i fshehur në guaskën time larg jetës së gjallë të masave punonjëse dhe revolucionit... — Përsëri heshti.

Në auditor nuk pipëtinte as miza. Ata të rreshtave të sipërm zgjasnin kokat poshtë, kurse të tjerët përpresa vështronin plot habi nga ai. Një pjesë nuk e njihnin, por kishin fizikanë të laboratorit, pedagogë e asistentë të katedrës së Universitetit që e dinin pak a shumë punën e tij.

— ...Po, është e vërtetë se në ndërgjegjen dhe menjën time të mjegulluar... mirë e thashë, të mjegulluar, kanë bërë fole botëkuptimet e konceptet filozofike idea-

liste. Kotësia e teorizimeve të mia, konceptet e gabuara për aplikimet e metodave bërthamore në dobi të prodhimit dhe të zhvillimit të lëndëve mësimore në tekstet universitare kanë ndikuar deri në atë masë sa i kam lejuar vetes sime të hijem nga hundët edhe nga elementë armiq të rendit tonë socialist si ai... Ky jam unë, i dështuar, mizantrop dhe shpirtnushtë! Jam gati të pranoj çdo fajësi jo vetëm nga këshilli shkencor e pedagogjik, por edhe nga ligjet e shtetit!

Doli nga karrigia e tij dhe, si qëndroi një copë herë aty në mes të korridorit, kur pa se askush nga pjesëmarrësit në atë auditor nuk po i thoshte më asgjë, uli kokën poshtë dhe nisi të ekte zvarrë-zvarrë me gjymtyrët e rënda si plumb që mezi i tërhiqte nëpër parket. Kur po ngjitej shkallëve të amfiteatrit shkencor qëndroi një hop te dera dhe, pasi ktheu për herë të fundit kokën dhe vështroi si në mjegull portretin e fizikanit të ri, Rrezart Deti, hodhi këmbën përtëj pragut të auditorit, e hodhi sikur po rrullisej në greminë... Ai e dinte se kishte vrarë veten.

Heshtjen e theu profesor Buron Gurra. U ngrit në këmbë e tha:

— Pesëmbëdhjetë minuta pushim.

Pas pushimit u dha kumtesa e ekonomistes mbi efikasitetin ekonomik të përdorimit të metodave bërthamore, veçanërisht të atyre që demonstroi fizikani Rrezart Deti.

Ekonomistja e re, një grua me trup të bukur, me një buzëqeshje naivë që i endej gjithmonë në fytyrën e saj të lëmuar, me ca sy që i ndrisnin, foli shkurt dhe e përfundoi bisedën e saj duke cituar një citat të ekonomisë politike që shprehte qartë rolin e metodave shkencore në një ekonomi të planifikuar dhe të përparuar socialiste.

Merita i ftoi shokët e fabrikës në shtëpi për drekë. Me ata shkuan edhe xha Sadiku e Thanas Himarioti. Rrezarti tërë gjësim ia shtrëngonte krahun miqësishit pojakuat të pyjeve dhe diç i thoshte në vesh, ngaqë ai e kundërshtonte të shkonte pas tyre. Në stacion dukej sikur ishte ditë festë. Banda e qytetit ekzekutonte një marsh pune. Tingujt me nota të larta dhe plot optimizëm përhapeshin në hollin e stacionit. Një tren i gjatë qëndronte në linjë

gati për udhëtim, kurse një tjetër atë çast po hynte dalngadalë e duke bërë një zhurmë si turbinë hidrocentrali.

Një turmë të rinjsh, shumica e të cilëve ishin vajza nga shkollat e mesme dhe nga universiteti, shoqëronin bandën me këngën e tyre melodioze.

— E, kush vjen? — pyeti Thanasi një vajzë topokale buzë trotuarit që zgjatej nga rruga e hekurt për të vështuar trenin që tanimë kishte hyrë në stacion.

— Po kthehen kampionet e Europës..., — tha ajo pa i kthyer sytë nga Thanasi.

— Vajzat shqiptare fituan edhe sivjet në garat e qitjes, — i shpjegoi duke ecur Rrezarti.

— Më iu lumi dora dhe syri, — thirri Thanas Himarioti tërë shend e gaz.

Rrezarti dhe Merita, të rrethuar nga shokët e fabrikës, zunë vend në një nga kupetë e trenit të ri. Piskamat e bilbilave të konduktoreve lajmëruan nisjen e trenit.

Pas një ore rrugë ata zbritën në qytetin e tyre buzë detit. Atë kohë, ngaqë rrezet e diellit binin vertikalisht mbi sipërfaqen e detit, kaltërsia e tij ishte shndërruar në një tonacion të gjelbër që i shembëllente pyllit në pranverë.

Nga stacioni pallati ku banonte Rrezarti nuk ishte më tepër se njëqind metra. Derën e hapi e ëma. Ajo e shtrëngoi në gjirin e saj, ashtu siç bënte dikur, kur ai ishte fëmijë. Lotët që ia njomën sytë, i ndrisnin si margaritarë të vegjël, ata ishin lot gëzimesh. I biri i mallëngjer e puthi me dashuri t'ëmën. Edhe ajo kishte pjesën e saj në ato arritjet e tij të punës shkencore. Ai u shtang në pragun e dhomës së pristes, ku ndeshi befasisht me vështrimin e ëmbël të sekretarit të partisë të qytetit që ishte ulur në kanape së bashku me profesor Buronin.

— Ja, e shikon, ta mbajta fjalën. Të thashë që kur u diplomove se do të vija dhe erdhëm me shokun Buron, — tha sekretari i partisë me një ton të shtruar të veshur me ca nota optimiste që ngacmonin ndjenjat thellë në zemrën e tjetrit. Rrezartit, fizikanit të ri, iu bë zemra mal dhe në shpirt i zienin ndjenja të ngrohta, ndjenja besimi dhe shpresash për të ecur pa ndërprerje dhe i papërkulur drejt përparimit të shkencës socialiste shqiptare.

Më në fund Merita solli raki e meze.

— Do të ngremë një dolli për shkencëtarët shqiptarë,
— tha sekretari i partisë. — Gëzuar, shokë!

— Ta ngremë që ç'ke me të, — tha menjëherë usta
Sala. — Se shqiptari ia ka thënë gishtit edhe penës... Se
ka pasur mendje të mëdha kjo Shqipëri... Po punëtorin
shkencëtar vetëm kjo Parti e bëri...

— Po zanatin, o usta Sala? — e ngacmoi dikush.

— Edhe zanatin byzlyk floriri kjo e bëri. Të na rrojë,
vëllezër!

Fund

nam p. nos illi apud eum a m
evidenter dicitur quod illi p. t.
t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis
etiam dicitur quod illi p. t. etiam a nobis

Jasa, S.

Rrezja e padukshme. Roman. [Red.:
H. Petrela]. T., «Naim Frashëri», 1981.

244 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-31

J 34

Tirazhi 13.000 Kopje

Formati 78x109/32

Stazh: 2204-79

Kombinati Poligrafik Shtypshkronja e Re Tiranë, 1980